

VLERËSIMI I MARRËDHËNIES NDËRMJET RREZIKUT, KAPITALIT DHE EFIÇENCËS NË SEKTORIN BANKAR NË SHQIPËRI

Aida Mosko

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Financë, me profil Financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Anilda Bozdo

Numri i fjalëve: 58419

Tiranë, janar 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë e nënshkruara Aida Mosko deklaroj me përgjegjësi të plotë personale që punimi i paraqitur në kërkim të marrjes së gradës shkencore "Doktor" është plotësisht autentik. Çdo material i marrë nga burime të treta është referuar sipas rregullave. Ky studim nuk është përdorur më parë si tezë apo projekt kursi në këtë Universitet apo në Universitete të tjera.

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij punimi është të zgjerojë teknikën e përdorur nga autorë të ndryshëm në studimet empirike për të ekzaminuar lidhjen ndërmjet rrezikut, efijencës së kostos dhe kapitalizimit në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri për një periudhë 5-vjeçare, 2014-2018. Si propozuar nga këta autorë, në këtë punim jo vetëm që do të shohim përcaktuesit e efijencës së kostos por do të testohen njësjerë hipotezash në lidhje me marrëdhënien e ndërsjelltë midis efijencës së bankës, kapitalit, rrezikut dhe faktorëve të tjerë specifikë të bankave që lidhen me ta. Studimi i këtyre lidhjeve është i rëndësishëm sepse është indikator i sjelljeve prezente në drejtimin bankar dhe shërben si orientues për drejtimin dhe njëkohësisht për hartuesit e politikave për zhvillimin e sektorit bankar.

Objektivi i këtij punimi është që të sigurojë një kuadër për të studiuar lidhjen që ka vendimmarrja dhe qëndrimi ndaj rreziqeve me kapitalin dhe efijencën e bankave. Të përcaktojë ndikimin që kanë në këtë lidhje faktorët specifikë të bankës dhe ato makroekonomikë.

Për vlerësimin e efijencës teknike të kostos është përdorur funksioni translog i kostos. Meqë databaza jonë përmban të dhëna panel, gabimi i funksionit translog është i përbërë nga dy komponentë të cilët përfaqësojnë gabimin dhe efijencën. Vlerësimi është bërë në programin kompjuterik STATA dhe metoda e përdorur për vlerësim është ajo e përgjasisë maksimale. Analiza e marrëdhënies ndërmjet rrezikut, efijencës dhe kapitalit realizohet nëpërmjet një sistemi me tre ekuacione i cili vlerësohet me anën e modelit 3SLS. Në studim përdoret edhe testi i shkakësisë së Grangerit.

Rezultatet e punimit nxjerrin në pah lidhjen ndërmjet rrezikut dhe kapitalit dhe ndikimin që ka në to efijenca. Niveli i efijencës është shumë i rëndësishëm në lidhje me kapitalin dhe rrezikun. Nga ana tjetër edhe rregullimi i kapitalit dhe qëndrimi ndaj rrezikut kanë ndikimin e tyre në efijenca duke ndikuar në rritjen apo rënien e saj.

ABSTRACT

The purpose of this paper is to expand the technique used by different authors in empirical studies to examine the relationship between risk, cost efficiency and capitalization in second level banks in Albania for a five year period, 2014-2018. As proposed by these authors, in this paper we will not only see the determinants of cost efficiency but will test different hypothesis regarding the mutual relationship between

the bank's efficiency, capital, risk and other bank's specific factors related to them. The study of these relations is important because it is an indicator of current banking behaviors and serves as a guide for management and at the same time for policy makers for development of banking sector.

For the cost technical efficiency estimate the translog cost function is used. Since our database contains panel data, the translog function error is made up of two components that represent error and efficiency. The evaluation is done in the STATA computer program and the method used for the evaluation is that of the maximum likelihood. The analysis of the relationship between risk, efficiency and capital is realized through a three-equation system that is evaluated by the 3SLS model. The Granger test is also used in the study.

The results of the paper highlight the relation between risk and capital and the impact of efficiency on them. On one side, efficiency level is very important in terms of capital and risk. On the other side, the regulation of capital and the attitude towards risk have their impact on efficiency by affecting its growth or decline.

DEDIKIMI

Prindërve të mi

FALENDERIME

Dëshiroj të falenderoj udhëheqësen time shkencore Prof.Dr Anilda Bozdo që më krijoi mundësinë të punoj për këtë temë interesante dhe kontribuoi maksimalisht duke qenë gjithmonë e gatshme për të më ndihmuar.

U jam mirënjohese prindërve, familjes dhe miqve të mi për mbështetjen e vazhdueshme gjatë realizimit të këtij studimi.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI 1: HYRJE DHE NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	1
1.1 Zhvillimet në Sektorin Bankar në Shqipëri	1
1.1.1 Zhvillimet në mjedisin ekonomik dhe financiar.....	1
1.1.2 Tregjet financiare dhe sistemet e pagesave	2
1.1.3 Individët dhe bizneset	3
1.1.4 Veprimtaria e sistemit financiar	3
1.2 Identifikimi dhe diskutimi i problemit.....	7
1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	11
1.4 Metodologjia e punimit	17
1.5 Besueshmëria dhe vlefshmëria e studimit.....	20
1.6 Pyetjet bazë të kërkimit dhe hipotezat	21
1.7 Natyra dhe rëndësia e studimit.....	23
KAPITULLI 2: KUADRI TEORIK.....	26
2.1 Menaxhimi i rrezikut në institucionet bankare	27
2.1.1 Kategoritë e menaxhimit të rrezikut	29
2.1.2 Rreziqet kryesore të institucioneve bankare	31
2.1.2.1 Rreziku i tregut	31
2.1.2.2 Rreziku i Kredithënies.....	31
2.1.2.3 Rreziku i normave të Interesit dhe teknikat e menaxhimit të këtij rreziku	32
2.1.2.4 Rreziku i Likuiditetit.....	32
2.1.2.5 Rreziku operacional.....	33
2.1.2.6 Rreziku strategjik.....	33
2.1.3 Menaxhimi i integruar i rrezikut	34
2.1.4 Domosdoshmeria e rregulloreve për institucionet financiare	35
2.1.5 Marrëveshja e Baselit.....	38
2.1.5.1 Basel I 1988	38
2.1.5.2 Basel II në 2004	42
2.1.5.3 Basel III në 2010	44
2.2 Veçoritë e kapitalit bankar	45
2.2.1 Kategoritë e kapitalit bankar	48
2.2.1.1 Kapitali aktual.....	48
2.2.1.2 Kapitali rregullator – mjaftueshmëria e kapitalit	48
2.2.1.3 Kapitali ekonomik.....	51

2.2.1.4	Dallimi ndërmjet kapitalit rregulator dhe atij ekonomik	53
2.3	Kuptimi, modelet dhe teknikat e vlerësimit të efijencës	54
2.3.1	Kuadri teorik i efijencës	55
2.3.1.1	Efijenca teknike, alokative dhe e kostos	55
2.3.2	Teoria ekonomike dhe shkaqet e efijencës	58
2.3.2.1	Teoria konvencionale neoklasike e firmës	58
2.3.2.2	Teoritë menaxheriale të firmës.....	60
2.3.2.3	Teoritë e sjelljes	61
2.3.2.4	Teoria e efijencës X.....	62
2.3.3	Modelet dhe teknikat e vlerësimit të efijencës	63
2.3.3.1	Përkufizimi dhe modelet e vlerësimit të inputeve dhe outputeve bankare	66
2.3.4	Konkluzion.....	72
2.4	Rrjeta e sigurisë financiare.....	73
2.4.1	Sigurimi i depozitave: roli i saj në rrjetën e sigurisë	75
2.4.1.1	Avantazhet dhe disavantazhet e sistemit të sigurimit të depozitave	76
2.4.1.2	Tipet e sistemeve të sigurimit të depozitave	77
2.4.1.3	Sistemet e sigurimit të depozitave në botë	79
2.4.2	Sistemi i sigurimit të depozitave në Shqipëri	80
KAPITULLI 3: RISHIKIMI I LITERATURËS		83
3.1	Rregullimi i sektorit bankar dhe raportet me bazë kapitalin	91
3.2	Efijenca bankare dhe konceptet për matjen e saj.....	97
3.3	Përcaktuesit e huave me probleme	101
3.4	Marrëdhënia ndërmjet kapitalit, rregullimit të tij dhe rrezikut	103
3.4.1	Teorema e Modiglianit dhe Millerit	105
3.4.2	Rreziku moral për shkak të detyrimeve të kufizuara dhe sigurimit të depozitave 106	
3.4.3	Modelet e portofolit.....	110
3.4.4	Vlera e brendëshme, reputacioni dhe roli i konkurrencës	112
3.4.5	Sjellja e menaxherëve	114
3.4.6	Rikapitalizimi	116
3.4.7	Përmbledhje e literaturës teorike	118
3.5	Literatura empirike	119
3.5.1	Studime në lidhje me marrëdhënien ndërmjet rrezikut dhe kapitalit	120
3.5.2	Studime të bazuara në rrezikun moral për shkak të sigurimit të depozitave	124
3.5.3	Studime që tregojnë ndikimin e vlerës së brendëshme	126
3.5.4	Ndikimi që ka struktura e pronësisë	126

3.5.5	Studime në lidhje me rikapitalizimin.....	127
3.5.6	Studime të marrëdhënies ndërmjet marrjes së rrezikut, kapitalit dhe efijencës në vend të ndryshme	128
3.5.7	Përmbledhje e literaturës empirike	150
3.6	Hipotezat kryesore të marrëdhënies ndërmjet rrezikut, kapitalit dhe efijencës.....	153
3.6.1	Hipotezat e punimit.....	158
KAPITULLI 4: KAPITULLI IV METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT		161
4.1	Metoda e kufirit stohastik (SFA, Stochastic Frontier Approach).....	161
4.2	Teknika e shkakësisë së Greinxherit	164
4.3	Të dhënat dhe analiza përshkruese e variablave	165
4.3.1	Kredia, cilësia e protofolit të kredive dhe rreziku i kredisë.....	166
4.3.2	Ecuria e depozitave	170
4.3.3	Rreziku i likuiditetit	173
4.3.4	Rreziqet e tregut	175
4.3.5	Rezistenca e sektorit bankar	176
4.3.5.1	Rezultati financiar	176
4.3.5.2	Mjaftueshmëria e kapitalit.....	178
4.3.6	Rreziqet për stabilitetin financiar.....	180
4.3.7	Politika makroprudenciale	181
4.3.8	Përshkrimi i variablave dhe ekuacioneve që do të përdoren në studim	192
4.3.8.1	Modeli i vlerësimit të efijencës	192
4.3.8.2	Modeli i vlerësimit të marrëdhënies rrezik, kapital dhe efijencë.....	193
4.3.8.3	Treguesit për kapitalin dhe rrezikun	193
4.3.8.4	Tregues të tjerë	194
4.4	Analiza e rezultateve	200
4.4.1	Vlerësimi i efijencës me anë të modelit të kufirit stokastik	200
4.4.2	Vlerësimi i modelit 3SLS	202
4.4.3	Vlerësimi i modelit VAR.....	208
KAPITULLI 5: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME		214
5.1	KONKLUSIONE	214
5.2	Kufizimet dhe studime në të ardhmen	221
KAPITULLI 6: ANEKS.....		222
LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA.....		232

LISTA E TABELAVE

Tabela 1.1-1 Pesha e segmenteve.....	4
Tabela 1.1-2 Pesha e segmenteve të sistemit financiar/totali i aktiveve të sistemit financiar (në%).....	5
Tabela 1.1-3 Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive ndaj PBB.....	5
Tabela 1.1-4 Struktura e bilancit të bankave dhe ndryshimi vjetor, dhjetor 2018	6
Tabela 1.1-5 Treguesit kryesorë të shëndetit financiar të sektorit bankar.....	7
Tabela 3.4.14-1 Studime empirike për marrëdhënien midis kapitalit dhe rrezikut dhe efijencës	151
Tabela 4.3-1 Lista e bankave të nivelit të dytë të përfshira në studim	166
Tabela 4.3-2 Të dhëna mbi kategoritë kryesore të kredisë	167
Tabela 4.3-3 Pesha e tepicës së kredisë sipas klasave (në %).....	168
Tabela 4.3-4 Ecuria e depozitave sipas monedhës, subjektit dhe produktit.....	170
Tabela 4.3-5 Treguesit e kapitalit aksioner, dhjetor 2018	178
Tabela 4.3-6 Struktura e kapitalit aksioner sipas origjinës	180
Tabela 4.3-7 Përkufizimi i variablave	192
Tabela 4.3-8 Sistemi i ekuacioneve të modelit	193
Tabela 4.3-9 Përshkrimi i variablave që do të përdoren	197
Tabela 4.3-10 Ekuacionet e modelit empirik	197
Tabela 4.4-1 Tregues të efijencës.....	201
Tabela 4.4-2 Faktorët shpjegues në sistemin e ekuacioneve të modelit.....	202
Tabela 4.4-3 Ekuacioni i vlerësuar i efijencës.....	204
Tabela 4.4-4 Ekuacioni i vlerësuar i marrjes së rrezikut.....	205
Tabela 4.4-5 Ekuacioni i vlerësuar i kapitalit.....	207
Tabela 4.4-6 Modeli i vlerësuar VAR (1).....	209
Tabela 4.4-7 Testi i shkakësisë sipas Granger	210
Tabela 4.4-8 Modeli i vlerësuar VAR (1) me efekte të fiksuara kohore	211
Tabela 5.2-1 Aksionerët dhe pesha specifike e secilës bankë në sistemin bankar, dhjetor 2018	222
Tabela 5.2-2 Analizë strukturore e vendeve që aplikojnë sigurimin e depozitave	224
Tabela 5.2-3 Kronologjia e kuadrit ligjor të ASD	227

LISTA E DIAGRAMEVE

Figure 1 Kapitali ekonomik ndaj atij rregullator.....	54
Figura 2 Efienca teknike, alokative dhe e kostos.....	56
Figura 3 Treguesit e cilësisë së aktiveve.....	169
Figura 4 Kredi ndaj depozitave	171
Figura 5 Treguesit me bazë aktivet (në %)	174
Figura 6 Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit	175
Figura 7 Kthimi nga aktivet (ROA)	177
Figure 8 Kthimi nga kapitali (ROE).....	177
Figure 9 Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve	177
Figura 10 Treguesit me bazë kapitalin	179
Figura 11 Struktura e kapitalit në sistemin bankar sipas origjinës.....	180
Figura 12 Aktivitet sipas bankave 2014-2018 (në milion lekë)	182
Figura 13 Totali i aktiveve sektori bankar 2014-2018	183
Figura 14 Kosto totale e aktivitetit të bankave 2014-2018	183
Figura 15 Kosto totale e sektorit bankar 2014-2018.....	184
Figure 16 Çmimi i fondeve sipas bankave 2014-2018.....	184
Figure 17 Çmimi i fondeve të sektorit bankar 2014-2018	185
Figura 18 Shpenzime personeli sipas bankave 2014-2018	185
Figure 19 Ecuria e totalit të shpenzimeve për personelin 2014-2018	186
Figure 20 Çmimi i punës sipas bankave 2014-2018	186
Figure 21 Treguesi i çmimit të punës për sektorin bankar në vite	187
Figure 22 Çmimi i kapitalit sipas bankave 2014-2018.....	187
Figure 23 Çmimi i kapitalit 2014-2018.....	188
Figure 24 Kredia mesatare sipas bankave 2014-2018.....	189
Figure 25 Kredia mesatare për sistemin bankar 2014-2018.....	190
Figure 26 Aktive të tjera që sjellin të ardhura sipas bankave.....	191
Figure 27 Aktive të tjera që sjellin fitim (sektori bankar 2014-2018).....	191
Figure 28 Funkcionet impuls - reagim.....	212
Figure 6-1	229
Figure 6-2 Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto.....	229
Figure 6-3 ROE.....	230
Figure 6-4 Marzhi i interesit neto	230
Figure 6-5 Të ardhura neto nga interesi	230
Figure 6-6 Krahësimi i ecurisë së shpenzimeve dhe të ardhurave.....	231

KAPITULLI 1: HYRJE DHE NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1.1 Zhvillimet në Sektorin Bankar në Shqipëri

Bazuar në Deklaratën e datës 26.04.2019, të Bankës së Shqipërisë, në lidhje me Stabilitetin Financiar për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2018, rezulton se sektori bankar është një sektor i qëndrueshëm.

Ashtu sikurse edhe në periudhat e mëparshme, karakteristikë e këtij sektori është një ekspozim i kontrolluar ndaj rreziqeve. Gjithashtu ky sektor karakterizohet nga një performancë dhe rezistencë financiare me tregues të mirë. Rrjedhimisht mund të thuhet se sektori bankar në Shqipëri konsiderohet i fortë për të përballuar rreziqet e veprimtarisë së tij. Në mbështetje të këtij sektori kanë qënë zhvillimet ekonomike si edhe ato të tregjeve financiare në vend.

1.1.1 Zhvillimet në mjedisin ekonomik dhe financiar

Për të vendosur zhvillimet në Shqipëri në kuadrin e zhvillimeve globale përmendin disa nga veçoritë e këtij të fundit. Gjatë vitit 2018 vihet re një ngadalësim në rritjen e aktivitetit ekonomik botëror. Kjo është ndikuar nga një klimë tensionesh tregëtare ndërmjet vendeve të zhvilluara. Për këto vende, zhvillime të tilla ndikojnë kushtet financiare të tyre duke i bërë ato më të shtrënguara. Kjo situatë është e ndryshme nga ajo e vendeve në zhvillimin të cilat gjatë kësaj periudhe kanë treguar një larmi të madhe në kushtet e financimit. Përsa i përket prirjeve inflacioniste vihet re një ndrydhje e tyre në nivel botëror, gjë që ndikon në parashikime jo shumë optimiste për ritmet rritjen e ekonomisë dhe rënien e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare. Bankat qëndrore të vendeve të zhvilluara, mbështetur në këto analiza dhe pritshmëri për rritjen ekonomike, i kanë ulur pritshmëritë e tyre për normalizimin e politikës monetare. Tregjet botërore,

për shkak të pritjeve për zhvillimet ekonomike, tregojnë pasiguri për rrugën sesi do të zgjidhen faktorët ekonomikë dhe politikë që frenojnë këtë zhvillim. Në Ballkan, vihet re një përmirësim i treguesve të punësimit edhe pse në kushte të një ngadalësimi në rritjen ekonomike¹.

Në një paraqitje të shkurtër të situatës makroekonomike në Shqipëri, përmendim se norma vjetore e rritjes ekonomike për vitin 2018 ishte 4.1%. Konstatohet se sektorët që ndikuan në këtë rritje janë ai i prodhimit dhe i shërbimeve. Konsumi final i popullatës dhe investimet, kryesisht ato të sektorit privat, ndikuan në rritjen e kërkesës agregate. Në lidhje me treguesit e tregëtisë, bilanci i llogarisë korente edhe për këtë periudhë mbetet defiçitar. Ky defiçit u mbuluar nga tepricat që patën llogaritë e kapitalit dhe ajo financiare. Në lidhje me tregun e punës, rezultoi një rënie e normës së papunësisë, në fund të vitit 2018, në nivelin 12.3% ndërsa normën e inflacionit arriti 1.8%. Për sa i përket politikave monetare të ndjekura nga Banka e Shqipërisë ato konsiderohen lehtësuese dhe për të ndikuar në vlerën e lekut, për të frenuar mbivlerësimin e tij, ajo ka ndërhyrë në tregun e këmbimit valutor.

1.1.2 Tregjet financiare dhe sistemet e pagesave

Tregjet financiare konsiderohen nga një zhvillim normal i tyre. Në kushtet e një oferte për blerjen e titujve të borxhit të qeverisë më të lartë sesa kërkesa për huamarrje nga ana e saj, tregu i titujve të borxhit të qeverisë shënon për vitin 2018 një rënie të normave të interesit. Vëllimi mesatar i transaksioneve në tregun ndërbankar shënon rritje. Normat ditore të interesit kanë qenë pranë nivelit të normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë. Përsa i përket vlerësimit për lekun në krahasim me monedhat e tjera, ai u

¹ BANKA E SHQIPËRISË, Deklarata e Stabilitetit Financiar për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2018

mbiçmua ndaj euros dhe nënçmua ndaj dollarit. Sistemi i pagesave gjatë kësaj periudhe cilësohet se ka funksionuar në mënyrë optimale. Vlen të përmendet zgjerimi i përdorimit instrumentit të pagesave elektronike ndër instrumentat e tjerë.

1.1.3 Individët dhe bizneset

Rritja e shpejtë e depozitave në krahasim me rritjen e kredisë gjatë kësaj periudhe, është tregues i rritjes së nivelit kreditor të individëve dhe rënies së nivelit debitor të bizneseve. Individët janë treguar të tërhequr në lidhje me investimin e kursimeve të tyre në titujt e borxhit të qeverisë apo në pjesëmarrje në fonde investimi dhe kanë preferuar kursimin e tyre në formë depozitash. Nga ana tjetër, kredia për individë, ndikuar nga niveli i performancës së kredisë në lekë, tregon përmirësim të ecurisë dhe cilësisë së saj. Kjo duket tek ulja e kredive me probleme për individët. Në kuadër të analizës së financave të familjes, gjendjes financiare dhe huamarrjes, gati 3/4 e familjeve huamarrëse rezultojnë të kenë një nivel borxhi deri në 30% të nivelit të të ardhurave të tyre.

Për bizneset kredia shënoi rënie ndërkohë që cilësia e saj është vlerësuar e përmirësuar ndjeshëm. Raporti i kredive me probleme arriti nivelin 14.3%. Përsa i përket vendit që zë borxhi në gati 80% të bizneseve, vlerësimet tregojnë se ai është sa gjysma e vlerës së kapitalit dhe cilësohet i përballueshëm nga ana e tyre. Për pjesen më të madhe të bizneseve që kanë borxh, shërbimi i tij është sa 20% e të ardhurave. Pritshmëritë për të ardhmen afatshkurtër, në lidhje me kërkesën për kredi, nga ana e familjeve dhe bizneseve, janë të moderuara.

1.1.4 Veprimtaria e sistemit financiar

Raporti i aktiveve të sistemit financiar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), si në Tabela 1.1-1 Pesha e segmenteve, në fund të tremujorit të tretë, ishte 107.6% , gati 2.7

pikë përqindjeje më i ulët se në fund të 2017-ës. Pësja e sektorit bankar ishte sa rreth 96.8% e PBB-së gjë që tregon se struktura e sistemit bankar dominohet nga sektori bankar. Rënia e peshës së sistemit financiar ndaj PBB në 2018 në krahasim me 2017 vjen si rezultati i rritjes më të madhe të PBB në krahasim me rritjen e aktiveve të këtij sistemi.

Tabela 1.1-1 Pësja e segmenteve

Autoriteti licencues dhe mbikqyrës	Sistemi financiar	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Banka e Shqipërisë	Sistemi banar	88.1	92.1	94.8	97.6	97.3	100.5	99.4	96.8
	Institucione jobanka	2.7	2.7	2.7	3.0	2.9	3.0	3.1	3.3
	SHKK-të dhe unionet e tyre	0.8	0.8	0.7	0.8	0.8	0.6	0.6	0.6
Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.5	1.6	1.7	1.9	2.1	2.1	2.1	2.2
	Fonde pensioni	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	Fonde investimi		1.2	3.9	4.8	5.0	4.7	5.0	4.5
Ndërmjetësimi financiar		93.1	98.6	103.8	108.2	108.0	111.0	110.3	107.6

Burimi i të dhënave : Banka e Shqipërisë

Ecuria e aktiveve të sektorit bankar dhe jobankar konsiderohet e qëndrueshme. Sikurse shihet edhe nga Tabela 1.1-1 Pësja e segmenteve, sektori bankar edhe për vitin 2018 zë një vend të rëndësishëm në sistemin financiar në Shqipëri. Aktivët e këtij sektori, Tabela 1.1-2, zënë 90.2%² të totalit të aktiveve të sistemit financiar. Nga segmentet e tjera të sistemit financiar, me përjashtim të fondeve të investimit (nga 5% në 2017 në 4.7% të PBB në 2018), të gjithë segmentët e tjerë kanë shënuar rritje të aktivitetit të tyre. Në përgjithësi, treguesit e kapitalit, të cilësisë së aktiveve, të performancës dhe të përfitueshmërisë janë në nivele të mira³. Përsa i përket nivelit të kapitalizimit sektori bankar është karakterizuar nga rritja e tij. Treguesit e tjerë të shëndetit financiar, siç janë nivelet e përfitueshmërisë dhe treguesit e likuiditetit konsiderohen respektivisht të larta edhe të kënaqshëm (Tabela 1.1-5). Sektori bankar ka si burim kryesor të

² Banka e Shqipërisë; Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare

³ Banka e Shqipërisë, 2018

veprimtarisë së tij depozitat dhe fondet e veta. Përdorimi i burimeve e huaja të financimit mbetet i kufizuar.

Tabela 1.1-2 Pesha e segmenteve të sistemit financiar/totali i aktiveve të sistemit financiar (në%)

Autoriteti licencues dhe mbikqyrës	Sistemi financiar	2018
Banka e Shqipërisë	Sektori banar	90.2
	Institucione jobanka	2.9
	SHKK-të dhe unionet e tyre	0.6
Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	2.0
	Fonde pensioni	0.1
	Fonde investimi	4.2

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë

Pesha që zë sistemi bankar në ekonomi, e shprehur nëpërmjet raportit të totalit të aktiveve ndaj Produktit të Brendshëm Bruto, vijon edhe për vitin 2018, të qëndrojë në nivele të larta. Ky tregues është ulur me 3,15 p.p, duke arritur në nivelin 89,35%. Ndërkohë që edhe raporti i kredive ndaj Produktit të Brendshëm Bruto ka pësuar rënie, si pasojë e rritjes së PBB-së kundrejt rënies së portofolit të kredive.

Tabela 1.1-3 Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive ndaj PBB

Treguesit	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Totali i aktiveve (në mld leke)	886.30	990.60	1,120.20	1,187.98	1,234.32	1,293.72	1,318.13	1,407.29	1,445.33	1,452.93
Totali i aktiveve /PBB (në %)	77.50	81.00	86.10	89.61	91.13	91.56	91.33	95.05	92.50	89.35
Totali i kredive /PBB (në %)	39.30	40.10	40.00	43.58	41.88	42.12	40.61	40.55	38.46	35.71

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë;

Aktivet e sektorit bankar, duke vijuar rritjen e tyre (shih Tabela 1.1-2 Pesha e segmenteve të sistemit financiar/totali i aktiveve të sistemit financiar (në%), për vitin 2018 kanë shënuar rritje me 1.9%. Në këtë rritje ndikim më të madh ka pasur rritja e investimeve në tituj dhe rënia në fondin e provigjioneve për kreditë me probleme. Krahasuar me vitin 2017 (ritmi i rritjes së aktiveve në këtë të fundit ka qënë 2.7%) ky tregues ka një rënie prej 0.6%. Ritmi i rritjes së kredisë është ngadalësuar dhe kjo pasqyrohet nga një kontribut i vogël dhe negativ i zërit "Veprime me Klientë" (-3.3%).

Tabela 1.1-4 Struktura e bilancit të bankave dhe ndryshimi vjetor, dhjetor 2018

Aktivi	% e aktiveve	Ndryshimi vjetor, %	Pasivi	% e pasiveve	Ndryshimi vjetor, %
I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	32.6	-1.8	I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	5.5	3.8
II. Veprime me klientët (Kredia)	39.8	-3.3	II. Veprime me klientët (Depozita)	81.0	1.2
Nga e cila: për sektorin publik	1.9	-26.1	Nga të cilat: të sektorit publik	1.9	-0.7
Nga e cila: për sektorin privat	38	-1.8	Nga të cilat: të sektorit privat	79.4	1.3
III. Veprimet me letrat me vlerë	26.5	7.8	III. Veprimet me letrat me vlerë	0.5	-10.1
IV. Fonde rezervë të krijuara	-3.0	-25.3	IV. Detyrime të tjera	1.3	-3.4
V. Të tjera*	4.1	-9.3	V. Burimet e përhershme	11.8	-4.3
			Nga të cilat: Borxhi i varur	1.0	-36.9
			Nga të cilat: Kapitali aksioner	10.1	0.6
Totali i aktiveve	100	0.6	Totali i pasiveve	100	0.6

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë

Për shkak të mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut, vlerat në valutë dhe raporti i tyre, është ndikuar negativisht. Kjo për arsyen se në këtë periudhë totali i aktiveve në më shumë se gjysmëm e tyre (55%) përbëhej nga aktivet në valutë dhe ndërsa për detyrimet në valutë ky raport qëndron në nivelin 53% e totalit të aktiveve. Në anën e aktiveve, efekti pakësues i kursit të këmbimit pasyrohet më tepër në veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare (-23miliardë lekë)⁴; veprimet me klientët (-22miliardë lekë), kurse në anën e pasivit pasqyrohet në treguesin e depozitave në valutë (-42miliardë lekë). Në lidhje me kapitalin në valutë, ky efekt pakësues ka qenë më i ulët sesa në zërat e përmendur (-6miliardë lekë).

⁴ Banka e Shqipërisë, Raporti i Stabilitetit Financiar 6M2-2018

Tabela 1.1-5 Treguesit kryesorë të shëndetit financiar të sektorit bankar

në përqindje	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Treguesit me bazë kapitalin									
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	15.40	15.56	16.17	17.96	16.84	15.72	16.01	17.03	18.24
Kapitali nivelit të parë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	14.52	14.30	14.57	14.88	13.79	13.45	14.10	15.53	16.99
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	9.40	8.69	8.57	8.37	8.58	9.53	9.73	10.17	10.15
Cilësia e aktiveve									
Huate me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	35.95	52.01	55.62	40.22	38.25	24.28	23.08	15.72	15.51
Huate me probleme (bruto) ndaj huave totale	13.96	18.77	22.49	23.49	22.80	18.22	18.27	13.23	11.08
Përfitueshmëria									
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore)	7.58	0.76	3.78	6.43	10.53	13.16	7.15	15.71	12.96
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore)	0.72	0.07	0.33	0.54	0.89	1.20	0.69	1.54	1.32
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit									
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	5.03	3.94	3.98	4.08	8.49	7.66	7.03	6.68	7.78
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit të nivelit të parë	5.33	4.29	4.41	4.92	10.37	8.95	8.00	7.34	8.35
Treguesit me bazë aktivet									
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	25.95	26.53	29.37	27.64	31.94	32.26	31.29	30.22	34.23
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	30.62	33.15	36.71	34.71	40.36	41.43	40.57	40.79	46.21
Depozita të klienteve ndaj totalit të huave	166.39	163.20	171.62	180.83	180.16	187.78	192.84	194.00	203.25

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë

1.2 Identifikimi dhe diskutimi i problemit

Kontributi i sistemit financiar në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në plotësimin e nevojave të klientëve të tij, është i qenësishëm. Qëndrueshmëria e sistemit financiar, është kusht themelor që sistemi financiar të rrisë nivelin e tij të efikasitetit në procesin e ndërmjetësimit, duke kontribuar në orientimin e burimeve financiare drejt investimit në projekte produktive, brenda parametrave të njohur dhe të kontrolluar të rrezikut të veprimtarisë. Që të arrihet dhe të ruhet stabiliteti i sistemit financiar, nevojiten institucione financiare të shëndetshme të cilat veprojnë në një treg financiar me infrastrukturë të zhvilluar e të mbrojtur, ku ekzistojnë mekanizma të cilat nxisin administrimin efektiv të burimeve financiare dhe të rreziqeve nga ana e investitorëve.

Sistemi financiar në Shqipëri është një sistem i dominuar nga dhe identifikuar me sistemin bankar. Industria bankare është segmenti më i rëndësishëm i sistemit financiar në Shqipëri. Kjo dëshmohet nga vendi i madh që zënë aktivet bankare në totalin e aktiveve financiare (96.8% ndaj PBB në vitin 2018)⁵. Meqënëse sistemi financiar shqiptar është i orientuar në drejtim të sistemit bankar, ndaj këtij të fundit duhet të tregohet një vëmendje e vazhdueshme në lidhje me vlerësimin e efikasitetit. Financimi i sektorit privat gjen tek sistemi bankar burimet e financimit të aktivitetit të tij.

Shqipëria, si pasojë e zhvillimit shumë të dobët të tregjeve financiare dhe mungesës së burimeve alternative të financimit të ekonomisë, bën pjesë në grupin e vendeve ku mbi 95% e kreditimit të veprimtarisë dhe sektorëve të ndryshëm të ekonomisë vjen nga sektori bankar. Krahas investimeve publike dhe IHD-ve, sektori bankar mban peshën kryesore në financimin e ekonomisë, duke qenë një nga ndikuesit më të drejtpërdrejt në treguesin e rritjes ekonomike në Shqipëri. Nga pikëpamja teorike, është normale përafrimi i evolucionit të kërkesës për hua me evolucionin e PBB-së. A priori të dy këto flukse duhet të jenë të lidhura me njëri-tjetrin: rritja ekonomike shton nevojat për financime (investime, konsum), përmirëson aftësinë paguese të agjentëve ekonomikë, e për pasojë, rrit kërkesën për hua. Megjithatë, janë të shumta rastet kur kjo ligjësi shfaqet mjaft e devijuar, aq më tepër që studime të shumta të realizuara për këtë çështje tregojnë devijime thelbësore, për shkak të ndikimit të krizave ekonomike e financiare si edhe cikleve të zhvillimit të biznesit.

Modeli i biznesit që ndjek sistemi financiar në Shqipëri është ai tradicional me një strukturë financiare të bazuar në depozitat e klientëve, me një nivel të moderuar të levës financiare si edhe me ofrim të produkteve dhe shërbimeve në forma të tilla që qëndrojnë

⁵ Banka e Shqipërisë, Raporti i Stabilitetit Financiar, 6M2-2018

larg produkteve të ndërlikuara dhe të ndikuara nga lëvizjet në tregjet globale. Përveç kësaj ky model biznesi është shoqëruar vazhdimish nga rregullime dhe supervizim strikt i Bankës së Shqipërisë.

Pika fillestare e sistemit bankar aktual shqiptar është viti 1998, kur bankat e para private u bënë pjesë e saj. Në vitin 2018 ekzistojnë 14 banka që operojnë në Shqipëri, të cilat ofrojnë shërbime si: depozita, llogari, transferta, kredi, e-banking, etj. në një mjedis konkurrues. Shërbimet e ofruara nga bankat shqiptare janë të krahasueshme me ato të ofruara në vendet më të zhvilluara. Bankat në Shqipëri janë shembulli i paqyrimit të kulturës europiane në shërbime. Sistemi bankar ka arritur të sjellë në Shqipëri shërbimin perëndimor.

Duke analizuar të dhënat në lidhje me peshën e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite, për periudhën 2011-2018 është e dukshme rritja e totalit të aktiveve gjatë viteve 2011-2016, nga 88.1% në vitin 2011 në 100.5 në vitin 2016. Në vitin 2017 ka një rënie në nivelin 99.4% dhe vitin 2018 96.8% si rezultat i rritjes më të madhe të PBB-së në krahasimi me rritjen e aktiveve të sektorit bankar.

Gjatë dekadave të fundit, zhvillimet e vrullshme teknologjike kanë ndikuar sjelljen konsumatore të klientëve të shërbimeve bankare në Shqipëri. Në këtë kuadër, në mënyrë të veçantë pas vitit 2007, institucionet bankare në Shqipëri kanë studiuar metoda dhe produkte të reja për të qënë sa më pranë klientelës së tyre me shërbimet bankare të ofruara. Numri i bankave që kanë operuar në Shqipëri nga viti 2014 deri 2017 ka qënë 16 të tilla⁶, në vitin 2018 ky numër shkon në 14 pas përthithjes së bankës Veneto Banca nga Intesa Sanpaolo Bank në Itali dhe pasi ABI Bank bleu të gjithë paketën e aksioneve të NBG Bank - Shqipëri. Këto ndryshime shënojnë fillimin e një procesi konsolidimi në

⁶ Burimi Banka e Shqipërise

të gjithë sektorin bankar në Shqipëri. Ky është një proces sa i rëndësishëm aq edhe i veçantë për rregullatorin, tregun bankar dhe klientët të cilët gjatë 20 viteve të fundit ishin mësuar me rritje të numrit të bankave (deri në 16). Numri i bankave nuk është tregues i konkurrencës brenda sektorit bankar. Konkurrenca bankare ndodhen para çështjes të tilla si cilësia e shërbimit për klientët, vlera e shtuar për njësi të kostos, sa mund të përfitojnë bankat e mëdha nga ekonomitë e shkallës për rritur gamën e shërbimeve me çmime më të ulëta. Konkurrenca bankare ka të bëjë me çështje të tilla si sa efektive janë masat rregulatore nga autoritete përkatëse, për të dekurajuar sjellje të papërshtatshme anit-konkurrencë, sa e madhe është fuqia e tregut e bankave për të detyruar klientët që për shërbimet e ofruara prej tyre të kryejnë pagesa më të larta etj. Derregullimi dhe ndryshimet e teknologjike çojnë drejt zhvillimit të integritetit financiar dhe rritjes së konkurrencës në sektorin bankar. Procesi i derregullimit i ka dhënë një rëndësi të veçantë rolit të efikasitetit në këtë sektor, duke i detyruar bankat të veprojnë në kufirin efikas të prodhimit. Nga ana tjetër, rritja e konkurrencës ndikon në rrënimin e fuqisë së tregut të bankave, duke ndikuar në rrënimin e vlerës së tyre të brendshme. Kjo e fundit e ndikuar nga skema e sigurimit të depozitave mund të nxisë bankat drejt ndërmarrjes së më tepër rreziqeve⁷. Në përgjigje të këtyre sjelljeve autoritetet rregulatore i kanë dhënë një rol të rëndësishëm kapitalit rregullator në gjithë procesin e rregullimit.

Si rezultat i këtyre del në pah rëndësia që ka studimi i ndikimit që ka kapitali, efikasiteti dhe lloji i biznesit në rrezikun që ndërmarrin bankat. Për më tepër, kriza e fundit e

⁷ Fiordelisi dhe të tjerë, 2011

financiare nxorri në pah rëndësinë që ka analiza e përcaktuesve të rreziqeve në kushtet e rritjes së efijencës në bankë dhe uljes së kapitalit bankar⁸.

Sistemi financiar shqiptar, si përmendur edhe më lart, jo vetëm dominohet dhe identifikohet nga sektori bankar por në të njëjtën kohë ai luan një rol shumë të rëndësishëm për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit ekonomik. Kjo është arsyeja që ka sjellë sektorin bankar shqiptar në qendër të kërkimeve të ndryshme të mbështetura në literaturën teorike dhe empirike. Ndër të tjerash, ka kërkime që synojnë të shpjegojnë marrëdhëniet midis rrezikut dhe kapitalit si edhe nivelin e efijencës në bankat e sistemit bankar shqiptar. Tema e efijencës së bankës është studiuar ose për të gjithë sistemin bankar ose për bankat individuale që janë pjesë e saj. Raporti midis rrezikut dhe kapitalit është gjetur pozitiv dhe i njëkohshëm, ndërsa hulumtimet në analizat e efikasitetit të kostos tregojnë praninë e bankave joefikase në Shqipëri, por lidhja midis tyre dhe efijencës së kostos, në dijeninë time nuk është përcaktuar. Gjatë analizës së marrëdhënieve midis kapitalit dhe rrezikut, është shumë e rëndësishme të merret parasysh niveli i efijencës së bankës. Niveli i saj është shumë i rëndësishëm për të përcaktuar strukturën e kapitalit ashtu edhe rrezikun. Kjo lidhje qëndron edhe në kahun e kundërt, rregullimi i kapitalit dhe vendimarrja në lidhje me riskun ndikojnë në efijencën e bankës. Si rezultat i tyre efijenca mund të përmirësohet ose përkeqësohet.

1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi është të zgjerojë teknikën e përdorur nga Berger dhe De Young (1997) për të studiuar lidhjen ndërmjet rrezikut, efijencës së kostos dhe kapitalizimit në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri për një periudhë 5-vjeçare, 2014-2018. Si propozuar

⁸ Haldane dhe Alessandri, 2009

nga këta autorë, në këtë punim jo vetëm që do të shohim përcaktuesit e efijencë së kostos (siç mund të përmendim këtu cilësinë e aktiveve, huatë me probleme dhe rrezikun), por do të testohen njësrë hipotezash në lidhje me marrëdhënien e ndërsjelltë midis efijencës së bankës, kapitalizimit, huave me probleme. Shpjegimi i marrëdhënies ndërmjet këtyre variablave në kushtet e rritjes së huave me probleme sepse një rritje e huave me probleme do të thotë përkeqësim i cilësisë së aktiveve/portofolit të bankës dhe futje e bankës në një situatë të vështirë përta i përket aftësisë së saj pague. Testi i shkaktësisë së Greinxherit përdoret për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet këtyre variablave në bazë të të cilave mund të përcaktohen sjellje të ndryshme të drejtimit bankar. Studimi i këtyre sjelljeve është i rëndësishëm për drejtuesit e bankës dhe njëkohësisht për hartuesit e politikave për zhvillimin e bankës.

Në këtë punim së pari, synohet të studiohet ndikimi që ka efijenca në rrezikun bankar. Në kuadër të kësaj pritët që nivele të ulëta të efijencës të çojnë në rritje të performancës si rezultat i mos zbatimit korrekt të procedurave të monitorimit të kredive. Gjithashtu do të analizohet lidhja e kundërt ndërmjet rrezikut si shkaktar për ndryshime në nivelin e efijencës. Për ilustrim, rritja e rrezikut bankar mund të paraprijë një përkeqësimi në efijencën e kostos për shkak të një analize dhe monitorimi jo të plotë të kredive.

Së dyti, në këtë punim, synohet të studiohet ndikimi që ka kapitali bankar në marrëdhënien rrezik-efijencë. Kjo marrëdhënie mund të ndikohet nga niveli i kapitalit sidomos në rastin kur niveli i i përgjithshëm i kapitalit përkeqësohet në raport me huatë totale në nivel makroekonomik. Në këtë rast sjellim në vëmendje rrezikun moral. Për shkak të këtij rreziku, bankat jo të mirëkapitalizuara mund të priren drejt ndërmarrjes së më tepër rreziqeve të cilat do të rezultojnë në një nivel më të lartë të huave me probleme në të ardhmen. Bankat e mirëkapitalizuara, mund të shfaqin më pak probleme të lidhura

me rrezikun moral. Për shkak të kësaj, ato mund të jenë më të kujdesshme dhe më efikënte sesa bankat jo të mirëkapitalizuara. Por, nga ana tjetër, meqënëse kostoja e kapitalit është e lartë, bankat e mirëkapitalizuara mund të rrisin nivelin e rrezikut të ndërmarrë për të maksimizuar të ardhurat.

Objektivat e punimit

Ky punim fokusohet në përcaktimin e marrëdhënies së ndërsjelltë ndërmjet pozicionit të rrezikut, nivelit të kapitalizimit dhe efikëncës në sektorin bankar në Shqipëri për periudhën 2014-2018. Rreziku përfaqëson mundësinë për të dështuar si edhe njëkohësisht nëse i referohemi kthimeve mbi aktivet, ai nënkupton një paqëndrueshmëri të tyre. Faktorët që qëndrojnë pas një sjellje që ndërmer rrezik në lidhje me nivelin e kapitalit dhe nivelin e efikëncës janë studiuar në një numër studimesh kërkimore në Europë, përmendim këtu studime për vendet e Bashkimit European, vendet e Europës qëndrore dhe lindore si edhe në Amerikë. Në dijeninë time, nuk ka një studim të tillë në lidhje me sektorin bankar në Shqipëri për të studiuar dhe shpjeguar lidhjen e ndërsjelltë ndërmjet këtyre tre faktorëve.

Krahas kësaj në këtë punim do të përcaktohet ndikimi ekonomik që ka çdo sjellje menaxheriale për të orientuar rregullatorët dhe mbikqyrësit të ngrejne mekanizmat e duhur për monitorimin e raporteve të kapitalit dhe performancën e menaxherëve.

Objektivi i këtij punimi është që të sigurojë një kuadër për të studiuar lidhjen që ka vendimmarrja dhe qëndrimi ndaj rreziqeve me kapitalin dhe efikëncën e bankave. Të përcaktojë ndikimin që kanë në këtë lidhje faktorët specifikë të bankës dhe ato makroekonomikë.

Mbështetur në testin shkakësisë së Greinxherit i cili përcakton llojin e lidhjes së ndërsjelltë midis efijencës, kapitalizimin dhe huave me probleme në rastin e sektorit bankar në Shqipëri, mund të testohen katër lloje të ndryshme të sjelljeve të menaxhimit: hipoteza e menaxhimit të keq (efijencë e ulët e kostos shkakton rritje të kredive me probleme), hipoteza e kufizimit (efijencë e lartë e kostos shkakton rritje të kredive me probleme), hipotezën e fatit të keq (goditjet ekzogjene në nivelin e kredive me probleme shkaktojnë ndryshime në nivelet e efijencës së kostos) dhe hipotezën e rrezikut moral (bankat me nivel më të ulët të kapitalizimit janë më të prirura për të marrë më tepër rrezik).

Mbështetur në sa më sipër, një tjetër objektiv i këtij punimi është të përcaktohen drejtimet kryesore ku sektori bankar ka nevoja për përmirësime të vazhdueshme dhe të japim disa rekomandime modeste në lidhje me përmirësimet e mundshme që mund të bëhen në këtë fushë.

Krahas kësaj në këtë punim do të përcaktohet ndikimi ekonomik që ka çdo sjellje menaxheriale për të orientuar rregullatorët dhe mbikqyrësit të ngrejne mekanizmat e duhur për monitorimin e raporteve të kapitalit dhe performancën e menaxherëve.

Mbështetur tek literatura zgjedhja që bën firma në lidhje me ndërmarrjen e rrezikut dhe shpërndarjen e kapitalit ndikon vendimet e prodhimit dhe si rezultat i kësaj ndikohen kostot dhe rentabiliteti i saj. Njohja e kësaj marrëdhënie është themelore për vendimmarrësit dhe mekanizmat e këtij nënsistemi duhet të kuptohen plotësisht nga menaxherët për të përmirësuar performancën e firmës dhe për të parandaluar çdo sjellje të rrezikshme. Për këtë arsye një tjetër objekt i këtij punimi është të japë një qasje më të mirë për të kuptuar këtë ndërvartësi.

Përdorimi i teknikave tradicionale, jo të strukturuar, të tilla si ajo e analizës së raporteve financiare nëpërmjet së cilës përmbledhet performanca e bankës në tregues statistikor, janë mjaft të përhapura por pavërsisht thjeshtësisë së tyre janë kritikuar sepse nuk mund të kontrollojnë një miks produktesh dhe çmimesh të inputeve bankare. Analistët e bankave e matin efikasitetin duke u mbështetur në terma shpenzimesh si ato administrative, të aktiveve të qëndrueshme, personelit dhe shërbimeve, të cilat janë produkt i bankave. Por efikasiteti dhe kostot nuk janë e njëjta gjë. Uljet e shpenzimeve mund të dëmtojnë cilësinë e shërbimeve, cilësinë e portofolit dhe fitimet. Raportet e shpenzimeve mund të jenë keqinformuese në analizën e trendit nëse gama e produkteve ndryshon në kohë si edhe në analizën ndërsektoriale nëse krahasohen banka të cilat nuk kanë të njëjtën gamë produktesh.

Teknikat e strukturuar në lidhje me performancën e firmës përqendrohen në kufirin e efikasitetit, një koncept që fokusohet tek kurba e efikasitetit dhe devijimet nga kjo kurbë përfaqësojnë ineffikasitetin individual. Kufiri i efikasitetit mat se sa efikasitet është firma në krahasim me "praktikën më të mirë" në treg. Objektivi i këtij punimi është llogaritja e efikasitetit të kostos bazuar tek teknikat e kufirit të efikasitetit dhe konkretisht tek analiza e kufirit stokastik si propozuar nga Altunbas dhe të tjerë (1996).

Ndër objektivat e tjera specifike mund të përmendim:

- për të ekzaminuar këtë marrëdhënie të ndërsjelltë efikasiteti, kapitali, rreziku, e cila është themelore në menaxhim, jo vetëm për të gjithë sektorin bankar por edhe sipas grupbankave (G1, G2 apo G3)
- për të identifikuar ndër faktorët e brendshëm, variablat specifike të bankës, ato që kanë ndikimin më të madh në këtë marrëdhënie

- për të identifikuar ndër faktorët e jashtëm makroekonomikë ato që kanë ndikimin më të madh në këtë marrëdhënie

Arsyet e zgjedhjes së kësaj teme

Zgjedhja e kësaj teme u orientua kryesisht nga studimet dhe propozimet që janë bërë në lidhje me rëndësinë që ka përfshirja e efikasitetit në studimin e rregullimit të kapitalit dhe ndërmarrjes së rreziqeve nga ana e menaxherëve të bankave. Bankat në Shqipëri si kudo në botë kanë lëvizur nga modeli tradicional i biznesit. Ato janë të përfshira në aktivitete jashtë bilancit si një mjet për menaxhimin e rrezikut si edhe në aktivitete të tjera, ndryshe nga huata, që sigurojnë fitim, si rezultat i lëvizjes së tyre drejt një bankingu universal.

Bankat janë menaxhere të rrezikut dhe roli parësor i funksionit të menaxhimit të rrezikut është të sigurojë se rreziku total i ndërmarrë nuk është më i madh sesa mundësitë që ka banka për të absorbuar humbjet në rastin më të keq brenda disa intervaleve specifike.

Kapitali bankar, në mënyrë të përmblodhur, mund të thuhet se ka tre funksione. Së pari, ai është mbajtës i rrezikut sepse shërben si mbrojtës i huadhënësve dhe depozituesve; së dyti mbështetur në faktin që aksionerët janë ata që e ndiejnë të parët humbjen shërben për ta dhe menaxherët që punojnë në emër të tyre, një motiv për të mos ndërmarrë rreziqe të panevojshme. Ky është funksioni nxitës i kapitalit dhe së treti, kapitali jep siguri tek investitorët e huaj dhe përdoruesit e informacionit financiar në lidhje me shëndetin financiar të bankës. Mund të thuhet se kapitali është guri i themelit të fuqisë së bankës.

Megjithatë në teori ndikimi që ka rregullimi i kapitalit bankar tek ndërmarrja e rrezikut nuk është i qartë. Menaxherët ndodhen ndërmjet dy presioneve të ndryshme, të aksionerëve dhe rregullatorëve. Nga njëra anë, rregullimi i kapitalit nuk ndikon në

vendimmarrjen në lidhje me rrezikun sepse një detyrim i lartë për kapital do të thotë rënie e kthimit të investimeve e cila do të ulë vlerën e brendshme të bankës. Për të kompensuar këtë, menaxherëve të bankës u kërkohet të sigurojnë fitime më të larta gjë e cila mund të arrihet duke ndërmarrë rreziqe më të larta. Në anën tjetër rregullimi i kapitalit bankar mund të ndikojë në uljen e ndërmarrjes së rreziqeve sepse menaxherëve të bankës u kërkohen më tepër kapital nëse ata ndërmarrin më tepër rrezik. Në këtë mënyrë, çështja nëse raporte më të larta të kapitalit ulin ndërmarrjen e rrezikut mbetet e pazgjidhur. Në këtë debat ka dhënë një kontribut të madh Hughes dhe Mester (1998, 2009) të cilët argumentuar nevojën e përfshirjes së efikasitetit bankar në analizën e marrëdhënies ndërmjet kapitalit dhe rrezikut.

1.4 Metodologjia e punimit

Për të realizuar qëllimet dhe objektivat e renditura më lart, ky studim synon që të paraqesë një analizë të bazuar metodat ekonometrike të vlerësimit të efikasitetit dhe të lidhjes shkakësore ndërmjet rrezikut, kapitalit dhe efikasitetit si edhe variablave të tjerë specifike të bankës dhe atyre makroekonomike. Përmes studimit të literaturës në pjesën teorike, është krijuar një kuadër teorik për modelet, metodat dhe faktorët që do të përdoren në procesin e vlerësimit.

Mbështetur në këtë kuadër teorik, për të përmbushur objektivat dhe qëllimin e këtij kërkimi shkencor janë specifikuar teknikat dhe instrumentat që do të përbëjnë metodologjinë e kërkimit.

- Metoda e kërkimit

Në fushën e biznesit sipas Saunders dhe të tjerë, 2013, ekzistojnë dy lloj modele për kërkim. Modeli deduktiv, ai i zhvillimit të teorisë dhe hipotezave të ndjekura nga

kërkimi për testimin e tyre dhe ai induktiv i cili konsiston në gjetjen e të dhënave dhe zhvillimin e teorisë mbështetur në përfundimet e nxjerra nga analiza e të dhënave.

Modeli deduktiv i kërkimit ka për qëllim dhe teston teorinë. Ajo zakonisht fillon me një hipotezë dhe në përgjithësi theksi vendoset në analiza e shkakësisë ndërmjet variablave.

Ky model është më shumë i lidhur me kërkimin sasior. Ndërsa modeli induktiv ka të bëjë me gjenerimin e teorisë së re që del nga të dhënat, zakonisht përdor pyetje kërkimore për të ngushtuar qëllimin e studimit. Qëllimi zakonisht në studime sipas modeli induktiv, përqendrohet në zbulimin e fenomeneve të reja ose duke parë fenomenet e hulumtuara më parë nga një këndvështrim tjetër⁹.

Ky studim do të mbështetet në modelin deduktiv të kërkimit. Fillimisht bëhet një rishikim i literaturës teorike dhe empirike të mëparshme dhe më pas aplikohen rezultatet në rastin konkret. Mbështetur në studimet e mëparshme janë ngritur hipotezat dhe është ndërtuar një model empirik për të testuar marrëdhëniet midis faktorëve të marrë në studim dhe variablave të varur (sipas rastit rreziku, kapitali dhe eficienca).

Metodologjia e përdorur në këtë studim është në përputhje me objektivat kryesore të kërkimit. Studimi bazohet kryesisht në dhëna sasiore për secilën nga bankat e nivelit të dytë dhe mbi bazën e tyre është ndërtuar ekacioni për përcaktimin e efijencës së kostos dhe modeli ekonometrik për të matur lidhjen ndërmjet tyre të faktorëve të varur si edhe ndërmjet tyre dhe faktorëve të tjerë specifike të bankës dhe atyre makroekonomikë.

Për ndërtimin fillestar të modelit të këtij studimi kërkimor është kryer përmes një kërkimi të literaturës në dispozicion për të identifikuar fillimisht komponentët e saktë të modelit. Kërkimi i mëtejshëm i literaturës u krye për të gjetur faktorët e tjerë të cilat mund të ndikojnë potencialisht dhe në mënyrë të qartë.

⁹ Research Methods for Business Students By Mark Saunders, Philip Leëis, Adrian Thornhil

Kërkimi shkencor gjatë këtij studimi është konceptuar në tre hapa kryesore të cilat janë:

➤ **Hapi i parë - Studimi i literaturës**

Studimet në fushën e analizës së faktorëve të brendshëm e të jashtëm për të ndërtuar një model të vlerësimit të efikasitetit dhe të studimit të marrëdhënieve rrezik, kapital dhe efikasitet shumë. Studimi i një literature shumë të pasur në lidhje me këtë fenomen ka ndihmuar për të ndërtuar një kuadër shumë të qartë të faktorëve që janë marrë në studimin tonë.

➤ **Hapi i dytë - Mbledhja e të dhënave**

Burimi kryesor i të dhënave kanë qenë raportet vjetore nga secila bankë si edhe të dhënat e publikuara nga Shoqata e Bankave dhe nga Banka e Shqipërisë. I gjithë studimi është mbështetur në mbledhjen e këtyre të dhënave dytësore, të dhëna shumë të besueshme pasi janë të dhëna të audituara dhe të çertifikuara nga organet e pavaruara audituese.

Duke bërë një analizë empirike mbi një kampion prej 16 bankash gjatë periudhës 2014-2017 dhe 14 për vitin 2018 (sepse gjatë vitit 2018 dy nga 16 bankat, aktive deri në vitin 2017, u përthithën/blejnë nga dy të tjera prezente në sektorin bankar).

Mbledhja e këtyre të dhënave ka kaluar përmes një procesi të vazhdueshëm monitorimi dhe përpunimi që i është bërë të gjithë zërave të bilanceve të këtyre bankave. Duke qenë se pothuaj të gjithë variablat e marrë në studim janë të shprehura në formë raporti, ka qenë një proces jo shumë i lehtë e mjaft impenjativ mbledhja dhe më pas përpunimi i tyre në studimin tonë të bazuar pikërisht në këto të dhëna shumë të besueshme.

➤ **Hapi i tretë – Analiza e të dhënave**

Studimi është bazuar në analizën dhe përpunimin e të dhënave sasiore të përftuara nga burimet e cituara më lart. Në mënyrë që të analizohej informacioni nga pikëpamja sasiore, trajtimi dhe përpunimi i të dhënave dytësore u realizua me anë të programeve e specializuara statistikore, programit ekonometrik

Regresionet e shumëfishta përdoren kryesisht për të shqyrtuar marrëdhëniet e ndërsjellta midis variablave në lidhje me rëndësinë relative të variablave të pavarura dhe vlerave të parashikuara të variablave të varur (Saunders et al, 2003) në modelin e ndërtuar.

1.5 Besueshmëria dhe vlefshmëria e studimit

Besueshmëria i referohet qëndrueshmërisë dhe saktësisë së rezultateve të gjetura nga ky studim. Në kërkimin sasior, besueshmëria mund të ilustruhet si stabiliteti i matjeve përgjatë kohës, ngjashmëritë që mund të evidentohen përgjatë një periudhe të dhënë dhe gjithashtu shkallës së rezultateve të njëjta për matje të përsëritura.

Përkufizimi: Besueshmëria është konsistenca e matjes suaj, ose shkalla në të cilën një instrument mat në të njëjtën mënyrë çdo herë që përdoret nën të njëjtin kusht me të njëjtat lëndë. Shkurtimisht, është përsëritshmëria e matjes suaj. Një masë konsiderohet e besueshme nëse rezultati i një personi në të njëjtin test të dhënë dy herë është i ngjashëm. Është e rëndësishme të mbani mend se besueshmëria nuk matet, është vlerësuar. Ekzistojnë dy mënyra që besueshmëria zakonisht vlerësohet: provë / përsëritje dhe konsistencë e brendshme

Vlefshmëria i referohet saktësisë së matjes dhe sa të vërteta janë rezultatet e kërkimit¹⁰. Në këtë studim janë mbledhur një sërë informacionesh nga shumë artikuj dhe revista shkencore të kryera nga studiues dhe specialistë të ndryshëm të sektorit bankar. Përveç kësaj janë përdorur edhe të dhëna dhe informacione të gjeneruara nga raportet vjetore të vetë bankave të marra në studim si edhe të dhëna zyrtare të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Për më tepër të dhënat si për variablat e pavarur dhe ato të varur, janë marrë direkt nga raportet vjetore dhe pasqyrat financiare të bankave (te audituara nga

¹⁰ Nahid Golafshani (2003) Understanding Reliability and Validity in Qualitative Research, The Qualitative Report Volume 8 Number 4 PP. 597-607 <http://www.nova.edu/ssss/QR/QR8-4/golafshani.pdf> (6/6/2019)

organizma nderkombetare te pavarur) me qellim shmangien e gabimeve te mundshme ne perlllogaritje. Megjithate jo te gjitha te dhënat janë disponibël direkt nga raportet vjetore te bankave, por kerkojne disa perlllogaritje shtese ne forme raportesh.

1.6 Pyetjet bazë të kërkimit dhe hipotezat

PYETJET

Mbështetur në literaturën e cila shpjegon lidhjen ndërmjet nivelit të rrezikut, të kapitalit dhe efijencës, ngrihen pyetjet si më poshtë:

1. Cila është lidhje ndërmjet efijencës dhe nivelit të rrezikut
2. Çfarë ndikimi ka rreziku tek efijenca e kostos
3. Çfarë lidhje egziston ndërmjet nivelit të kapitalit dhe nivelit të rrezikut që mbajnë bankat
4. A janë të predispozura bankat me nivel të ulët të efijencës të ndërmarrin me tepër rrezik
5. Marrëdhënie të ndryshme (pozitive apo negative) ndërmjet rrezikut, kapitalit dhe efijencës përcaktojnë qëndrime të ndryshme të manaxhimit. Cila/Cilat qëndrime të menaxhimit vërtetohet/vërtetohen si prezente në bankat e nivelit në Shqipëri
6. Cilat janë efektet ekonomike që sjell ndryshimi i njërit prej këtyre faktorëve tek faktorët e tjerë
7. Cilët janë faktorët e tjerë që ndikojnë më tepër në marrëdhënien e ndërsjelltë ndërmjet rrezikut, kapitalit dhe efijencës

HIPOTEZAT

A. Hipotezat në lidhje me marrëdhënien e ndërsjelltë ndërmjet kapitalit, rrezikut dhe efijencës

H1. Efiçenca është përcaktues i rëndësishëm në cilësinë e kapitalit dhe menaxhimin e rreziqeve.

H1.1 Efiçenca ka një marrëdhënie negative me kapitalin

H1.2 Efiçenca ka një marrëdhënie pozitive me rrezikun

H2. Cilesia e kapitali është përcaktues i rëndësishëm i efiçencës dhe menaxhimit të rrezikut

H 2.1 Kapitali ka marrëdhënie negative me efiçencën

H 2.2 Kapitali ka marrëdhënie pozitive me rrezikun

H3 Rreziku është përcaktues i rëndësishëm i efiçencës dhe cilesise se kapitalit

H3.1 Rreziku ka marrëdhënie pozitive me efiçencën

H3.2 Rreziku ka marrëdhënie pozitive me kapitalin

B Hipoteza në lidhje me menaxhimin të përcaktuara nga marrëdhënie të caktuara ndërmjet rrezikut, kapitalit dhe efiçencës

- ▶ a) *hipoteza e menaxhimit të keq*, rënia e efiçencës (menaxhim jo i mirë i portofolit) rritje e huave me probleme;
- ▶ b) *hipoteza e kufizimit* korelacion pozitiv ndërmjet efiçencës së kostos dhe huave me probleme
- ▶ c) *hipoteza e menaxhimit të keq*, faktorë të jashtëm ndikojnë rritjen e huave me probleme dhe në këto kushte në rënien e efiçencës sepse rriten kostot e monitorimit
- ▶ d) *hipoteza e rrezikut moral* menaxherët e bankave që nuk janë të mirë kapitalizuar janë pranues të rrezikut dhe kjo çon në rritje të rrezikut, domethënë në rritje të huave me probleme.

	Rrezik Y=NPL/L	Efiçencë Y=EFF	Kapital Y=E/A
Rrezik NPL/L		(-) fati i keq	
Efiçencë EFF	(-) menaxhim i keq (+) hip. e kufizimit.		
Kapital E/A	(-) rreziku moral		

1.7 Natyra dhe rëndësia e studimit

Bankat tregtare janë biznese që jo vetëm mbartin një rrezik të shumëfishtë por që janë edhe shumë komplekse në studim, për këtë arsye kërkojnë një vëmendje shumë të veçantë në studimin e elementëve financiare të tyre.

Mbështetur në literaturën teorike dhe atë empirike, analiza e niveleve të efiçencës së bankave vazhdon të jetë e rëndësishme të trajtohet si nga pikëpamja makroekonomike edhe ajo mikroekonomike. Çështja e efiçencës bankare, nga këndvështimi në nivel mikro, është vendimtare sidomos për ekonomitë në tranzicion të Evropës Lindore¹¹. Prioriteti i sektorit financiar në këto vende, duke pasur parasysh konkurrencën në rritje dhe praninë e fortë të bankave të huaja në këto vende, bëhet çështja e rritjes së performancës së sektorit bankar. Nga këndvështrimi në nivel makroekonomik, sektori bankar zë një vend të rëndësishëm në ndërmjetësimin financiar (në Shqipëri 96.8% në vitin 2018) dhe për këtë qëllim efiçencia e këtij sektori ndikon në kostot e

¹¹ Rossi dhe të tjerë (2005)

ndërmjetësimit financiar dhe në stabilitetin e përgjithshëm të tregjeve financiare. Përmirësimet në sektorin bankar të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore kanë një ndikim të rëndësishëm në shpërndarjen e burimeve financiare sepse ky sektor, duke pasur parasysh se në këto vende tregjet financiare nuk janë të zhvilluara, mbetet si burimi më i rëndësishëm i financimit të investimeve private (Caviglia et al., 2002). Rritja ekonomike është e lidhur ngushtë me zhvillimin e ndërmjetësve financiarë, në të cilët përfshihen bankat tregtare, bankat e investimeve, kompanitë e sigurimeve, bursa dhe fondet e investimeve. Në vendin tonë, sistemi financiar përbëhet nga ndërmjetës të tillë si: sektori bankar, institucione jobanka, shoqëritë kursim krediti dhe unionet e tyre, shoqëritë e sigurimit, fondet e pensionit dhe ato të investimeve. Sektori financiar i vendit tonë është ende i dobët dhe në disa prej ndërmjetësve financiarë të tij, në faza embrionale. Për vitin 2018, pesha e sektorit bankar ndaj PBB ishte 96.8%, pjesa tjetër ishte për të gjithë ndërmjetësit e tjerë të sistemit financiar. Tregu i kapitaleve dhe në veçanti bursa mungon. Ekziston një dallim në kulturën financiare midis vendeve anglosaksone dhe vendeve të tjera (përfshi këtu vendet e Europës Qendrore dhe Lindore). Të parat përdorin më shumë si alternativa financimi tregjet e kapitaleve, ndërsa të dytat, më shumë bankat.

Gjatë dekadave të fundit është përmirësuar ndjeshëm të kuptuarit e rëndësisë që kanë bankat tregtare në sektorin financiar dhe në ditët e sotme gjithnjë e më tepër po i kushtohet atyre një rëndësi shumë të madhe. Mjafton të themi se pjesëmarrësit e tregut kërkojnë shërbimet e këtyre institucioneve financiare për shkak të aftësisë së tyre për të siguruar njohuri të tregut, efikasitetin e transaksionit dhe aftësi të financimit. Natyra e biznesit bankar është shumë e ndjeshme, sepse më shumë se 85% e detyrimeve të tyre vijnë nga depozituesit (Saunders, Cornett, 2005). Bankat përdorin këto depozita për të

gjeneruar kredi për huamarrësit e tyre, e cila në fakt është një aktivitet për gjenerimin e të ardhurave për pjesën më të madhe të bankave ashtu sikurse ndodh edhe në bankat tregtare shqiptare.

Entet rregullatore e mbikëqyrëse, qeveria, bankat, bizneset duhet që në bashkëpunim ndërmjet tyre të synojnë rritjen e cilësisë së investimit të kursimeve dhe likuiditeteve në ekonomi, krijimin e lehtësive që mundësojnë rritjen e kreditimit të bizneseve si edhe uljen e kostos së financimit të ekonomisë për sektorin privat dhe borxhin publik.

Ky studim përveç rëndësisë që ka për kontributin modest në fushën akademike ka rëndësi edhe për arsyet e mëposhtme:

Rëndësia e këtij studimi, përveç asaj kërkimore në fushën akademike është edhe për arsyet e mëposhtme:

1. Vlerëson dhe teston marrëdhënien ndërmjet kapitalit, huave me probleme dhe efikasitet dhe ndikimin që kanë në to faktorë të brendshëm, specifikë të bankës dhe faktorët makroekonomikë
2. Teston dhe mat ndikimin që ka efikasiteti tek rreziku që ndërmarrin bankat
3. Teston efektin ekonomik që ka ndryshimi në rritjen e huave me probleme si rezultat i uljes së efikasitetit
4. Teston efektin ekonomik që ka ndryshimi në rritje të huave me probleme si rezultati i ndryshimit në rritje të efikasitetit të kostos
5. Teston efektin ekonomik që ka ndryshimi në rritje të huave me probleme si rezultat i ndryshimit (rënies) së kapitalizimit të bankës

Teston efektin ekonomik që ka ndryshimi në ulje të efikasitetit si rezultat i rritjes së huave me probleme nga goditje të ndryshme që mund të pësojë ekonomia e vendit.

KAPITULLI 2: KUADRI TEORIK

Industria bankare është segmenti më i rëndësishëm i sistemit financiar në Shqipëri. Për këtë arsye analiza financiare e tij kërkon një vëmendje të veçantë.

Kriza e fundit financiare e shkaktuar nga kriza e subprime mortgages në Shtetet e Bashkuara në 2007 dhe efektet e saj në tregjet financiare dhe pjesëmarrësit e industrisë financiare në gjithë botën kanë rezultuar në një krizë të menaxhimit të kapitalit në shumicën e institucioneve financiare e në mënyrë të veçantë në banka. Ajo ka vendosur në focus analizën e shkaqeve, pasojave dhe daljes prej saj sistemin e menaxhimit të rrezikut. Më konkretisht kriza nuk është rezultat i dështimit të procesit të menaxhimit të rrezikut në vetvete por është më tepër një dështim në aplikimin e procesit të menaxhimit të rrezikut.

Menaxhimi me efikasitet të rrezikut dhe është një çështje komplekse. Ai ndihmon në përcaktimin e prioritetëve, alokimin e burimeve, implementimin e proceseve dhe metodave të cilat reduktojnë rrezikun. Qëllimi primar i një institucioni financiar është rritja e kthimit për pronarët e saj. Por kjo tendencë e kthimit shoqërohet me të njëjtën tendencë, rritje të rrezikut.

Si përmendur nga Saunders and Eilon (2001), një tipar i përgjithshëm i bankave në mbarë botën është rritja e numrit të bankave në paaftësi paguese. Ngjarje të veçanta të zhvilluara kanë nxjerrë në pah dobësitë e Standarteve të Baselit. Mangësitë e Basel I çuan në ristrukturimin e saj dhe daljen e marrëveshjes Basel II. Rënia e fundit financiare nxorri në pahamjaftueshmërinë e Basel II i cili fokusohet te raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit. Bazuar tek kjo situatë u propozua Basel III dhe një udhëzues i ri u nxorr për aplikim nga ekonomitë e G20 nga 31 dhjetori 2011.

Jo vetëm kaq, po komitetet e BIS Bazelit kanë riparë amandamentet e ndryshme në lidhje me menaxhimin e rreziqeve dhe veçanërisht menaxhimin e rreziqeve financiare të bankave, të cilët dhe janë një nga rreziqet që kanë shkaktuar dhe thelluar krizën aktuale financiare të tregjeve. Ata kanë thelluar metodologjitë e përdorura jo vetëm për matjen e rreziqeve, por ajo që është më e rëndësishme për parashikimin e tyre, në mënyrë që të ndërhyhet në kohën e duhur dhe të merren masat për parandalimin apo minimizimin e tyre.

Materiali i prezantuar në këtë punim ka për qëllim të japë një kuadër teorik në lidhje me rreziqet me të cilat përballen institucionet financiare dhe efikasitetin në menaxhimin e tyre.

2.1 Menaxhimi i rrezikut në institucionet bankare

Në lidhje me konceptin e menaxhimit të rrezikut jepen disa përkufizime. Menaxhimi i rrezikut mund të konsiderohet si realizim i njësjerë aktivitetesh të cilat kanë si qëllim final minimizimin e efekteve negative të pasigurisë në lidhje me humbjet e mundshme (Schmidt and Roth, 1990). Nga një tjetër këndvështrim, (Redja 1998) ai mund të konsiderohet si një proces sistematik i cili lidhet së pari me identifikimin dhe vlerësimin e ekspozimit ndaj humbjeve me të cilat mund të përballë një biznes apo individ. Së dyti, ai ka të bëjë me përzgjedhjen dhe zbatimin e teknikave të duhura në lidhje me mbrojtjen ndaj këtij ekspozimi. Në mënyrë të përmbledhur, procesi i menaxhimit të rrezikut përfshin: identifikimin, matjen dhe menaxhimin e tij. Sipas Bessis (2010), pjesë e këtij procesi janë njësjerë mjete dhe modele të cilat do të përdoren për matjen dhe kontrollin e rrezikut.

Bazuar tek përkufizimet për rrezikun mund të përcaktohen objektivat e menaxhimit të tij: minimizimi i humbjeve nga kurset e këmbimit, mbrojtje ndaj luhatjeve në të ardhurat, ulje e paqëndrueshmërisë në fluksin e mjeteve monetare, rritje e fitimeve dhe

sigurimin e mbijetesës për biznesin (Fatemi and Glaum, 2000). Aktiviteti bankar duhet të realizohet në një ambient me risk të mirëmenaxhuar, me ndikim të reduktuar të pasigurisë dhe humbjeve të mundshme. Për të arritur në këtë ambient të brendshëm të ushtrimit të aktivitetit drejtuesit duhet të kenë një vlerësim korrekt të rrezikut për të drejtuar kapitalet në aktivitete me normën më të mirë risk/kthim. Atyre u duhen vlerësime në mënyrë që madhësia e humbjeve të mundshme të qendrojë brenda limiteve të lejuara nga rregulloret e brendëshme të këtyre institucioneve apo rregullatorëve të jashtëme.

Sipas Pyle (1997), menaxhimi i rrezikut është një proces i cili përmbush këto nevoja të drejtimit nëpërmjet identifikimit të rreziqeve kryesore, marrjen e masave për rrezikun operacional, përzgjedhjen se cili është rreziku që do të reduktohet, çfarë duhet të rritet dhe në çfarë mënyrë dhe ngritjen e procedurave për të monitoruar nivelin e rrezikut. Bessis (2010) thekson se qëllimi i menaxhimit të rrezikut është matja e rreziqeve për të bërë të mundur monitorimin dhe kontrollin e tyre. Në të njëjtën kohë këto informacione vendosen në shërbim të funksioneve të tjera të bankës të cilat janë të ndryshme nga funksioni i saj financiar. Konkretisht, përfshirja e menaxhimit të rrezikut në zbatimin e strategjisë së bankës siguron për të një pamje më të qartë për të ardhmen. Për rrjedhojë, ai ndihmon në përcaktimin e politikave të duhura për biznesin si edhe në zhvillimin e avantazheve konkurruese nëpërmjet përlllogaritjes së saktë të çmimeve dhe formulimit të strategjive të diferencimit të cilat bazohen tek profili i rrezikut të klientëve.

Bazuar tek Santomero (1995), menaxhimi bankar mbështetet në një radhë hapash që duhet të ndërmeren për zbatimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut. Normalisht ai përmban katër pjesë të cilat janë standardet dhe raportet, rregullat apo limit për çdo pozicion, udhëzimet për investime apo strategjitë, kontrata kompensime stimuluese.

Nëpërmjet tyre kryhet matja e ekspozimit, formulohen procedura për menaxhimin e ekspozimeve, kufizimi i pozicioneve individuale në nivele të pranueshme dhe mbështetja e vendim marrësve në menaxhimin e rrezikut në përputhje me qëllimet dhe objektivat e biznesit.

2.1.1 Kategoritë e menaxhimit të rrezikut

Merton (1989) cilëson se një nga tiparet kryesore të institucioneve financiare (përfshi edhe bankat) është bundle ing and unbundling of risks. Megjithatë, jo të gjitha rreziqet e qënësishme duhet të mbahen prej tyre; disa mund të transferohen ndërsa të tjerë mund të eliminohen. Duke u nisur nga ky këndvështrim është e nevojshme që rreziqet e qënësishme në aktivitetet dhe mjetet të ndahen në tre nëngrupe të veçanta në përputhje me natyrën e tyre. Kjo ndarjen bën të mundur hartimin e strategjive të duhura për zvogëlimin e rreziqeve. Oldfield and Santomero (1995) argumentojnë se nga perspektiva manaxheriale, rreziqet me të cilat përballen institucionet financiare mund të ndahen në tre kategori të veçanta.

- (i) rreziqe të cilat mund të eliminohen apo shmangen nëpërmjet praktikave të thjeshta të biznesit,
- (ii) rreziqe që mund të transferohen tek pjestarë të tjerë dhe
- (iii) rreziqe që mund të menaxhohen në nivel firme

Nëpërmjet eliminimit të rreziqeve apo mbajtjes së tyre në një sasi optimale, bëhet e mundur që të shpëtohet banka nga rreziqe të cilat nuk janë thelbësore për shërbimet që ajo ofron. Kjo kryhet duke ndërmarrë veprime të tilla si nënshkrimi i standardeve, diversifikimi, risigurimi si edhe kryerjes së investimeve të kujdesshme për të ulur shanset e humbjes për shkak të rrezikut josistematik duke eliminuar rreziqe që janë të panevojshme për arritjen e qëllimeve të biznesit. Eliminimi i disa prej tyre kryhet

nëpërmjet teknikave të transferimit të rreziqeve. Madje, për një pjesë të mirë të rreziqeve ekziston treg për transferimin e tyre. Rreziku I normës së interest mund të transferohet nëpërmjet përdorimit të kontratave SËAP dhe derivativëve të tjerë financiarë. Kushtet e huasë mund të modifikohen për të bërë të mundur përfitimin nga ndryshimet në kohëzgjatjen e tyre. Një tjetër veprim që ndikon në eliminimin, absorbimin e rrezikut është blerja ose shitja nga ana e bankës e pretendimeve financiare për të diversifikuar ose përqendruar rreziqet që vijnë nga shërbimet që u ofrohen klientëve. Në këtë kuadër, në përputhje me shkallën se sa është kuptuar nga tregu rreziku financiar i mjeteve që zotëron firma përcaktohet mundësia e shitjes së tyre me vlerë të drejtë. Kur institucioni ka një avantazh krahasues në menaxhimin e rreziqeve nuk ka arsye përse ai të mbahet e mos transferohet.

Ka dy grupe mjeteve ose aktiviteteve për të cilat rreziku duhet të mbahet, (amortizohet), në nivel banke. Së pari, grupi i mjeteve financiare ose aktiviteteve tek të cilat natyra e rrezikut që i shoqëron është kompleks dhe shumë I vështirë të mund të transferohet tek të tretët. Si të tilla mund të përmendim mjete për të cilat nuk ekziston, por edhe nëse po është shumë I dobët, tregu sekondar. Në këto raste shpenzimet dhe vështirësia në komunikim janë më të larta se përballimi me to. Përveç kësaj dhënia e informacionit për këta klientë mund jetë në avantazh të konkurentëve.

Grupi I dytë I mjeteve është ai për të cilat duhet të mbahet rreziku nga vetë banka. Nje pjesë e rreziqeve abosorbohen nga banka dhe si të tilla janë ato rreziqe që konsiderohen të rëndësishme për arritjen e qëllimit për të cilin ushtrojnë aktivitet. Në të tilla rreziqe hyn rreziku I kreditit të cilin e mbart banka në aktivitetet e saj të huadhënies. Rreziku I tregut gjithashtu është I pranishën në transaksione të shitjes së aktiveve të bankës në

tregje të caktuara. Në kushte të tilla rreziku mbahet dhe ajo çfarë është e rëndësishme për tu kryer është monitorimi dhe menaxhimi me eficiencë nga ana e njësisë.

2.1.2 Rreziqet kryesore të institucioneve bankare

Rreziqet me të cilat është i lidhur ofrimi i shërbimeve bankare ndryshon në varësi të tipit të shërbimit. Autorë të ndryshëm i grupojnë ato në mënyra të ndryshme në varësi të analizës që duan të kryejnë. Në mënyrë më të përmblodhur në to përfshihen:

2.1.2.1 Rreziku i tregut

Mund të përkufizohet si "Rrezik që lidhet me pasigurinë e fitimeve të portofolit tregëtar të një institucioni financiar, si rezultat i ndryshimeve në kushtet e tregut, si të çmimeve të një aktivi, të normave të interesit, të luhatshmërisë së tregut, si dhe të likuiditetit të tregut. Rrezikut i tregut mund të ndahet në rrezik të kapitalit, normës së interesit dhe rrezikut të monedhës. Rreziku i tregut është i lidhur ngushtësisht a) me normën e interesit, b) me kthyeshmërinë e kapitalit dhe c) me rrezikun e kursit të këmbimit.

Matja e rrezikut të tregut është e rëndësishme dhe kjo argumentohet nga të paktën pesë arsye kryesore:

1. Informacion për menaxhimin
2. Vendorsja e limiteve
3. Shpërndarja e burimeve
4. Vlersim performance
5. Sistem rregullativ

2.1.2.2 Rreziku i Kredithënies

Rreziku i kredithënies është rreziku që një ndryshim në cilësinë e kredisë të një pale tjetër do të ndikojë në vlerën e një banke ose në pozicionin e një institucioni tjetër financiar. Shuma e vlerës së zëvendësimit të flukseve të humbura monetare, nënkupton që nuk janë humbjet vetëm nëse vlera e zëvendësimit është pozitive. Humbja në vetvete

është një funksion i ekspozimit origjinalë, dmth rrjedh në rrezik, p.sh. përqindja e vlerës që mund të mbulohet. Duhet të theksohet se standartet aktuale nuk janë burimi i vetëm i rrezikut të kredisë. Burime të tjera të rrezikut të kredisë rrjedhin nga ndryshimet e perceptuara apo aktuale në cilësinë e kredisë së palës tjetër.

2.1.2.3 Rreziku i normave të Interesit dhe teknikat e menaxhimit të këtij rreziku

Meqë biznesi bankar ka të bëjë me matjen, manaxhimin, dhe pranimin e rrezikut, zemra e manaxhimit të sistemit bankar është manaxhimi i rrezikut. Një nga funksionet kryesorë të manaxhimit të rrezikut në bankë është manaxhimi i aktiveve dhe pasiveve (ALM).

Bankat përballen me katër rreziqe të medha: rreziku i kredit, rreziku i normave të interesit, rreziku i likuiditetit, rreziku i parapagimit. Në ALM, fokusi vendoset mbi normat e interesit. Për më tepër, opsionet të lidhura me kontratat e kredisë dhe kontratat e depozitave shkaktojnë rrezikun e likuiditetit dhe parapagimit, kështu që ALM mund të shikohet si një manaxhimin i kordinuar i tre rreziqeve të ndryshme.

2.1.2.4 Rreziku i Likuiditetit

Ndryshe nga rreziqet që kërcënojnë aftësinë paguese të një institucioni financiar , rreziku i likuiditetit është një aspekt normal i menaxhimit ditor të një institucioni financiar. Rreziqet e likuiditeti shfaqen për dy arsye : arsyeja e parë prej pasivit dhe arsyeja e dytë prej aktivit. Mungesa e likuiditetit për shkak të pasivit ndodh kur mbajtësit e depozitave si depozituesit dhe mbajtësit e policave të sigurimit kërkojnë cash nëpërmjet tërheqjes së depozitave. Kjo sigurohet nëpërmjet : Shitjes së aktiveve, si dhe nga marrja e fondeve të reja borxh. Ndërkaq shumica e aktiveve mund të kthehen në cash , por për disa aktive kjo mund të bëhet me kosto më të lartë, kur aktivet duhet të likuidohen menjëherë. Në mënyrë alternative më shume se sa likuidimi i aktiveve të një institucioni financiar mund të kërkojë të blejë ose të marrë hua fonde shtesë.

2.1.2.5 Rreziku operacional

Sipas marrëveshjes së Baselit (2007) rreziku operacional përcaktohet si një risk i humbjeve direkte apo indirekte që vijnë nga procese të brendëshme të cilat janë të papërshtatshme ose kanë dështuar në aplikimin e tyre, nga njerëz, sisteme apo ngjarje të jashtme. Funksionimi i keq i sistemeve të informacionit, sistemeve të raportimit, rregullave të brendëshme të monitorimit dhe procedurave të brendshme të hartuara për të kryer në kohë rregullimet e nevojshme ose përqsjet me politikat e brendëshme të rrezikut çojnë në rrezikun operacional (Bessis, 2010). Rreziku operacional shfaqet në nivele të ndryshme siç janë gabimet njerëzore, procese, probleme teknike dhe të teknologjisë së informacionit. Zhvillimet e fundit në lidhje me modernizimin e mjedisit bankar, të tilla si rritja e mbështetjes në teknologji të sofistikuar, rritja e tregëtisë elektronike, transferimi i funksioneve dhe aktiviteteve si edhe përdorimi më i madh i strukturave teknike financiare të cilat çojnë drejt uljes së rrezikut të kredisë dhe tregut kanë kontribuar në nivele më të larta të rrezikut operacional në banka (Greuning dhe Bratanovic, 2009).

2.1.2.6 Rreziku strategjik

Në një kohë kur rreziku i kredisë dhe ai financiar me të cilin përballen institucionet financiare janë studiuar në mënyrë riogoroze. Lidhjes që ka menaxhimi i rrezikut me strategjiëe e korporatës, pasigurive të jashtme të tregut dhe industrisë u është kushtuar pak vëmendje (Miller, 1992). Slyëotzky and Drzik (2005), e përcatojnë rrezikun strategjik si një grup ngjarjesh dhe tendencash të jashtme të cilat mund të shkatërrojnë trajektoren e rritjes së kompanisë dhe vlerën e aksionerëve. Ndërsa këta dy autorë e konsiderojnë rrezikun strategjik si një pasojë e ngjarjeve të jashtme, autorë të tjerë e shohin rrezikun strategjik si ndikim i të sotmes dhe perspektivës në fitimet dhe/ose ngritjen e kapitalit nga aktivitete të brendëshme të biznesit. Si të tilla mund të

përmendim vendime të papërshtatshme për biznesin, zbatim jo I saktë I vendimeve të mara ose mos reagimi ndaj ndryshimeve të industrisë. Në këtë mënyrë rreziku strategjik konsiderohet si funksion I pajtueshmërisë së objektivave strategjike të organizatës, strategjitë e hartuara për të arritur këto objektiva, burimet e përdorura për këto qëllime dhe cilësia e zbatimit. Rreziqet strategjike sjellin ekspozimin më të madh të një institucioni (përfshi edhe atë bankar) dhe për këtë arsye ato mund të jenë një arsye serioze për rënien e vlerës së tyre. Për arsye se këto rreziqe nuk mund të parashikohen, probabiliteti për parashikimin e tyre është shumë i ulët si edhe i formave të ndryshme që ato mund të shfaqin drejtuesit nuk kanë mundur deri tani të ndërtojnë mjete dhe teknika për tu drejtuar atyre në mënyrë sistematike (Slyëotzky dhe Drzik, 2005). Këta autorë kanë arritur në konkluzionin se mënyra më e mirë për t'iu adresuar rrezikut strategjik është gjetja e mënyrës më të mirë për të bërë vlerësimin e tyre dhe bazuar tek kjo të përdoren burimet e duhura për përballimin e tyre. Ata sygjerojnë për drejtuesit të rregullojnë shpërndarjen e kapitalit në mënyrë të tillë që për projekte me risk të lartë të aplikojnë kosto të lartë kapitali si edhe të kenë një strukturë sa më fleksibël në strukturën e kapitalit kur ata përballen me një ambient konkurrues më risk të lartë.

2.1.3 Menaxhimi I integruar I rrezikut

Menaxhimi I rrezikut duhet të jetë pjesë përbërëse e plani të biznesit dhe menaxhimit strategjik duke vendosur në këtë mënyrë një lidhje të pazgjidhshme në këto procese. Një raport i grupit të punës së forumit të përbashët të komitetit të Bazelit për supervizimin e bankave në vitin 2003, nxjerr në pah se duhet vendosur një theks më I madh tek menaxhimi I rrezikut në mënyrë të integruar dhe trajtimi në kompleksitet I tyre në sektorin financiar. Grupi I punës mendon se kjo tendence vjen nga interesi për të kuptuar më mirë llojshmërinë e rreziqeve më të cilat përballen dhe për të bërë të mundur

për ta përcaktimin e madhësisë së kapitalit të nevojshëm për të aktivitetin e tyre. Nga studimet e kryera rezulton se 80% e kompanive me humbjet më të mëdha gjatë kohëve të fundit janë goditur nga dy ose më shumë rreziqe që ishin të lidhur mes tyre. Nga këndvështrimi i perspektivës në vendim-marrje, menaxhimi i integruar i rrezikut përfshin krijimin e sistemeve hierarkike të limiteve si edhe të komiteteve të menaxhimit të rrezikut të cilat ndihmojnë në mënyrën e përcaktimit dhe shpërndarjes së këtyre limiteve.

Sipas Rosenberg dhe Schuermann (2005), qëllimi i menaxhimit të integruar të rrezikut në një bankë është matja dhe menaxhimi i rrezikut dhe kapitalit përmes njëserë aktivitetesh të ndryshme bankare, të cilat kërkojnë një model për bashkimin e të gjitha llojeve të rreziqeve. Për të bërë të mundur arritjen e këtij bashkimi, shumë banka kanë rritur pjesën e burimeve të vendosura në dispozicion të aktiviteteve të menaxhimit të rrezikut për të bërë të mundur forcimin e funksionimit të menaxhimit të rrezikut.

Grupi i punës së forumit të përbashkët të komitetit të Bazelit për supervizimin e bankave i referohet bashkimit apo ndërthurjes së rreziqeve si përpjekje e firmave për të zhvilluar matje sasiore të rrezikut tek të cilat përfshihen shumë tipe ose burime rreziqesh. Modeli më i përgjithshëm është ai i vlerësimit të shumës së “kapitalit ekonomik” që firma mendon se është e nevojshme për absorbimin e humbjeve potenciale të lidhura me secilin prej rreziqeve.

2.1.4 Domosdoshmeria e rregulloreve për institucionet financiare

Institucionet bankare dhe ato të sigurimeve kanë qënë objekt i rregullimeve për shumë vite. Në mënyrë të veçantë ka qënë në fokus rreziku i mospagësës dhe mundësisë së tyre për falimentim. Këto janë risqe të cilat ndikojnë tek aksionerët dhe kreditorët e bankave dhe kompanive të sigurimit por rregulloret nuk janë hartuar vetëm për këtë qëllim. Këta

aktorë janë paguar për rrezikun që kanë marrë e njëkohësisht kanë gjithë mundësitë për të marrë informacionin në nevojshëm për të mbrojtur veten. Për më tepër, ata mund të bëjnë diverifikim të portofolit të tyre me një kosto më të ulët se atë që duhet të përballojnë institucionet financiare aksionet e të cilave zotërohen prej tyre.

Në të kundërt me ta, mbajtësit e depozitave dhe të policave të sigurimit, nuk kanë mundësi përdorimi të njëserë instrumentash që mundësojnë monitorimin e lëshesve të këtyre produkteve. Për këto grupe aktorësh të tregut financiar, kostot e përdorimit të këtyre instrumentave janë shumë të larta në krahasim me aksionmbajtësit apo kredituesit të cilët kanë mundësi të marrin në mënyrë direkte këtë informacion. Në këtë mënyrë, një mënyrë e lirë, përse i përket kostove, për të monitoruar bankën apo siguruesin është blerja e aksioneve të tij. Duke qenë në këtë pozicion ndaj këtyre institucioneve, investitorët mund të marrin raporte të rregullta tre-mujore dhe vjetore madje të ndjekin mbledhjet e aksionerëve. Por pavarësisht nga këto, nuk mund të thuhet se në këtë formë zotërohet gjithë informacioni i nevojshëm për të siguruar se investimi i kryer është i mirë.

Ajo çfarë është më e rëndësishme për tu marrë në konsideratë është fakti se investitorët e vegjël kanë më pak mundësi diversifikimi sesa aksionerët, kreditorët dhe menaxherët e institucioneve financiare. Gjithashtu është e rëndësishme të kihet parasysh fakti se depozitat bankare dhe policat e sigurimit konsiderohen si letra me vlerë pa rrezik. Mbrojtja e tyre, në shumë vende kryhet nëpërmjet sigurimit të depozitave ose fondeve të sigurimit të depozitave por kjo mbrojtje mund të shoqërohet me hazardin moral dhe sjellje të pranimi të rrezikut të cilat nuk janë në interes të mbajtësve të depozitave dhe

policave të sigurimit si edhe të sistemit financiar në përgjithësi në të cilin bankat dhe kompanitë e sigurimeve luajnë një rol të rëndësishëm.

Në mënyrë të përgjithshme, nëse diskutojmë për problemet e mbrojtjes ndaj rrezikut, ekziston gjithmonë një marrëdhënie ndërmjet parandalimit dhe niveleve të mbrojtjes nga rreziku të të siguruarit në prani të hazardit moral. Nëse do të jepnim një shembull marim atë të mbajtësve të policave të sigurimit për vjedhjen e automjetit apo aksidenteve. Këta persona kanë interes më të pakët të reduktojnë rrezikun e aksidenteve sesa ata drejtrues mjetesh që nuk janë të siguruar. Megjithatë, nëse arrihet një kontroll i mirë i rrezikut moral nëpërmjet mekanizmave stimulues del në pah rëndësia dhe dobishmëria më e lartë që përfitohet nga sigurimi krahasuar me mos kryerjen e tij sepse një pjesë e rreziqeve nuk janë të diversifikueshme në tregjet financiare.

Në ndryshim nga kontratat e sigurimit i siguruar-sigurues, mbajtësit e depozitave të mbrojtura dhe agjentëve që marrin vendime në lidhje me rrezikun e bankave nuk janë të njëjtët persona. Mbajtësit e depozitave (të cilët mund të bëhen ndoshta viktimat të qëndrimeve që zgjedhin të mbajnë ndaj rrezikut menaxherët e bankave) nuk kanë një stimul për vet-mbrojtje nga falimentimi i bankës sepse është e pamundur teknikisht që veprimet e tyre të ndikojnë në probabilitetin që ka një bankë për të falimentuar (Dionne, 2004).

Në këtë mënyrë, e vetmja lëvizje mbrojtëse që mund të kryejnë mbajtësit e depozitave është diversifikimi i tyre ndërmjet bankave. Kjo formë diversifikimi nuk inkurajohet nga bankat dhe për pasojë mund të shoqërohet me kosto më të larta. Sigurimi i depozitave nuk e inkurajon klientin të diversifikojë depozitat. Drejtuesit e bankave duke pasur parasysh faktin se klientët e tyre janë të mbrojtur nuk janë shumë të motivuar për

përpjekje në drejtim të uljes së rrezikut. Në këtë mënyrë ata ndërmarin veprime me rrezik të lartë dhe mbajnë kapitalin në nivele minimale për të rritur fitimet e bankës. Duke vepruar në këtë mënyrë ata janë kontribues të krijimit të eksternaliteteve negavite në sistemin financiar të cilat shpejtojnë arsyen e domosdoshmërisë së hartimit të rregulloreve bankare. Bankat kanë dimensione makro ekonomike sepse janë një pjesë mjaft e rëndësishme në funksionimin e sistemit financiar. Kjo vërtetohet nga çfarë ndodhi gjatë krizës së fundit financiare. Nga falimentimi i bankave të mëdha mund të vijë humbje të konsiderueshme për gjithë sistemin financiar sepse ajo mund të shkaktojë falimentime të tjera. Një ngjarje e tillë është objekt i rrezikut sistematik.

Rreziku sistematik është rreziku që një institucion financiar të ketë efekt domino në sistemin financiar apo edhe në ekonomi. Në përgjithësi është rrezik mospagese apo falimentimi. Nëse një bankë e madhe falimenton, detyrimet e saj financiare ndaj institucioneve financiare do të shkaktonin humbje të mëdha.

2.1.5 Marrëveshja e Baselit

Progresi që është kryer në drejtim të rregulloreve ndërkombëtare ndaj bankave paraqitet më poshtë në mënyrë të përmbledhur.

2.1.5.1 Basel I 1988

Komiteti i Baselit për Mbikqyrjen Bankare është një organizëm për bashkpunimin në fushën e mbikqyrjes botërore bankare dhe ka si qëllim përmirësimin e kësaj mbikqyrje. Grupi I vendeve më të industrializuara (G10) nënshkruan për këtë qëllim një marrëveshje në vitin 1988 (hyrja në fuqi e saj do të ishte në 1992). Komiteti përbëhej nga 12 përfaqësuesve të autoriteteve nga vendet e G10 plus Luksemburgu (SHBA, Mbretëri e Bashkuar, Japoni, Gjermani, Francë, Itali, Kanada, Hollandë, Belgjikë, Suedi, Zvicër). Aktualisht ka shumë vende të tjera të cilat kanë nënshkruar këtë

marrëveshje. Nëpërmjet këtij Komiteti do të arrihej të vendosej një mbikqyrje e bazuar në parime të përgjithshme ndërkombëtare e lidhur kjo edhe me specifikat e rregjimeve rregullatore bankare të vendeve të ndryshme ku ato do të aplikohen. Qëllimi i punës së këtij Komiteti është formulimi i standardeve të gjera mbikqyrëse, përgatitja e udhëzimeve dhe rekomandimeve. Komiteti në këtë mënyrë ofron materiale mbështetëse dhe orientuese për autoritetet e veçanta por nuk ka as fuqi mbikqyrëse dhe as ligjore.

Me anën e këtij komiteti autoriteteve mbikqyrëse të shteteve të ndryshme u krijohet mundësia e shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre me qëllim nxitjen e një qëndrimi të përbashkët. Gjithashtu, pjesë e aktiviteteve të këtij komiteti janë publikimi i standarteve dhe rregullave në fusha të caktuara të mbikqyrjes bankare nëse kjo shihet si e nevojshme. Standartet ndërkombëtare mbi nivelin e përshtatshëm të kapitalit bankar, të njohura si “Basel”, janë një nga publikimet më të rëndësishme të këtij Komiteti.

Rritja e problemeve ndërkombëtare të krijuara kanë nxjerrë në pah nevojën për të përmirësuar dhe forcuar sistemin financiar. Si rezultat, Komiteti i Bazelit ka hartuar një dokument me titull “Parimet bazë për një mbikëqyrje bankare efektive” i cili është rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë edhe me vendet që nuk janë anëtare të G10. Vendet anëtare mund të imponojnë rregulla edhe më të forta ndaj bankave të tyre por ato duhet të qendrojnë korrekte me një minimum parimesh të marrëveshjes. Marrëveshja i vë bankat para detyrimit të mbajtjes së një nivelit të caktuar minimal për tu mbrojtur ndaj rreziqeve të ndryshme. Për të pasur një sistem efektiv të mbikëqyrjes është e nevojshme të zbatohen 25 parimet e Komitetit të Bazelit të cilat lidhen me parakushtet e një mbikqyrje të efektshme; kërkesat për informacion; liçencimi; struktura; fuqia ligjore e

mbikqyrësve; kryerja e mbikqyrjes së aktivitetit bankar jashtë kufijve. Këto parime, pavarësisht nga niveli i zhvillimit të një vendi, përbëjnë disa kërkesa minimale që zbatohen duke pasur parasysh edhe kushtet specifike të vendit përkatës.

Marrëveshja e parë ishte e limituar në rrezikun e kredisë. Parimi kryesor i Bazel I: Mbulimi dhe adresimi i rrezikut të besueshmërisë (credit rrezik). Bazuar tek kjo çdo bankë i kërkohej që të mbante një kapital rezervë prej 8% e vlerës së letrave me vlerë që përfaqëson rrezikun e kredisë së portofolit të saj.

$\text{Kapitali} = 8\% \times \text{ponderimi i rrezikut} \times \text{ekspozimin}.$

Përkufizimi i kapitalit për të krijuar rezerva përfshinte më tepër sesa kapitalin e vet të bankës. Nga viti 1988 kapitali ndahej në dy pjese përbërëse:

- Kapitali bazë (Tier I – core capital): Përbëhet nga kapitali aksioner, rezervat dhe fitimi i pashpërndarë i vitit actual, pronat në filialet dhe disa rezerva të bëra të ditura për autoritetet rregullatore.
- Kapitali shtesë (Tier II - supplementary capital): instrumente hibridë të kapitalit (aksione dhe borxhe me afat shumë të gjatë), borxhi i varur me afate maturimi më tepër se 5 vjet, të tjera letra me vlerë dhe rezerva.

50% e kapitalit duhet të mbulohet nga Tier 1 dhe kjo shumë duhet të përfaqësojë së paku 8% të kapitalit të ponderuar me rrezik të mbajtur nga banka. Në shtesë të fondit rezervë të kërkuar, kjo marrëveshje diktonte kufizime në lidhje me qendrimet të tepruara ndaj mbajtjes së rreziqeve:

- Asnjë zotërim nuk duhet të kalonte 25% të kapitalit të kompanisë
- Totali i rreziqeve të larta nuk duhet të kalonte tetë herë kapitalin e kërkuar edhe pse raporti i rezervës kapitale (8%) e lejonte deri në 12.5 herë

Marrëveshja fillestare e Basel I u kritikua mjaft për shkak se nuk merte në konsideratë rrezikun e tregut. Në bazë të saj ishte një qëndrim konservator ndaj rrezikut të kredisë. Kjo do të thotë të mund të lidhin ndërmjet maturiteteve në pozicion të shkurtër dhe të gjatë. Në 1996 u bë reformimi i parë i Basel I me qëllim përfshirjen në të të rrezikut të tregut dhe lejimin e përdorimit të modeleve të brendshme të rrezikut të tregut.

- Kapitali ekstra (Tier III) (i përcaktuar në 1996 si një element shtesë që merte parasysh rrezikun e tregut): borxhi i varur me afat minimal 2 vjeçar maturimi dhe i rishlyeshëm me miratim të autoritetit mbikëqyrës, fitimet e akumuluar nga shitblerja e letrave me vlerë.

Këto modele supozonin që banka llogariste vlerën e saj në rrezik (VaR) për rrezikun e kthimit të mjeteve, rrezikun e normës së interesit, rrezikun e këmbimit dhe rrezikun e çmimit të metaleve të çmuara. Në këtë mënyrë vlera totale e VaR ishte shumë e VaR për rreziqet e veçanta. Ky model është gjithashtu konservativ sepse nuk lejon diversifikimin ndërmjet kategorive të grupeve të rreziqeve. Në formë të përgjithshme ndër kufizimet e Basel I mund të përmenden: kushtëzimi i diferencave në madhësinë e kapitalit midis vendeve të ndryshme për shkak të diferencave në rregullat kontabël dhe ato fiskale; Basel I u fokusua vetëm në rrezikun e besueshmërisë; llojet e tjera të rreziqeve nuk u konsideruan (rreziku i normave të interesit, likuiditetit, i këmbimit valutor dhe ai operacional); nuk ekzistonte asnjë mekanizëm shpërblyes për bankat që reduktonin rrezikun e portofolit të investimit, pasi kërkesat për kapital nuk merrnin parasysh diversifikimin e rrezikut; bankat ishin të detyruara të zbatonin të njëjtin standard rregullator për kapitalin, pavarësisht se ato angazhoheshin në operacione të ndryshme financiare; nuk merrte parasysh vlerën e tregut të aktiveve të bankës.

Rregullat për përdorimin e VaR për rrezikun e tregut janë:

- Horizonti kohor është dhjetë ditë tregu ose dy javë;
- Shkalla e konfidencës 99%
- Përdorimi i të dhënave historike është deri në vit para, me përditësim të parametrave të modelit çdo tre muaj;
- Mund të përdoren lidhje ndërmjet të gjitha formave të rrezikut
- Për shkak të nevojës për më tepër kapital si rezultat i rrezikut të tregut, bankat mund të përdorin kapitalin ekstra, Tier 3, për të krijuar rezerva të cilat korrespondojnë me huatë afat shkurtra. Kapitali i përdorur në përbërësit e Tier 2 dhe 3 për kapitalin e rrezikut nuk duhet të kalojnë 250% të kapitalit Tier 1 të përdorur për rrezikun e tregut.

2.1.5.2 Basel II në 2004

Në vitin 2004 u bë një reformë e madhe në lidhje me rrezikun operacional dhe atë të kredisë (Basel II) e cila hyri në fuqi në vitin 2006 (BIS, 2005), por një pjesë e mirë e vendeve nuk kanë ecur shumë në lidhje me zbatimin e saj për shkak të tronditura nga kriza financiare e vitit 2007

Në bazë të kësaj marrëveshje, raporti i mjeteve të ponderuara me rrezik mbeti 8%. Qëllimi kryesor i reformës ishte në vetvete një rishikim të rëndësishëm të rregullave mbi rrezikun e besueshmërisë, në drejtim të ndjeshmërisë ndaj një diapazoni më të gjerë rreziqesh, sikundër dhe ndaj mbështetjes në eksperiencën e kompetencën e vetë bankës, bazat e të dhënave historike, metodologjitë, modelet dhe parametrat e manaxhimit dhe parashikimit të rrezikut të saj. Basel II shtoi formula kapitali për rrezikun e kredisë me metodën e brendshme (modeli CreditMetrics) për të marrë në konsideratë diversifikimin e mjeteve të portofolit që ishin subjekt i rrezikut të kredisë. Përveç kësaj, rregulla të

llogaritjes së kapitalit (standarde dhe të avancuara) u prezantuar për rrezikun e likuiditetit. Rreziku i kredisë u vlerësua të përbënte 80% të rrezikut total, rreziku operacional 15% dhe ai i tregut 5%. Në lidhje me rrezikun e kredisë, bankat mund të përdorin vlerësimet e brendëshme, të cilat janë më të ndryshueshme se vlerësimet e dhëna nga agjencitë për shkak se ato mund të modifikohen në varësi të cikleve ekonomike.

Bazel II bazohet në tre shtylla:

1. Kërkesa për kapital minimal; Llogaritja e kapitalit: bazohet më tepër në modelet financiare sesa në rregullat kontabël.
2. Rishikimi i procesit të mbikëqyrjes dhe procesi i vlerësimit të brendshëm të bankave; Mbikqyrja (implementimi): vlefshmëri më të madhe për metodat dhe të dhënat statistikore. Më tepër teste të vlefshmërinë e kapitalit bankar në mënyrë të veçantë në situata krizash.
3. Disiplina e tregut, ekspozim më i madh i informacionit bankar dhe nxitja e praktikave të sigurta e të shëndosha bankare

Në lidhje me rrezikun e kredisë, tashmë ka dy metoda për llogaritjen e kapitalit.

- Metoda standarde e vitit 1988 e modifikuar për përdorimin në vlerësimin e rrezikut
- Modele të brendshme që mund të përfshijnë përdorimin e modeleve të bazuara në vlerësimet e brendshme (Internal Ratings Based – IRB) dhe ato që përfshijnë VaR të kredisë në rrezikun e portofolit. Basel II nxiste përdorimin e sistemeve të brendshme të vlerësimit të rrezikut nga ana e bankave, për një përlllogaritje më të mirë të nevojave për kapital, duke marrë në konsideratë faktin se, ishte e vështirë

për autoritetet mbikëqyrëse e rregullatore identifikimi dhe monitorimi i të gjithë rreziqeve ndaj të cilëve ekspozoheshin bankat.

Kriza globale e vitit 2008 nxorri në pah disa kufizime të Bazel II: Kërkesa për kapital bazë prej 4% rezultoi e pamjaftueshme për të mbuluar humbjet në shkallë të gjerë; Përgjegjësia për përcaktimin dhe vlerësimin e rrezikut të palëve të tjera iu besua agjencive të klasifikimit të rrezikut, veprim ky që u provua i paqëndrueshëm dhe me konflikte interesi; Kërkesa për kapital bazë nga natyra vazhdon të mbetet “prociklike”; gjatë periudhës së zgjerimit ekonomik rreziku i palëve të treta dhe ai sovran ulet, duke ulur kërkesat për kapital dhe anasjelltas; Bazel II nxit procesin e titullizimit (mundëson shitjen e huave, ripaketimin e tyre dhe nxjerrjen jashtë bilancit të tyre) duke ulur aktivet e ponderuara me rrezik, rritur përdorimin e levës financiare nga bankat dhe ulur kërkesat për kapital.

2.1.5.3 Basel III në 2010

Basel III vjen me rregulla të reja në lidhje me kapitalin për të mbrojtur bankat dhe për të përmirësuar kontrollin e rrezikut të likuditetit. Marrëveshja kërkon më tepër menaxhim të rrezikut për bankat dhe rritjen e mbikqyrjes së tyre. CRO's (Chief Risk Officers) duhet të jenë të pavarur nga CEO's (BIS, 2012). Gjithashtu kërkohet më tepër transparencë dhe kapital në rezervat (afatgjatë):

- Minimumi i kapitalit bazë (Tier 1) do të jetë: Raporti i kapitalit të vet/aktiveve të peshuara me rrezik shkon nga 2% në 4.5% dhe totali i kapitalit Tier 1 nga 4% shkon në 6% në 2019. Sipas Basel III ky raport do të konsiderohet si pikë referuese duke zëvendësuar raportin e kapitalit bazë (Tier 1 capital ratio)

- Totali kapital minimal mbetet 8% në 2013 por në mbështetje të masave mbrojtëse propozohet një masë sigurie (conservation buffer), në masën mbi 2.5% që do të plotësohet me aksione të zakonshme; në periudha stresi (kur raporti i kapitalit të bankave bie nën 7.0%). Kështu në 2019 kapitali minimal do të arrijë në 10.5% për të mbrojtur bankat nga recesioni apo krizat financiare.

Kapitali rezervë (Tier 3) i lidhur me rrezikun e tregut u hoq dhe në vend të tij u vendos një raport i mbulimit të likuiditetit së bashku me një standard të ri të kontrollit të raportit të borxhit të bankës. Rregullimi i ri do të reduktojë prociklicitetin duke marrë në konsideratë riskun sistematik. Do të ushtrohet një kontroll më i madh në lidhje me sigurimin dhe do të lejohen më pak transaksione mbi banak. Së fundmi, kërkohet më tepër kapital për rrezikun e likuiditetit.

2.2 Veçoritë e kapitalit bankar

Në kuadër të nxitjes së stabilitetit financiar, autoritetet rregullatore i kushtojnë një vëmendje të veçantë rregullimit të kapitalit. Në terma të përgjithshme kapitali bankar lidhet me burimet e veta për financimin e aktiveve. Ato mund të mendohen si burime që lejojnë bankën të mbështesë detyrimet e veta nëpërmjet aktiveve të veta. Volumi i kapitalit është ekuivalenti i vlerës neto të aktiveve dhe përfaqëson marzhin me të cilin aktivet tejkalojnë detyrimet. Aktivet e barabarta me kapitalin përfaqësojnë atë që mbetet për pronarët e bankës pasi janë përmbushur detyrimet ndaj depozituesve dhe kreditorëve. Kapitali nuk duhet të mendohet si diçka e mbajtur nga banka. Kapitali konsiderohet si ekuivalent me diferencën ndërmjet aktiveve totale dhe detyrimeve totale. Por edhe pse ky është përcaktim mjaft i përdorshëm për kapitalin bankar njëkohësisht mund të jetë edhe çorientues. Në ndryshim nga huatë ose bonot qeveritare të cilat banka

i mban në anën e aktiveve të bilancit, kapitali është një formë alternative financimi me karakteristika të veçanta. Karakteristika kryesore e tij është se ai shërben si një formë financimi e cila mund të absorbojë humbjet të cilat mund të rrezikojnë aftësinë paguese të bankës. Në këtë mënyrë kapitali bankar shërben si një mjet mbrojtës dhe nxitës për një menaxhim të kujdesshëm të bankës sepse kapitali i aksionerëve është në rrezik nëse ndodh falimentimi. Kapitali bankar luan një rol të rëndësishëm jo vetëm për sigurmë e bankave individuale por për gjithë sistemin bankar. Pjesa më e madhe e aktiviteteve të bankës financohet nga depozitat e klientëve dhe format e tjera të huamarrjes të cilat duhet të paguhen plotësisht. Nëse një bankë i mbështet dobët me fonde këto huamarrje, që do të thotë nuk ka kapital, në rast të një humbje në një periudhë të caktuar nuk do të jetë në gjendje të paguajë huadhënësit e saj. Në kuadër të bilancit të saj, nuk do të ketë aftësi paguese, detyrimet do të jenë më të mëdha sesa aktivet. Në të kundërt, një bankë me kapital kur kalon një periudhë humbje ajo që përjeton është ulje e kapitalit bazë të saj. Në aspektin e bilancit të saj ajo rezulton me aftësi paguese.

Kapitali ka edhe dy karakteristika të tjera të rëndësishme. Së pari, në ndryshim nga detyrimet bankare ai është i përhershëm, për sa kohë aktiviteti i biznesit vazhdon, banka nuk është e detyruar të paguajë investimin fillestar të investitorëve të saj. Ata do të paguhen pasi të gjithë kreditorët janë likuiduar. Së dyti, shpërndarjet për investitorët e kapitalit nuk janë të detyrueshme dhe zakonisht ndryshojnë në varësi të fitimeve që siguron banka. Nga ana tjetër, aksionerët presin që në periudha afatgjata të kenë kthime më të mëdha sesa investitorët në tituj borxhi.

Kapitali bazë i bankës dhe aktivet e veta likuide janë të rëndësishme për të mundësuar përballimin e tipeve të ndryshme të goditjeve me të cilat mund të përballëtohet banka. Është

e rëndësishme të kuptohet se kapitali nuk është sinonim me likuiditetin. Ashtu sikurse ndryshon natyra e tyre përsa i përket burimeve financiare, ndryshon edhe natyra e goditjeve që ato mbulojnë. Kapitali dhe likuiditetet shërbejnë si burime financimi por ndërsa kapitali shërben për si amortizues i humbjeve nuk nënkuptohet sa ka fonde të mbajtura të bllokuara për këto raste. Aktivet likuide (siç janë mjete monetare, rezervat e bankës qendrore ose bonot qeveritare) janë në kahun e përdorimeve të fondeve (aktiv) dhe banka mban aktive likuide për të përballuar/zbutur rrezikun e likuiditetit i cili shkaktohet kur nuk ka burime të tjera të financimit. Një bankë mund të jetë e mirëkapitalizuar, që do të thotë se ka më tepër aktive sesa detyrime e ndërkohë të ketë probleme me likuiditetin kur këto aktive nuk mund të konvertohen shpejt në mjete monetare ose ekuivalentë për të plotësuar nevojat e tjera. Ka tre koncepte të lidhura me kapitalin:

- *Kapitali aktual*, i cili lidhet me kapitalin fizik dhe përfaqësohet si kapitali i vet dhe detyrime afatgjata në bilanc. Ai matet si raporti i kapitalit të vet me aktivet totale (raporti i kapitalit)
- *Kapitali rregullator*, ka të bëjë me kapitalin e bazuar në rrezik, të cilin bankat e mbajnë në përputhje me kërkesat e përcaktuar nga rregulloret e mbikqyrjes dhe matet si raport i kapitalit me aktivet e ponderuara me rrezik. (raporti i kapitalit i bazuar në rrezik)
- *Kapitali ekonomik*, i cili përfaqëson sasinë e kapitali që nevojitet për ushtrimin normal të aktivitetit bazuar në strategjitë e tij.

2.2.1 Kategoritë e kapitalit bankar

2.2.1.1 Kapitali aktual

Kapitali aktual përkufizohet si kapitali i zgjedhur aksionerët duke marrë parasysh kufizimet rregulluese. Në mënyrë të veçantë mbahen parasysh dy rregulla. Së pari, niveli i kapitalit që duhet të ketë çdo bankë në fillim të çdo periudhe nuk duhet të jetë më i ulët se kapitali rregullator. Së dyti, bankat që në fund të periudhës rezultojnë të kënë një kapital poshtë një niveli minimal konsiderohen si të nënkapitalizuara dhe mbyllen. Për një diapazon të gjerë të vlerave të parametrave, kërcënimi i mbylljes së aktivitetit i nxit bankat të zgjedhin një nivel kapitali mbi atë rregullator.

2.2.1.2 Kapitali rregullator – mjaftueshmëria e kapitalit

Kapitali *ekonomik* dhe ai *rregullator* janë dy terma që përdoren shpesh në kudër të rregullimit të kapitalit bankar propozuar nga Komiteti i Baselit për mbikqyrjen bankare (2004). Kapitali rregullator duhet të vijë nga maksimizimi i funksionit të mirëqënies i cili mer në konsideratë kostot dhe përfitimet nga rregulloja e kapitalit ¹².

Institucionet financiare janë në gjendje që të bëjnë parashikime në lidhje me rrezikun mesatar dhe humjet në aktivet e tyre të lidhura me kreditë. Këto humbje të pritshme (expected loss EL) janë pjesë e ushtrimit të aktiviteti dhe mbulimi i tyre kryhet nëpërmjet çmimit të aktiveve. Për humjet të cilat janë jashtë pritshmërive, humbjet e papritshme (unexpected losses UL) duhet që në një masë të caktuar të mbulohen nga kapitali bankar. çështja kryesore me të cilën është lidhur përcaktimi i kërkesave të kapitalit është sigurimi i depozitave dhe mbrojtja e ekonomisë nga rreziku sistematik (Sharpe, 1978)¹³. Duke mbajtur një nivel të lartë kapitali sigurohet mbrojtje për investitorët e vegjël dhe ndaj falimentimit të mundshëm për shkak të rrezikut sistematik.

¹² Tek kostot mund të përmendim një rritje në koston e kredisë ndërsa tek përfitimet përmendim një ulje të probabilitetit të falimentimit të bankës.

¹³ Regulatory and economic capital: theory and practice, evidence from the field

Duhet pasur parasysh se mbajtja e një niveli shumë të lartë të kërkesave për kapital mund të krijojë kosto në drejtim të efikasitetit (Jackson et al. (2002)) duke orientuar burimet financiare nga drejtimi më produktiv i përdorimit të tyre, duke krijuar stimuj artificialë për të ndërmarrë rreziqe jashtë bilancit etj.

Kur bankat përlogarisin kërkesat për kapital rregullator duhet të kryejnë në përputhje me përkufizimet e dhëna në rregullore, rregulla dhe udhëzues. Sipas tyre, niveli minimal i kapitalit është pjesë e kapitali bankar. Kapitali total sipas udhëzimeve të Basel II është u përbërë nga tre kategori:

1. Tier 1 kapitali bazë: i cili përfshin në një masë të madhe elementë të tilla si aksionet e zakonshme, aksionet e preferuar të kualifikuara, teprica dhe fitimi i mbartur
2. Tier 2 kapitali shtesë: i cili përfshin elementë të tillë si rezerva të përgjithshme për humbjet e huasë, forma të caktuara të aksioneve të preferuara, borxhi i varur, borxhi i përhershëm, huatë të tjera hibride dhe instrumenta të kapitalit.
3. Tier 3 Kapitali: përfshin borxhin e varur afatshkurtër dhe fitimet neto të librit tregëtar të cilat nuk janë verifikuar nga jashtë

Këto kategori mund të formohen në mënyra të ndryshme në përputhje me regjimet legale dhe ato të kontabilitetit që aplikojnë vende të ndryshme. Duhet të theksohet gjithashtu ndryshimi ndërmjet këtyre kategorive në varësi të aftësisë që kanë për të amortizuar humbjet. Kategoria 1 është kategoria që ka mundësitë më të mira për amortizim të humbjeve.

Për bankat që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri, bazuar tek rregullorja “PËR KAPITALIN RREGULLATOR TË BANKËS”¹⁴, kapitali rregullator është kapitali i bankës për mbulimin e rrezikut të kredisë, të rreziqeve të tregut dhe të rrezikut operacional. Kapitali rregullator i bankës, në varësi të karakteristikave të tij dhe të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, ndahet në dy kategori: a) kapitali i nivelit të parë; b) kapitali i nivelit të dytë. Bankat llogarisin kapitalin rregullator të saj si shumë të kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë, duke marrë në konsideratë edhe zbritjet sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe/ose të akteve të tjera rregullative.

Kapitali bankar përkufizohet në rrjeshta (tiers) ose kategori të cilat përfshijnë kapitalin e aksionerëve, fitimet e mbatura, rezervat instrumenta hibride të kapitalit dhe borxhi i varur. Raportet e kapitalit zakonisht maten si përqindje e aktiveve bankare ose aktiveve të ponderuara me rrezik. Kapitali i bankës dhe pozicioni i likuiditetit janë koncepte thelbësore për të kuptuar se çfarë bëjnë bankat, cilat janë rreziqet që ndërmarin ato dhe cila është forma më e mirë për zvogëlimin e tyre. Kriza e fundit financiare dëshmoi paqendrue-shmërinë që krijohet nëse bankat përjetojnë mungesa të burimeve financiare – kapital ose likuiditet – si edhe dëmtimin e funksioneve thelbësore ekonomike që luajnë ato.

Bankat llogarisin kapitalin e nivelit të parë¹⁵ si shumë të kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë, duke marrë në konsideratë edhe zbritjet sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe/ose të akteve të tjera rregullative. Kapitali bazë i nivelit të parë përbëhet nga elementet e mëposhtme:

- 1) kapitali i paguar (aksione të zakonshme);

¹⁴ Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 69, datë 18.12.2014

¹⁵ Rregullorja “PËR KAPITALIN RREGULLATOR TË BANKËS”, Neni 6.

- 2) primet e aksioneve (të zakonshme);
- 3) fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme;
- 4) fitimi ushtrimor i fundit të vitit;
- 5) fitimi ushtrimor i periudhës raportuese;
- 6) rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit);
- 7) diferenca rivlerësimi kreditore.

Niveli i kapitalit bazë të nivelit të parë duhet të jetë në çdo kohë më i madh se niveli i kapitalit fillestar minimal të kërkuar. Kapitali i paguar përbëhet vetëm nga aksionet e zakonshme, të cilat mbartin të gjitha karakteristikat sipas përcaktimeve në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Bankat luajnë njësrë rolesh të rëndësishme në funksionimin e ekonomisë. Së pari, ato ofrojnë për individë dhe kompani shërbimin e pagesave dhe mundësojnë ato të kryejnë transaksione. Së dyti, ato sigurojnë kreditimin për ekonominë reale. Së treti, bankat ndihmojnë individë dhe biznese të menaxhojnë rreziqet më të cilat përballen.

2.2.1.3 Kapitali ekonomik

Bankat ndeshen sot me njësrë rreziqesh dhe shumë prej tyre kanë gjetur një lidhje ndërmjet planifikimit të kapitalit ekonomik identifikimit të rreziqeve, lidhjen e këtyre rreziqeve me aktivitete të veçanta të biznesit. Pavarësisht progresit të bërë në këtë drejtim ato vazhdojnë t’u adresohen çështjeve teknike të cilat lidhen me menaxhimin e kapitalit ekonomik. Për këtë arsye, bankat nuk bëjnë përlllogaritje vetëm për kthimet e biznesit të tyre por edhe për rreziqet dhe nivelin e kapitalit ekonomik që lidhet me to¹⁶. Kapitali ekonomik është përdorur fillimisht nga bankat si një mjet për shpërndarjen e

¹⁶<https://www.kpmg.com/LU/en/IssuesAndInsights/Articlespublications/Documents/Economic-capital-Basel-II-2.pdf>

kapitalit dhe vlerësimin e performancës. Për këtë arsye, treguesit e kapitalit ekonomik duhet që në mënyrë të besueshme dhe të saktë të masin rreziqet në mënyrë relative duke u kushtuar atyre më tepër vëmendje sesa matjes së nivelit të përgjithshëm të rreziqeve dhe kapitalit.

Përdorimi i kapitalit ekonomik në drejtim të çështjeve për të cilat vlerësimi i nivelit të kapitali kërkon përpikmëri është zgjeruar në mënyrë graduale. Si tillë mund të përmendim përdorimin e tij në përcaktimin e kapitalit të brendshëm që i nevojitet një banke në vlera absolute¹⁷. Kapitali ekonomik mund të analizohet dhe përdoret për nivele të ndryshme – duke variuar nga nivel firme tek tipe të rrezikut ose nivele të biznesit e deri tek portofolet individuale dhe nivelet e ekspozimit. Në mënyrë të veçantë, shtylla 2 e Basel II përfshin një vlerësim të modelit të kapitalit ekonomik bankar. Nëpërmjet Basel II synohet arritja e një konvegjencë të mëtejshme të kapitalit ekonomik, megjithëse në studime të ndryshme argumentohet se edhe nën këtë marrëveshje faktorët përcaktues të kapitalit ekonomik dhe rregullator do të jenë të ndryshëm.

Basel II vendos në fokus të bankave menaxhimin e kapitalit ekonomik, nëpërmjet një lidhje më të mirë të rreziqeve bankare dhe menaxhimit të tyre me kërkesat e kapitalit rregullator, Basel II nxit bankat për të rishikojnë përpjekjet e tyre për menaxhimin e rreziqeve nëpërmjet zhvillimit të një modeli për planifikimin e kapitalit. Ky model është i ndërtuar si një kombinim i modeleve të veçanta kapitalit rregullator dhe atij ekonomik. Për më tepër, sipas Basel II shtylla 2, mbikqyrësit e bankës mund t'i kërkojnë asaj të mbajë kapital shtesë nëse nuk ka një menaxhim të mirë të rreziqeve. Në përputhje me shtyllën 2, bankat duhet të përdorin modele të ndryshme për të shpërndarë kapitalin në aktivitetet e biznesit bazuar në sa dhe çfarë rrezik sjellin ato tek rreziqet e portofolit të

¹⁷ Range of practices and issues in economic capital framework <http://www.bis.org/publ/bcbs152.pdf>

bankës. Këto modele do të duhet të përcaktojnë se sa kapital kërkohet për të mbështetur aktivitetet të ndryshme të bankës – një qëllim që nuk mund të arrihet nga kapitali rregullator për të gjitha aktivitetet.

Planifikimi i kapitalit rregullator ka qenë një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit bankar. Megjithatë tashme kapitali ekonomik po bëhet përherë e më i rëndësishëm për konkureshmërinë e përgjithshme të bankës, reflektuar kjo edhe te Basel II. *Kapitali ekonomik* është pjesë e kapitalit të bankës të mbajtur për të përballuar goditjet nga humbjet e mundshme në aktivitetin e një biznesi. Fokusimi i bankave tek kapitali ekonomik është pjesë e një lëvizjeje të kryer në drejtim të matjes së rreziqeve, optimizimit të matjes së performancës, mundësisë për të mbështetur vendimet strategjike në informacion të saktë. Qëllimi i gjithë këtyre është forcimi i përfitimeve dhe aftësisë konkurruese. Kapitali ekonomik është një tregues rreziku që nuk thotë asgjë në lidhje me sasinë e kapitalit të mbajtur, ai është i pashkëputur nga kapitali kontabël dhe ai rregullator.

Meqenëse kapitali ekonomik është më tepër një matës i brendshëm i kapitalit të vlefshëm nuk ka një përkufizim global të tij. Megjithatë, ka disa elementë të cilat shumë banka i kanë të përbashkëta kur duhet të përcaktohet kapitali ekonomik. Vlerësimi i tij mund të kryhet nëpërmjet elementëve të Nivelit 1 (Tier 1), Nivelit 2 (Tier 2) ose Nivelit 3 ose përkufizime të cilat përdoren nga agjenci të rankimit dhe/ose tipe të tjera kapitali.


2.2.1.4 Dallimi ndërmjet kapitalit rregullator dhe atij ekonomik

Matja e kapitalit rregullator dhe atij ekonomik përfshin dy tipe modele të menaxhimit të rrezikut të cilat përdoren nga bankat.

Modeli I parë u ndërtuar në vitin 1980 për nevoja të mbikqyrjes së rreziqeve të jashtme dhe raportimit. Sipas tij kapitali rregullator matet si shuma minimale e kapitalit ose fondeve të tjera që insitucioni mund të mbajë për të përmbushur kërkesat e rregullores (Basel I dhe Basel II, shtylla 1).

Modeli I dytë u zhvillua në 1990 nga nevojat për menaxhimin e rrezikut dhe kapitalit. Ai mat kapitalin ekonomik, i cili përkufizohet sipas Komitetit të Baselit si “një pjesë e sasisë së kapitalit që një firmë beson se I duhet për të mbështetur aktivitetet ose një sërë rreziqesh...”

Figure 1 Kapitali ekonomik ndaj atij rregullator



2.3 Kuptimi, modelet dhe teknikat e vlerësimit të efijencës

Efijenca është një tregues mjaft i rëndësishëm për vendet të cilat gjatë dy dekadave të fundit kanë ngritur një sistem të ri financiar. Analiza e efijencës bankare kërkon analizë të efijencës së kostos, të ardhurave dhe fitimit. Ky punim do të fokusohet në analizën e efijencës së kostos në bankat e nivelit të dytë që aktualisht operojnë në Shqipëri. Nga

literatura njihen pesë metodat e ndryshme që mund të përdoren për vlerësimin e efijencës bankare. Dy prej tyre janë metoda joparametrike dhe tre të tjerat parametrike. Metoda që do të përdoret në këtë punim është Analiza e Kufirit Stokastik (Stochastic Frontier Analysis) e cila është një prej metodave parametrike më të përdoura në këto lloj vlerësimesh dhe analizash. Në lidhje me përkufizim e inputeve dhe outputeve bankare ka disa modele. Përcaktimi i inputeve dhe outputeve bankare do të kryehet sipas modelit të mjeteve (ose ndërmjetësimit). Modeli I ndërtuar për vlerësimin e efijencës së kostos do të mund të nxjerrë në pah se cilët outpute, ndër ata të përzgjedhur si variabla të pavarur në këtë vlerësim, janë më të ndjeshëm ndaj kostos.

2.3.1 Kuadri teorik i efijencës

Në këtë kapitull do të prezantohen njëserë konceptesh që lidhen me efijencën e cila konsiderohet si një koncept ekonomik i lidhur me teorinë mikroekonomike të firmës. Të parët që prezantuan kufirin e prodhimit ose siç mund të thuhet ndryshe standardet e efijencës produktive janë Debreu (1951) dhe Farrell (1957). Bazuar tek idetë e tyre efijenca ekonomike mund të shihet e përbërë nga efijenca e shkallës, efijencia e shtrirjes (scope), teknike dhe ajo aloktive, Një njësi ekonomike vepron në një efijencë të plotë atëherë kur prodhon duke siguruar njëkohësisht maksimizim të fitimit dhe minimizim të kostove të mundshme.


2.3.1.1 Efijenca teknike, aloktive dhe e kostos

Bazuar tek Farrell (1957) efijenca mund të matet nëpërmjet përdorimit të “izokuantit të efijencës” të vlerësuar si një pjesë e vije konvekse të pikave të vrojtuar. Ai supozon se funksioni i prodhimit është një funksion homotetik që do të thotë se ai është një transformim monotonik i një funksioni homogjen në të cilin norma marxhinale e zëvendësuesve teknike është konstant përgjatë një vije nga origjina. Një krahasim

ndërmjet një izokuanti eficient dhe izokuanteve të tjera për një output të dhënë do të tregonte një largim nga efienca e plotë (Clemhout, 1968).

Analiza e efiençës sipas Farrell (1957) paraqitet në "Figura 2 Efienca teknike, alokative dhe e kostos" për një output dhe dy inpute.

Figura 2 Efienca teknike, alokative dhe e kostos



Burimi: Cooper et al. (2007, p.258)

Farrell së pari supozon se kthimet konstante të shkallës përcaktojnë funksionin e prodhimit eficient ose kufi. Kombinimi teknologjik është përshkruar plotësisht nga izokuanti YY' që përfshin kombinime në nivele të tilla të inputeve (X_1 , X_2) për të prodhuar output në kushtet e efiençës perfekte. Kombinim i inputeve (X_1 , X_2) përgjatë YY' përfaqëson kombinimet minimale të inputeve të cilat janë të nevojshme për të prodhuar një nivel të caktuar output. Nën këtë kuadër, çdo kombinim i inputeve i ndodhur në izokuant konsiderohet si teknikisht eficient ndërsa çdo pikë lart ose në të djathtë (si është pika P) konsiderohet prodhim jo eficient sepse është përdorur një kombinim inputesh në sasi më të mëdha se ato të nevojshme. Në këtë mënyrë distanca

RP përgjatë rrezes OP mat inefficiencën teknike të një produkt që ndodhet në pikën P. Kjo distancë, RP, përfaqëson masën në të cilën duhet të reduktohen inputet e përdorura pa ndikuar në ulje të nivelit të prodhimit. Nëse bëjmë interpretim gjeometrik, inefficienca teknike e lidhur me pikën P mund të shprehet me raportin RP/OP dhe për rrjedhim *efiçenca teknike* (TE) e këtij prodhimi do të jepej nga raporti OR/OP , vlerat e të cilës ndodhen në kufijtë nga zero në një. Nëse ky raport është një do të thotë se firma është duke punuar në kushte të efiçencës së plotë teknike.

Efiçenca alokative lidhet me përzgjedhjen e një kombinimi inputesh që bën shpërndarjen e faktorëve atje ku arrihet vlera më e lartë e përdorimit të tyre dhe në lidhje me matjen e efiçencës produktive përdoret kostoja oportune për inputet. Efiçenca alokative gjithashtu mund të interpretohet tek figura 1. Vija e isokostos CC që kalon nga P, bazuar tek çmimet e tregut për inputet x_1 dhe x_2 janë (w_1, w_2) lidhet me barazimin $w_1 x_1 + w_2 x_2 = k_1$ dhe pjerrësia e kësaj vije paraqet raportin e çmimeve të inputeve. Kjo kosto mund të reduktohet më tej nëse lëvizim paralelisht derisa të kalojë tangent me izokuantin në pikën Q. Koordinatat e CC japin $w_1 x_1^* + w_2 x_2^* = k_0$ kombinimin e inputeve në sasi të tillë që siguron një kosto minimale për një nivel të caktuar outputi. Distancat relative të S dhe R mund të përcaktohen për të përfituar raportin OS/OR . Në kuadër të kombinimit me kosto më të ulët të inputeve në pikën Q, ky raport, (OS/OR) , tregon reduktimin e koston që mund të arrijë një prodhues nëse ai lëviz nga një pikë me efiçencë teknike por jo alokative (R) tek një pikë ku arrihen së bashku efiçenca teknologjike dhe ajo alokative (Q). Për këtë arsye efiçenca alokative që karakterizon prodhuesin në pikën P jepet nga raporti OS/OR .

Një tjetër matës i efijencës është *efijenca e kostos ose ekonomike*. Kjo efijencë përfaqësohet nga raporti i kostos minimale ($w x^*$) ndaj asaj aktuale ($w x_0$), $w x^* / w x_0 = OS/OP$. Një njësi ekonomike që punon në kushte të efijencës së kostos do të zgjedhë inputet në ato sasi dhe çmime që i sigurojnë minimizim të kostos totale. Inefijenca e kostos mund të shkaktohet nga 2 burime të ndryshme. Një nga mungesa e efijencës në aplikimin e teknologjisë (inefijencë teknologjike) dhe tjetra është shpërndarja jo optimale e burimeve (efijenca alokative). Bazuar tek kjo efijenca e kostos mund të paraqitet si prodhim i dy efijencave të veçanta (teknologjike dhe alokative):

$$\begin{aligned} \text{Efijenca e kostos} &= \text{efijencë alokative} \times \text{efijencë teknologjike} \\ &= OS/OR \times OR/OP \\ &= OS/OP \end{aligned}$$

2.3.2 Teoria ekonomike dhe shkaqet e efijencës

Me qëllim dhënien e lidhjes ndërmjet teorisë së firmës dhe literaturës për analizën e kufirit të efijencës, para trajtimit të metodave të kufirit të efijencës trajtohen disa teori të ndryshme në lidhje me firmën. Trajtimi do të jetë nën këndvështrimin e përgjigjes se pyetjes përse firmat mund të mos jenë në gjendje të përdorin në mënyrë efijente burimet e tyre.

2.3.2.1 Teoria konvencionale neoklasike e firmës

Konceptet e efijencës e kanë bazën e tyre nga teoria mikroekonomike e firmës. Teoria neo-klasike e firmës rrjedh nga korniza e ekuilibrit statik të prezantuar për herë të parë nga Cournot në vitin 1883. Teoria konvencionale neoklasike e firmës bazohet në supozimin se firma funksionon në kushte të një tregu me konkurrencë perfekte. Në këtë treg, qëllimi i aktivitetit të tyre është maksimizimi i fitimeve i cili është i lidhur me

maksimizimin e të ardhurave dhe minimizimin e kostos. Ekuilibri konkurrues në këto kushte arrihet duke barazuar normat marxhinale të zëvendësimit për të gjitha firmat ndërmjet dy variablave ekonomike (inpute dhe outpute) (Cohen and Cyert, 1975). Ekuilibri konkurrues bën që të gjitha firmat të arrijnë një fitim normal. Kjo do të thotë që firmat nuk mund të fitojnë më tepër sesa është e nevojshme për të mbuluar kostot ekonomike. Në periudha afat shkurtër, për disa firma individuale ka mundësi të arrihen fitime mbi normalen. Ekzistenca e një mundësie të tillë fitimi do të shërbejë si nxitje për firma të tjera për të hyrë në treg dhe të konkurojnë këto firma. Konkurenca ndërmjet tyre do të çojë në ulje të çmimit në treg deri në një pikë që përfaqëson fitime të njejta për të gjitha firmat në periudhë afatgjatë. Nëse ndonjë prej firmave që kanë hyrë në këtë treg nuk ka mundësi të sigurojë fitime normale për shkak të ineffiçencës në funksionim, atëherë për në periudhë afatgjatë, këto firma ineffiçente ose do të shkrihen me firmat e tjera ose do të tërhiqen nga tregu. Prandaj, sipas teorisë konvencionale neo-klasike të firmës, firma të cilat mund të shpërndajnë burimet në mënyrë efiçente për të prodhuar një nivel maksimal output për një sasi të dhënë inputi do të mbijetojnë dhe në të kundërt, firmat të cilat funksionojnë në kushte të mungesës së efiçencës do të tërhiqen nga tregu. Nëse shprehemi ndryshe, në tregje të konkurrencës perfekte, nëse firmat nuk arrijnë të funksionojnë në kufirin e efiçencës atëherë do të duhet të dalin nga tregu për të lenë në të vetëm firmat efiçente. Studime empirike të kryera në lidhje me këtë çështje, sygjerojnë se jo të gjitha firmat ndodhen përse i përket efiçencës në kufirin e efiçencës dhe një numër i tyre nuk prodhojnë në pikën ku kostot mesatare afatgjata janë në minimumin e tyre por përsëri ato arrijnë të qëndrojnë në treg. Kështu, teoria tradicionale neoklasike nuk arrin të shpjegojë përse firma jo efiçente arrijnë të mbijetojnë në treg dhe për këtë arsye janë zhvilluar teori të tjera si plotësuese të saj.

2.3.2.2 Teoritë menaxheriale të firmës

Ndër kritikak që i drejtohen teorisë konvencionale për maksimizimin e fitimit është se ajo qendron shumë larg realitetit të një ekonomie moderne në të cilën (për një pjesë të madhe të organizimeve) pronësia dhe kontrolli janë të ndara nga njera tjetra. Bazuar tek ky realitet u zhvillua teoritë menaxheriale e firmës. Tek secila prej tyre argumentohet se grupi menaxherial do të jetë i prirur të shkojë më tepër sipas interesave dhe dobishmërisë së vet sesa në drejtim të maksimizimit të fitimit të firmës edhe pse ata duhet të arrijnë disa kufij të vendosur në lidhje me fitimin. Nëse ilustrojmë nëpërmjet një shembulli, menaxherët e firmës janë më të interesuar për arritjen e atyre objektivave të cilat u japin atyre prestigj, pushtet dhe më tepër përfitime monetare. Duke vepruar në këtë mënyrë, kostot mund të mos jenë në nivelin e tyre minimal dhe në këtë mënyrë fillojnë të ngrejë njëfarë ngërçi në sistemin e kësaj firme (Breëster, 1997). Në përgjigje të këtyre mangësive janë zhvilluar modele të ndryshme për menaxhimin.

Në vitin 1970 teoritë menaxheriale të firmës marrin një zhvillim të ri. Në fokus të tyre vendosen koncepte të analizave primar-agjent (principal-agent analysis). Në bazë të këtyre analiza qendrojnë çështja e asimetrisë së informacionit dhe teoria e agjentit.

Në analizat principal-agjent Spence dhe Zeckhauser (1971) dhe Ross (1973) konsiderojnë firmën si një tërësi lidhjesh ose kontratash ndërmjet saj, principalit (kryesori) dhe nënkontraktorëve të tij dhe agjentit. Kryesorët (aksionerët) kontaktojnë agjentët (si të tillë konsiderohen menaxherët) duke pritur prej tyre që të punojnë për arritjen e maksimizimit të vlerës së firmës. Kjo sepse aksionerët, në këtë rast kryesorët, nuk zotërojnë njohuritë e duhura në lidhje me aktivitetin e firmës dhe rendimentin e mundshëm të saj. Nëse do të analizojnë agjentin, ai është superior ndaj kryetarit në lidhje me informacionin dhe njohuritë. Në kushte të tilla, të një asimetri informacioni,

është shumë e mundshme të krijohen probleme nga kryerja e “veprimeve të fshehura” ose “rreziku moral”. Agjentët përmbushin interesat e tyre (në lidhje me nivelin e pagës, kushtet e punës, sigurinë në punë etj.) duke qenë të pa kontrolluar nga kryetari sepse realisht ai/ata nuk ka/kanë mundësi për të ndjekur aktivitetin e tyre. Nëse do të kryhet një kontroll i tillë mbi agjentët (menaxherët) do të duhen kosto shtesë për ta të cilat konsiderohen si kosto të agjentit. Në lidhje me përbërjen e këtyre kostove Jansen dhe Meckling (1976) cilësojnë se ajo është shumë e shpenzimeve të monitorimit për shkak të kryetarit, shpenzime të lidhjes të cilat shkaktohen nga agjentët dhe vlera e mbetur e humbur e cila përballohet nga principalit dhe vjen si pasojë e problemeve në agjenci. Duke qenë i lidhur me agjentin, në kuadër të motivimit të tij nga ana e principalit mund të krijohen skema vlerësimi dhe shpërblimi. Në përfundim të të gjitha këtyre përpjekjeve për të zgjidhur problemet principal-agjent, rezultojnë kosto të cilat çojnë në uljen e fitimit të firmës dhe rrjedhimisht në funksionimin e saj në kushte të inefiçencës.

2.3.2.3 Teoritë e sjelljes

Teoritë e sjelljes së firmës bazuar tek ajo çfarë ndodh në praktikë vendosin në pikpyetje mundësinë, aftësitë e madje edhe dëshirën e firmave për të përmbushur objektivat e tyre. Ambienti në të cilin veprojnë këto firma i vë ato përballë pasigurisë dhe mungesës së informacionit. Duke analizuar aktivitetin e firmave nën këtë këndvështrim, Simon (1959) zhvilloi një teori në bazë të së cilës në procesin e vendimmarrjes duhet të sigurohet një racionalitet i kufizuar dhe i kënaqshëm, i pranueshëm në vend të përqendrimit dhe ecjes drejt maksimizimit të qëllimeve. Në mbështetje të kësaj duhet të kihet parasysh se individet dhe firmat nuk kanë mundësi reale të jenë racionalë sepse ata nuk janë në gjendje të zgjidhin probleme të ndryshme komplekse e njëkohësisht të analizojnë informacionin (Breëster, 1997). Në këtë mënyrë është më korrekte të

pranohet ekzistenca e një racionaliteti të kufizuar në vendim marrje. Bazuar tek ky interpretim i sjelljes në firmë dhe funksionimit të saj, nuk është e mundur të mbahen kostot në nivelin e tyre minimal dhe për rrjedhim nuk do të arrihet efizienz.

Mbështetur tek punimi e Simon (1959), në studimin e tyre Cyert and March (1963), e koncepton firmën si një bashkepunim ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm si pronarë, menaxherë, punonjës, klientë e kështu me radhë. Nga njëra anë janë të gjitha këto grupe të cilat kanë interesa apo objektiva të ndryshme me njeri- tjetrin, nga ana tjetër janë objektivat e firmës të cilat lidhen me prodhimin, inventaret, shitjen, pjesa e tregut dhe fitimi. Një pjesë e objektivave të këtyre palëve mund të jenë në kontradiktë me njëra tjetrën. Vendimmarrja brenda firmës është një proces i vazhdueshëm marrëveshje gjatë së cilës bëhen pagesa për të siguruar përputhshmëri ose për të përfshirë individët në nëngrupime. Duke vepruar në këtë mënyrë është e mundshme që firma të ndodhet para mospërputhjes së burimeve që ajo ka në dispozicion dhe pagesave që duhet të kryhen për të mbajtur në nivelin e tyre këta aktorë. Për shkak të cikleve të biznesit, progresit teknologji, firmat duhet që në mënyrë të vazhdueshme të përpiqen të mbijetojnë dhe ta mbajnë veten në kufirin e praktikve më të mira. Nën këtë mënyrë është e mundur që edhe firmat jo efizente të mund të mbijetojnë në treg deri në një nivel të caktuar të inefizencës (Dobb, 2000).

2.3.2.4 Teoria e efizencës X

Teoria e efizencës X prezanton një ndërthurje të teorisë së sjelljes dhe teorisë së dobishmërisë manaxheriale. Kjo teori është formuluar nga Leibenstain në një sërë studimesh (1966, 1975, 1977 dhe 1978). Efizienz X konsideron si efizente një firmë kur ajo bën transformimin me kosto minimale të inputeve për të marrë maksimum outputesh. Ai mban një qëndrim kritik ndaj teorisë neoklasike në lidhje me

maksimizimin e fitimit. Ai nuk është dakort me pohimin se firmat mund të arrijnë maksimizimin e fitimit, por se shumica e tyre në vend të kësaj maksimizojnë dobishmërinë manaxheriale (Demsetz, 1995).

Bazuar tek të dhënat, sipas Libenstein mund të identifikohen dy burime të mundshme të ineffiçencës: Njëra është efiçenca alokative që ka të bëjë me divergjencën ndërmjet çmimit dhe kostos marxhinale. Arsyeja e kësaj divergjence mund të jetë monopoli, tarifatat dhe pengesat e tjera për norma konkurruese të outputeve. Tjetra, quhet ineffiçenca X e cila rrjedh nga dështimi i biznesit për të arritur funksionin më të ulët të kostos për të prodhuar produktet e saj. Për pasojë në të ka humbje të kota të burimeve. Efiçenca X synon të analizojë sjelljen dhe marrëdhëniet brenda firmës, ndërveprimin e njerëzve më tepër sesa sistemin e çmimeve. Sipas Libenstein ineffiçenca që vjen nga ineffiçenca X është më e rëndësishme se ajo që vjen nga ineffiçenca alokative.

Brenda teorisë së ineffiçencës X del në pah se ideja kryesore e saj është identifikimi i sjelljes së mos maksimizimit. Shkalla e ineffiçencës X është së pari e përcaktuar nga nivelet e përpjekjeve të individëve brenda firmës. Problemi i marrëdhënieve principal-agent janë një burim i rëndësishëm i ineffiçencës X. Për më tepër, për shkak të tipareve të kontratave jo të plota, të kushtëzuara ndërmjet principalit dhe agentit, agjenti mund të shmanget pasojave të tejkalimit të kostove dhe nuk ka motivim për të mbajtur kostot në nivele të ulta. Për këtë arsye firma do të bëhet më tepër ineffiçente X.

2.3.3 Modelet dhe teknikat e vlerësimit të efiçencës

Përdorimi në mënyrë efektive dhe me efiçencë i burimeve përbëjnë objektivat kryesorë të aktivitetit të çdo institucioni financiar dhe rrjedhimisht çdo institucioni bankar. Këto çështje kanë qenë vazhdimisht ndër më të rëndësishmen në menaxhimin bankar.

Megjithatë, duhet theksuar se njësrë ngjarjesh të fundit nxjerrin në pah domosdoshmërinë e rritjes së analizave dhe studimeve për efikasitë e bankave dhe sistemit bankar në tërësi. Ndër ndryshimet në ambientin e jashtëm ku ushtrojnë aktivitetin e tyre institucionet bankare mund të përmendim rritja e konkurrencës në ofrimin e shërbimeve financiare, progresi në fushën e teknologjisë si edhe konsolidimi i bankave. Duke u nisur nga efekti që këto ndryshime kanë në rezultatin e aktivitetit bankar del në pah rëndësia e rritjes së vëmendjes ndaj kontrollit të kostove dhe efikasitë në sigurimin e shërbimeve dhe produkteve.

Rritja e konkurrencës ndërmjet institucioneve bankare si edhe ajo ndërmjet tyre dhe institucioneve jo bankare, zgjerimi i tregut vendos përherë e më tepër theksin tek përmirësimi i fitimeve dhe kontrolli i kostove nga ana bankave. Faktori kryesor që një bankë të vazhdojë të qendrojë konkurente në treg është efikasitë. Nga njësrë studimesh statistikore arrihet në përfundimin se bankat më efikasitë kanë ndjeshëm avantazhe kostojë dhe konkurrese ndaj atyre që kanë një nivel mesatar ose poshtë mesatares në lidhje me efikasitë.

Ndryshimet në fushën e teknologjisë në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe komunikimit të të dhënave janë një tjetër fakt që çon në rritjen e rëndësisë që ka efikasitë në menaxhimin bankar. Të gjitha bankat, pavarësisht nga madhësia e tyre mundohen të gjejnë mënyrat më të përshtatshme përsa i përket kostove në ofrimin e produkteve të reja dhe ruajtjes së pozicionit konkurrese në treg.

Një tjetër ndryshim i lidhur me rritjen e efikasitë është edhe bashkimi i cili kryhet nga institucionet bankare në funksion të rritjes së efikasitë. Nëpërmjet bashkimeve bëhet i mundur zgjerimi i bazës së shpërndarjes së kostove të operacioneve dhe zhvillimit të

produkteve. Në të njejtën kohë shmangen mbivendosje të shpenzimeve për zyra, personelin dhe të tjera shërbime.

Në studime të shumta akademike një vend i rëndësishëm i kushtohet matjes së efijencës së industrisë bankare, vlerësimit të kufirit të efijencës dhe matjes së ndryshimve ndërmjet bankave.

“Koncepti I aktivitetit ekonomik si një proces inputesh dhe outputesh është ndoshta koncepti bazë I ekonomiksit. Megjithatë ka paqartësi dhe lundin vështirësi kur na duhet të specifikojmë inputet dhe outputet e përfshira si edhe të përcaktojmë natyrën e transformimit që ka ndodhur” Boulding (1961).

Në këto studime konstatohet se është e vështirë të meret prej tyre një përcaktim i qartë i inputeve dhe outputeve të industrisë bankare. Triplett (1992) vë në dukje se vlerësimi i industrisë bankare është I rrezikuar nga moszgjidhja e pyetjes se cilat do të konsiderohen si inpute dhe cilat si outpute. Kjo çështje problematike është pjesë e studimit të Wykoff (1992):

“Nëse depozitat konsiderohen si outpute përse janë kaq të lira? Përse kur ato janë inpute njerëzit i çojnë ato në banka?”

Duke mbetur e pazgjidhur çështja e një përkufizimi të qartë dhe të prerë për inputet dhe outputet bankare, rezultatet e kërkimeve të ndryshme bëhen të pakrahasueshme. Nryshimet në përcaktimin se cilat klasifikohen si inpute dhe cilat si outpute nuk janë të vetmet që vështirësojnë vlerësimin e efijencës së bankave. Përveç tyre ndryshimi në të dhënat e përdorura, konceptet e efijencës dhe metodat e përdorura për vlerësimin kontribuojnë në vështirësimin e vlerësimit të efijencës.

Pavarësisht nga interesi në rritje për studime në industrinë bankare ende nuk ka një përkufizim të qartë për këto koncepte. Përpjekjet për këtë qëllim kanë filluar nga Sealey

dhe Lindley (1977), Colwell dhe Davids (1992) dhe më vonë nga Berger dhe Humphery (1997). Matja e këtyre treguesve paraqet vështirësi sepse mungon baza teorike për këto përkufizime. Për të ilustruar këtë mendim sjellim shembullin e modelit të prodhimit. Bankat trajtohen si firma të cilat përdorin kapital dhe punë për të prodhuar kategori të ndryshme të llogarive të depozitave dhe të huave. Ndërkohë që nga këndvështrimi i modelit të mjeteve (aseteve), bankat shihen si ndërmjetës të shërbimeve financiare më tepër se prodhues të shërbimeve të huave dhe llogarive të depozitave. Në këtë rast, vlera e huave dhe investimeve përdoret si masë për vlerësimin e outputit, puna dhe kapitali konsiderohen si inpute të këtij procesi. Të dy këto modele në thelb janë të njëjta. Ndryshimi ndërmjet tyre vjen nga mënyra se si trajtohen outputet. Tek modeli I mjeteve (ose I ndërmjetësimit) përdoret vlera në vend të sasisë.

2.3.3.1 Përkufizimi dhe modelet e vlerësimit të inputeve dhe outputeve bankare

Në lidhje me përkufizimin se çfarë përfshihet tek outputet bankare ka një diskutim ende të hapur. Pavarësisht nga interesi në rritje për studime në industrinë bankare ende nuk ka një përkufizim të qartë për këto koncepte.

Sipas Frisch (1965) prodhimi përkufizohet “si një proces transformimi i drejtuar nga njeriu dhe i dëshiruar për disa individë”. Në qendër të këtij përkufizimi është transformimi i cili konsiderohet si një proces gjatë të cilit produkte apo shërbime të caktuara (të cilat quhen inpute) që marrin pjesë në të “humbin identitetin fillestar”, formën e tyre origjinale ndërkohë që prej tij dalin produkte apo shërbime të tjera. Mënyra e trajtimit dhe përkufizimet për inputet dhe outputet të dhëna sipas këtij autori gjejnë zbatim në sektorin e prodhimit dhe atë të bujqësisë.

Por, nëse marrim në konsideratë sektorin bankar situata nuk është e njëjtë me sa më sipër. Në institucionet bankare, procesi prodhimit, i transformimit të inputeve, përfshin

përdorimin e depozitave dhe të mjeteve të tjera në zotërim të tyre. Outputet bankare, në ndryshim nga outputet e njësive të prodhimit, mund të përcaktohen saktë nga pikpamja sasiore vetëm nëse japim fillimisht një qëllim të qartë të ushtrimit të aktivitetit.

Ndër shërbimet kryesore që institucionet bankare ofrojnë për klientët e tyre mund të përmenden sigurimi i mjeteve me risk të ulët, shërbime të kredisë dhe pagesave duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm si ndërmjetësuese në orientimin e fondeve nga individë apo subjekte me tepricë fondësh tek ata me mungesë të tyre. Përveç këtyre shërbimeve ato ofrojnë gjithashtu edhe shërbime jo-monetare. Ndër to mund të përmendim mbrojtjen e objekteve me vlerë, ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit dhe drejtimin e portofolit të investimeve (Colëll and Davis (1992)).

Për nga natyra e tij, prodhimi në sektorin bankar është mjaft i integruar dhe kjo karakterisitë e tij e bën të vështirë përcaktimin e matjes së outputeve¹⁸. Arsyeja e kësaj vështirësie konceptuale në lidhje me outputet qendron kryesisht tek të karakteristika e tyre si të paprekshme po ashtu edhe tek mungesa e trajtimit teorik të një strukture prodhimi multi-input multi-output.

Gjithsesi, autorë të ndryshëm, në lidhje me matjen e outputeve bankare, kanë përdorur tre metoda alternative: e mjeteve (asset approach), kostos së përdorimit dhe ajo vlerës së shtuar (value-added).

i. Modeli i mjeteve (asset approach) ose i ndërmjetësimit

Në qoftë se bëjmë një përgjithësim të aktivitetit bankar dhe produkteve që prodhohen prej tij mund të cilësojmë faktin se detyrimet bankare përbëjnë lëndën e parë për fondet e investimeve e në këtë mënyrë arsyetimi do të duhet të pohojmë se ato kanë karakteristika të inputeve. Në anën tjetër, do të duhet të pohojmë se mjetet kanë

¹⁸ Fixler and Zieschang 1992; Beger and Humphrey 1992a)

karakteristikat e outputeve sepse janë përdorimet e fundit të fondeve të cilat sigurojnë të ardhurat direkte që fiton banka. Sipas modelit të mjeteve, bankat janë pranuese të depozitave dhe duke luajtur veçse rolin e nëpërmjetësit financiar I transformojnë ato në hua për klientët e tyre. Huatë dhe mjete e tjera (të aktivitetit të bilancit të një banke) konsiderohen si outpute bankare; depozitat dhe detyrimet e tjera (elemente të pasivit) konsiderohen si inpute në procesin e ndërmjetësimit (Sealey and Lindley 1977). Një klasifikim i tillë i lëndës së parë dhe produkteve bankare është mjaft i përshtatshëm për disa banka të mëdha, të cilat fillimisht i blejnë fondet e tyre (me pagesë interesi për to) nga banka të tjera dhe depozitorë dhe i transformojnë këto fonde në hua. Por, duhet pasur parasysh fakti se shumica e bankave nuk ngelen vetëm në këtë aktivitet, thjesht blerje e fondeve. Ato sigurojnë edhe mjaft shërbime të tjera të rëndësishme për depozitorët e tyre. Këto shërbime nuk janë pjesë e outputeve bankare në rastin e modelit të mjeteve. Në përbërje të inputeve, sipas këtij modeli, janë puna, materialet dhe depozitat ndërsa në përbërje të outputeve janë huatë dhe aktivitetet e tjera të cilat sigurojnë të ardhura (Mester 1997). Sipas modelit të mjeteve (apo ndërmjetësimit) dalin në pah dy role të rëndësishme të bankave në arritjen e futjes së investimeve në ekonomi: mobilizimi dhe shpërndarja e burimeve në mënyrë efikase. Ky model ka dy nën grupe kryesore: (1) modeli i fitimit dhe (2) modeli i menaxhimit të rrezikut

1.1 Modeli i fitimit

Modeli i fitimit është i njohur ndryshe në literaturë si modeli i kostos së përdorimit. Sipas këtij modeli përcaktimi nëse një produkt financiar është input apo output bazohet në kontributin neto të tij në të ardhurat e bankës. Në rast se do të rezultonte që të ardhurat financiare në një mjet do të ishin më të larta se kostoja oportune e fondeve, instrumentat e përfshirë do të konsiderohen si outpute bankare. Nëse rezulton e kundërta

e kësaj situate atëhere do të konsideroheshin si inpute bankare (Hancock 1985). Sipas këtij modeli, kthimi varet nga çmimi dhe kushtet e tregut të këtij produkti financiar. Në këtë mënyrë, gjatë rënieve ekonomike, shumë produkte do të cilësohen si inpute dhe kjo e bën këtë përkufizim të papërshtatshëm.

Analiza e efikasitetit ekonomike të një banke kryhet shpesh duke përdorur modelin e fitimit apo atë të kostos. Sipas modeli të fitimit, qëllimi i menaxherëve të bankës është maksimizimi i funksionit të fitimit. Menaxherët duhet të analizojnë dhe vlerësojnë njëkohësisht si të gjitha tipet e kostove ashtu edhe ato të të ardhurave në procesin e prodhimit. Në këtë mënyrë ky model vlerëson njëkohësisht ineffikasitetin e inputeve dhe outputeve.

1.2 Modeli i menaxhimit të riskut

Ky model përdoret për të vlerësuar rrezikun me të cilin lidhen forma të ndryshme të mjeteve bankare. Nëpërmjet menaxhimit të rrezikut, bankat marrin përsipër disa rreziqe për të siguruar disa kthime të pranueshme prej tyre. Efektiviteti në aktivitetin e një banke do të ndikojë në vlerësimin e saj në treg, mundësinë dhe aftësinë e saj për të marrë banka të tjera apo për tu kërkuar nga të tjera për shkrirje me një çmim të mirë, po ashtu edhe mundësinë për tu financuar në tregun e depozitave apo edhe atë financiar (Mester 1996; Heshmati 1997). Modeli i menaxhimit të rrezikut mund të shihet në këndvështrimin e klasifikimit input dhe output duke e konsideruar procesin e vendim marrjes të menaxhimit dhe zbatimin e tij si input dhe nga ana tjetër, vlerën e aksionerëve dhe fitimin bankar si output.

1.2 Modeli i vlerës së shtuar (value-added approach)

Sipas këtij modeli (i cili njihet edhe si modeli i prodhimit ose sigurimit të shërbimeve), bankat ofrojnë shërbime për konsumatorët nëpërmjet administrimit të transaksioneve

financiare të tyre, mbajtjes së depozitave, dhënies së huave, likuidimit të çeqeve dhe menaxhimit të mjeteve të tjera. (Berg et al.1991; Berg et al.1993; Parson et al.1993). Ndryshimi ndërmjet këtij modeli dhe atyre të prezantuara më parë qendron në vendosjen në të gjitha mjetet dhe detyrimet karakteristika të outputeve në vend të ndarjes së tyre si inpute dhe outpute në mënyrë reciproke dhe ekskluzive. Analiza e efektivitetit dhe efijencës mund të kryhen mëpërmjet krahasimit të sasisë së shërbimeve të ofruara dhe sasisë së burimeve të përdorura. E shprehur në këtë mënyrë, duke përdorur konceptin e rrjedhjes nga burime tek shërbime, ky model ndjek atë standard të prodhimit. Nga aplikimi I modeli të vlerës së shtuar në studime të lidhura me koston në industrinë bankare identifikojnë kategoritë kryesore të depozitave të prodhuara dhe të huave si outpute të rëndësishme. Një cilësim i tillë për to kryhet duke u nisur nga fakti që ato japin kontributin më të madh në vlerën e shtuar. Fondet e blera, (fondet qeveritare, certifikatat e depozitave, depozitat e huaja, detyrimet e tjera për shumat e marra borxh), trajtohen si inpute financiare për procesin e ndërmjetësimit bankar. Arsyeja e këtij klasifikimi është sasia e vogël e inputeve fizike (punë dhe kapital) që kërkohet prej tyre.

ii. Teknikat e vlerësimit të efijencës

Në mjaft studime të lidhura me inputet dhe outputet bankare përdoren 2 modele teknikash vlerësimi: **(a)** jo-parametrike dhe ato **(b)** parametrike. Këto modele vlerësimi mund të grupohen në pesë kategori të ndryshme. Dy prej tyre jo-parametrike Data envelopment analysis (DEA) dhe free disposal hull (FHD) ndërsa tre kategoritë e tjera cilësohen si parametrike **(i)** Data envelopment analysis (DEA), një model jo-parametrik, i cili përdor teknika të programimit linear të cilat nuk marrin në konsideratë gabime të rastësishme. Kjo metodë përdoret për të përlogaritur efijencën teknike. Firma efijente janë ato të cilat prodhojnë më shumë output për një nivel të dhënë inputi ose

përdorin më pak input për një nivel të dhënë output në krahasim me firmat e tjera (Rangan et al. 1988; Elysiani and Mehdiian 1990; Berg et al. 1993). **(ii)** free disposal hull (FHD), është një tjetër teknikë jo-parametrike dhe jo-stohasitke e cila mund konsiderohet si një përgjithësim i variablilit të analizës së (data envelopment analysis) – model i kthimeve të shkallës. Sipas këtij modeli nuk duhet që kurba vlerësimit të jetë kovekse (Tulkens 1993; Tulkens and Malnero 1994). **(iii)** modeli i kufirit (stochastic forntier approach SFA, është një metodë e cila bazohet në supozimin se termi i gabimit përfshin dy pjesë ose është një term i përbërë. Bazuar tek ky model, ineffiçienca supozohet se ndjek një shpërndarje asimetrike, zakonisht kjo është gjysëm normale, ndërkohë që gabimi i rastit ndjek një shpërndarje simetrike (Ferrier and Lovell 1990). **(iv)** The thick frontier approach (TFA) është një model i ngritur nga Berger and Humprey (1991) krahason një mesatare të efiçencës së grupeve të firmave në vend të vlerësimit të kufirit të efiçencës (Baurer et al. 1993; De Young 1994; Lang and Eelzel 1996; Clark 1996). **(v)** Modeli i shpërndarjes së lirë (DFA the distribution free approach) e cila merr në konsideratë mesataren e vlerave e mbetura të funksionit të kostos të vlerësuar me panelin e të dhënave për të ndërtuar një masë për kufirin e efiçencës së kostos. Sipas këtij modeli nuk përcaktohet një formë specifike në shpërndarjen e efiçencës por supozohet se ka një nivel mesatar të efiçencës për çdo firmë e cila është konstante me kalimin e kohës. Në këtë sesion do të bëhet një prezantim i përgjithshëm i teknikave që lidhen me matjen e efiçencës.

Metodat që mund të përdoren për vlerësimin e efiçencës së bankës mund të ndahen në metoda të mbështetura tek raportet financiare dhe ne ato të kufirit të prodhimit. Këto të fundit përfshijnë dy modelet parametrike dhe ato jo parametrike. Në modelet parametrike zakonisht aplikohet një kufi stohastik ndërsa tek metodat jo parametrike

përdoret teknika e programimit linear e quajtur "Data Envelopment Analysis (DEA)". Metoda e matjes së efijencës bankare nëpërmjet raporteve financiare mer në konsiderate një input dhe një output ndërkohë që industria bankare karakterizohet nga shumë inpute dhe outpute. Në një situatë të tillë, kur ka më shumë sesa një input dhe output, duhet të bëhet përmbledhja e tyre në një indeks të vetëm për të përcaktuar një raport për matjen e efijencës. Metodat parametrike bëjnë supozime në lidhje me funksionin e prodhimit dhe atë të kostos; ato gjithashtu supozojnë se shpërndarja probabilitare e termit të gabimit është normale.

2.3.4 Konkluzion

Efijenca është një tregues mjaft i rëndësishëm për vendet të cilat gjatë dekadave të fundit kanë ngritur një sistem të ri financiar. Analiza e efijencës bankare kërkon analizë të efijencës së kostos, të ardhurave dhe fitimit. Ky punim do të përdorë efijencën e kostos për të vlerësuar marrëdhënien e saj me kapitalin dhe rrezikun në bankat e nivelit të dytë që aktualisht operojnë në Shqipëri. Nga literatura njihen pesë metodat e ndryshme që mund të përdoren për vlerësimin e efijencës bankare. Dy prej tyre janë metoda joparametrike dhe tre të tjerat parametrike. Metoda që do të përdoret në këtë punim është Analiza e Kufirit Stokastik (Stochastic Frontier Analysis) e cila është një prej metodave parametrike më të përdoura në këto lloj vlerësimesh dhe analizash. Në lidhje me përkufizim e inputeve dhe outputeve bankare ka disa modele. Përcaktimi i inputeve dhe outputeve bankare do të kryhet sipas modelit të mjeteve (ose ndërmjetësimit). Modeli I ndërtuar për vlerësimin e efijencës së kostos do të nxjerrë në pah se cilët outpute, ndër ata të përzgjedhur si variabla të pavarur në këtë vlerësim, janë më të ndjeshëm ndaj kostos.

2.4 Rrjeta e sigurisë financiare

Sigurimi i depozitave luan një rol të rëndësishëm në rrjetën e sigurisë financiare të një vendi. Për këtë qëllim është me vend të bëhet një prezantim i shkurtër i asaj që nënkupton një rrjetë e tillë dhe cila është arsyeja e krijimit të saj në shumë vende.

Për vitalitetin ekonomik të një vendi një rëndësi të veçantë ka prezenca e një sistemi bankar të shëndetshëm dhe konkurrues. Bankat kanë një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin huadhënësve dhe huamarrësve duke përdorur fondet likuide afatshkurtra në për të financuar aktivet afatgjata jolikuide. Bankat luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e rritjes ekonomike sepse ato nga njëra anë sigurojnë një mundësi kursimi për investitorët e mëdhenj apo të vegjël dhe nga ana tjetër kanë zhvilluar aftësi për të vlerësuar dhe diversifikuar rrezikun e huamarrësve. Bankat gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm për sistemin e pagesave, janë një element i rëndësishëm për të drejtuar politikën monetare të cilat nëpërmjet institucioneve financiare dhe tregut arrijnë të ndikojnë në ekonomi. Janë pikërisht këto role të cilat i luajnë bankat që diktojnë tek qeveritë nevojën për përgatitjen e marrëveshjeve për rrjetën e sigurisë në funksion të politikave publike në lidhje promovimin e rritjes ekonomike dhe stabilitetit financiar. Natyra e këtyre marrëveshjeve mund të jetë e ndryshme por ato të gjitha konvergjojnë në kombinimin e: (1) aksesit bankar tek huadhënësi i fundit¹⁹; (2) kryerjen pa rrezik të transaksioneve të sistemit të pagesave (3) mbikëqyrja e kujdesshme e bankave; dhe (4) sigurimi i depozitave. Në vijim do të fokusohemi tek një prej elementëve të rrjetës së sigurisë financiare, roli dhe efektet e sistemit të sigurimit të depozitave.

¹⁹ Si i tillë konsiderohet një institucion, zakonisht banka qendrore e një vendi, që ofron kredi bankave ose institucioneve të tjera që kanë vështirësi financiare ose konsiderohen me nivel të lartë rreziku ose afër falimentit.

Kriza e fundit financiare, përveç të tjerash, shërbeu edhe si testuese e skemave të aplikuara për sigurimin e depozitave dhe njëkohësisht aftësinë e tyre për mbrojtur depozituesit e kursimeve të tyre familjare në ndërmjetësit financiare banka. Organet drejtuese të vendeve të ndryshme si edhe rregullatorët financiarë ndërhyjnë duke zgjeruar mbulimin e ofruar në marrëveshjet ekzistuese që lidheshin me sigurimin e depozitave ose, në rastet kur nuk kishte të tilla, duke miratuar sigurimin e depozitave. Qëndrimet e ndryshme, të mbajtura në përgjigje të krizës, nxorrën në pah efektet negative të një skeme bujare mbështetëse dhe njëkohësisht pikat e forta dhe të dobëta të veçorive që kanë skema të ndryshme të sigurimit të depozitave (Kane dhe të tjerë , 2014). Sipas konkluzioneve të studimit të këtyre të fundit, në lidhje me aplikimin e skemave të sigurimit në nivel botëror, marrëveshjet e sigurimit të depozitave kanë qënë të efektshme në mbrojtjen e një mase të gjerë të depozitorëve. Në anën tjetër, ato nuk janë vlerësuar asnjëherë në mënyrë të saktë dhe pikërisht ky nënvlerësim, ose nënçmim, mund të shërbejë si nxitëse për bankat që në të ardhmen, ashtu si në të shkuarën, të ndërmarin rreziqe që mund të çojnë në dështimin e tyre. Zgjerimi i rrjetës së sigurisë, gjatë krizave, ngre dyshimin në lidhje me mundësinë reale që kanë vendet për të përmbushur detyrimet e tyre dhe rritjen e rrezikut moral.

Bazuar tek roli që kanë bankat në ekonominë e vendit, analiza në kuadrin rregullator dhe operacional i sigurimit të depozitave është me rëndësi të veçantë. Bankat janë ndërmjetësit e shpërndarjes së fondeve; janë pjesë e sistemit të pagesa dhe luajnë një rol të rëndësishëm në transmetimin e politikave monetare. Rreziqet para të cilave ato janë të ekspozuara, mund të sjellin humbje për depozitorët, por jo vetëm. Kur nuk merren masat e duhura për zvogëlimin dhe menaxhimin e tyre, ato mund të kthehen në një kërcënim

për gjithë sistemin financiar. Pikërisht për të parandaluar ngjarje të tilla është e domosdoshme prezenca e një rrjete sigurie financiare, që nënkupton një rregullim dhe mbikqyrje të kujdesshme. Një organizim i mirë i rrjetës së sigurisë kontribuon në rritjen e stabilitetit të sistemit financiar, rolit ndërmjetës të bankave, sistemin e pagesave dhe transmetimin e politikave monetare. Por, krahas këtyre efekteve pozitive që transmeton rrjeta e sigurisë, ajo gjithashtu mund të bëhet shkaktare e rritjes së rrezikut moral. Siguria që jep tek depozituesit dhe huadhënësit skema e sigurimit të depozitave, i bën ata më pak të interesuar për të marrë informacion dhe për të monitoruar sjelljen e bankave. Si rezultat e këtyre, bankat të ndjerë të mbrojtura, mund të ndërmarrin më tepër rrezik.

Për të ndikuar në uljen e rrezikut moral ka metoda të ndryshme, të cilat kanë anët e tyre pozitive dhe negative. Për arritjen e rezultateve sa më të efektshme në aplikimin e rrjetës së sigurisë duhet: *Së pari*, monitorim i pjesëmarrësve në këtë rrjetë mbështetur në rregullore dhe mbikqyrje shumë të kujdesshme. *Së dyti*, një qeverisje e mirë e bankave individuale dhe një menaxhim i mirë i rrezikut nga ana e tyre mbështetur në strategjitë e tyre të biznesit të cilat duhet të jenë në përputhje me ndërmarrjen e operacioneve të sigurta dhe të shëndet. *Së treti*, disiplinë efektive e tregut të ushtruar nga depozitorët jo të mbuluar dhe kreditorët e tjerë. Përveç këtyre udhëzimeve, elementë të veçantë të skemës së sigurimit të depozitave, siç janë kufiri limit i mbulimit, përjashtimi i kategorive të caktuara të depozitave, marrëveshjet e risigurimit, primi i sigurimit i bazuar në nivelin e rrezikut, konsiderohen si të rëndësishëm në uljen e rrezikut moral.

2.4.1 Sigurimi i depozitave: roli i saj në rrjetën e sigurisë

Bankt janë institucione financiare që luajnë një rol të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të politikës monetare dhe në ndërmjetësimin financiar në ekonomi. Ato

gjithashtu janë të ekspozuara ndaj rrezikut të likuiditetit dhe dështimit, të cilat mund të shkaktojnë humbe ndaj depozituesve. Sigurimi i depozitave është shumë i rëndësishëm për institucionet bankare dhe njëkohësisht një komponent mjaft i rëndësishëm i rrjetës së sigurisë financiare.

2.4.1.1 Avantazhet dhe disavantazhet e sistemit të sigurimit të depozitave

Sigurimi i depozitave jep garanci për depozituesit se nuk do të humbin. Si rezultat i kësaj, mund të thuhet se sigurimi i depozitave ka në një fare mënyre efekte kontradiktore. Efekti pozitiv qendron në shmangien e përfshirjes në falimentim ndërsa ai negativ është tërheqja e depozituesve nga monitorimi i sjelljes së bankës në lidhje me ndërmarrjen e rreziqeve. Sigurimi i depozitave, duke ofruar mbrojtje për individet apo bizneset e vogla, bën ëq ata të ndihen të sigurt në lidhje me fondet e tyre. Një qëndrim i tillë është shumë i rëndësishëm për sigurinë publike dhe shumë pozitiv përsa i përket stabilitetit të ekonomisë .

Siguria publike e lidhur me sigurinë e depozitave bankare siguron stabilitet për institucionet bankare, ul mundësinë që depozitorët e tyre të drejtohen me panik për të tërhequr menjëherë fondet e tyre. Një mbrojtje, siç është ajo e krijuar nga sigurimi i depozitave, nga reagime të tilla të depozituesve nuk mund ta krijojë asnjë formë mbikqyrje sado e kujdesshme të jetë ajo. Një tjetër efekt pozitiv në lidhje me depozitat e sigurisë është mundësia e përdorimit dhe vendosjes në të njëjtin nivel i institucioneve të vogla dhe atyre të mëdha. Të gjitha këto institucione mund të ofrojnë mbrojtje për depozituesit e tyre sipas kushteve të përcaktuara në skemën e sigurimit të depozitave. Së fundi, rregullat e kësaj skeme japin siguri shtesë në lidhje me procedurat e zgjidhjes për bankat e falimentuara dhe luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit në momente kur bankat janë të kërcënuara nga kriza. Sigurimi i depozitave si pjesë e

elementëve të rrjetës së sigurisë mbështet stabilitetin ekonomik duke mbrojtur institucione të veçanta apo grup institucionesh nga rreziqe të mundshme (siç janë ai i likuiditetit apo i kredisë).

Të gjithë elementët e rrjetës së sigurisë financiare, pjesë së cilës është sigurimi i depozitave, ndikojnë në stabilitetin dhe rrjedhimish nxisin rritjen ekonomike. Por megjithatë ato mund të japin edhe efekte negative. Duke dhënë siguri dhe mbrojtje për pjesëmarrësit në treg, sigurimi i depozitave, bën të mundur që kostot e ndërmarrjes së strategjive më të rrezikshme të bëhen më të ulta. Si rezultat, bankat kanë nxitje për të ndërmarrë më tepër rrezik - problemi i rrezikut moral. Tashme, të siguruar për fondet e tyre, depozituesit nuk janë më të interesuar të monitorojnë aktivitetin e bankës, por të marrin më tepër kthime, të cilat, mund të sigurohen me më tepër rrezik. Një sjellje të tillë është prezente në të gjitha llojet e sigurimeve, madje edhe modele më të mira strukturore të sistemeve të sigurimit të depozitave nuk mund të eliminojnë rrezikun moral. Për këtë qëllim, për të ruajtur sigurinë dhe shëndetin e sektorit bankar, mbikqyrja dhe rregullimi i institucioneve të siguruara janë thelbësore për kontrollin e rrezikut moral.

Duhet të theksojmë ndryshimin ndërmjet ruajtjes së stabilitetit dhe masave për parandalimin e dështimit. Krahas rolit pozitiv që ka rrjeta e sigurisë, prezenca e saj mund të ndikojë në frenimin e inovacionit dhe të përgjigjes së industrisë bankare ndaj ndryshimeve në nevojat e konsumatorëve.

2.4.1.2 Tipet e sistemeve të sigurimit të depozitave

Sigurimi i depozitave mund të jetë i qatë (eksplicit) ose i nënkuptuar (implicit). Sipas Kunt dhe Kane (2006) mbroja e depozitave sipas sistemit të qartë (eksplicit) nënkupton detyrime kontraktuale ndërsa sipas atij të nënkuptuar (implicit) mbulimi është hipotetik.

Ai vjen si rezultat i stimujve politikë, që ndikojnë qëndrimin e qeverive për të ndërhyrë në rast problemesh të mëdha në sektorin bankar, bëhet e pashmangshme aplikimin e një pakete shpëtimi për bankat e ndodhura në paaftësi paguese.

a. Sigurim i nënkuptuar (implicit) i depozitave

Nën rastin e një sistemi të nënkuptuar të mbrojtjes së depozitave, mbrojtja për depozituesit varet nga vullneti i qeverisë (Garcia 2000). Ky është një sistem i cili nuk bazohet në ligje ose rregullore formale të cilat përcaktojnë mënyrën e kompensimit të depozituesve në rastin e dështimit të një banke. Forma e mbrojtjes si edhe shuma e rimbursimit bazohen në një vendim adhoc të bërë vetëm nga qeveria e cila është njëkohësisht përgjegjëse për financimin e depozituesve. Sipas këtij sistemi, qeveria mund të bëjë pagesa të drejtpërdrejta për depozituesit; ose të bëjë të mundur kalimin e depozitave të dështuara të njëjës bankës në një bankë tjetër; të mundësojë ose lehtësojë shkrirjen e një banke me probleme me një bankë të shëndoshë; të ndërhyjë me paketë shpëtimi në bankën me probleme nëpërmjet injektimit direkt të kapitalit shtesë. Një nga mangësitë e këtij sistemi është pasiguria që ai ofron në lidhje me mënyrën se si dhe kur do të kompensohen depozituesit sepse ky financim varet nga mundësia e qeverisë për të siguruar fonde për një ndërhyrje të tillë në rast dështimi të bankës/bankave.

b. Sigurimi i qartë (explicit) i depozitave

Në rastin e aplikimit të një skeme të qartë të sigurimit të depozitave, ndodh e kundërta e sistemit të nënkuptuar. Ky sistem mbështetet në ligje dhe rregulla të caktuara që parashikojnë garancitë e depozitave dhe paraqesin elementët kryesorë të kësaj forme mbrojtje: kufiri i mbulimit; nëse dhe si do të kryhet mbulimi i humbjeve; si duhet të paguhet depozituesit në rast dështimi; formën e anëtarësimit në skemën e sigurimit të depozitave, të detyrueshën apo vullnetar; përcaktimi i llojeve të institucioneve dhe

depozitave të përshtatshme për këtë mbrojtje. Këto tipe sistemesh krijohen me Akte Parlamentare.

Sistemet e qarta të mbulimit të depozitave, mund të ofrojnë mbulim të plotë ndaj depozituesit ose të kufizuar. Kjo e fundit është aktualisht më e përhapur sesa mbrojtja e nënkuptuar. Por duhet përmendur se aplikimi i një sistemi të tillë nuk e përjashton aplikimin e sistemit të nënkuptuar të mbrojtjes. Kjo mund të ndodhë në rastin e një krize sistemike.

Ky sistem konsiderohet se ndihmon qeverinë në përmbushjen e detyrime të saj ndaj depozituesve, kufizon mundësinë për vendime të mara në varësi të vullnetit të qevverisë dhe rrit besimin e publikut, duke krijuar një panoramë të qartë të zgjidhjes së situatës së krijuar në rast dështimi të bankës/bankave, ndikon në rritjen e stabilitetit financiar.

Ky sistem ka të përcaktuar edhe rastet kur nuk do të ofrohet mbështetja, përjashtimin nga skema e sigurimit të depozitave. Ndër to përmendim pjesën mbi kufirin limit të sigurimit të depozitave, nuk do të ndërhyhet në rast konstatimi të rrezikut moral. Depozituesit e mbrojtur në këtë mënyrë do të shfaqin qendrimë indiferente ndaj monitorimit të aktivitetit të bankës, njëkohësisht edhe bankat mund të kenë më tepër nxitje për të rritur nivelin e rrezikut që ndërmarrin.

2.4.1.3 Sistemet e sigurimit të depozitave në botë

Në tabelën më poshtë, jepen informacione të mare nga të dhënat e Unionit Ndërkombëtar të Sigurimit të Depozitave: viti kur ka filluar aplikimi i skemës së depozitave për çdo vend; sistemi që aplikohet për këtë qëllim; nëse institucioni i autorizuar për këtë qëllim është i pavarur apo publik; numri i institucioneve të përfshira në skemën e sigurimit; shuma e siguruar e depozitave. Mbështetur tek të dhënat e Tabela 5.2-2, sistemi i sigurimit të depozitave ka filluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në

vitin 1933 dhe ka vijuat të shtrihet në shumë vende të tjera gjatë viteve '90. Në shumicën e vendeve, sigurimi i depozitave kryhet me ndërmjetësimin e një autoriteti të pavarur ose nga Bankat qendrore. Ndryshimi në limitet e shumës së siguruar të depozitave sipas shteteve të ndryshme varet nga politikat e qeverive përkatëse si edhe nga fuqia ekonomike dhe investuese e tyre.

2.4.2 Sistemi i sigurimit të depozitave në Shqipëri

Skema e sigurimit të depozitave është një nga shtyllat kryesore të rrjetit të sigurisë financiare.

Në Shqipëri, sigurimi i depozitave rregullohet me ligjin "Për sigurimin e depozitave" Nr. 53/2014 datë 22.05.2014. Skema e aplikuar është ajo eksplicite (i qartë). Mbështetur në këtë ligj, që prej vitit 2002 institucioni përgjegjës për administrimin e skemës së sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë është Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD). Niveli maksimal i sigurimit të depozitave për çdo bankë është 2.500.000 lekë, në rast se banka nuk është në gjendje të paguajë për to.

Ligji për sigurimin e depozitave është hartuar me qëllim zhvillimin dhe rritjen e integritetit të skemës së sigurimit të depozitave të individëve në banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit në vendin tonë. Hartimi i tij është kryer në përputhje me praktikën më të mirë të vendeve anëtare të BE-së (përafrim legjislativ me Direktivën 94/19/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Mbi skemat e garantimit të depozitave, të ndryshuar me Direktivën 2009/14/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit) në vitin 2014 u propozua një projektligji tërësisht i ri. Ai mbështetet në Parimet Themelore të Skemave Efektive të Sigurimit të Depozitave të Organizatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI) si edhe siguron përmbushjen e Standardeve Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave.

Ndryshimet kryesore në projektligjin e vitit 2014 prekin edhe përfshirjen e shoqërive të kursim-kreditit në skemën e sigurimit të depozitave, duke i trajtuar ato në mënyrë të diferencuar në krahasim me bankat për sa i përket primit dhe mbulimit. Për këto të fundit primi sipas këtij ligji është më i ulët, 0.3 % (ndërkohë që bankat e kanë, 0.5%. Në rastet e thyerjes nga shkk-të e treguesve kryesorë rregullatorë aplikohet prim shtesë). Niveli i mbulimit 1 000 000 lekë (bankat 2.5 milionë lekë).

Të gjitha bankat e licensuata nga Banka e Shqipërisë janë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Anëtarësimi i tyre është i detyrueshëm. Mbështetur në ligjin "Për sigurimin e depozitave", si përmendur më lart, përfitues e kësaj skeme është çdo depozitues: individ, tregëtar dhe shoqëri tregëtare, rezident ose jorezident, shqiptar ose i huaj, i cili ka depozitë në një bankë në lekë ose në monedhë të huaj. Ligji përcakton kompetencat dhe funksionet e institucioneve publike në skemë dhe subjekteve anëtare të saj me qëllim kompensimin e depozitave të depozituesëve, mbrojtjen e interesave të tyre duke kontribuar kështu në stabilitetin e sistemit bankar dhe financiar.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2018 ka siguruar depozitat e depozituesve në 16 bankat e sistemit, si dhe në 6 shoqëri kursim-krediti. Nga data 1 tetor 2018, si rezultat i bashkimit me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. me Bankën NBG Albania, si dhe të bashkimit me përthithje të Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a., me Veneto Banka sh.a., numri i bankave që sigurohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave është 14. Në fund të vitit 2018 totali i depozitave në sistemin bankar është 1,121 mld lekë, ndërsa totali i depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit është 6.9 mld lekë. Depozituesi në çdo bankë apo në çdo degë të bankës së huaj sigurohet në masën 100 për qind, por në çdo rast jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, ndërsa depozituesi në shoqëritë e kursim-kreditit sigurohet në masën 100 për qind,

por në çdo rast jo më shumë se 2 000 000 (dy milionë) lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre, të depozituara në këtë SHKK. Nga 1 janari i vitit 2017²⁰, skema ofron siguri për më shumë depozitues duke përfshinë dhe depozitat e shoqërive të kursim kredit dhe tregtarëve dhe shoqërive tregtar.

Në Aneksin i këtij materiali (si edhe në "Tabela 5.2-3 Kronologjia e kuadrit ligjor të ASD") jepet informacion për profilin i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në Shqipëri.

²⁰ mbështetur në VENDIM Nr. 4187, datë 1.9.2016 PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË UDHËZIMIN E BANKËS SË SHQIPËRISË NR. 3241, DATË 18.12.2014, "PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE NË BANKA"

KAPITULLI 3: RISHIKIMI I LITERATURËS

Gjatë viteve të fundit kemi një sistemi bankar europian i cili nëpërmjet rritjes së produkteve dhe derregullimit të shërbimeve që ofron po ecën drejt integritit dhe liberalizimit. Shqipëria si shumë vende të tjera në zhvillim është në procesin e integritit financiar. Ky proces ndikon në rritjen e konkurrencës ndërmjet institucioneve financiare dhe për rrjedhojë nxjerr në pah rëndësinë që duhet t'i kushtohet rritjes së efikasitetit. Mbështetur tek argumentimet e autorëve të ndryshëm, rritja e konkurrencës mund të rezultojë në një tendencë për të ndërmarrë më tepër rrezik²¹. Në kushte të tilla, në kuadër të rregullimit të procesit bankar, masat e mara nga institucionet rregullatore synojnë të balancojnë këtë tendencë nëpërmjet rritjes së rolit të kapitalit të mjaftueshmërisë.

Krizat bankare që kanë ndodhur gjatë 20 viteve të fundit kanë rritur fokusin ndaj stabilitetit të sistemit financiar. Mbështetur tek kjo, autorë të ndryshëm përqendrohen tek efektet negative që mund të kenë tek rreziku bankar masat e rritjes së sigurisë të vendosura në kuadër të një rregullimi të kujdesshëm. Kapitali i mjaftueshmërisë dhe rregullimi i tij, është një nga instrumentat më të rëndësishëm që përdoret për qëllime rregullimi nga ana e institucioneve rregullatore.

Përsa i përket literaturës teorike, në lidhje me përcaktimin e një niveli optimal të kapitalit të mjaftueshmërisë si edhe me ndikimin që kanë kërkesat për kapitalin tek qëndrimi ndaj rrezikut, vijnë rezultate kontradiktore²². Në këtë literaturë nuk i është dhënë përgjigje pyetjes se si raportet e larta të kapitalit ulin rrezikun e përgjithshëm të

²¹ Danthine *et al.*, 1999; Hellman *et al.*, 2000

²² Berger *et al.*, 1995; Freixas and Rochet, 1997; Santos, 1999; Boot *et al.*, 1999; Rime, 2001b)

bankës. Nga ana tjetër, rregulloret e kapitalit të mjaftueshmërisë duhet të hartohen në lidhje me rregulloret e tjera të rrjetës së sigurisë dhe instrumentat e tregut²³.

Mjaft autorë të tjerë vendosin theksin në rëndësinë që ka disiplina e tregut në ndërmarrjen e rreziqeve dhe në forcimin e kapitalit. Menaxherët e bankave ndërmarrin më tepër rrezik sesa niveli i optimal për shkak të "rrezikut moral". Një nga fushat ku del ky problem është ajo e marrëdhënieve ndërmjet aksionerëve (mbajtësve të kapitalit) dhe huadhënësve (mbajtësve të detyrimeve të bankës). Kjo sepse aksionerët preferojnë më tepër rrezik dhe përpiqen që ta kalojnë atë tek kreditorët e tyre. Kjo sepse në rast falimentimi pjesa më e madhe e humbjeve do të mbahet nga huadhënësit. Për këtë arsye, aksionerët preferojnë aktive me risk më të lartë dhe kthime më të larta (Duran dhe Lozano-Vivas, 2015)

Analiza e zgjidhjes së problemit të mbartjes së rrezikut nga aksionerët tek kreditorët nën kontekstin e rregullimeve të Bazelit është kryer nga (Duran dhe Lozano-Vivas, 2015) . Sipas tyre, shtyllat e Basel II nuk e zgjidhin problemin e motivimit nga "rreziku moral" por nëse një bankë ka kapital më tepër sesa ai i kërkuar rezulton më pak e motivuar të mbartë rrezikun tek kreditorët.

Nier e trajton uljen e rrezikut të mbartjes në kuadër të disiplinës së tregut²⁴. Bankat për shkak të rrjetës së sigurisë financiare përfshihen në sjellje më të rrezikshme dhe priren të mbajnë më pak kapital. Përcakimi i një shume të konsidrueshme si të pasiguruar do të ndikonte që bankat të mbanin më tepër kapital.

²³ Freixas and Gabillon, 1999

²⁴ Nier dhe Baumann, 2006

Në kushtet e mungesës së disiplinës së tregut, marrëdhënia ndërmjet kapitalit dhe rrezikut do të jetë negative. Duke u nisur nga studimet teorike, disa autorë janë të mendimit se kapitali, është ai që do të përcaktojë shkallën e humbjeve në rast falimentimi. Një nivel i lartë kapitali do të thotë që banka të përballet me më pak rreziqe. Në një situatë kur të gjitha depozitat janë të siguruar me një normë të caktuar, në kushtet e mungesës së "disiplinës së tregut", do të rezultojë një marrëdhënie negative ndërmjet kapitalit dhe rrezikut. Në këtë rast, kostoja marxhinale e uljes së kapitalit dhe/ose rritjes së rrezikut bankar është zero meqënëse primi i sigurimit mbetet konstant me rrezikun ose kapitalin. Sipas disa autorëve²⁵ vendosja e kërkesave për kapitalin e mjaftueshmërisë ka sjellë ulje të ndërmarrjes së aktiviteteve me rrezik. Në ndryshim nga këto përfundime, autorë të tjerë²⁶ argumentojnë se vendosja e kërkesave të larta për kapital mund të shërbejë si shtysë për të ndërmarrë më tepër rrezik sepse një kufizim i tillë mund të ndikojë në uljen e vlerës së brendëshme të bankës.

Spektori bankar është një sektori i cili, për nga natyra e tij, cilësohet si i prirur drejt çështjeve të lidhura me rrezikun moral "moral hazard". Rrjeti i sigurisë, i ngritur si një sistem mbrojtje për klientët e bankave, bëhet shkak për përfshirjen e këtij rreziku në aktivitetin bankar.

Ky rrezik ndikon marrëdhënien e rrezikut me kapitalit. Nëse kosto e kapitali është e lartë, sa më e lartë kërkesa për kapital më të larta rreziqet që do të ndërmerreshin për të gjeneruar një nivel më të lartë të kthimit nga kapitali.

Por gjithashtu të ndikuar nga rreziku moral (Moral hazard) që vjen nga aplikimi i skemave të rrjetës së sigurisë, bankat mund të tregojnë një tendencë për të ndërmarrë më

²⁵ Repullo, 2004; Konishi & Yasuda, 2004 dhe Furlong & Keeley, 1989)

²⁶ Besanko dhe Kanatas, 1996; Hellman, Murdock dhe Stiglitz, 2000

tepër rrezik. Rreziku moral ndodh kur nga bankat qendrore, qeveritë apo institucionet mbikqyrëse marin masa që tregojnë përfshirjen e tyre për të mbrojtur një institucion dhe kreditorët e saj në rast të ndonjë dështimi. Hipoteza e rrezikut moral mund të përfshihet kur analizohet problemi i agjensisë në marrëdhënien ndërmjet menaxherëve dhe aksionerëve. Në kushtet e një mjedisi jo të shëndetshëm për industrinë bankare, menaxherët nuk do të ndërmarin më tepër rrezik. Në anën tjetër, menaxherë të mirë informuar do të përpiqeshin të ndiqnin një strategji zgjerimi e cila shoqërohet me shumë rrezik. Por kjo marrëdhënie negative ndërmjet kapitalit bankar dhe rrezikut nuk mund të shpjegohet vetëm me "rrezikun moral". Bankave të mëdha, nën argumentin "shumë e madhe për të falimentuar", ndërmarin më tepër rrezik sepse mbështeten në mundësinë për paketë publike shpëtimi në rast vështirësie financiare për shkak të rëndësisë që ato kanë në sistemin financiar. Gjithashtu edhe bankat e tjera, ndërmarin më shumë rrezik sepse mendojnë që do të përfitojnë nga paketat publike të shpëtimit në rast falimentimi në të njëjtën kohë me bankat e tjera të mëdha.

Bazuar në literaturën empirike, ka një sërë studime më të hershme në SHBA të cilat ekzaminon ndikimin që ka kapitali bankar në sjelljen e bankës²⁷. Në këto studime, qëllimi kryesor është analiza e efektivitetit të rregullimit financiar, më konkretisht, ndikimi që ka sigurimi i depozitave, si një nga komponentët e rrjetës së sigurisë, në qëndrimin ndaj rrezikut. A shërben sigurimi i depozitave si një nxitje për të ndërmarrë më tepër rreziqe meqënëse këto të fundit, nëpërmjet sigurimit, mund të transferohen tek kompanitë e sigurimit të depozitave. Pikërisht për të shmangur këtë mënyrë të transferimit të vlerës rregullatorët financiarë detyrojnë këto kompani që të mbajnë një nivel të caktuar të kapitalit, kapitali i mjaftueshmërisë, në përputhje me sasinë e rrezikut

²⁷ Petzman, 1970; Mayne, 1972

që ndërmerre çdo institucion. Sipas Marcus 1983, rregullimi i kapitalit bankar nuk ka ndikimin e pritshëm në arritjen e raportit të kapitalit të synuar nga menaxherët. Mbështetur në këto rezultate, vihet theksi në faktorë të tjerë të cilët do të kufizonin marrjen e rreziqeve. Ndër këta faktorë përmendet normat me tarifa të sheshta të sigurimit të depozitave ose efekti i normave të larta të interesit.

Studimet në lidhje me efektin që ka rregullimi i kapitalit në kapitalin bankar ngjallën interes pas Marrëveshjes së Bazelit në 1988. Ato arrijnë në rezultate të cilat sygjerojnë se kufizimet për një nivel minimal të kapitalit kanë ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare.²⁸ Këto studime empirike analizojnë efektivitetin e rregullimit të kapitalit të mjaftueshmërisë dhe marrëdhënies ndërmjet rritjes së kapitalit dhe rrezikut. Në to konfirmohet lidhja pozitive ndërmjet rrezikut të portofolit dhe kapitalit. Bankat rrisin kapitalin kur rreziku i portofolit rritet me qëllim që të mbajnë në nivelin e duhur kapitalin zbutës.

Mbështetur në to mund të thuhet se rregullimi i kapitalit në banka ka qenë i efektshëm sepse rezulton të ketë rritje të raporteve të kapitalit pa ekspozuar portofolin dhe zërat jashtë bilancit ndaj mjeteve më të rrezikshme.²⁹ Megjithatë, këto studime vendosin pikëpyetje në lidhje me qëndrueshmërinë e këtyre rezultateve për shkak të ndryshimeve dhe risive financiare. Në kushtet e rritjes së konkurrencës dhe kostos më të lartë të kapitalit mund të nxitet marrja e rreziqeve si një mënyrë për të kompensuar kthimet e përdoruar për rritjen e raporteve të kapitalit.

Kwan and Eisenbeis (1997) në studimin e tyre kanë bërë një përmbledhje të literaturës empirike që lidhet me efektet e rregullimit të kapitalit bankar si edhe të studimeve që

²⁸ Eall and Peterson, 1988; Shrieves and Dahl, 1990

²⁹ Shrieves dhe Dahl, 1992; Editz et al., 1997; Rime 2001a

lidhen me efijencën bankare. Në vijim të studimeve të mëparshme të Hughes and Moon (1995), ata theksojnë rëndësinë që ka përfshirja e efijencës në modelet empirike për përcaktimin e lidhjes ndërmjet kapitalit bankar dhe rrezikut. Në këtë mënyrë, në këto studime bëhet lidhja e literaturës për efektet e rregullimit bankar në ndërmarrjen e rrezikut me studimet empirike në lidhje me efijencën në banka. Rezultatet e tyre tregojnë se efijenca dhe kapitali janë përcaktues të iniciativave të bankave për të ndërmarrë rrezik si edhe të rrezikshmërisë morale (ose hazardit moral).

Në kushte të tjera konstante, autoritetet mbikqyrëse mund të tregohen më fleksibël në lidhje me levën e kapitalit ose rrezikun bankar për një bankë efijente (menaxhim me cilësi të lartë). Në një situatë tjetër për të kompensuar rënien në kthim për shkak të rrezikut moral një bankë më pak efijente, mund të synojë të ndërmarrë më tepër rrezik. Në këtë mënyrë rregullimi i kapitalit dhe lidhja e tij me qëndrimin ndaj rrezikut mund të ndikojë në rritjen ose uljen e efijencës. Kjo tregon se ka një marrëdhënie të ndërsjelltë midis rregullimit të kapitalit dhe efijencës.

Efijenca e bankës ndikohet edhe nga faktorë makroekonomikë të cilët influencojnë ekonominë në përgjithësi dhe rrjedhimisht edhe aktivitetin bankar dhe efijencën e operacioneve të tyre. Nëse flasim nga një perspektive lokale, bankat mund të ndikohen nga zhvillimet ekonomike në rajon. Ato mund të ndikohen nga goditjet që mund të pësojë aktiviteti ekonomik rajonal

Zhvillimet në biznesin bankar kanë bërë të mundur lëvizjen e tyre nga një institucion financiar i depozitave dhe kredive në drejtim të bankingut universal. Kjo lidhet me produktet e ndryshme, të përziera, që ofrohen sot nga bankat. Ato sot përdorin aktivet

jashtë bilancit si një mjet për menaxhimin e riskut por në të njejtën kohë kanë rritur gamën e produkteve jo-bankare.

Bankat sigurojnë të ardhura duke qenë të ekspozuar para klientëve të tyre dhe pikërisht për të kompensuar këtë ekspozim ato sigurojnë kthimet e nevojshme. Në parim bankat janë menaxhere të riskut. Nëse ndërmarin më tepër rrezik ato pritët të sigurojnë më tepër kthim. Bankat e mirëmenaxhuara synojnë të arrijnë maksimizimin e kthimeve nëpërmjet marrjes së rreziqeve në një mënyrë të kujdesshme dhe të mirë informuar. Qëllimi kryesor dhe më i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut është që të sigurojë se rreziku i marë nga banka është në nivele të tilla që nuk e kalon aftësinë e bankës për të përballuar humbjet në skenarin më të keq brenda disa intervaleve të caktuara.

Roli kryesor i kapitalit në institucionet financiare siç janë bankat, në ndryshim me kapitalin e bizneseve të tjera, nuk është ai i sigurimit të burimit të fondeve. Bankat sigurojnë fonde nëpërmjet mbledhjes së depozitave. Raporti i kapitalit ndaj mjeteve në banka është shumë më i ulët se në biznese të tjera. Në sektorin bankar norma e kapitalit ndaj mjeteve është në kufijë nga 4 deri 8% ndërkohë që ky raport në firmat tregëtare apo dhe ato industriale është në kufijtë nga 30 deri në 40%. Ky është një tregues që thekson rëndësinë që ka rregullimi i bankave në mënyrë më rigoroze se çdo industri tjetër.

Duke iu referuar Matten (1996) dhe Porteus dhe Tapadar (2006) kapitali bankar ka tre funksione. *Së pari*, kapitali siguron një zbutje në daljen me radhë të mjeteve dhe mbron mbajtësit e borxhit (depozitorët) nga humbjet. Nëse nuk ka një mbrojtje të tillë, mjetet mund të shiten me një çmim shumë të ulët, gjë e cila do të shtonte humbjet për depozitorët dhe kompanitë e sigurimit të depozitave. Në këtë rast kapitali është pjesë e funksionit të rrezikut. *Së dyti*, fakti që aksionerët janë ata mbi të cilët kalon fillimisht

humbja, i bën ata ose manaxherët që veprojnë në emër të tyre, të kenë motive për të shmangur rreziqe të panevojshme. Kjo shpjegon funksionin stimulues të kapitalit, i cili përfaqëson pasurinë neto dhe mund të zbusë humbjet e papritura. *Së treti*, kapitali është një tregues i rëndësishëm i shëndetit financiar dhe i qëndrueshmërisë dhe siguron besim tek investitorët e jashtëm. Prezenca e një kapitali të konsiderueshëm siguron kreditorët dhe rrit besimin tek banka.

Në teori ndikimi që ka rregullimi i kapitalit në marjen e rrezikut nuk është i qartë. Nga njëra anë pritet që rregullimet e kapitalit të mos ndikojnë në uljen e rreziku bankar sepse për zotëruesit e kapitalit të bankës rritja e pjesës së kapitalit të detyrueshëm konsiderohet si ulje e kthimit të investimeve. Kjo do të ulë vlerën e bankës (e cila njihet si...) dhe për të kompensuar këto ndryshime nga menaxherët e bankës kërkohet të sigurohet më tepër fitim. Për të arritur këtë do të duhet të ndërmeret më tepër rrezik. Pra, rregullimi i kapitalit do të nxisë rritjen e ndërmarrjes së rrezikut. Por në anën tjetër, duket se rregullimi i kapitalit ndikon në uljen e rrezikut të marë nga banka sepse menaxherëve të bankave u kërkohet të mbajnë më tepër kapital nëse rritet rreziku. Meqënëse kërkesat për kapital lidhen me nivelin e rrezikut të aktiveve të saj, do të thotë se ka një marrëdhënie pozitive ndërmjet rrezikut dhe kapitalit.

Studimet teorike në lidhje me qëndrimin e bankave ndaj rrezikut dhe përcaktuesit e tij si edhe studime të cilat kanë për qëllim studimin e marrëdhënies ndërmjet kapitalit bankar dhe rrezikut kanë rezultuar me parashikime kontradiktore. Këtu mund të përmendim ndikimin që kanë në marrëdhënien ndërmjet rrezikut dhe kapitalit, kostoja e agjensisë dhe problemi i asimetrisë së informacionit³⁰. Për shkak të tyre, disa institucione mund

³⁰ Jansen, 1986; Berger, 1995

t'iu përgjigjen kërkesave për kapital duke ndërmarrë më shumë rrezik ndërsa të tjera duke ulur nivelin e përdorimit të levës.

Meqënëse studimet teorike japin interpretime dhe parashikime kontradiktore mënyra e vetme për përcaktuar marrëdhënien ndërmjet kapitalit, rrezikut dhe efikasitetit është analiza empirike. Për këtë qëllim në vijim do të bëhet rishikimi i i literaturës për çështje që kanë të bëjnë me rregullimin bankar, efikasitetin në banka, rrezikun bankar (konkretisht përcaktuesit e huave me probleme që do të përdoren si treguese të nivelit të rrezikut dhe rreziku moral në banka)

3.1 Rregullimi i sektorit bankar dhe raportet me bazë kapitalin

Kriza financiare e vitit 2008 e cila u pasua nga kriza ekonomike në 2009 nxorri në pah brishtësinë e sistemit financiar. Nëpërmjet zbatimit të rregullave të Basel III supozohet të nxitet stabiliteti në sistemin financiar dhe të zvogëlohet dëmtimi i ekonomisë nga bankat që marrin më shumë rrezik. Kjo rregullore cilësohet si një version më i shtrënguar i Basel II në lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit bankar. Gjithashtu, sipas kësaj rregulloreje, vendosen për herë të parë detyrime në lidhje me likuiditetin në këtë sektor dhe ka për qëllim të pengojë ndërmarrjen e rrezikut. Implementimi Basel III ka filluar nga viti (2012) dhe pritet që të përfundojë në 2019. Mbështetur tek Basel III përcaktohen detyrimet minimale që duhet të ndjekin bankat dhe mbështetur tek këto secili shtet, nëse e sheh të arsyeshme, mund të aplikojë detyrime edhe më shtrënguese.

Motivimi për rregullimin e kapitalit lidhet me faktin që bankat, në krahasim me rrezikun që mbajnë, kanë tendencë të mbajnë kapital më pak sesa niveli optimal. Bankat, nuk do të mbanin kapital më tepër sesa kërkohet nga rregullatorët.

Rime (2001) ka bërë një studim për të analizuar rregullimet në kapital dhe rrezik në bankat zviceriane të ndodhura para presionit të kërkesës për nivel minimal të kapitalit rregullator. Sipas tij, bankat në nivelin minimal të kapitalit rregullator përpiqen të rrisin kapitalin për shkak të presioneve të rregullatorëve. Kjo tregon se ndëshkimet për norma kapitali më të ulët sesa niveli minimal i kërkuar japin efektin e dëshiruar në sjelljen e bankave por nuk ndikojnë në nivelin e rrezikut.

Me interes për të studiuar efekte që ka rregullimi i kapitalit bankar, kapitali i mjaftueshmërisë në rrezik, Ediz et al., (1997) dhe Jaques dhe Nigro (master) arrijnë në përfundimin se rregullimi i kapitalit është efektiv në rritjen e raportit të kapitalit dhe uljen e rrezikut të portofolit. Demsetz et al., (1996) dhe Salas dhe Saurina (2003) dëshmojnë se bankat me nivel të ulët të kapitalit kanë për tendencë të kenë nivele të larta të rrezikut të kredisë sipas hipotezës së rrezikut moral. Në këtë mënyrë mund të thuhet se ndikimi që ka rritja e raporteve të kapitalit në rrezikun bankar është ende i pa përcaktuar.

Në këtë debat Hughes dhe Mester (1998, 2009) kanë dhënë një kontribut të madh duke nxjerrë në pah rëndësinë që ka përfshirja e efikasitetit bankar në analizën e marrëdhënies ndërmjet rrezikut dhe kapitalit.

Barth et al.³¹ vëzhguan, ndërmjet të tjerash, rregulloren e kapitalit të mjaftueshmërisë. Huatë me probleme dhe rregulloret shtrënguese për kapitalin kanë një lidhje negative ndërmjet tyre që do të thotë se sa më shtrënguese të jenë masat që meren në lidhje me kapitalin aq më i ulët do të jetë niveli i huave me probleme. Kjo do të thotë që cilësia e huave është më e mirë në rastin e zbatimit të rregulloreve të rrepta për kapitalin.

³¹ Barth et al., 2004, MASTER

Nëpërmjet rregullimit të Baselit, institucionet rregullatore mundohen të mbajnë të shëndetshëm dhe të stabilizuar sistemin bankar. Studime të ndryshme empirike tregojnë se rregullimi nuk është aq i efektshëm as pritej. Duket se bankat të cilat operojnë me nivele të kapitalit shumë pranë nivelit minimal vazhdojnë të ndjekin sjellje jo optimale.

Struktura e kapitalit përcakton se cilat janë burimet e financimit të operacioneve të përgjithshme dhe të rritjes së një firme. Ajo konsiderohet si një kombimin i borxhit me kapitali e vet. Katër janë teoritë më të rëndësishme që përdoren për të shpjeguar vendimet në lidhje me strukturën e kapitalit: Teoria e kompromisit statik (the Static Trade-off Theory); Teoria e Agjencisë (Agency Theory); Teoria e Renditjes së Urdhrave (Pecking-Order Theory) dhe ajo e Kostos së Falimentimit (Bankruptcy Cost Theory).

Gropp dhe Heider (2017) arrijnë në konkluzionin se përcaktuesit e kapitalit të firmave/koorporatave janë të rëndësishëm edhe për atë të bankave. Sipas Berger et al. (1995) teoria e strukturës së kapitalit nuk është plotësisht e aplikueshme për institucionet financiare për shkak se ato i nënshtrohen rregullimit si edhe theksuan rëndësinë që kanë faktorët e jashtëm për kapitalin e këtyre institucioneve. Në vijim të këtij përfundimi Breëer et al. (2008) shtojnë se këta faktorë përcaktues duhet të kombinohen me efektin që kanë politikat qeveritare në lidhje me rrjetën e sigurisë dhe rregullimin. Rregullimi nuk është i vetmi faktor që ndikon raportin e kapitalit. Ka shumë faktorë të tjerë makroekonomike dhe specifike të bankës të cilët janë mjaft të rëndësishëm në shpjegimin e këtij raporti. Si të tillë, përveç rregullores, janë: rentabiliteti, kostoja e kapitalit, depozitat dhe madhësia e aktiveve.

Struktura e kapitalit bankar përcaktohet nga një sërë faktorësh të brendshëm (mikroekonomikë) dhe të jashtëm (makroekonomikë). Politikat fiskale, kushtet e tregut

dhe norma e inflacioni janë nga faktorët më të rëndësishëm makroekonomikë. Faktorët e brendshëm lidhen me karakteristikat individuale, specifike të bankës si madhësia, norma e rritjes, rentabiliteti, pagesa e dividendëve, rreziku i biznesit, taksat dhe aktivet e qëndrueshme.

Madhësia

Mbështetur tek teoria e kostos së falimentimit përcaktohet një marrëdhënie pozitive ndërmjet strukturës së kapitalit dhe madhësisë së firmës. Firmat e mëdha, për shkak të diversifikimit më të madh (Remmers et al 1974) mund të operojnë më lehtë në tregun e kapitalit, mund të japin kredi me norma më të larta interesi dhe të paguajnë norma më të ulta për kapitalin e huazuar (Pinches dhe Mingo 1973), kanë probabilitet më të ulët për të falimentuar (Titman dhe Wessels 1988) që do të thotë kosto më të ulta falimentimi. Mbështetur tek teoria e kostos së falimentimit, studime të kryera gjatë viteve 1970 tregojnë se ekziston një lidhje pozitive ndërmjet madhësisë së bankës dhe strukturës së kapitalit (Martin et al., 1988) ndërkohë rezultate të studimeve të tjera nuk e konfirmojnë këtë marrëdhënie.

Norma e rritjes

Norma e rritjes është një tjetër faktor i strukturës së kapitalit. Teori të ndryshme strukturës së kapitalit siç janë teoria e agjencisë dhe ajo e renditjes përcaktojnë një marrëdhënie negative ndërmjet normave të rritjes dhe strukturës së kapitalit.

Rentabiliteti

Rentabiliteti, i cili përfaqësohet nga raportet ROA dhe/ose ROE, është një tjetër faktor specifik i bankës që lidhet me strukturën e kapitalit. Sipas hipotezës së marrëdhënies statike hidhet ideja se firmat e rrezikuara duhet të mbajnë një nivel të ulët të borxhit (Myers 1984).

Marrëdhënia ndërmjet rentabilitetit dhe borxhit është e tillë që sa më i lartë rentabiliteti aq më e lartë mundësia për të borxhe dhe më i ulët rreziku për mbajtësit e këtyre borxheve. Në këtë mënyrë, marrëdhënia ndërmjet struktura e kapitalit dhe rentabiliteti është një marrëdhënie pozitive. E kundërt paraqitet kjo lidhje sipas teorisë së radhës në renditjes. Kjo sepse sipas kësaj teorie, firmat preferojnë financimin e brendshëm dhe për këtë arsye ndjekin politika shtrënguese në lidhje me dividendët. Sipas Myers, 1984, nëse burimet e brendëshme nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat financiare, do të preferohej për diferencën financimi me borxh ndaj financimit me kapital. Mbështetur tek ky argumentim, sa më i lartë rentabiliteti aq më e lartë mundësia për financim të brendëshëm dhe aq më ulët varësi ndaj financimit me borxhe (Aremu, Ekpo dhe Mustapha (2013)). Studimet empirike, në shumicën e tyre mbështesin argumentimin e kësaj lidhje sipas teorisë së renditjes. Sipas Titman dhe Ëessels (1988), Kester (1986), Friend dhe Hasbrouck (1989), Friend dhe Lang (1988), Gonedes et al (1988) ndërmjet nivelit të borxhit në strukturën e kapitalit dhe rentabilitetit ekziston një marrëdhënie negative.

Pagesa e dividendëve

Mbështetur në teorinë e kostos së falimentimit argumentohet një marrëdhënie negative ndërmjet raportit të pagesës së dividendëve dhe nivelit të borxhit në strukturën e kapitalit. Një raport i ulët i pagesës së dividendëve sjell rritje të kapitalit dhe ulje të mundësisë për të shkuar në likuidim e rrjedhimisht kosto e falimentimit është e ulët. Për shkak të kësaj kostoje të ulët të falimentimit banka mund të aplikojë një nivel më të lartë të borxhit në strukturën e kapitalit. Nga ana tjetër, sipas teorisë së radhës në renditje (pecking order) marrëdhënia ndërmjet nivelit të borxhit dhe pagesës së dividendëve është pozitive (Titman dhe Ëessels (1988)). Manaxhimi, sipas kësaj teorie, do të preferonte

më tepër financimin e brendshëm sesa atë të jashtëm, mbajtjen e fitimeve më tepër sesa shërndarjen e tyre. Sipas këtij argumentimi, aplikimi i normave të ulta të pagesës së dividendëve do të ndikojë në uljen e nivelit të borxhit në strukturën e kapitalit.

Rreziku i biznesit

Një nga përcaktuesit më të rëndësishëm me të cilin është lidhur kapitali i bankave është rreziku. Autoritetet rregullatore përcaktojnë nivelin e kapitalit që duhet të mbajnë bankat në përputhje me nivelin e rrezikut që ato mbajnë. Kjo sepse kapitali siguron mbrojtje ndaj humbjeve të papritura dhe falimentimi. Marrëdhënia e kapitalit me rrezikun, sipas teorisë së agjentit dhe asaj të kostos së falimentimit, vlerësohet si negative. Sipas teorisë së kostos së falimentimit sa më të paqendrueshme të jenë fitimet aq më e madhe mundësia e falimentimit, rrjedhimisht pesha që do të zënë kostot e falimentimit në vendimet financiare do të jetë më e lartë. Për shkak të rritjes së mundësisë për të falimentuar edhe problemet e agjencisë në lidhje me borxhin do të jenë më të mprehta. Mbështetur tek ky argumentim, sipas teorisë së agjencisë, rritja e rrezikut të biznesit duhet të sjellë ulje të nivelit të borxhit në strukturën e kapitalit (Taggart 1985). Studimet empirike, në vendet perëndimore, Indi dhe Nepal, në lidhje me marrëdhënien e rrezikut dhe strukturës së kapitalit kanë sjellë konkluzione kontradiktore me sa trajtuar nga këndvështrimi teorik (Martin et al, 1988).

Taksimi

Në lidhje më ndikimin që ka taksimi në vendimet që marrin korporatat financiare janë kryer një numër i madh studimesh. Qëllimi i disa prej këtyre studimeve³² ishte studimi i marrëdhënies ndërmjet politikave të taksave dhe zgjedhjes ndërmjet borxhit dhe kapitalit. Sipas MacKie-Mason (1990) taksat kanë një ndikim shumë të madh në këtë

³² MacKie-Mason (1990), Shum (1996) dhe Graham (1999)

zgjedhje. Ai arrin në konkluzionin se norma maxhinale e taksës për çdo firmë ndikon vendimmarrjen në lidhje me financimin. Firmat me një mundësi të lartë të kenë një normë taksimi zero (për shkak të transferimit të humbjeve të perudhave), pra, më një mbulim të lartë nga taksat është më pak e prirur të financojë me borxhe.

Mjetet e qëndrueshme

Spektori bankar është i prirur drejt problemeve me "rrezikun moral". Një nga fushat ku mund të dalin probleme të tilla është ajo ndërmjet siguruesve të borxhit dhe aksionerëve për shkak të konfliktit të interesit ndërmjet këtyre dy grupeve. Huadhënësit kërkojnë siguri dhe vlera e kolateralit (e cila përfaqësohet nga raporti i mjeteve të qëndrueshme me totalin e mjeteve) mund të konsiderohet si një element mjaft i rëndësishëm për nivelin e financimit me borxh (Scott 1977), Stiglitz dhe Eeiss (1981), Eëilliamson (1988) dhe Harris dhe Raviv (1990).

Niveli i mjeteve të qëndrueshme tregon se firma ka një vlerë të lartë likuidimi. Kompanitë me kapital intensiv³³ (kompani të cilat kanë një përqindje të lartë të mjeteve të qëndrueshme) aplikojnë nivele më të larta borxhi sepse i mbajnë këto mjete si kolateral në rast situatash të vështira. Financimi i aktivitetit me hua do të varet nga fakti sesa mund të mbulohet ky borxh me mjete të qëndrueshme. Mbështetur në këtë argumentim rezulton që marrëdhënia ndërmjet mjeteve të qëndrueshme dhe raportit të levës të jetë pozitive.

3.2 Efiçenca bankare dhe konceptet për matjen e saj

Vlerësimi i efiçencës në këtë punim do të kryhet nëpërmjet kufirit të efiçencës (ose e quajtur në literaturën ekonomike si X-efiçenca) që do të thotë distanca (e prodhimit, kostos, të ardhurave ose fitimit) e njësisë vendimmarrëse nga praktika më e mirë. Kjo

³³ Myers, 1977; Harris dhe Raviv, 1991

pasqyrohet nga një renditje e shkallëzuar me vlera nga zero (niveli më i ulët e efijencës) dhe një (niveli më i mirë). Efijenca mund të përkufizohet si "*prodhimi i një outputi të dhënë me më pak inpute ose shfrytëzimi i një grupi të caktuar inputesh për të prodhuar më tepër outpute*" (Daley dhe Mattheës, 2007, p.3). Nga ky përkufizim kuptohet se efijenca nuk lidhet me rritjen e të ardhurave por me mënyrën sesi kontrollohen kostot.

Një çështje me rëndësi në matjen e efijencës është përcaktimi i konceptit që do të përdoret. Ka tre koncepte kryesore të efijencës ekonomike: efijenca e kostos, fitimit standard dhe alternative e fitimit. *Efijenca e kostos* tregon se sa afër nivelit më të mirë të kostos është niveli i kostove të bankës për të prodhuar të njëjtin output në kushte të njëjta. Ajo përcaktohet nga një funksion ku kostoja varet nga çmimet i inputeve variablë, sasi të e outputeve variabël dhe ndonjë input ose output i fiksuar. *Efijenca e fitimit standard* vlerëson se sa afër mundësisë për të prodhuar në nivelin që siguron fitim maksimal për një nivel të dhënë të çmimeve të inputeve dhe outputeve. Në ndryshim nga funksini i kostos, në këtë funksion përdoret si variablë fitimi dhe në vend të sasisë së outputeve të përcaktuar nga nivelet e realizuara të cilat ndoshta janë joefijente. Sipas këtij koncepti, variabli i varur, fitimi, përcaktohet nga të ardhura të cilat vijnë nga outpute dhe inpute që ndryshojnë. Në matjen e efijencës së fitimit përfshihen gabime në anën e outputeve dhe atë të inputeve. Mbështetur tek Berger et al., 1993, inefijenca në anën e outputeve mund të jetë më e madhe se ajo i inputeve. Për këtë arsye, në matjen e efijencës teknike, përdorimi i konceptit të efijencës së fitimit standard mund të konsiderohet se ka përparësi ndaj atij të kostos. *Efijenca alternative e fitimit* mund të përdoret kur disa nga supozimet mbi të cilat ngrihen efijencat e kostos dhe fitimit standard nuk arrihen. Sipas këtij koncepti, efijenca tregon se sa afër nivelit maksimal të gjenerimit të fitimit për një nivel të dhënë të outputit (në vend të përdorimit të çmimeve

të tyre). Variabli i varur, si edhe tek funksioni i fitimit standard, është fitimi dhe variablat e tjerë përcaktohen si tek funksioni i efijencës së kostos. Në këtë mënyrë, për matjen e efijencës, variabli i outputit mbahet konstant (si në rastin e funksionit të efijencës së kostos) ndërsa çmimet e outputeve mund të ndryshojnë duke ndikur kështu tek fitimet. Ky funksion krijon mundësinë e kontrollimit të diferencave të pamatura në cilësinë e outputeve sepse një cilësi më e lartë e outputeve mund të sjellë të ardhura shtesë.

Sipas Farrel (1957) efijenca përbëhet nga dy komponentë: *efijenca teknike*, e cila përfaqëson mundësië që ka menaxhimi për të maksimizuar outputet për një kombinim të caktuar të inputeve dhe *efijenca alokative* (e shpërndarjes) e cila tregon aftësinë e menaxhimit për të përdorur një nivel të dhënë inputesh në mënyrë optimale, me supozimin se çmimet e inputeve dhe teknologjia janë të njohura. Këto dy efijenca përbëjnë efijencën ekonomike. Në këtë punim do të flitet për efijencën ekonomike të kostos.

Efijenca ndikohet nga njësërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm. Ndër faktorët e brendshëm mund të përmenden përmirësimi i teknologjisë, komunikimi më produktiv dhe përpunimi i të dhënave. Këta faktorë ndikojnë në rritjen e cilësisë operationale dhe uljen e kostos së tyre. Faktorët kryesorë të suksesit bankar janë gjetja e mënyrave sesi të ulin dhe kontrollojnë kostot nga njëra anë dhe të maksimizojnë shfrytëzimin e burimeve të tyre (Spong et al., 1995)

Ndër faktorët e jashtëm, që ndikojnë në efijencën e bankës dhe në operationet e saj, mund të përmendim të drejtat e pronës, kërkesat ligjore dhe ato rregullatore si edhe kushtet e tregut. Operationet bankare ndikohen nga mjedise të ndryshme nën të cilat veprojnë dhe si të tilla janë ndryshimet në parimet kontabël, kushtet e regjistrimit ose

tregu i punës (Hughes dhe Mester, 2008)³⁴. Në operacionet bankare, menaxherët me sjelljet e tyre luajnë një rol të rëndësishëm nëpërmjet vendimeve që marín për strukturat, strategjitë, ose sesi do të kontrollohen kostot.

Koncepti i efíçencës bankare, sikurse përmendur edhe më herët, është përfshirë në studimet e marrëdhënieve ndërmjet kapitalit dhe rrezikut. Berger dhe De Young (1997) si edhe Këan and Eisenbeis (1997) kanë testuar hipotezën e kësaj ndërmarrëdhënie. Në këto të dy artikuj dëshmohe se efíçenca dhe kapitali janë përcaktues të nivelit të rrezikut të bankës.

Sipas Berger dhe De Young (1997) ulja e efíçencës së kostos i paraprin rritjes së huave me probleme (sidomos kjo në banka me një nivel të ulët të kapitalit) dhe anasjelltas, huatë me probleme rezultojnë të sjellin ulje të kostos së efíçencës. Këan and Eisenbeis (1997) kanë arritur në konkluzionin se bankat me performancë të ulët janë më të gatshme të ndërmarin më tepër rrezik dhe se bankat e mirëkapitalizuara kanë një operojnë me efíçencë më të lartë sesa ato më pak të kapitalizuara.

Studimi i marrëdhënies ndërmjet huave me probleme, efíçencës së kostos dhe kapitali financiar është kryer nga Ëilliams (2004) dhe nga Altunbas et al., (2007) për një grup bankash europiane për periudhat respektivisht 1990-1998 dhe 1992-2000. Ëilliams (2004) arrin në konkluzionin se bankat që nuk menaxhohen mire, pra që operojnë më efíçencë të ulët kanë tendencë të kënë një cilësi jo të mirë të huave, rrezik më të lartë. Në kontrast me të, Altunbas et al., (2007) nuk gjen një marrëdhënie pozitive ndërmjet inefíçencës dhe ndërmarrjes së rrezikut nga ana e bankave. Kjo sepse bankat europiane joefíçente kanë tendencë të mbajnë më tepër kapital dhe të ndërmarrin më pak rrezik

³⁴ Hughes dhe Mester, 2008

(ulet efiçenca, rritet kapitali, ulet rreziku). Mbështetur në këto studime rezultatet e marrëdhënies së ndërsjelltë ndërmjet efiçencës së kostos, kapitalit dhe rrezikut janë kontradiktore.

3.3 Përcaktuesit e huave me probleme

Në lidhje me përcaktimin e faktorëve që ndikojnë tek huatë me probleme (NPL) ka një sërë kërkimesh Messai dhe Jouini (2013); Louiz (2010); Klein (2013); Boudriga (2009). Sipas tyre dy janë grupet që ndikojnë NPL: grupi i faktorëve makroekonomik dhe atyre mikroekonomik, faktorë specifikë të bankës.

Klein (2013) ka marë në analizë përcaktuesit e huave me probleme për bankat e Europës Qëndrore, Lindore dhe Verilindore për periudhën 1998-2011. Sipas konkluzioneve të tij, norma e lartë e papunësisë, inflacionit dhe rënia e kursit të këmbimit përbëjnë faktorët makroekonomikë që ndikojnë në keqësimin e cilësisë së huave, rritjen e nivelit të huave me probleme. Gjithashtu, rritjet e prodhimit të brendshëm bruto, PBB, ndikojnë në uljen e kredive me probleme; inflacioni i lartë i paraprin rritjes së nivelit të tyre. Si faktorë specifikë të bankës, faktorë mikroekonomike, ai përmend: rentabilitetin e periudhës së mëparshme, si tregues të cilësisë së menaxhimit, nivelin e ulët të kapitalit, si tregues të stimujve të "rrezikut moral"; raportin e huave ndaj totalit të aktiveve dhe rritjen e huave të bankës, si tregues për ndërmarrjen e rreziqeve shtesë. Klein arrin të vërtetojë efektin e "rrezikut moral" sipas të cilit rritja e raporti të kapitalit ndaj aktiveve sjell ulje të NPL; rritja e raporteve të rreziqeve shtesë rrisin edhe huatë me probleme NPL. Faktorët specifikë të bankës kanë një ndikim të rëndësishëm në NPL por shpjegojnë relativisht pak variacionin e NPL (Klein, 2013, p.4).

Messai dhe Jouini në punimin e tyre analizuan përcaktuesit makroekonomike dhe ata specifikë të bankës për NPL në Itali, Greqi dhe Spanjë, për 85 banka, për periudhën 2004-2008. Ata arritën në përfundimin se rritja ekonomie, PBB dhe rentabiliteti i bankave lidheshin negativisht me huatë me probleme. Norma reale e interesit, niveli i papunësisë, raporti i rezervave për huatë e humbura mbi huatë totale kanë një marrëdhënie pozitive me huatë me probleme. Louizis et. al. në punimin e tij në lidhje me përcaktuesit e kredive me probleme për bankat greke në periudhën 2003-2009 arrin në konkluzionin se normat e huadhënies, norma e papunësisë dhe rritja e PBB ndikojnë në një shkallë të lartë NPL. Normat e huadhënies kanë një marrëdhënie pozitive me NPL, ndërsa norma e papunësisë dhe rritja e PBB negative.

Boultriga et. al. në punimin e tyre marrin në analizë një grup bankash nga 59 vende të ndryshme për periudhën 2002-2006. Ndër të tjerash ata nxjerrin konkluzionin se kuadri mbikqyrës nuk ndikon tek huatë me probleme dhe në këtë mënyrë vendosin një pikëpyetje në efektivitetin e rregullimit. Variablat e përdorur për këtë qëllim janë liria politike, sundimi i ligjit dhe niveli i korrupsionit.

Në mënyrë të përmbledhur, të gjithë këta autorë, tregojnë se NPL varet nga faktorë makroekonomike dhe ata specifikë të bankës. Ata pajtohen në përcaktimin e mënyrës sesi lidhen ndërmjet tyre PBB dhe norma e papunësisë me nivelin e NPL. Përsa u përket faktorëve specifikë të bankës, autorë të ndryshëm përfshijnë variabla të ndryshëm, por ndër ta, treguesi i rentabilitetit ose ROA dhe një variabël tregues i huasë së bankës janë përdorur nga të gjithë.

3.4 Marrëdhënia ndërmjet kapitalit, rregullimit të tij dhe rrezikut

Për sektorin bankar vitet '70 janë vite të derregullimit në këtë sektor, proces nëpërmjet të cilit u abandonua rregullimi i aktiveve, kontrollet në hyrje dhe kufizimeve në lidhje me normat e depozitave. Ky proces u pasua me rritje, në numër dhe ashpërsi, të krizave në sektorin bankar. Për shkak të kësaj situate, rregullatorët në përpjekje për të gjetur instrumenta në përshtatje me bankingun e lirë, i dhanë përparësi rregullimit të kapitalit i cili fillimisht ishte i lidhur me nivelin maksimal të përdorimit të levës financiare. Bankat kanë aftësi pague se nëse vlera e aktiveve të tyre është së paku sa kërkesat e depozitorëve. Qëllimi i përdorimit të kapitalit rregullator mbështetej nga percipimi se bankat zgjedhin të veprojnë me një nivel më të lartë probabilitety për të dështuar. Arsytet e një sjellje të tillë ndër të tjerash mbështeten tek rreziku moral dhe skema e sigurimit të depozitave. Për të penguar bankat të ishin agresive ndaj rrezikut, institucionet rregullatore lidhën nivelin e kërkuar të kapitalit me nivelin e rrezikut që paraqet portofoli i huave. Nga viti 1988, viti i iniciativës së parë ndërkombëtare (marrëveshja e Bazelit), aktivet u vlerësuan në kategori të ndryshme në lidhje me nivelin e rrezikut. Për çdo kategori ka një nivel të caktuar kërkesë për kapital dhe në total niveli minimal i kapitalit të kërkuar për aktivet e ponderuara me rrezik është 8% (në Shqipëri ky nivel është 12%). Marrëveshja e Bazelit, konsiderohet e suksesshme në arritjen e dy parimeve kryesore: sigurimi i një niveli të mjaftueshëm kapitali në sistemin ndërkombëtar bankar dhe vendosjen e konkurrencës në një nivel më të lartë dhe për këtë arsye aplikimi i saj u shtri në sektorin bankar të mbi 100 vendeve. Por megjithatë, kjo zbatimi i kësaj marrëveshjeje nxorri në pak edhe disa mangësi të saj. Kategorizimi i aktiveve në lidhje me rrezikun që ato paraqesin lidhte në mënyrë të pamjaftueshme kërkesat për kapital me

rrezikun ekonomik. Kjo sepse bankat mund të shfrytëzonin mundësinë për arbitrazh me kapitalin rregullator.

Mangësitë e marrëveshjes së 1988, çuan Komitetin e Bazelit për Mbikqyrjen Bankare, në hartimin e një pakete të re në qershor 1999 dhe një tjetër të rishikuar në janar 2001. Ndërkohë që marrëveshja e vjetër kishte në fokus të saj kapitalin rregullator, marrëveshja e re mbështetej në tre shtylla: kërkesat për kapitalin minimal, rishikimin e procesit të mbikqyrjes dhe disiplina e tregut.

Sipas Basel II bankat mund të zgjedhin ndërmjet modelit standard dhe atij të mbështetur në vlerësimin e brendëshëm. Ndryshimi në modelin e parë qëndron në faktin se klasifikimi i aktiveve sipas rrezikut kryhet nga institucione të jashtme të vlerësimit të kredive. Në rastin e metodës së vlerësimit të brendëshëm bank mund të përdorë vlerësues të brendëshëm për aftësinë paguese të huamarrësve për të vlerësuar rrezikun e kredisë për portofolin e tyre, duke përdorur standarde strikte metodologjike dhe vlerësimi.

Në këtë seksion për të vlerësuar nëse rregullimi i kapitalit ndikon në uljen e probabiliteti për të dështuar analiza kryhet në dy drejtime. Përse bankat preferojnë të jenë agresive ndaj rrezikut dhe të mbajnë nivel të ulët të kapitalit si edhe çfarë efekt mund të ketë kapitali rregullator në vendimmarrje nga ana e bankës. Supozimet e këtyre modeleve ndryshojnë gjerësisht. Në pjesën e parë bëhet një paraqitje e modeleve teorike që lidhen me këtë pyetje dhe paraqitet lidhja e rezultatit me supozimet specifike në të cilat mbështetet secili model. Në pjesën e dytë, bëhet një rishikim i literaturës empirike. Qëllimi i këtij rishikimi është evidentimi i shkallës në të cilën vërtetohen gjetjet teorike në sjelljen reale të bankave.

3.4.1 Teorema e Modiglianit dhe Millerit

Modigliani dhe Miller (1985) ngrejne supozimin se nëse tregjet financiare janë perfekte dhe depozitorët janë të mirëinformuar në lidhje me rrezikun për falimentimin të bankës, zbatohet parimi i pasigurisë. Një parim i tillë nënkupton gjithashtu se aksionerët nuk kanë mundësi të përdorin depozitorët. Në kuadër të aktivitetit bankar, supozojnë se menaxherët veprojnë në përputhje me interesat e aksionerëve dhe synojnë maksimizimin e vlerës së aksioneve. Meqenëse bankat janë korporata, si të tilla detyrimet e tyre janë të kufizuara, ato arrijnë deri në nivelin e investimit të kryer. Si rrjedhim, humbjet e aksionerëve janë të kufizuara por në anën tjetër fitimet që ata sigurojnë nga shumat që u detyrohen depozituesve janë të gjitha të tyre. Nga këto cilësi të organizimit të korporatave, në lidhje me detyrimet dhe të drejtat (të parat të kufizuara, të dytat të pakufizuara), bankat preferojnë më tepër investimet me rrezik krahasuar me ato të sigurta ose me rrezik të ulët. Funkzioni i likuidimit për aksionerët ka formë konkave, të ngjashme me atë të një opsioni blerje, në lidhje me vlerën e bankës, me cmim të fiksuar të njëjtë me vlerën e detyrimeve ndaj depozitorëve. Por, nëse depozituesit janë të mirëinformuar në lidhje me strategjitë e investimit që ndjek banka, ata do të kërkojnë norma interesi që të jenë në përputhje me nivelin e rrezikut që ndërmerr ajo. Në këtë mënyrë aksionerët nuk mund të përfitojnë nga pozicioni i tyre kontrollues. Rrjedhimisht qëllimi i tyre për maksimizimin e aksioneve nënkupton maksimizimin e vlerës totale të bankës. Zgjedhja e një portofoli që maksimizon këtë vlerën e bën të pavarur vlerën e bankës nga struktura e kapitalit të saj. Nga një trajtim i tillë, rezulton se bankat do të synojnë të zgjedhin nivele optimale të rrezikut në mënyrë dhe rrjedhimisht nuk kanë nevojë për rregullim.

3.4.2 Rreziku moral për shkak të detyrimeve të kufizuara dhe sigurimit të depozitave

Në lidhje me qëndrimin që mbahet ndaj teorisë së Modigliani dhe Miller autorë të ndryshëm shprehen se ajo nuk është e përshtatshme të aplikohet në rastin e bankave ³⁵. Në kushte të ekzistencës së tregjeve perfekte dhe në mungesë të mosmarrëveshjeve, ndërmjetësit financiarë nuk janë të nevojshëm. Duke u mbështetur tek teoritë e informacionit arsyeja kryesore pse bankat mund të ushtrojnë aktivitetin e tyre është avantazhi që kanë ato në informacion që zotërojnë në lidhje me monitorimin e firmës. Depozitorët nuk mund të kenë informacion të plotë në lidhje me nivelin e rrezikut që përmban portofoli i bankës dhe si rezultat nuk mund të monitorojnë dhe kufizojnë bankën. Pikërisht, ky avantazh në lidhje me informacionin, është arsyeja pse në bankat shfaqet rreziku moral (moral hazard).

Në lidhje me asimetrinë e informacionit, Jensen dhe Meckling (1976) theksojnë se sjellja e mbajtësve të kapitalit është e tillë: pretendojnë fillimisht se investojnë në aktive me rrezik të ulët, por pas shitjes së obligacioneve, rritin rrezikun e portofolit ose nivelin e borxhit. Kjo për bankat do të thotë se për shkak të pamundësisë që kanë depozitorët për të marrë informacion në lidhje me aktivitetin e bankës, nuk mund të kërkojnë interesa që reflektojnë nivelin e rrezikut që mban portofoli i investimeve. Kjo asimetri informacioni, sjell rrezikun moral i cili shtyn bankat drejt rritjes të përdorimit të levës dhe të nivelit të rrezikut.

Sigurimi i depozitave me mbulim të plotë i bën depozitorët indiferentë ndaj nivelit të rrezikut që mbajnë fonde e bankës. Likuidimi i tyre është i sigurt dhe për këtë arsye ata nuk janë të prirur të monitorojnë sjelljen e bankës. Normat e depozitave për investitorë

³⁵ Stéphanie Stolz (2002)

që janë plotësisht të siguruar nuk tregojnë nivelin e rrezikut të aktiveve dhe bankat shfaqin tendencë të rritin nivelin e rrezikut të portofolit të tyre. Një sjellje e tillë është e mundur vetëm në rast se primi i sigurimit të depozitave nuk përcaktohet në bazë të nivelit të rrezikut. Nëse ndodh e kundërta, pra nëse primi i sigurimit do të caktohet në varësi të rrezikut, bankat nuk do të synojnë të ndërmarrin më tepër rrezik.

Merton (1977) dhe autorë të tjerë ka studiuar efektin negativ që ka sigurimi i depozitave nëpërmjet cimit të opsioneve. Për depozituesit, ata e konsiderojnë kërkesën ndaj siguruesit si një opion put i cili ka si premtim pagese çmimin e kontraktuar. Çmimi i këtij opsioni përcaktohet duke përdorur formulën e Black dhe Scholes³⁶. Kur rreziku për sigurimin e depozitave nënçmohet, si në rastin e primeve të sheshta të sigurimit, bankat do të synojnë të maksimizojnë vlerën e sigurimit të depozitave për të maksimizuar vlerën e kapitalit aksioner. Një përfitimi i tillë për aksionerët konsiderohet si "subvencion nga sigurimi i depozitave" të cilin bankat e shfrytëzojnë duke rritur raportin e levës dhe/ose duke aktive me rrezik. Si rrjedhim, rritin probabilitetin për të falimentuar.

Kane (1989) u përqendrua në një rast të veçantë të rrezikut moral për shkak të sigurimit të depozitave, në atë të bankave zombi. Depozitorët e siguruar duke mos ndjere rrezikun nuk i çjnë këto banka drejt falimentimit madje janë të gatshëm të vazhdojnë të depozitojnë. Këto fonde, këto lloj bankash, i investojnë në aktive me rrezik të lartë duke pretenduar kthime të larta nëse janë të suksesshme dhe duke kaluar humbjet tek siguruesit e depozitave nëse këto investime rezultojnë të dështuara.

³⁶ njohur ndryshe edhe si modli BSM, Black-Scholes-Merton.

Problemi i rrezikut moral është më tepër shqetësues për bankat e mëdha. Nën pretendimin se janë shumë të mëdha për të falimentuar, duke ditur rëndësinë që kanë mbështeten tek mbështetja publike që mund të marrin në rast stresi financiar. Në këtë mënyrë, këto banka duke u mbështetur në garancitë publike, mbajnë qëndrim pozitiv ndaj mundësive për të rritur rrezikun.

Në literaturë, ka një dakortësi në lidhje me ndikimin që ka një vlerësim jo i drejtë i sigurimit të depozitave ose në përgjithësi një rrjet publik i sigurisë në rritjen e probabilitetit për të dështuar. Në anën tjetër, ka mendime që nuk konvergjojnë në një pikë të përbashkët përse i përket ndikimit që ka kapitali rregullator në uljen e problemit të rrezikut moral.

Brenda dy grup modeleve, modelet e statusit të preferencës dhe ato të mbështetura në çmimin e opsioneve, kërkesat për kapital nuk ndikojnë nivelin e rrezikut sepse rritja e kapitalit nuk ndyshon sjelljen e bankës. Për bankën është përsëri e mundshme të zgjidhet një portofol që ja nivel të lartë rreziku. Prandaj, në kushte të zbatimit të sigurimit të depozitave, për të kufizuar probabilitetin e dështimit, është e rëndësishme që kërkesat për kapital të kombinohen me rregullime në portofolin e aktiveve të bankës. Në lidhje me nevojën e rregullimit të kapitali Sharpe (1978) shtron një tjetër pyetje. Kërkesat për kapital të mbështetura në nivelet e rrezikut, mund të ndikojnë në problemin e rrezikut moral në të njëjtën mënyrë si edhe përcaktimi i primeve të sigurimit mbështetur në nivelet e rrezikut. Mbështetur në këtë arsyetim, sipas të cilit rezulton se të dy këto kërkesa rregullatore japin të njëjtin rezultat përse duhet të kërkohen rregullimi i kapitalit kur vetëm një përcaktim korrekt i çmimit të depozitave të sigurimit mund të eliminojë rrezikun moral. Në përgjigje të kësaj pyetje Flannery (1991) vë në dukje se

këto lloj mekanizmash, në kushtet kur për përcaktimin e çmimit siguruesi nuk mund të përcaktojë saktë nivelin e rrezikut të bankës, nuk janë të njëjta. Për rrjedhojë, është i nevojshëm kombinimi i të dy këtyre instrumentave për të arritur minimizimin e gabimit në shpërndarjen e sektorit privat.

Në ndryshim nga Flannery, autorët Giammarino, Leëis dhe Sappington (1993) e trajtojnë këtë problem nga këndvështrimi i asimetrisë së informacionit ndërmjet bankës dhe mbikqyrësve të saj. Sipas modelit të prezantuar prej tyre, menaxherët e bankës kanë më tepër informacion në lidhje me cilësinë që kanë alternativat e investimit të bankës sesa siguruesi-rregullator. Këtij të fundit i duhet të përcaktojë koston oportune ndërmjet humbjeve nga falimentimi dhe kostove për të shmangur falimentimin. Për të bërë të mundur arritjen e një niveli optimal, kërkesat e kapitalit të bazuara në rrezik dhe primi i sigurimit, duhet të shoqërohet nga ana e rregullatorëve me masa kufizuese përsa i përket huadhenies.

Në studimin e tyre, Furlong dhe Keeley (1989) e kundërshtojnë pikëpamjen rreziku që ndërmarrin bankat nuk ndikohet nga kërkesat për një nivel minimal të kapitalit. Në kushte të sigurimit të depozitave, modelet e statusit të preferencës dhe ato të opsioneve, shkalla e rritjes së levës dhe rrezikut varet njëkohësisht nga nivelet e levës dhe të rrezikut. Një lidhje e tillë nxjerr në pah rëndësinë që ka rregullimi i kapitalit. Sa më forta kërkesat për kapital rregullator aq më tepër ulet rreziku moral rrjedhimisht edhe probabiliteti i bankës për të falimentuar.

Gennotte dhe Pyle (1991) e vendosin në diskutim këtë rezultat. Duke u mbështetur në të njëjtin model të vlerësimit të opsioneve, ata tregojnë se rregullimi i kapitalit mund të ndikojë në rritjen edhe të rrezikut të portofolit edhe të probabilitetit që banka të

falimentojë. Ata arrijnë në këtë rezultat duke bërë supozimin se investimet në aktive me rrezik sjellin ulje të kthimeve në to. Sipas tyre, bankat janë të specializuara në hua të ndjeshme ndaj informacionit dhe jo të tregëtueshme dhe kjo është arsyeja se përse kthimi nga investimi ulet. Një rritje në kërkesat për kapital ndikon njëkohësisht madhësinë e portofolit dhe rrezikun e tij, duke ulur të parin dhe rritur të dytin duke ndikuar në rritjen e probabilitetit për të falimentuar më shumë sesa në kushtet e mungesës së rregullimit.

Mundësia që një kapital rregullator i sheshtë të ketë efekt negativ në bankat është rezultat i teorive të modeleve të portofolit.

3.4.3 Modelet e portofolit

Sipas modeleve të portofolit, objektivi i bankave është të maksimizojnë pritshmëritë e funksionit von Neumann-Morgenstern të dobishmërisë i cili përshkruan preferencat kundërshtuese të rrezikut të menaxherëve-pronarë.

Koehn dhe Santomero (1980) analizojnë efektet e rregullimit të kapitalit . Një nivel i lartë i kapitalit do të ndikojë në uljen e kthimeve. Për të kompensuar këtë humbje bankat do të investojnë në aktive me rrezik më të lartë. Rritja e rrezikut që do të ndërmmarrë banka, rrjedhimisht edhe ndryshimi në probabilitetin e dështimit, do të varen nga qëndrimi që mban banka ndaj rrezikut. Për banka që janë refuzuese të rrezikut, kanë një probabilitet më të ulët për të dështuar sepse rritje relativisht të ulta të aktiveve me rrezik kompesohen me nivele më të larta të kapitalit. Për bankat që nuk kundërshtues të rrezikut, vendosja e rregullave strikte për kapitalin do të ndikohë në rritjen e paaftësisë së tyre paguese. Këta autorë gjetën se vetëm nëpërmjet kapitalit rregullator nuk mund të

ulet probabiliteti i dështimit. Efekti i tij në këtë drejtim ndihet nëse kombinohet me rregullime në aktivet.

Në një studim të mëvonshëm, Kim dhe Santomero (1988) arrijnë në përfundimin se kërkesat për kapital të lidhura me rrezikun mund të jenë një mënyrë e efektshme për të ulur probabilitetin e dështimit për bankat të cilat janë të siguruara. Për të përcaktuar në këtë mënyrë kërkesat për kapital është e rëndësishme të zgjidhen nivelet optimale të koeficientëve të ponderimit të rrezikut të cilat japin nivelin më të lartë të probabilitetit të paaftësisë paguese. Sipas përfaqësuesve teorike përcaktimi i saktë i koeficientëve të ponderimit të rrezikut varet nga kthimet e pritura, struktura e variancës dhe kovariancës, niveli më i lartë i rrezikut të lejuar të paaftësisë paguese që synojnë rregullatorët. Sipas këtij përcaktimi këta koeficientë nuk varen nga qëndrimi individual si refuzues rreziku.

Këto dy studime, Koehn dhe Santomero (1980) dhe Kim dhe Santomero (1988), mbështeten në supozimin se normat e huasë janë konstante dhe kostot janë të pavarura nga rreziku i portofolit. Për këtë arsye Keeley dhe Furlong (1990) i cilësojnë këto modele portofoli si jo të përshtatshme për të analizuar efektet që ka kapitali rregullator në falimentimin. Mundësia e pafundme për të marrë hua me një normë pa rrezik e çon në zero që në fillimi mundësinë për të falimentuar. Për më tepër, në një botë ku nuk ka sigurim të depozitave dhe probabiliteti për të dështuar është i ndryshëm nga zero depozitorët (e pasiguruar) do të kërkojnë norma kthimi (norma të depozitave) në varësi të rrezikut që paraqet portofoli i bankës. Ky i fundit përcaktohet nga niveli i levës dhe niveli i rrezikut për aktivet. Në një tjetër situatë, ku depozituesit e sigurvekës kërkojnë norma konstante pa rrezik, përsëri supozimi për kosto konstante të huamarrjes nuk mund

të aplikohet. Kjo për shkak se kosto marzhinale neto e pritshme e depozitave bie me rritjen e sasisë së depozitave sepse vlera e opsioneve të depozitave rritet me rritjen e leves. Mbështetur tek ky argumentim, Keeley dhe Furlong sygjerojnë një model sipas të cilit rritja e standardeve të kapitalit nuk do të shkaktojë rritje të rrezikut të portofolit. Kjo ndodh sepse një rritje në kapital do të shkaktojë ulje në vlerën put option të sigurimit të depozitave duke ndikuar në uljen e motiveve të bankës për të rritur nivelin e rrezikut të portofolit të saj.

Rochet (1992) sugjerojnë një përllogaritje të koeficientëve të ponderimit të aktiveve proporcional me rrezikun sistematik të tyre (koeficientë ponderimi të bazuara në treg). Një llogaritje e tillë e koeficientëve mund të bëjë që kapitali rregullator i ponderuar me rrezikun të ndikojë në uljen e probabilitetit të dështimit. Sipas këtij modeli, të gjitha bankat do të zgjedhin portofole që është në të njëjtën linjë efieience me banka që kanë kufizime në lidhje me kapitalin dhe zgjedhin portofole më pak të rrezikshme. Si rezultat i kësaj, ulet rreziku i dështimit.

3.4.4 Vlera e brendëshme, reputacioni dhe roli i konkurencës

Nga literaturat e sjellë deri tani në vëmendje studiohet një bankë konkuruese nga një këndvështrim statik. Në kuadër të modeleve të preferencës sipas (state-preference) kushteve ose çmimit të opsioneve, aksionerët kanë prirje të rrisin nivelin e levës dhe të rrezikut. Megjithatë, disa studiues theksojnë se konsiderata të ndërsjellta kanë një ndikim të moderuar në ndërmarrjen e rreziqeve. Ata marrin në konsideratë mundësinë për të gjeneruar flukse hyrëse. Këto flukse hyrëse mund të vijnë si rezultat i kostove të ndryshme të monitorimit ose konkurencës jo perfekte. Nga një këndvështrim dinamik vlera aktuale e të gjitha këtyre flukseve përfaqëson vlerën e brendshme të bankës e cila

mund të humbasë në rast falimentimi. Sa më e lartë kjo vlerë, aq më e lartë është kosto e rrezikut të portofolit dhe levës.

Në kuadër të kësaj, Hellmann, Murdock dhe Stiglitz (2000) kanë studiuar ndikimin që ka konkurrenca. Sipas tyre në vlera e brendëshme e bankës bie për shkak të konkurrencës banka do të rrisë nivelin e levës dhe të rrezikut. Gjatë analizës së rolit që ka kapitali rregullator si një mënyrë për të reduktuar rrezikun moral ata nxjerrin në pah se kërkesat minimale për kapital kanë një efekt të kundërt motivimi. Rritja e financimit nëpërmjet kapitalit me kosto të lartë çon në ulje të fitimeve, duke e bërë më të pakët humbjen në falimentim. Për bankat që përcaktojnë koeficientë ponderimi më të ulët periudhave më të largëta, humbja në vlerën e brendëshme është relativisht e ulët dhe mund të kompensohet me një efekt pozitiv të rrezikut në kapital. Për këto banka, kërkesat për nivel minimal të kapitalit eliminojnë rrezikun moral. Megjithatë, kërkesat për nivel minimal do të jenë në mënyrë joeficiente të larta. Autorët japin argumentin e tyre në mbështetje të idesë së kombinimit të kapitalit rregullator me përcaktimin e kufijve të sipërm të normave të depozitave..

Boot dhe Greenbaum (1993) studiojnë një aspekt tjetër të sigurimit të depozitave duke i bërë ato përgjegjëse për rritjen e rrezikut që ndërmarrin bankat. Sipas tyre konsideratat në lidhje me reputacionin janë shumë të rëndësishme në kushtet e rritjes së konkurrencës në sektorin bankar. Në këtë përjasje dinamike, bankat kanë tendencë të shangin rrezikun duke rritur monitorimin. Një monitorim më i mirë do të sjellë përmirësim në reputacionin e bankës dhe si rrjedhim kostot e financimit do të ulen. Këto përfitime që vijnë nga reputacioni kanë të njëjtat efekte nxitëse pozitive si tek modeli i ngritur nga Hellmann, Murdock dhe Stiglitz. Këto përfitime të financimit janë të vlefshme për

institucionet e pasiguruara në të cilat depozitorët janë të kujdesshëm ndaj rreziqeve të mundshme. Përfshirja e sigurimit të depozitave e shkatërron këtë përfitim në fonde të krijuar nga sigurimi i depozitave. Sipas tyre, skema e sigurimit të depozitave duhet të zbatohet kur niveli i ulët i konkurrencës nxit një monitorim optimal. Kur rritet konkurrenca, bankat ulin përpjekjet për monitorim dhe kjo në rritjen e rrezikut. Në lidhje me ndërmarrjen e rreziqeve kontrolli i kapitalit nuk do ta zbusë këtë efekt, në të kundërt, do ta përkeqësojë.

3.4.5 Sjellja e menaxherëve

Në trajtimet teorike të deritanishme është supozuar se aksionerët kontrollojnë bankën ose menaxherët veprojnë plotësisht sipas interesave të pronarëve. Veprimet e bankës përcaktohen nga aksionerët por kjo nuk përjashton mundësinë që menaxherët të kenë interesa të cilat janë të ndryshme nga ato të aksionerëve. Kjo ide në kontekstin e bankave është studiuar nga Saunders, Stock dhe Travlos (1990) të cilët argumentojnë se menaxherët mund të preferojnë një nivel më të ulët të rrezikut të dështimit sesa aksionerët. Në studimin e tyre ata përqendrohen kryesisht në qëndrimin e ndryshëm që mbajnë ndaj rrezikut bankat e kontrolluara nga menaxhimi dhe ato të kontrolluara nga aksionerët. Si banka të kontrolluara nga menaxhimi konsiderohen ato banka në të cilat menaxherët kanë, relativisht, një përqindje të vogël të kapitalit aksioner veprojnë për interes të maksimizimit të dobishmërisë së tyre. Banka të kontrolluara nga aksionerët konsiderohen ato banka në të cilat menaxherët kanë, relativisht, një përqindje të madhe të kapitalit aksioner dhe rrjedhimisht veprimet e tyre do të synojnë maksimizimin e vlerës së aksioneve dhe në këtë rast ata i ndjejnë humbjet e falimentimit. Ky konflikt interesash në varësi të strukturës së pronësisë së bankës është i rëndësishëm sepse nga njëra anë nga studimet rezulton një marrëdhënie negative ndërmjet marrjes së rrezikut

dhe shkallës së kontrollit manaxherial. Nga ana tjetër prezenca e palëve të treta siç janë rregullatorët bankare të cilët përcaktojnë masa apo rregulla që ndikojnë në vendimmarrjen në lidhje me nivelin e rrezikut. Duke ndryshuar mjedisin rregullator, qëndrimet konfliktuale të aksionerëve dhe menaxhimit në lidhje me rrezikun mund të thellohen dhe për bankat e kontrolluara nga aksionerët shkalla e rrezikut të ndërmarrë rritet. Sipas tyre, struktura e pronësisë ndikon në karakteristikat e rrezikut më tepër në periudhat e derregullimit sesa në ato të rregullimit. Menaxherët përpiqën të balancojnë rrezikun dhe nivelin e levës dhe si rrjedhim lidhja ndërmjet rrezikut të portofolit dhe kapitalit është pozitive.

Deëatripont dhe Tirole (1994) në teorinë e tyre ndjekin një tjetër model në lidhje me rrezikun moral. Ata ndjekin modelin standard të rrezikut moral. Përpjekjet dhe qëndrimi i menaxherëve nuk është i evidentueshëm dhe për këtë arsye ata nuk kanë nxitje për të monitoruar aktivitetin huadhënës të bankës. Ndaj menaxhimit mund të ofrohen stimuj shtesë nga aksionerët ose debitorët. Meqënëse menaxherët nuk janë shumë pozitivë ndaj ndërhyrjeve është mirë që në rastin e një performancë të mirë niveli i ndërhyrjes të jetë i ulët dhe në të kundërt, nëse performanca është mesatare, ndërhyrja të jetë e lartë. Duke pasur parasysh se kthimet për mbajtësit e kapitalit kanë një strukturë konkave dhe ato për mbajtësit e borxhit konvekse, sipas supozimit të bërë ndërhyrja ndërhyrja çon në uljen e rrezikut, mbajtësit e borxhit janë më të prirur të ndërhyjnë se mbajtësit e kapitalit. Duke ndjekur këtë arsyetim, mund të thuhet se në rastin e një performance mesatare kontrolli kalon nga mbajtësit e kapitalit tek mbajtësit e borxhit. Por, depozitorët e vegjël të cilët sigurojnë pjesëm më të madhe të fondeve të bankave tregëtare nuk zotërojnë njohuritë e duhura, individualisht apo së bashku, apo nuk janë të gatshëm për të marrë përsipër kontrollin, prandaj kjo detyrë duhet të meret përsipër të kryhet nga institucione të tjera

rregullatore ose mbikqyrëse. Këto institucione janë të përgatitura për ta kryer këtë detyrë ashtu si duhet ta kryenin depozitorët. (Kjo quhet hipoteza e përfaqësimit)

Në modelin e tyre të strukturës së kapitalit Deättripont dhe Tirole tregojnë sesi mund të arrihet rregullimi optimal nëpërmjet përdorimit të kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe ndërhyrjen e jashtme në rastet kur aktiviteti i bankës është i rrezikuar. Në rastet kur aftësia paguese e bankës është nën një nivel kritik të përcaktuar, rregullimi i kapitalit shërben si një zëvendësues i strukturës qeverisëse të bankës sepse ai e kalon kontrollin e bankës tek rregullatorët. Ndërkohë që probabiliteti i rënies rritet nga niveli i kapitalit të aftësisë paguese (Solvency Capital Rate) në drejtim të nivelit minimal të kërkesës për kapital (Minimal Capital Rate) menaxherët është më mirë që të monitorojnë aktivet sesa të uljen e rrezikut të portofolit. Në një situatë të tilla ata mund të rrisin kapitalin nëse aksionerët kërkojnë rikapitalizimin e bankës. Në këtë mënyrë, kërkesat për kapital ndikojnë në uljen e rrezikut të dështimit.

3.4.6 Rikapitalizimi

Në teoritë e trajtuara deri tani ka qenë në qendër të vëmendjes efektet që ka rregullimi i kapitalit në kapitalin e bankës dhe në nivelin e rrezikut që ndërmer ajo. Gjithashtu është trajtuar qëndrimi i aksionerëve meqënëse ata janë përcaktuesit kryesorë të kapitalit dhe të rrezikut. Në lidhje me rikapitalizimin, në rastin e bankave që kanë një kapital të kufizuar, përmendim efektin negativ që ka ai në çmimin e aksioneve.

Besanko dhe Kanatas (1996) e trajtojnë këtë ulje të çmimit të aksioneve në një model i cili mer në konsideratë bankat në kushtet e asimetrisë së informacionit. Si tek Jensen dhe Meckling (1997, ky model aplikohet për banka në të cilat ekziston problemi i agjensisë ndërmjet investitorëve të brendëshëm (menaxherëve pronarë të cilët zotërojnë një pjesë të kapitalit) dhe atyre të jashtëm (aksionerëve). Sipas Jensen dhe Meckling

menaxhertë-pronarë kanë tendencë të shfrytëzojnë aksionerët duke ndërmarrë, në rritje, veprime në favor të interesave të tyre me shpenzimet e bankës. Për shkak të asimetrisë së informacionit këto veprime nuk mund të kontrollohen nga investitorët e jashtëm dhe për këtë arsye ata nuk mund të ndalin këtë shfrytëzim që u bëhet nga menaxherët. Në rastin e një banke të dobët, vlera e kapitalit të saj, në kushtet e kësaj asimetrie, mund të ulet ose të ngrihet.

Besani dhe Kanatas (1996) ndërtojnë një model me supozime të ngjashme si Gennotte dhe Pyle (1990). Sipas tyre mundësitë për huadhënie me një vlerë aktuale neto pozitive dhe financim nëpërmjet depozitave me normë pa rrezik për shkak të sigurimit të depozitave, sjell një shtesë për aksionerët. Investitorët e brendëshëm, përpiqen për të rritur sigurinë në pagesën e huave. Kufizimet për kapitalin e detyrojnë bankën, edhe pse me aftësi të mirë paguese, të mbajnë një pjesë të kapitalit për të financuar depozitat. Kjo ndikon në uljen e fitimeve të pritshme nga mbajtësit e aksioneve, të cilët për këtë arsye, do të tregohen më pak të kujdesshëm dhe do të ndikojnë kështu në rritjen e aktiveve me rrezik. Aksionerët e rinj do të paguajnë një çmim më të ulët për aksonet e tyre dhe do të veprojnë njësoj. Si përfundim, rikapitalizimi do të rrisë fillimisht sasinë e kapitalit por do të ulë vlerën e tij për shkak të këtyre efekteve negative në sjelljen e menaxherëve. Në përputhje me studime të tjera empirike ata arrijnë në konkluzionin se si rezultat i rikapitalizimit të detyruar, pavarësisht nga ajo se çfarë ndodh me vlerën e kapitalit të bankës, çmimi i aksioneve do të bjerë. Sipas tyre, kjo rënie do të jetë më e madhe në banka që kanë një nivel pronësie të ulët nga ana e menaxherëve. Po për efekt të kapitalizimit të detyruar, modeli i tyre parashikon rritje në shpenzimet jointerеси. Kështu, për shkak të kapitalizimit të detyruar, mund të ndodhë që emetimi i aksioneve të

reja nga ana e bankës të ulë vlerën e tregut të kapitalit dhe të rritë mundësinë për të falimentuar.

3.4.7 Përmbledhje e literaturës teorike

Mbështetur në literaturën teorike në lidhje me marrëdhënien ndërmjet rrezikut që zgjedh banka dhe nivelit të kapitalit konstatohet se ato janë të ndërvarrura. Faktorë që ndikojnë në përcaktimin e strukturës së kapitalit janë kostot e falimentimit, taksat, kostot e agjencisë dhe sinjalizime të tjera. Në aktivitetin e bankave është prezent rreziku moral i cili, nëpërmjet veprimeve të fshehura, kontratave jo të plota, detyrimeve tëkufizuara për shkak të formës së organizimit të bankave si edhe skemës së sigurimit të depozitave, mund të stimulojë sjellë që rrisin rrezikun e portofolit ose levën. Qëndrimi kundërshtues ndaj rrezikut, zhvillime të tilla si rënia e vlerës së brendëshme në rast falimentimi sjellin efekte çekuilibruese. Konkurenca luan një rol të rëndësishëm në këtë marrëdhënie për shkak të ndikimit që ka ajo në flukset hyrëse të ardhshme të bankës.

Rregullimi i kapitalit, duke u konsideruar si një pengesë për optimizimin e vendimeve bankare, ndikon në vendimmarrje. Për bankat që kanë nivel të kapitalit rregullator mbi nivelin minimal, kërkesat për kapital ndikojnë tek bankat sepse për to, dështimi mund të konsiderohet i mundshëm kur niveli i kapitalit është poshtë atij minimal. Kjo do të thotë kosto shtesë për shkak të të qënurit i monitoruar nga afër nga autoritetet rregulluese dhe mbikqyrëse të cilat i vendosin këto kërkesa ose kufizime shtesë.

Në lidhje me efektet e rritjes së kërkesave për kapital nga literatura vijnë qëndrime kontradiktore. Sipas shumë modele të ngritura rezulton se rregullimet e sheshta të kapitalit (rregullime që nuk marin parasysh nivelin e rrezikut të aktiveve) ndikojnë në uljen e probabilitetit për të dështuar për shkak të kapitalit më të lartë zbutës. Nga ana tjetër, disa autorë e konsiderojnë këtë formë rregullimi të kapitalit se nuk sjell asnjë dhe si

rezultat do të rrisin nivelin e rrezikut të portofolit të tyre. Madje, sipas tyre, kjo formë do të neutralizojë efektin pozitiv që ka kërkesa për kapital më të lartë zbutës dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në rritjen e probabilitetit të dështimit. Për më tepër, përdorimi i rikapitalizimit si një mundësi për të arritur nivelet e kërkuara për kapital mund të çojë në rënien e çmimit të aksioneve për këto banka dhe kjo rënie sjell rënie të kapitalit zbutës.

Në lidhje me rregullimin e kapitalit të bazuar në shkallën e rrezikut që paraqesin aktivet e portofolit mund të eliminohen efektet e prirjeve negative . Por në përcaktimin e kërkesave për kapital sipas kësaj mënyrë është shumë i rëndësishëm përcaktimi korrekt i koefiçientit të ponderimit të rrezikut. Ky përcaktim mund të jetë i vështirë ose madje edhe i pamundur. Mbështetur në teorinë e informacionit, bankat e ushtrojnë aktivitetin e tyre sepse ato kanë avantazhe informacioni në monitorim. Për këtë arsye vlera e tregut e aktiveve të bankës nuk është drejtpërdrejt e vëzhgueshme e për pasojë rregullimi i kapitalit i bazuar në tregu nuk mund të praktikohet lehtësisht në rastin e bankave. Kjo ndër të tjera edhe për faktin se është një pjesë e madhe e aktiveve të bankës nuk janë kredi të tregtueshme. Ky argumentim nuk qëndron në rasti e titullizimit . Si përfundim mund të themi se një përcaktim jo korrekt i koefiçientit të ponderimit të rrezikut bën të mundur zëvendësimin e aktiveve dhe bëhet shkak për simuj të rinj për të rritur rrezikun.

Mbështetur në çfarë paraqet literatura teorike në lidhje me rrezikun, strukturën e kapitalit dhe rregullimin e tij rezultatet që vijnë janë kontradiktore. Modelet që përdoren janë gjithashtu subjekt kritikash. Për të vendosur se cili nga modelet teorike të trajtuara është i efektshëm për bankat duhet të bëhet testimi empirik i tyre.

3.5 Literatura empirike

Në këtë seksion bëhet një rishikim i literaturës empirike në lidhje me strukturën e kapitalit, marrjen e rrezikut dhe ndikimin që kanë në to rregullimi dhe mbikqyrja.

Fillimisht prezantohen studime të cilat kanë të bëjnë me marrëdhënien ndërmjet kapitalit dhe rrezikut nën rregjime të ndryshme kapitali rregullator (që nënkuton rregullim i sheshtë i kapitalit ose rregullim i bazuar në nivelin e rrezikut). Në vijim prezantohet studime që lidhen me vlerësimin e ndikimit që kanë sigurimi i depozitave, vlera e brendëshem dhe struktura e pronësisë në ndërmarrjen e rrezikut.

3.5.1 Studime në lidhje me marrëdhënien ndërmjet rrezikut dhe kapitalit

Ndryshimet në rrezik dhe kapital varen nga dy komponentë: endogjenë dhe ekzogjenë.

Komponentët endogjenë (ose variablat e varur) janë të lidhur proporcionalisht me diferencën ndërmjet nivelit të synuar të rrezikut ose kapitalit të bankës dhe këtyre niveleve në fillim të periudhës. Nivelet e synuara të rrezikut dhe kapitalit varen nga variablat ekzogjenë (ose të pavarur) siç janë norma e interesit të tregut, avantazhet që kanë në lidhje me taksat depozitat në krahasim me kapitalin, shkalla e trysnisë që vjen nga rregullatorët. Në rastet e modeleve me ekuacione simultane këto variabla ekzogjenë për rrezikun dhe kapitalin janë respektivisht kapitali dhe rreziku.



Studime në lidhje me kërkesën e sheshtë për kapital

Para viteve 1980, rregullimi në SHBA karakterizohen nga modele që mbështeteshin në grupime sipas karakteristikave të caktuara (peer group approach), që do të thotë se mbikqyrja ishte e orientuar në bilancin mesatar të bankës. Në studimin e tij Marcus (1983) kërkon të shpjegojë rënien dramatike të kapitalit ndaj raporteve të aktiveve në bankat tregtare amerikane mbështet presionin rregullator të mbështetur në teorinë e grupimit peer. Hipoteza e ngritur në këtë studim lidhet me ndikimin që ka rritja e normave nominale të interesit në rënien e raporteve të kapitalit. Rritja e normave të interesit sjell humbje në kapitalin e bankës. Në kushte të tilla rritja e kostos së kapitalit rregullator është më e vogël se në rastin kur vetë banka do të bënte këtë ulje të kapitalit.

Rrënia e nivelit të kapitalit për të gjitha bankat nuk kërkon nga bankat të rregullojnë kapitalin.

Pas viteve 1980, kërkesat për rregullimi e kapitalit sipas grupeve të ngjashme (peer groups) u zëvendësuan nga kërkesat për një nivel minimal të raportit të kapitalit me aktivet. Keeley (1988) në studimin e tij për 100 bankat më të mëdha në lidhje me pozicionin e kapitalit, gjeti se si rezultat i rregullimit bankat me nivel të ulët të raporteve të kapitalit i rritin këto raporte në vlera absolute dhe relative në krahasim me bankat me raporte të larta të kapitalit. Sipas studimit të tyre, kjo u arrit duke ngadalësuar rritjen e aktiveve.

Në studimet e sipërpërmendura, nuk merret në konsideratë nivelin i rrezikut. Shrives dhe Dahl (1992) studiojnë në punimin e tyre marrëdhënien e kapitalit me rrezikun e portofolit. Ata zhvillojnë më tej metodologjinë e ndjekur nga Marcus duke përdorur një sistem ekuacionesh simultane me dy shkallë. Sipas këtyre autorëve, niveli i rrezikut të portofolit lidhet me shpërndarjen që u bëhet aktiveve në kategori sipas rrezikut që mbartin ato dhe cilësia që ka portofoli i kredive në tërësinë e portofolit të aktiveve të bankës. Mbështetur në këtë argumentim të tyre ata përdorin dy matës të rrezikut: raportin e kapitalit të bazuar në nivelin e rrezikut të aktiveve dhe raportin e huave me probleme ndaj totalit të huave.

Autorët mbështetur në evidencat e studimit të tyre gjetën marrëdhënie pozitive ndërmjet kapitalit dhe rrezikut. Marrëdhënia mbeti e njëjtë edhe për banka të cilat kishin nivel të kapitalit rregullator më të lartë se ai minimal i kërkuar. Kjo e fundit mbështet konkluzionin se marrëdhënia pozitive ndërmjet kapitalit dhe rrezikut nuk është rezultat i rregullimit dhe tregon se ajo reflekton qëndrimin që mbajnë pronarët dhe/ose menaxherët ndaj rrezikut. Nivelet e synuara të kapitalit dhe normat e rregullimit të tij

rezultuan më të larta për banka të cilat duke patur nivele të ulta kapitali ishin më tepër nën presionin e rregullatorëve. Sipas rezultateve të këtij studimi marrëdhënia pozitive ndërmjet kapitalit dhe rrezikut tregon se rritja e kapitalit rregullator do të shoqërohet me rritjen e nivelit të rrezikut në portofolin e aktiveve me përjashtim të rasteve kur kjo kufizohet nga rregullatorët.

Studime në lidhje me kërkesat për kapital të bazuar në rrezik

Avery dhe Berger (1991) analizojnë standardet e kapitalit të bazuara në rrezik për bankat në Amerikë. Ata vlerësojnë marrëdhënien ndërmjet performancës, raporteve të kapitalit të bazuara në rrezik dhe standardeve në lidhje me këto raporte. Për të këtë qëllim përdoren disa variabla që lidhen me performancën e bankës në lagje të protofolit të bankës të krijuara për çdo kategori të aktiveve si përcaktuar nga standardet për kapitalin e bazuar në rrezik. Rezultatet e punimit të tyre tregojnë se për bankat që kanë raporte më të larta të aktiveve të ponderuara me rrezik ndaj aktiveve që nuk janë të ponderuara me rrezik, parashikohet një performancë më e ulët. Masa më të cilën bankat nuk arrijnë të përmbushin standardet konsiderohet si një tregues i mirë për të parashikuar problemet e ardhshme në performancë si edhe politikat mbështetëse për ndërmarrjen e veprimeve të duhura në vartësi të shkallës së shkeljes së standardeve. Nga ana tjetër, shkalla në të cilën bankat qëndrojnë mbi nivelin e kërkuar nga standardet nuk parashikon një performancë më të mirë nga ana e tyre.

Pasi konstatuan një rritjen e investimeve të bankave në aktive me nivelit të ulët të rrezikut, Haubrich dhe Wachtel (1993) studiojnë lidhjen ndërmjet kësaj sjelljeje dhe zbatimit të marrëveshjes së Basel I. Përfundimet e këtij studimi tregojnë se zbatimi i kësaj marrëveshjeje bëri që bankat me nivel të ulët të kapitalit të rikompozojnë kapitalin

duke u larguar nga aktivet me rrezik të lartë dhe përqëndruar tek aktivet me nivel të ulët të rrezikut.

Në vijim të studimit të Shrives dhe Dahl, Jacques dhe Nigro (1997) analizojnë marrëdhënien e ndërsjellë ndërmjet ndryshimeve në kapital dhe rrezikut të portofolit duke përdorur këtë herë standardet e kapitalit të bazuara në rrezik. Autorët gjetën se këto raporte kanë çuar në një rritje të konsiderueshme të raporteve të kapitalit dhe në uljen e nivelit të rrezikut ndaj të cilit janë të ekspozuara. Kjo marrëdhënie qëndron e tillë edhe për bankat me kapital me bazë rreziku të kufizuar edhe për ato me këtë tregues jo të kufizuar. Në ndryshim nga rezultatet e Shrives dhe Dahl, rezultatet e studimit të Jacques dhe Nigro vlerësojnë një marrëdhënie negative ndërmjet raporteve të kapitalit dhe rrezikut.



Studime mbështetur në modelin e çmimit të opsioneve

Furlong (1988) bazuar në teorinë e çmimit të opsioneve studioi ndryshimin rrezikut të dështimit për bankat e madha para dhe pas periudhës së aplikimit të marrëveshjes së Bazelit. Sipas kësaj teorie vlera e tregut e kapitalit të bankës mund të konsiderohet si vlera e një opsi për shitje të shkruar me vlerën e aktiveve të bankës dhe me çmim të caktuar të këtij opsi sa vlera e depozitave. Paqëndrueshmërinë e vlerës së aktiveve, Furlong , e përcakton duke përdorur formulën e Black dhe Scholes për çmimin e opsioneve për shitje. Matja e rrezikut të aktiveve në këtë mënyrë tregoi se ai u dyfishua për periudhën pas vendosjes së kërkesave për kapital në krahasim me periudhën e mëparshme, para vendosjes së tyre. Rritja e rrezikut më tepër sase përmirësoi nivelin e kapitalit duket se ndikoi në rritjen e rrezikut të dështimit. Megjithatë duhet përmendur se kjo rritje është vërejtur më tepër në bankat e mirëkapitalizuara.

Sheldon (1996) bën të njëjtën analizë për 219 banka të G-10 gjatë periudhës 1987-1994, periudhë gjatë së cilës filloi zbatimi i rregullave të Bazelit. Ai studion efektet që ka në rrezik zbatimi i standardeve të kapitalit të bazuara në rrezik. Nga pikëpamja teorike, meqënëse këto standarde rritin përqindjen e kapitalit që duhet të mbahet si amortizator në rast dështimi, pritet që të ndikojnë në uljen e mundësisë për të falimentuar, rritjen e mbrojtjes ndaj huadhënësve dhe fuqizimin e treguesve të shëndetit dhe stabilitet të të gjithë sektorit bankar. Nga ana tjetër, ka modele ekonomike të cilat tregojnë se rritja e kërkesave për kapital shërben si shtytje për bankat drejt investimit në aktive me më tepër rrezik. Rezultatet e studimit të tij nuk e mbështetën supozimin se zbatimi i kërkesave për kapital rregullator çon në rritje të nivelit të rrezikut në aktivet e portofolit të bankave. Rrjedhimisht ato nuk mbështetën supozimin se implementimi i rregullave të Bazelit në lidhje me kapitalin dhe të rritin probabilitetin për dështimin e bankave. Pavarësisht nga rezultatet e këtyre dy studimeve në konceptimi e tyre ato karakterizohen nga mos përdorimi i variablave të kontrollit për të përcaktuar influencën e tyre në marrjen e rrezikut për periudhën e marrë në vëzhgim. Përveç kësaj edhe zbatimi i formulës së Black dhe Scholes ka kufizime gjithashtu.

3.5.2 Studime të bazuara në rrezikun moral për shkak të sigurimit të depozitave

Në lidhje me ndikimin negativ që ka siguri i depozitave ka një literaturë të pasur empirike. Në studimet e tyre Thies dhe Gerloëski (1989) dhe Echeolock (1992), të cilët marin në analizë sektorin bankar të SHBA, arrijnë në përfundimin se siguri i depozitave ndikon në rritjen e rrezikut dhe probabiliteti për të dështuar. Në të njëjtin përfundim arrijnë edhe Demirguç-Kunt dhe Detragiache (2000). Sipas tyre, ndikimi negativ i sigurimit të depozitave ishte edhe me i lartë në kushtet e derregullimit të

normave të interesit. Në vende ku rregullimi bankar dhe mbikqyrja nuk ishin në nivelin e duhur ky efekt negativ i sigurimit të depozitave ishte edhe më i lartë.

Rezultatet empirike të studimit të Gropp dhe Vesala (2001) vijnë në kontrast me ato të përmendura më sipër. Në këtë studim përfshihen bankat europiane dhe studiohet në to marrëdhënia ndërmjet sigurimit të depozitave, monitorimit të huave, vlerës së brendshme të bankave dhe rrezikut. Aplikimi i sigurimit të depozitave ndikon në uljen e rrezikut që ndërmarrin bankat. Sipas tyre, në kushte të mungesës së sigurimit të depozitave, sistemi bankar europian karakterizohet nga një sistem sigurimi i nënkuptuar që do të thotë në raste stresi pritej shpëtimi nga ndërhyrja publike. Duke u përqëndruar vetëm tek sigurimi i depozitave spektri i rrjetës së sigurisë ngushtohet dhe njëkohësisht edhe rrezikut moral. Sipas tyre besimi i depozitorëve për një shpëtim publik shërben si nxitës për rrezikun moral. Në këtë mënyrë qeveria nuk e përjashton mundësinë e rrjetës së sigurisë (e përcakton saktë së përfshin vetëm depozitat) por njëkohësisht tregon se nuk do të ndërhyjë në situata stresi/krize. Testimi i hipotezës së këtij studimi në lidhje me marrëdhënien e ndërsjellë ndërmjet vlerës së brendshme dhe qëndrimit ndaj rrezikut rezulton se bankat që kanë një vlerë të brendshme më të ulët tregohen më të kujdesshme ndaj rrezikut nën ndikimin e sigurimit të depozitave. Kjo tregon se për këto banka rreziku moral është më i lartë. Ndërkohë që bankat e mëdha dhe të rëndësishme në sistemin bankar nuk ndryshojnë qëndrimin ndaj rrezikut nga zbatimi i sigurimit të depozitave. Kjo tregon se ky lloj sigurimi i ofruar nuk e shmang problemin "shumë e madhë për të dështuar".

Trajtimin e këtij problemi nën këndvështrimin e bankës si maksimizuese të vlerës së opsioneve për shitje është kryer nga shumë studiues. Në studimin e tij Keeley (1988) jep prova se bankat mbajnë më tepër kapital se niveli i kërkuar. Studiues të tjerë konstatojnë

se për shumë banka vlera e opsionit sigurim i depozitave është më e vogël sesa çmimi i tij. Në periudha kur sektori bankar është karakterizuar nga një rregullim i fortë, sistemi i sigurimeve ka pasur norma të ultë të dështimeve rezultat që është i kundërt me atë që pritej nëse bankat do të ishin të suksesshme në maksimizimin e vlerës së opsionit për shitje. Fakti krizat e huave dhe të depozitave ndodhën pasi filloi procesi i derregullimit tregon se sa një vlerë e brendëshme e lartë ndikon në uljen e efekteve negative që mund të shkatohen nga sigurimi i depozitave.

3.5.3 Studime që tregojnë ndikimin e vlerës së brendëshme

Në studimin e tij Keeley (1990) teston hipotezën se konkurenca dhe vlera e brendëshme e bankës janë në një marrëdhënie të zhdrejtë ndërmjet tyre, rritja e konkurrencës bëhet shkak që vlera e bankës të pësojë rënie. Për shkak të rritjes së aktiveve me probleme dhe uljes së kapitalit, rënia në vlerë do të sjellë rritje të rrezikut të dështimit. Kjo hipotezë vërtetohet nga rezultatet empirike të studimit të tij. Sipas tij, disa prej problemeve të bankës mund të shkaktohen nga rënia e vlerës së tregut të saj për shkak të konkurrencës brenda sektorit bankar.

3.5.4 Ndikimi që ka struktura e pronësisë

Në studimin e tyre Saunders, Stock dhe Travlos (1990) japin shpjegime për rrezikun që ndërmarin bankat në lidhje me strukturën e pronësisë, ambientin rregullator dhe të tjerë variabla karakteristike për bankën. Autorët konstatojnë se ndërmjet menaxherëve, të cilat janë njëkohësisht edhe mbajtës të kapitalit të bankës (të quajtur në këtë rast të brendshmit) dhe investitorëve (të quajtur në këtë rast të jashtmit, të cilët nuk janë të përfshirë në menaxhim) është prezent problemi i agentit. Niveli i rrezikut të portofolit rezulton të jetë më i lartë në rastin kur bankat kontrollohen nga aksionerët e jashtëm sesa në rastin kur aksionerët e brendshëm zotërojnë një pjesë të mjaftueshme të kapitalit të

bankës. Për më tepër, nga ky studim rezulton se ndryshimet në qëndrimin ndaj rrezikut në varësi të strukturës së pronësisë dalin me tepër në pah në periudhat e derregullimit.

3.5.5 Studime në lidhje me rikapitalizimin

Ndër studimet në lidhje me ndikimin që ka rikapitali te vlera e aksioneve përmendim atë të Keeley (1989). Autori mer në analizë ndryshimet në çmimet e aksioneve në rastin e rritjes së kapitalit në mënyrë të vullnetshme nga ana e bankave dhe në atë të rritjes së tij për shkak të përmbushjes së kërkesave për kapital rregullator. Rezultatet e studimit të tij tregojnë se çmimi i aksioneve për bankat me nivel të kufizuar kapitali pas rikapitalizimit pëson një rrënie të ndjeshme. Ndërkohë që çmimi i aksioneve i bankave me nivel të mirë kapitalizimi nuk tregon të njëjtën sjellje. Cornett dhe Tehranian (1994) studiovan sektorin bankar në SHBA. Rezultatet e studimit të tyre tregojnë se për bankat që nuk janë të mirëkapitalizuara, rikapitalizimi çon në rrënien e vlerës së aksioneve. Kjo rrënie është më e madhe në rastin e rikapitalizimit të kryer në mënyrë të vullnetshme nga vetë bankat. Gjithashtu sa më e madhe të jetë nevoja për rikapitalizim aq më e madhe është kjo rënie për shkak edhe të uljes së mbështetjes nga sigurimi i depozitave. Në lidhje me strukturën e pronësisë, autorët konstatojnë se ajo ndikon në madhësinë e rënies në kthime. Marrëdhënia ndërmjet pronësisë së brendshme dhe rënies së kthimit është negative. Sa më e lartë të jetë pronësia e brendëshme (përfshin menaxhimin) aq më e ulët është kjo rënie.

Gjetja e një lidhje negative ndërmjet rritjes së kapitalit dhe çmimit të aksioneve vë në dukje se rregullatorët duhet të marrin në konsideratë këtë rënie të çmimit dhe të synojnë kufizimin e mundësisë për të dështuar.

Në studimin e Laderman (1994) rezulton se ka një rënie të ndjeshme në kthimin e aksioneve në rast emetimi të aksioneve të reja.

3.5.6 Studime të marrëdhënies ndërmjet marrjes së rrezikut, kapitalit dhe efijencës në vend të ndryshme

i. Bankat tregëtare SHBA

Berger dhe De Young ishin të parët që studiuan këtë lidhje në vitin 1997, për bankat tregëtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për periudhën 1985-1994. Si parametër i cilësisë së hausë përdoret raporti i huave me probleme ndaj huave totale. Efijenca e kostos vlerësohet duke përdorur teknikën e kufirit stohasitk për të përlllogaritur një tregues vjetor të efijencës për çdo bankë. Për të kryer testin e shkakësisë së Greinxherit modeli mbështetet në një sistem me tre ekuacione. Në këtë mënyrë për secilin nga variablat e varur mund të përcaktohen koefijentët e regresionit të lidhjes së tyre me variablat e pavarur dhe për të kontrolluar për burime të tjera të variacionit ndërsektorial dhe të kohës. Vlerësimi i çdo ekuacioni kryhet me metodën OLS dhe shuma e koefijentëve të lageve për çdo variabël jep informacion për ekzistencën apo jo të lidhjes shkakësore. Rezultatet e këtij studimi tregojnë një lidhje negative ndërmjet efijencës së kostos dhe huave me probleme. Ndërmjet tyre u gjet një lidhje e ndërsjelltë shkakësie, me drejtim në të dyja anët, duke vërtetuar në këtë mënyrë hipotezën e "fatit të keq" dhe atë të "menaxhimit të keq". Sipas këtij studimi efijenca lidhet pozitivisht me huatë me probleme, duke vërtetuar atë që parashikohet nga hipoteza e "kufizimit". Ata gjithashtu argumentojnë se rritja e nivelit të huave me probleme është e lidhur me ngjarje të jashtme, jashë ndikimit të menaxhimit, duke vërtetuar atë që parashikohet nga hipoteza e "fatit të keq" (Berger dhe De Young, 1997). Berger dhe De Young testuan vetëm për bankat efijente sepse hipoteza e "menaxhimit të keq" dominonte atë të "kufizimit" në gjithë bankat e zgjedhura. Për këtë shkak të kësaj atë testuan për gjetur evidenca në lidhje me hipotezën "skimping" për bankat të cilat ishin në një nivel efijencë mbi atë mesatare të modelit.

ii. EUROPE bankat e kursimeve

Ëilliams, studion sjelljen manaxheriale në bankat e kursimeve në 6 vende të Europës (Danimarë, Francë, Gjermani, Itali, Spanjë dhe Mbretëria e Bashkuar)për periudhën 1991-1998, për të krahasuar rezultatet e studimit të tij me ato të Berger dhe De Young në lidhje me hipotezat e menaxhimit të keq, fatit të keq, kufizimit dhe rrezikut moral. Në ndryshim nga Berger dhe De Young të cilët përdorën shumën e huave me probleme si tregues së cilësisë së aktiveve, ai përdor për këtë qëllim provizionet për kreditë e humbura për shkak të mungesës së të dhënave. Përdorimi i këtij treguesi, nuk është aq i përshtatshëm sa ai i huave me problemë ndaj totalit të huave, sepse nuk përjashtohet mundësia e ndikimit të brendëshëm (influenca e menaxherëve të bankës) në vlerësimin e provizioneve. Në këtë punim vlerësohen dy tregues të efijencës ekonomike: efijenca e kostos dhe ajo e fitimit. Autori e cilëson qartë arsyen e përfshirjes së efijencës në studimin e sjelljes manaxheriale. Sipas tij, efijenca e kostos në studim është efijenca e shpenzimeve operative sepse burimet që mund të shpenzohen për shkak të sjelljeve të fatit të keq, menaxhimit të keq, kufizimit dhe rrezikut moral ndikojnë në shpenzimet e personelit ose në shpenzimet e jointeresit. Literatura teorike në lidhje me efijencën në banka mbështet idenë se kostot operative janë elementi më i rëndësishëm në inefijencën e kostos (Berger dhe Humphrey, 1991)

Vlerësimi i të dy këtyre treguesve alternative, kryhet me modelin e kufirit stohasitik. Qëllimi i vlerësimit të efijencës së fitimit është përdorimi për të ritestuar hipotezën e kufizimit. Sjellja në rastin e vërtetimit të kësaj hipoteze ndikon në uljen e cilësisë së outputeve, të cilat ndikojnë edhe kostos edhe të ardhurat. Rritja e huave me probleme, nga njëra anë rrit kostot operationale për shkak të nevojës së kostove shtesë për monitorimin etj., nga ana tjetër ul të ardhurat për shkak të problemeve me shlyerje e

detyrimeve nga ana e huamarrësve. Ky element i metodologjisë përbën ndryshimin me studimin e Berger dhe De Young (1997) sepse metodologjia e përdorur në vlerësimet e shkakësisë është e njejtë me ta.

$$LLP_{st} = f_1 (LLP_{s\ lag}, XEFF_{s\ lag}, CAP_{s\ lag}, LTA_{s\ lag}, Yr_t) + \varepsilon_{1st}$$

$$XEFF_{st} = f_2 (LLP_{s\ lag}, XEFF_{s\ lag}, CAP_{s\ lag}, LTA_{s\ lag}, Yr_t) + \varepsilon_{2st}$$

$$CAP_{st} = f_3 (LLP_{s\ lag}, XEFF_{s\ lag}, CAP_{s\ lag}, LTA_{s\ lag}, Yr_t) + \varepsilon_{3st}$$

Vlerat e efijencës *XEFF* (efijenca e kostos/fitimit) përdoren për të vlerësuar nëse menaxhimi i cilësisë së aktiveve *LLP*(*provizionit i huave me probleme*) dhe kapitalizimi *CAP*(*raporti i kapitalit me totalin e aktiveve*) ndikojnë në efijencën e bankës.

Vlerësimi i efijencës bankare kryhet duke përdorur modelin e kufirit stohasitik si tek Battese dhe Coelli (1995). Sipas këtij modeli termi i efijencës del nga një shpërndarje normale e cunuar dhe është një model me një hap, sipas të cilit kufiri stohasitik percaktohet duke përdorur formën elastike të funksionit Fourier (FF). Sipas këtij funksioni niveli i inefijencës së firmës percaktohet nga një vektor i variablave ambientale dhe specifike të firmës të cilët supozohet të ndikojnë inefijencën (Wang dhe Schmidt (2002))

Rezultatet ekonometrike tregojnë se ulja e efijencës së kostos dhe asaj të fitimit do t'i paraprijnë përkeqësimit cilësisë së huave, lidhje që parashikohet në rastin e hipotezës së menaxhimit të keq. Kjo hipotezë rezulton statistikisht shumë e fortë.

Mbështetur tek këto rezultate, problemi më i madh i menaxhimit në bankat europiane rezulton se është manaxhimi i keq (Williams, 2004).

	Rrezik Y=NPL/L	Efiçencë Y=EFF	Kapital Y=E/A
Rrezik NPL/L		(-) bad lack	
Efiçencë EFF	(-) bad manag. (+) most eff. banks; skin		
Kapital E/A	(-) moral hazard		

iii. Europa qendrore lindore

Në vendet e zhvilluara dhe në ato në zhvillim, përgjigjia ndaj krizave financiare ka qënë rritja e kapitalit dhe ulja e ekspozimit ndaj rrezikut. Bankat, mund të konsiderohen si maksimizuese të fitimit duke përcaktuar njëkohësisht kapitalin dhe rrezikun. Rritja e nivelit të kapitali ka kosto dhe për këtë arsye shqetësimi që ngrihet lidhet me mundësinë që ka kjo rritje kapitali mbi nivelin e atij të kërkuar, të sigurojë përfitime shtesë. Studimet empirike japin evidenca se zgjedhjet që bëjnë bankat në Amerikë dhe Europë në lidhje me kapitalin dhe rrezikun janë të njëkohëshme. Ndërsa përsa i përket marrëdhënies ndërmjet kapitalit dhe rrezikut, parashikimet janë kontradiktore. Megjithatë, duhet përmendur se kjo marrëdhënie ndikon shumë politikat e sektorit bankar dhe ekonominë si e tërë. Duke u mbështetur në faktin se kriza e kredive, si e vërejtur në periudhën 2009-2011 në vendet e Europës Juglindore (përfshi edhe Shqipërinë), është më e përhapur në vendet me një sistem kredie të bazuar në bankat³⁷. Për shkak të këtyre krizave të gjitha bankat e vendeve të Europës Juglindore patën humbje në portofolin e tyre të huave.

³⁷ Panayiotis P. Athanasoglou (2011) Bank capital and risk in the South Eastern European region

Rossi, Schëaiger dhe Eïnkler (2005), e zgjerojnë studimin e Eïlliams (2004) duke përfshirë në studim vendet në tranzicion, sektorin bankar të 9 vendeve të europës qëndrore dhe lindore (Republika Çeke, Estonia, Hungara, Letuania, Litonia Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia). Analizat e tyre përfshijnë 278 banka nga 9 vende në tranzicion për peirudhën 1995-2002. Ashtu si në punimet e mëparshme, ata përcaktojnë marrëdhënien ndërmjet cilësisë së huave, efiçencës (së kostos dhe fitimit) dhe kapitalit nëpërmjet përlogaritjes së efiçencës së kostos dhe fitimit duke përdorur një metodë semi joparametrike Fourier flexible form (FF), teknikën e shkakësisë së Greinxherit si në punimet e mëparshme.

Në përcaktimin e efiçencës, modeli i përkufizimit të inputeve dhe outputeve që përdoret në këtë studim është ai i sygjeruar nga Berger dhe Humphrey (1991) Bauer et al. (1993) modeli i modifikuar i prodhimit sipas të cilit depozitat mund të konsiderohen në funksionin e kostos/fitimit me karakteristika të inputeve dhe outputeve njëkohësisht. Sipas këtij modeli interesat që paguhen për depozitat konsiderohen si inpute ndërsa sasia e tyre duhet të konsiderohet si output. Zgjedhja e këtij modeli ka qenë më i përshtatshmi për të dhënat në funksion të këtij studimi dhe është i mbështetur nga rezultatet e procedurave të testit F. Mbështetur në këtë model, autorët përdorin si faktorë të inputeve, për funksionet e kostos dhe fitimit, çmimin e punës, kapitalit dhe depozitave dhe si outpute huatë, depozitat dhe aktive të tjera që sjellin fitim.

Për funksionin e kostos dhe të fitimit autorët përdorin modelin Fourier flexible (FF) i cili është një model gjysëm-joparametrik që kombimon specifikimin standard translog (TL) me formën joparametrike Fourier. Në këtë mënyrë, FF prezanton avantazhet e të qënurit i përshtatshëm dhe përfshirjen e specifikave të funksionit Cobb-Douglas të prodhimit. Ky përmirësim teorik, sipas të cilit bëhet e mundur paraqitja e një numri të

madh funksionesh, ka rezultuar si më i përshtatshëm me të dhënat sesa TL i cili nuk i afrohet funksionit të vërtetë të panjohur të një industrie.

Vlerat e efikasitetit *XEFF* (efikasiteti i kostos/fitimit) përdoren për të vlerësuar nëse menaxhimi i cilësisë së aktiveve *LLP*(provizionet e huave me probleme) dhe kapitalizimi *CAP*(raporti i kapitalit me totalin e aktiveve) ndikojnë në efikasitetin e bankës. Për të kontrolluar ndikimin që ka pronësia, *Oënership* (% e bankave me kapital të huaj), madhësia, *Market-share* (aktet e çdo banke në raport me aktivet totale të sistemit), përqendrimi i tregut *Concentration* (raporti i aktiveve të 5 bankave më të mëdha me totalin e aktiveve të sistemit) dhe trendi *Trend* (koha), autorët i përdorin këta variabla kontrolli si në barazimin më poshtë :

$$XEFF_{st} = LLP_{st} + CAP_{st} + LTA_{st} + Market-share_{st} + Concentration_{st} + Oënership_{st} + Trend_{st} + \varepsilon_{st}$$

Modeli i përdorur për studimin e marrëdhënies së efikasitetit, kapitalit dhe rrezikut ka për qëllim verifikimin e katër hipotezave të ndryshme të sjelljes menaxheriale, të ngjashme me ato të përdorura nga Berger and DeYoung (1997) për bankat tregëtare në SHBA. Këto hipoteza janë:

- a) *hipoteza e menaxhimit të keq*, rënia e efikasitetit (menaxhim jo i mirë i portofolit) rritje e huave me probleme;
- b) *hipoteza e kufizimit* korelacion pozitiv ndërmjet efikasitetit të kostos dhe huave me probleme
- c) *hipoteza e menaxhimit të keq*, faktorë të jashtëm ndikojnë rritjen e huave me probleme dhe në këto kushte në rënie të efikasitetit sepse rriten kostot e monitorimit

d) *hipoteza e rrezikut moral* menaxherët e bankave që nuk janë të mirë kapitalizuar janë pranues të rrezikut dhe kjo çon në rritje të rrezikut, domethënë në rritje të huave me probleme.

Modeli i ngritur nga këta autorë është i ngjashëm me atë të studimeve të mëparshme.

Ekuacione e këtij modeli janë:

$LLP_{st} = f_1 (LLP_{s\ lag}, XEFF_{s\ lag}, CAP_{s\ lag}, LTA_{s\ lag}, Yr_t) + \varepsilon_{1st}$	<i>Për të testuar hipotezën e menaxhimit të keq shenjë - në marrëdhënien LLP dhe vlerave të laguara të EFF; kufizimit, në rast shenje + në këtë marrëdhënie dhe rrezikut moral, kur marrëdhënia e LLP me vlerat e laguara të CAP është -</i>
$\overline{XEFF}_{st} = f_2 (LLP_{s\ lag}, XEFF_{s\ lag}, CAP_{s\ lag}, LTA_{s\ lag}, Yr_t) + \varepsilon_{2st}$	<i>Për të testuar hipotezën e fatit të keq: marrëdhënie negative ndërmjet EFF dhe vlerave të laguara të LLP</i>
$\overline{CAP}_{st} = f_3 (LLP_{s\ lag}, XEFF_{s\ lag}, CAP_{s\ lag}, LTA_{s\ lag}, Yr_t) + \varepsilon_{3st}$	<i>nuk kontrollon asnjë nga hipotezat e lartpërmendura</i>

Për vlerësimin e këtij modeli përdoret teknika e shkakësisë së Greinxherit.

Gjetjet e këtij punimi në lidhje me efikasitetin e kostos dhe fitimit tregojnë se bankat e vendeve të europës qendrore dhe lindore kanë një nivel të ulët të efikasitetit të kostos dhe fitimit ndërkohë që tendenca e tyre është në rritje.

Për këto banka, në këtë studim, nuk u gjetën rezultate për praninë e hipotezës së "menaxhimit të keq" edhe pse ka një lidhje negative ndërmjet huave me probleme dhe efikasitetit. Kjo sepse dështimi dhe inefikasiteti në studimin e tyre ndikoheshin më tepër nga faktorët e jashtëm sesa nga ato nën kontrollin e menaxhimit. Në këtë mënyrë, negativiteti në këtë lidhje, sipas rezultateve të nxjerra nga ky studim, vërteton hipotezën e "fatit të keq" (Rossi et al., 2005). Në lidhje me politikat rregullatore që duhet të

ndërmeren në këtë rast, autorët sygjerojnë se duhet thënë se ato duhet të mbajnë parasysh faktin se inefiçenca dhe falimentimi në këto banka lidhet me faktorë të cilët nuk mund të kontrollohen nga manaxherët. Sipas tyre, Institucionet rregullatore dhe ato mbikqyrëse duhet të fokusohen në uljen e ekspozimit të bankave ndaj ngjarjeve të paparashikuara. Ndër veprimet që mund të ndërmeret për këtë qëllim përmenden diversifikimi i portofolit të huave, ulja e përqendrimit të huave, bashkimet ose mbajtja e një profili të aktiveve me rrezik të ulët.

iv. ÇEKI

Podpiera dhe Weill studiuhan sjelljen manaxheriale në industrinë bankare në Çeki dhe japin evidinca në lidhje me marrëdhënien ndërmjet huave me probleme dhe efikasitetit të kostos. Një analizë e tillë ka interes të lartë për këto vende të cilat gjatë viteve '90 dhe dekadës në vijim patën një numër relativisht të lartë të falimentimit të bankave³⁸. Ndikuar nga këto zhvillime studimi empirik ka për qëllim identifikimin e dy faktorëve kryesorë që lidhen me dhe mund të parashikojnë dështimet e bankave. I pari, vëllimi i kredive me probleme në portofolin e kredisë dhe i dyti është një nivel i ulët i efikasitetit të kostos. Studimi synon të japë një provë empirike të shkaqeve të falimentimit të bankave në vendet në tranzicion duke analizuar lidhjen shkak pasojë ndërmjet efikasitetit të kostos dhe huave me probleme në industrinë bankare në Çeki. Vlerësimi i kufirit të efikasitetit kryhet duke përdorur çmimin e inputeve: punë, kapital fizik dhe fonde të marra hua; dhe sasinë e outputeve: hua totale dhe aktive financiare. Për shkak të mungesës së të dhënave për huatë me probleme përdoret si tregues i rrezikut dhe cilësisë së aktiveve raporti i provigjioneve për huatë e këqija.

³⁸ Në sektorin bankar të Çekisë, nga 48 banka në 1994 dhe 6 të licencuara më vonë, 21 prej tyre, në vitin 2003, falimentuan

Hipotezat e ngritura edhe në këtë studim bazohen të propozimet e Berger dhe De Young (1997) për të shpjeguar marrëdhënien ndërmjet efijencës së kostos dhe huave me probleme. Dy hipoteza ngrihen për të vërtetuar korelacionin negativ, gjerësisht të vëzhguar në studimet empirike, ndërmjet efijencës së kostos dhe huave me probleme. *Së pari*, hipoteza e "fatit të keq" si rezultat i së cilës pritet që rritja e nivelit të huave me probleme të shkaktojë rënien e efijencës së kostos. Së dyti, hipoteza e "menaxhimit të keq" sipas së cilës rënia e efijencës do të paraprijë rritjes së huave me probleme, rrezikut. Një tjetër alternative është ajo e një korelacioni negativ në marrëdhënien ndërmjet efijencës dhe rrezikut e cila lidhet me hipotezën e "kufizimit".

Modeli që autorët ngrejne për të vlerësuar këto marrëdhënie është ai i shkakësisë së Greinxherit. Për të matur efektet që ka efijenca tek rreziku dhe anasjelltas rreziku te efijenca ata ngrejne një model me dy ekuacione si paraqitur më poshtë dhe në të cilat: ekuacioni me variabël të varur rrezikun pritet që në rastin e një marrëdhënie negative shkakësore efijencë rrezik të shpjegojë hipotezën e "menaxhimit të keq", ndërsa ekuacioni me variabël të varur efijencën pritet që në rastin e një marrëdhënie negative shkakësore efijencë rrezik të shpjegojë hipotezën e "fatit të keq".

$$RTM_{i,t} = f(RTM_{i,t-1}, \dots, RTM_{i,t-n}; EFF_{i,t-1}, \dots, EFF_{i,t-n}) + e_i + \eta_{1i,t}$$

$$EFF_{i,t} = f(RTM_{i,t-1}, \dots, RTM_{i,t-n}; EFF_{i,t-1}, \dots, EFF_{i,t-n}) + e_i + \eta_{2i,t}$$

ku RTM është variabli i rrezikut, që në këtë studim përcaktohet nga raporti i huave me probleme; EFF është variabli i efijencës së kostos; *n* përcakton numrin e lagueve, *e_i* përfaqëson variabla specifike të banës dhe *η_{i,t}* është termi i gabimit.

Në këtë studim, ndryshe nga studimet e paraqitura deri tani, treguesi i rrezikut, RTM, matet në dy mënyra të ndryshme. *Së pari*, përdoret raporti i huave me probleme (hua që kanë kaluar 361ditë vonesë) në raport me huatë totale, raporti konvencional i matjes së

rrezikut (RTM1). Ky tregues i masave konencionale që meren për rrezikun dhe supozon për të gjitha kreditë me probleme me një fatkeqësi, për shembull mund të ndodhë diçka e papritur që të gjitha huatë të klasifikohen si hua të humbura. Një vlerësim i tillë mbivlerëson huatë që lidhen me ngjarje të rastësishme, të papritura, sepse disa nga këto hua të humbura priteshin të ishin të tilla dhe për këtë qëllim normat e interesit që janë kërkuar për to e kanë të përfshirë këtë rrezik. Për këtë arsye, si rezultat i kompensimit që vjen nga të ardhurat e interesit të portofolit të huave (për shkak të diversifikimit të suksesshëm të rrezikut) treguesi i rrezikut aktual duhet të zvogëlohet. Në funksion të kësaj, autorët, përdorin një matës të dytë për rrezikun (RTM2) i cili llogaritet si raporti i huave të humbura ndaj totalit të huave të zvogëluar për pjesën e të ardhurave nga interesi për totalin e huave.

Përfundimet e studimit tregojnë se huatë me probleme dhe efienca e kostos janë dy faktorë që influencojnë në falimentimin e bankave. Në lidhje me sjelljen manaxheriale rezultatet vërtetojnë hipotezën e "menaxhimit të keq" sipas së cilës ulja e efijencës së kostos ndikon në rritjen e huave me probleme ndërsa për hipotezën e "fatit të keq" (sipas së cilës rritja e huave me probleme ndikon negativisht efijencën) nuk ka tregues sinjifikativë. (Podpiera dhe Ėeill, 2007)

v. EUROPE vendet e bashkimit europian (EU-26)

Në studimin e Friordelisi dhe të tjerë "Efienca dhe rreziku në bankat europiane", rezultatet empirike tregojnë se në to gjen vërtetim hipoteza e "menaxhimit të keq" dhe ajo e "rrezikut moral", testuar me ato banka të cilat kishin nivelin e efijencës poshtë asaj mesatare (Fiordelisi dhe të tjerë, 2010). Qëllimi i studimit të tyre, së pari, ka qenë vlerësimi i ndikimit të ndërsjelltë që ka efienca në rreziku bankar (lidhja e shkakësisë

në të dy drejtimet) dhe së dyti, ndikimi që ka kapitali në marrëdhënien ndërmjet rrezikut dhe efikasitetit. Objekt i këtij studimi janë bankat tregëtare të Bashkimit Europian nga 26 vende të Bashkimit Europian (EU-26) për periudhën 1995-2007. Studimi përqendrohet tek bankat tregëtare sepse sjellja e tyre, motivet dhe ambienti konkurrenës ndryshojnë nga ato të bankave të kursimeve, investimeve dhe institucioneve të tjera financiare. Për të përcaktuar marrëdhënien ndërmjet këtyre faktorëve, rrezik, kapital dhe efikasitet, përdoret metoda e shkakësisë së Greinxherit si tek studimet e Berger dhe De Young 1997 dhe Eilliams 2004. Për të vlerësuar efikasitetin përdoret metoda e kufirit stokastik. Në këto modele përdoren përkufizime të ndryshme për efikasitetin e bankës (eficencia e kostos, të ardhurave dhe fitimit), tregues të rrezikut (ndër të tjera huatë me probleme, probabiliteti i dështimit). Në ndryshim nga studimet e prezantuara deri tani, Fiordelisi et al, përfshijnë në studimin e tyre jo vetëm efikasitetin e kostos por edhe atë të fitimit.

Në modelimin e funksionit të efikasitetit përkufizimi i inputeve dhe outputeve të përdorura është ai i dhënë sipas modelit të prodhimit (i quajtur ndryshe modeli i vlerës së shtuar ose i kostos) si propozuar nga Berger dhe Humphrey (1992). Si faktorë të inputeve janë puna, kapitali fizik dhe kapitali financiar ndërsa si faktorë të outputeve janë depozitat, huatë totale dhe aktive të sjella që sjellin fitim. Çmimet e inputeve llogariten: çmimi i punës si raport i shpenzimeve të personelit ndaj aktiveve totale; çmimi i kapitalit fizik si raport i shpenzimeve për amortizim dhe shpenzimeve të tjera kapitale ndaj raportit të totalit të aktiveve fikse dhe çmimi i kapitalit financiar (burimeve të financimit) llogaritet si raport i shpenzimeve për interesa ndaj totalit të fondeve.

Në modelin e ngritur për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet rrezikut, efikasitetit (së kostos (x) dhe fitimit (τ)) dhe kapitalit përdoret teknika e shkakësisë së Greinxherit dhe për këtë qëllim ngrihet një sistem me katër ekuacione (si më poshtë) për të vlerësuar

ndërvartësinë e mundëshme ndërmjet këtyre faktorëve si edhe të faktorëve të tjerë të cilësuar si faktorë kontrolli (Z) dhe gabimin e rastësishëm $\varepsilon_{i,t}$.

$$Risk_{i,t} = f(Risk_{i,lag}, x-eff_{i,lag}, \tau_{i,lag}, E/TA_{i,lag}, Z_{i,t}) + \varepsilon_{i,t} \quad 1$$

$$x-eff_{i,t} = f(Risk_{i,lag}, x-eff_{i,lag}, \tau_{i,lag}, E/TA_{i,lag}, Z_{i,t}) + \varepsilon_{i,t} \quad 2$$

$$\tau_{i,t} = f(Risk_{i,lag}, x-eff_{i,lag}, \tau_{i,lag}, E/TA_{i,lag}, Z_{i,t}) + \varepsilon_{i,t} \quad 3$$

$$E/TA_{i,t} = f(Risk_{i,lag}, x-eff_{i,lag}, \tau_{i,lag}, E/TA_{i,lag}, Z_{i,t}) + \varepsilon_{i,t} \quad 4$$

Ekuacioni (1) teston nëse ndryshimet në efikasitetin e kostos i paraprijnë ndryshimeve në rrezikun e bankës. Në dy ekuacione të tjera (2) dhe (3) përcaktohet nëse ndryshimet në nivelin e rrezikut bankar i paraprijnë ndryshimeve në efikasitetin e kostos dhe atë të fitimit. Ekuacioni (4) përdoret për të vlerësuar nivelet e kapitalit i paraprijnë ndryshimeve në rrezik.

Në lidhje me variablat e përdorur duke pasur parasysh se termi i gabimit është një nga problemet që lidhen me vlerësimin e rrezikut dhe efikasitetit në banka, për vlerësimin e rrezikut përdoren dy tregues. Njëri prej tyre është treguesi për 5 vitet e ardhshme i probabilitetit të pritshëm të mospagimit (Expected Default Frequency EDF) për çdo bankë dhe tjetri, treguesi tradicional i huave të humbura ndaj totalit të huave NPL/L. Studimet e mëparshme, mbështeten vetëm tek ky tregues për të vlerësuar rrezikun e kredisë i cili është tregues i mbështetur në informacionin kontablë, i varur nga vendimmarja e menaxherëve dhe siguron informacion për çfarë ka ndodhur në të kaluarën, rrezikun e kredisë që është ndërmarë ose që është realizuar. Treguesi tjetër, ai EDF, është një tregues që sheh në atë se çfarë mund të ndodhë në të ardhme dhe përfshin me tepër sesa vetëm rrezikun bankar.

Përsa i përket vlerësimit të efijencës, në këtë studim, kryhet vlerësimi i efijencës së kostos dhe fitimit. Argumentimi i përdorur është mbështetur në atë çfarë sygjerohet nga literaturat e mëparshme në lidhje me marrëdhënie të ndryshme që mund të kenë efijenca dhe rreziku me efijencën e të ardhurave ose të kostos.

Treguesi i përdorur për kapitalin është ai i kapitalit rregullator si raport i kapitalit të vet dhe aktiveve totale. Kapitali i vet është matur në këtë studim mbështetur në përkufizimin e Komiteti të Bazelit për kapitalin e vet dhe llogaritet si shumë e komponentëve të kapitalit bankar: kapitali i nivelit të parë dhe nivelit të dytë. Qëllimi i përdorimi të këtij përkufizimi të gjerë të kapitalit të vet është përdorimi i treguesve të tjerë që përdoren nga bankat për të rritur kapitalin e tyre. Për këtë arsye është më mirë të përdoret treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit sesa vlera kontablël e raportit të kapitalit të vet (Santos, 1999, Diamond dhe Rajan, 2000). Për të kontrolluar qëndrueshmërinë ata përdorin një tregues tjetër të kapitalit, atë të llogaritur si raport i vlerës së kapitalit të vet me aktivet totale (E_A/TA).

Studimi i marrëdhënies që është në objekt, kërkon përfshirjen në model edhe të faktorëve të tjerë të cilët mund të ndikojnë lidhjen shkakësore ndërmjet tyre. Mbështetur në literaturën e mëparshme, autorët e këtij punimi përfshijnë si të tillë: *modelin e biznesit* të përcaktuar nga variabli i difersifikimit të të dhënave (ID). Mbështetur tek Lepetit dhe të tjerë (2008) përdoret raporti i të ardhurave neto jo nga interesat dhe të ardhurave neto operacionale; *strukturën e tregut* duke përdorur treguesin e përqendrimit të tregut, CONC (duke përdorur indeksin H) dhe numrin e institucioneve të kreditit, logaritmi i tyre $\ln(NCI)$ dhe së fundmi *madhësinë e bankës*, $\ln(TA)$, logaritmi i aktiveve totale.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se ulja e efijencës (të kostos ose të ardhurave) i paraprin një rreziku më të lartë për falimentim. Një marrëdhënie e tillë konfirmon hipotezën e "menaxhimit të keq". Ky rezultat është i njëjtë me atë Berger dhe De Young (1997), Këan dhe Eisenbeis (1997) dhe Ëilliams (2004). Lidhja ndërmjet indeksit të përqendrimit dhe probabilitetit të pritshëm për mospagim është negative duke treguar se në tregje më të përqendruara rreziku për bankat është më i ulët. Marrëdhënia ndërmjet treguesit kontabël të rrezikut NPL/L me efijencën është negative.

Rezultatet tregojnë se marrëdhënia e raportit të kapitalit si shkakëtar Greinxher efijencës së kostos është pozitive. Rritja e raporteve të kapitalit i paraprijnë rritjes së efijencës ndërkohë që këto ndryshime u paraprijnë ndryshimeve të rrezikut. Një marrëdhënie e tillë vërteton se në bankat e përfshira në studim hipoteza e rrezikut moral nuk vërtetohet ndërkohë që bankat rrisin nivelin e kapitalit. Kjo sepse këto banka janë më të prirura të ulin kostot sesa ato me nivel më të ulët kapitalizimi. Kjo marrëdhënie është e njëjtë dhe e pavarur nga treguesi i përdorur për rrezikun (EDF, EDF_{5Y}, NPL).

Lidhja ndërmjet *efijencës* së kostos dhe *modelit të biznesit* të vlerësuar nga raporti i diversifikimit të të ardhurave (ID) rezulton *negative*. Kjo, sipas autorëve, sepse bankat e specializuara përfitojnë nga ekonomitë e shkallës dhe në këtë mënyrë arrijnë uljen e kostos më tepër sesa në rastin e diversifikimit. Lidhja e shkakësisë Greinxher e efijencës së kostos me kapitalin është pozitive dhe po kështu qëndron kjo lidhje edhe për treguesit e gjithë rreziqeve që përdoren në model. Ky rezultat, i njëjtë me atë të Berger dhe De Young (1997) dhe Ëilliams (2004), tregon se përfitimet nga ulja e kostove (si rezultat i uljes së kostove në vlerësimin, disbursimin dhe monitorimin e huave) në periudhë afatshkurtër do të ndikojë si faktor rritës për kapitalin. Sipas autorëve, bankat më

efiçente kanë fitime më të larta që rezultojnë si shkaktare Greinxher të rritjes së kapitalit.

Autorët kanë bërë pjesë të këtij studime edhe testet e fuqisë duke përdorur tregues të ndryshëm për kapitalin dhe për rrezikun. Për kapitalin në këto teste përdoret raporti i vlerës kontabël të kapitalit të vet ndaj aktiveve totale krahas raportit të kapitalit rregullator me totalin e aktiveve dhe për rrezikun përdoren tre matës të ndryshëm të rrezikut bankar: EDF norma afatshkurtër e mundësisë për mospagim, EDF_{5y} norma afagjatë, 5 vjeçare, e mundësisë për mospagim dhe raporti NPL/L.

Metodologjia e përdorur në këtë studim mbështetet në testin e rastësisë Greinxher sepse ky është një testim i cili teston në rend kohor shenjën në marrëdhënien ndërmjet rrezikut të bankës, kapitalit dhe efiçencës. Ky model është përdorur gjerësisht për të analizuar ndërvartësinë në literaturën ekonomike dhe atë të bankave.

Rezultatet e studimit të Fiordelisi et al., 2010 konfirmojnë se efiçenca (e kostos ose e të ardhurave) është shkaktar Greinxher i rrezikut, lidhje kjo që mbështet hipotezën e "menaxhimit të keq" dhe variantin e efiçencës për hipotezën e "rrezikut moral". Në lidhje me ndërvartësinë kapital-efiçencë, rezultatet tregojnë se rritja e kapitalit bankar i paraprin përmirësimit të efiçencës duke treguar se "rreziku moral" bie ndërkohë që rritet kapitali. Kjo tregon se bankat e mirëkapitalizuara kanë kosto më të ulta sesa kostot e bankave me nivel kapitali më të ulët. Marrëdhënia kapital-efiçencë në kuptimin e shkaksisë mund të konsiderohet si një marrëdhënie ndërsjelltë, që mund të interpretohet në dy drejtime. Efiçenca e kostos (dhe e fitimit) është pozitivisht shkaktar Grenxher për kapitalin. Në mënyrë të përmbledhur, kjo marrëdhënie e ndërsjelltë mund të interpretohet: një bankë që ka një nivel të lartë efiçence ka nivel më të lartë kapitalizimi

dhe në drejtimin tjetër rritja e kapitalit të bankës ndikon pozitivisht në rritjen e efijencës.

Në lidhje me hipotezën e "moralit hazard" ky studim nuk ka rezultat, nuk ka evidenca të marrëdhënies ndërmjet kapitalit dhe rrezikut. Lidhja e ndërsjelltë midis kapitalit dhe rrezikut duket se qëndron në rastin kur si tregues i rrezikut përdoret matësi kontabël i tij (NPL/L) por për treguesit e tjerë të rrezikut (EDF dhe EDF_{5y}) ka shumë pak evidenca.

Autorët sygjerojnë se rezultatet e një studimi të tillë shërbejnë për qëllime të mbikqyrjes të kujdesshme. Nivele të ulta të efijencës parashikojnë rritje të rrezikut në të ardhmen prandaj duhet të merren masa që forcojnë pozicionin e kapitalit. Gjithashtu, mbështetur në gjetjet e këtij studimi theksohet rëndësia që ka efijenca në periudhë afatgjatë për të siguruar mbështetje për objektivat e stabilitetit financiar të sistemit bankar.

	Rrezik Y=NPL/L	Efijencë Y=EFF	Kapital Y=E/A
Rrezik NPL/L		(-) Bad manag. (-) skimping (-) moral	
Efijencë EFF	(-) bad lack		(+)
Kapital E/A	(-) moral hazard	(+)	

vi. *INDI bankat tregëtare*

Studimi i Reddy (2011) ka për qëllim eksplorimin e sjelljes manaxheriale në bankat tregëtare të Indisë për periudhën pas reformave (87 banka, periudha 1995-2007) nëpërmjet vlerësimit të marrëdhënie të ndërsjellta ndërmjet rrezikut (huave të humbura),

efiçencës së kostos dhe kapitalizimit. Në studimin e tij autori mbështet në teknikën e Berger dhe De Young (1997). Teknika që përdoret në studim është ajo e testimit të rastësisë së Greinxherit. Objekt i tij janë bankat tregëtare publike, private dhe ato të huaja. Për të zbuluar sjelljen menaxheriale në këto banka, autori ngre katër hipoteza të cilat si edhe në studimet e tjera të ngjashme janë (1) menaxhimi i keq, (2) fati i keq, (3) e kufizimit dhe (4) ajo e rrezikut moral. Këto hipoteza ai kërkon ti testojnë nëpërmjet rezultateve nga analiza e marrëdhënieve të ndërsjellta të mundshme midis rrezikut, kapitalit dhe efiçencës. Modeli i ngritur për testimin e këtyre hipotezave është:

Ekuacioni	Hipoteza
$NPL_{i,t} = f_1(NPL_{i,lag}, X-EFF_{i,lag}, CAP_{i,lag}, LTA_{i,lag}, Y_{rt}) + \varepsilon_{1i,t}$	Menaxhimit të keq Kufizimit
$X-EFF_{i,t} = f_2(NPL_{i,lag}, X-EFF_{i,lag}, CAP_{i,lag}, LTA_{i,lag}, Y_{rt}) + \varepsilon_{2i,t}$	Rrezikut moral Hipoteza e fatit të keq
$CAP_{i,t} = f_3(NPL_{i,lag}, X-EFF_{i,lag}, CAP_{i,lag}, LTA_{i,lag}, Y_{rt}) + \varepsilon_{3i,t}$	Nuk kontrollon ndonjë hipotezë të caktuar

ku:

$NPL_{i,t}$ = raporti i huave me probleme (të cilat përcaktohen si hua të cilat janë me vonesë më tepër se 90 ditë ose hua që nuk sjellin fitim) ndaj huave totale për bankën e i -të në viti e t -të përdoret si tregues i cilësisë së aktiveve

$X-EFF_{i,t}$ = efiçenca e kostos (e cila vlerësohet duke përdorur modelin e kufirit stohasitik)

për bankën e i -të në viti e t -të

$CAPI_{i,t}$ = raporti i kapitalit të vet me aktivet totale për bankën e $i^{t\bar{e}}$ në viti e $t^{t\bar{e}}$ tregues i kapitalizimit

$LTAi,t$ = raporti i huave totale ndaj aktiveve totale për bankën e $i^{t\bar{e}}$ në viti e $t^{t\bar{e}}$ përdoret si tregues i rrezikut dhe përfshihet në të tre ekuacionet

Yrt= variabël vjetorë kontrolli. Këto përfshihen në model për të kontrolluar ndryshimet makroekonomie të tilla si rritja e inflacionit, rritja e normës së interesit, ndryshimet rregullatore si edhe ndryshimet teknologjike.

Testimi i hipotezave kryhet si edhe tek studimet e tjera. Ajo çfarë autori sjell si të re është ekzaminimi i efekteve ekonomike që kanë këto katër hipoteza. Efektet ekonomike llogariten duke përcaktuar se si rritja ose rënia e devijimit standard për një variabël çon në rritjen ose rënien kumulative të variablit tjetër. Rezultatet tregojnë se intensiteti i efekteve ekonomike të sjelljes së keqe të menaxhimit dhe të fatit të keq është më i lartë në bankat e brendshme private sesa në ato huaja.

vii. EUROPE

(Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermani, Greqi, Irlandë, Itali, Luksemburg, Hollandë, Portugali, Spanjë, Suedi, UK)

Yener Altunbas, Saniago Carbo, Edëard P.M. Gardener dhe Philip Molyneux (2007) analizuan marrëdhënien ndërmjet kapitalit, rrezikut dhe efijencës për një numër të madh bankash tregëtare, kursimi dhe kooperativa në Europë³⁹, për periudhën 1992-2000. Në ndryshim nga përfundimet e studimit të kësaj marrëdhënie për bankat tregëtare në SHBA marrëdhënia ndërmjet rrezikut dhe inefijencës nuk rezulton pozitive sepse

³⁹ Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermani, Greqi, Irlandë, Itali, Luksemburg, Hollandë, Portugali, Spanjë, Suedi, UK

bankat joeficiente mbajnë më tepër kapital dhe më pak rrezik. Rezultatet empirike tregojnë një marrëdhënie pozitive ndërmjet rrezikut dhe nivelit të kapitalit, dëshmojnë për përdorimin e rregullave për kapitalin si mjet për kufizimin e aktiviteteve me rrezik. Gjithashtu, studimi jep evidenca në lidhje me influencën pozitive që ka fuqia financiare në uljen e rrezikut dhe kapitalit. Rezultatet e studimit nuk tregojnë ndryshime në marrëdhënien e kapitalit, rrezikut dhe efijencës për bankat tregëtare dhe ato të kursimit, ndërkohë që kooperativat bankare rezultatet flasin për një marrëdhënie negative ndërmjet kapitalit dhe rrezikut dhe ineffijencës dhe nivelit të kapitalit.

Hipotezat e këtij studimi synojnë të japin rezultate empirike për ndikimin që kanë rreziku moral për shkak të rrjetave të sigurisë dhe problemeve të agjensisë si edhe veprimet rregullatore në marrëdhënien ndërmjet rrezikut, kapitalit dhe rrezikut.

Modeli që ngrejnë autorët për këtë qëllim mbështetet, ndër të tjera, në atë të sygjëruar nga Shrives dhe Dahl (1992); Këan dhe Eisenbeis (1997) dhe Hughes dhe Mater (1998). Sistemi i ekuacioneve që ngrihet për këtë qëllim vlerësohet duke përdorur teknikën e regresionit në dukje të palidhur SUR. Nëpërmjet kësaj teknike mund të bëhet vlerësimi i njëkohshëm i marrëdhënies rrezik-kapital-efijencë si edhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm që lidhen me specifika të vetë bankave dhe të vendit të cilat pritet të ndikojnë në këtë marrëdhënie.

Vlerësimi SUR sipas Zeller (1962) përdoret në raste kur një sistem ekuacionesh mendohet të ketë lidhje korrelacion të njëjtë gabimi ndër ekuacional.

Sistemi i ekuacioneve dhe përshkrimi i variablave (të varur dhe të pavarur) të përdorur nga këta autorë janë si më poshtë:

$$LLRL_{ij} = a + bETA_{ij} + c INEFF_{ij} + dNLTA_{ij} + e LNTA_{ij} + f LAODEP_{ij} + g INSB0C_j + h SOLVENCY_j + i LAOAC_j + j LLPOAC_j + YEAR_j$$

$$ETA_{ij} = a + b INEFF_{ij} + cNLTA_{ij} + d LNTA_{ij} + eROA_{ij} + f LAODEP_{ij} + g INSB0C_j + h SOLVENCY_j + i LAOAC_j + j ROCC_j + k COIRC_j + l OEPOAC_j + mLLPOAC_j + YEAR_j.$$

$$\text{INEFF}_{ij} = a + b\text{ETA}_{ij} + c \text{LLRL}_{ij} + d\text{NLTA}_{ij} + e \text{LNTA}_{ij} + f \text{LAODEP}_{ij} + g \text{INSBOC}_j + h \text{SOLVENCY}_j + i \text{LAOAC}_j + j \text{COIRC}_j + k \text{OEPOAC}_j + l \text{LLPOAC}_j + \text{YEAR}_j$$

Variablat specifike të bankës

LLRL_{ij} Rezerva provigjionimi për huatë e humbura për bankën i në vendin j
 ETA_{ij} Raporti i kapitalit të vet me aktivet për bankën i në vendin j
 INEFF_{ij} Inefiçenca e kostos për bankën i në vendin j (nga vlerësimet e nxjerra nga kufiri stohastik)
 NLTA_{ij} Huatë neto ndaj totalit të aktiveve për bankën i në vendin j
 LNTA_{ij} Logaritmi natyral i aktiveve për bankën i në vendin j
 ROA_{ij} Kthimi nga aktivet për bankën i në vendin j
 LAODEP_{ij} Aktive likuide/(depozita me klientë dhe ato afatshkurtër) për bankën i në vendin j

Variabla specifike të vendit

INSBOC_j Spre di i normave 3 vjeçare të interesit të bonove qeveritare të vendit j;
 SOLVENCY_j aktive likuide ndaj detyrimeve likuide për vendin j
 LAOAC_j raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktive të sistemit bankar për vendin j
 ROCC_j Kthimi nga kapitali për sistemin bankar të vendit j
 COIRC_j raporti i kostove ndaj të ardhurave për vendin j
 OEPOAC_j shpenzime operative të sistemit bankar ndaj aktiveve total në vendin j
 LLPOAC_j provizionet për kreditë e humbura ndaj totalit të huave për vendin j
 YEAR_j variablat dumi për periudhën

Në këtë studim përdoret variabli Rezerva provigjionimi për huatë e humbura (LLR) për të vlerësuar rrezikun, i llogaritur nga të dhënat e pasygrave financiare. Autorët shpjegojnë se kanë qenë të detyruar të përdori këtë raport në vend të atij të huave me probleme ndaj totalit të huave për shkak të mundesës së të dhënave si edhe për faktin se vlerat e provigjionimit për huatë e humbura rezultuan me një nivel më të lartë dispersioni sesa ato të rezervave për huatë e humbura. Për të njëjtat arsye përmendur në studime të tjera që përdorin këtë raport për cilësinë e portofolit, ky është një tregues që mund të ndikohet nga menaxhimi për të bërë të mundur uljen e nivelit të kapitalit rregullator.

Faktorët e përdorur si variabla specifike për bankën dhe për vendin mendohet se janë faktorë të rëndësishëm për të shpjeguar performancën dhe rrezikun që ndërmer banka.

Autorët shpjegojnë arsyen e përfshirjes së faktorëve specifike të bankave: NLTA_{ij} Huatë neto ndaj totalit të aktiveve - rritja e shpejtë e huave mund të ndikojë në rritjen e rrezikut dhe ndikon negativisht në kapitali; LAOAC_j aktivet likuide të sistemit bankar

ndaj aktiveve totale: $LAODEP_{ij} = \text{Aktive likuide} / (\text{depozita me klientë dhe ato afatshkurtër})$ bankat që janë më tepër likuide mund të jenë më efikente dhe për këtë arsye kanë nevojë për më pak kapital; $LNTA_{ij}$ Logaritmi natyral i aktiveve - madhësia e bankës në rastin e ekonomive të shkallë mund të jetë një faktor që ndikon në marrëdhënien ndërmjet kapitalit, rrezikut dhe efikasitetit. Bankat e mëdha mbajnë më pak kapital sesa bankat e vogla. Ato mund të përfitojnë nga diversifikimi ose nga avantazhet që sjell madhësia. ROA_{ij} Kthimi nga aktivet : Në modelin e kapitalit, kontrollohet për performancën e bankës sepse niveli i kapitalit është i lidhur me performancën e bankës. Sipas Scholtens (2000) në bankat ndërkombëtare rezulton që lidhja ndërmjet rentabilitetit dhe kapitalit të nivelit të parë është shumë e fortë. Sipas Berger (2005) kjo lidhje për bankat amerikane kjo lidhje është pozitive.

Autorët përfshijnë si variabla specifike të vendeve të përfshira në studim normat e interesit dhe aftësinë paguese të korporatave. Ndryshimet ndërmjet tyre për shkak të niveleve që kanë normat e interesit. Sa më të paqendrueshme të jenë normat e interesit aq më i paqendrueshëm është ambienti ku veprojnë bankat dhe rrjedhimisht kjo mund të jetë shkak për presione për rritjen e kapitalit dhe rrezikut. Variabli që përdoret në këtë rast është ai i spredave të normave të obligacioneve 3 vjeçare të qeverisë gjermane. Ky variabël tregon ndryshimet me nivelin mesatar. Një tjetër variabël, specifik i vendeve që përfshihen në këtë studim është aftësia paguese e sektorit të korporatave në Europë ($SOLVENCY_j$) i cili llogaritet si raport i aktiveve rrjedhëse ndaj detyrimeve të fimës. Nëpërmjet përdorimit të këtij variabli autorët kanë për qëllim të testojnë ndikimin që ka sektori i korporatave në ndërmarrjen e rrezikut dhe kapitalin e bankave. Ata përdorin edhe disa tregues të tjerë për të nxjerrë në pah ndryshimet ndërmjet sistemeve bankare të vendeve të përfshira në studim. Si të tillë ata përdorin $LAOAC_j$ aktivet likuide të

sistemit bankar ndaj aktiveve totale ROCCj kthimin mbi kapitalin për sistemin bankar; efienca e sistemit bankar COIRCj si edhe raporti e provizionimeve për huatë e humbura ndaj totalit të huave për sistemin bankar.

Për llogaritjen e efiençës së kostos, autorët përdorin një funksion trans log me dy outpute dhe tre inpute. Si outpute përdoren huatë dhe veprimet me letra me vlerë dhe si inpute përdoren: pagat, kosto interesi dhe kosto të tjera operative . Vlerësimi i efiençës kryhet duke vlerësuar fillimisht një kurbë globale të efiençës së kostos për të gjitha bankat he më pas identifikohen nivelet e inefiençave për bankat me pronësi të ndryshme. Rezultatet kontrollohen me ato që dalin nga vlerësimi i kurbave individuale.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se ka një lidhje pozitive ndërmjet niveleve të kapitalit dhe rrezikut bankar. Ndërkohë për bankat më efiente kjo marrëdhënie është negative dhe kjo sepse autoritetet rregullatore/rregulloret pranojnë një kompromis për marrëdhënien kapital rrezik për bankat me efiençë më të lartë.

Rezultatet e këtij punimi tregojnë se bankat joefiente europiane mbajnë më tepër kapital dhe më pak rrezik. Lidhja ndërmjet rrezikut dhe nivelit të kapitalit është pozitive duke treguar se një marrëdhënie e tillë mund të jetë rezultat kërkesë për më tepër kapital nga autoritetet rregullatore për të kufizuar nivelin e rrezikut. Fuqia financiare e sektorit të korporatave ndikon pozitivisht në uljen e rrezikut dhe kapitalit bankar. Lidhja ndërmjet inefiençës dhe rrezikut nuk rezulton e fortë, rezultat ky që është i ndryshëm nga studime rreth sektorit bankar në amerikë. Kjo sipas autorëve mund të vijë nga ndryshimet në metodologji dhe në periudhat kohore që marrin në analizë. Ndër të tjera ata sygjerojnë që në studime të ardhshme për të vërtetuar përputhshmërinë të përfshihen dhe metoda të tjera alternative për rrezikun të mbështetura në informacionin kontabël

dhe në treguesit e rrezikut të tregut; në faktorët e kapitalit sipas Basel dhe matës alternativë të efijcës bankare të kostos dhe fitimit.

	Rrezik Y=NPL/L	Efijcë Y=EFF	Kapital Y=E/A
Rrezik NPL/L			(+) (-)(most eff. banks) reg eff.
Efijcë EFF			
Kapital E/A		(+)	

3.5.7 Përmbledhje e literaturës empirike

Në përmbledhje të literaturës empirike mund të sygjerojmë se bankat kanë tendencë të rritin nivelin e levës dhe/ose nivelin e rrezikut të portofolit të aktiveve të tyre për shkak të avantazheve që kanë në lidhje me taksat kur financohen me anën e depozitave, mundësisë për të treguar vlerën e tyre të vërtetë dhe rreziku moral i cili shkaktohet nga rrjeta publike e sigurisë (ripërmendim ketu, ky sigurim është i ndyshëm nga siguri i depozitave). Qendrimi i menaxherëve si kundërshtues të rrezikut mund të ndikojë në mbajtjen në kontroll të rrezikut moral dhe të vlerës së tregut. Konkurenca, normat e interesit dhe struktura e pronësisë janë gjithashtu tregues të rëndësishëm në vlerën e brendshme të bankës .

Sjellja e bankve është e ndikuar pozitivisht nga niveli i rregullimit bankar. Sa më i fortë të jetë ky kontroll aq më i madh është ndikimi i tij. Të njëjtën forcë dhe ndikim ka edhe mbikqyrja bankare. Në rastin e kërkesave fikse për kapital rregullator rezultatet empirike tregojnë se bankat për të përmbushur këto kërkesa të rregullatorëve rrisin nivelin e kapitalit dhe njëkohësisht ulin ritmin e rritjes së aktiveve. Në lidhje me ndikimin që kanë këto kërkesa në nivelin e rrezikut që ndërmarin bankat mund të thuhet

se bankat kompensojnë efektet e rritjes së kapitalit duke rritur nivelin e rrezikut të portofolit të tyre.

Në lidhje me kërkesat për kapital të bazuara në rrezikun e aktiveve bankat rezultatet janë më heterogjene. Të ndikuara nga këto kërkesa për kapital bankat rritin nivelin e tij dhe kanë mundësi të ulin nivelin e rrezikut. Por, në këtë vendimmarrje duket se ndikojnë specifikat institucionale dhe ato të periudhës kur bëhet studimi. Për këtë arsye, rezultatet e studimeve empirike duhet të interpretohen me kujdes.

Tabela 3.4.14-1 Studime empirike për marrëdhënien midis kapitalit dhe rrezikut dhe efijencës

Autorët	Viti	Kampioni dhe periudha	Pyetja kërkimore	Metodologjia	Kapitali	Risk	Marrëdhënia ndërmjet kapitalit dhe rrezikut
Shrives dhe Dahl	1992	1800 banka me aktive > \$100milion 1984-1986	Testim i shenjës algjebrike në marrëdhënien kapital-rrezik	2SLS	Kap.vet/RËA	RWA/TA; NPL/TL	+ per B
Jacques dhe Nigro	1997	2750 banka të siguruara me aktive > \$100milion 1991-1992	Ndikimi i efekteve që kanë normat e kapitalit të ponderuara me rrezik	3SLS	Kapitalit rregullator (Niveli 1+2)/ RWA	RWA/TA	0 dhe + për B
Hovakimian dhe Kane	2000	123 banka TI1985 - TIV 1994 me aktive > \$100milion	Ndikimi i rregullimeve në sjelljen e bankave				
AggaRWAI dhe Jacques	2001	1685 banka me aktive > \$100milion 1991-1996	Efektet e përmirësimeve në aktin e sigurimit të depozitave	3SLS	Raporti i levës (Niv.1); Niv.I/RWA; Total (I+II)/RWA	RWA/TA; NPL/TL	+ dhe - në 1991; + dhe - në 1992; + 1993-1996
Rime	2001	154 banka Zviceriane 1989-1996	Vlerëson sesi rregullohet kapitali për t'ju përgjigjur kërkesave rregullatore (rritje kapitali ose ulje e rrezikut)	3SLS	Kapital/Aktive totale Kapital/RWA	RWA/TA	0
Heid dhe të tjerë	2003	570 banka kursimi 1993-2000	Qëndrimi i këtyre bankave në lidhje me kapitalin dhe rrezikun	2SLS, 3SLS	Kapital total/Aktive totale	RWA/Aktive totale	0
Bichsel dhe Blum	2004	18 banka Jan 1990-Mars 2000	Investigohet marrëdhënia ndërmjet ndryshimit të levës dhe rrezikut	Modeli i vlerësimit të çmimit të opsioneve	Kapital/Aktive me vlerën e tregut dhe atë kontabël	Devijimi standard i vlerës së tregut të kapitalit	+
Das dhe Ghosh	2004	27 banka publike 1995/96 - 2000/01	Vlerësimi i sjelles në lidhje me rrezikun dhe	2SLS	Kapital/RWA	RWA/Aktive totale	- për B

			kapitalin				
Godleëski	2005	2779 banka nga 30 vende në zhvillim 1996-2001	Vlerëson marrëdhënien ndërmjet kapitalit dhe rrezikut	2 SLS, 3 SLS	Kapital/Aktive totale	NPL/TL	- për B
Lindquist	2005	147 banka në Norvegji 1995-2001	Testohen hipoteza të ndryshme në lidhje me rëndësinë e raporteve të kapitalit	GLS	Minimuni i kapitalit rregullator	Rreziku i kredisë	- për B
Marinde dhe Yaseen	2004	98 banka nga 11 vende të Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut 1995-2002	Ndikimi që kanë kërkesat për kapital në rreziku dhe kapitali	3 SLS	Kapitalit rregullator (Niveli 1+2)/ RWA; Kapital/Aktive totale	RWA/Aktive totale	- për B; 0 për B
Hussain dhe Hassan	2005	300 banka nga 11 vende në zhvillim 2001-2004	Ndikimi i Basel I në bankat e vendeve në zhvillim	GMM, 3SLS	Kapitalit rregullator (Niveli 1+2)/ RWA; Kapital niv. I/RWA	RWA/Aktive totale	- për B
Iëatsubo	2007	35 banka private Japoneze 1990-2000	Testojnë nëse ka një marrëdhënie jo-lineare ndërmjet kapitalit dhe rrezikut	GMM	Kapital/RWA	Huatë për pasuri të paluajtshme/ Hua totale	Ndryshon nga + për B në - për B
Van Roy	2005	586 banka nga vende të G10 me aktive > \$100 milion 1988-1995	Reagimin e bankave të vendeve të G10 ndaj kërkesave të Baselit për kapital	2SLS, 3SLS	Kapital/Aktive (kapitali total ose kapital Niveli I)	RWA/Aktive totale	- për B
Bouri dhe Ben Hmida	2006	Bankat në Tunizi Janar 1992-Gusht 2005	Efektiviteti i Basel I dhe pse bankat rregullojnë raportet kapitalit	2SLS, 3SLS	Kapitali aksioner/RWA	RWA/TA; NPLR/TL në ekonomi	- dhe 0 për B
Floquet dhe Beikpe	2008	2940 banka nga 44 vende në zhvillim	Studimi i marrëdhënies ndërmjet kapitalit dhe rrezikut	3SLS	Kapitali total (kontabël)/Aktive totale	NPL/TL	-; + dhe 0 për B në varësi të vendit
Kleff dhe Eëber	2008	2971 banka gjermane 1992-2001	Si përcaktohet kapitali në këto banka; testohen modelet teorike në rastin e bankave në Gjermani	GMM	CAP1=kapital/aktive totale; CAP2= (Niv.1 + Niv 2) kapitalit / aktive totale CAP3 = Niv.1 kapitalit/aktive totale	RWA/Aktive totale	+ dhe 0 për t - dhe 0 për t-1
Ahmed dhe të tjerë	2009	42 institucione financiare Malajziane 1995-2002	Si meren vendimet në lidhje me kapitalin dhe nëse influencohen ato nga rreziku dhe/ose rregullimi	OLS; FGLS	Kapitalit rregullator (Niveli 1+2)/ RWA	NPL/TL	+ për B
Matajesak dhe të tjerë	2009	508 banka europiane dhe 683	Të përcaktohet roli që ka kapitali	2SLS, 3SLS	Kapitali rregullator/RWA	RWA/Aktive totale	+ për B

		amerikane 2000-2005	rregullator në vendimet në lidhje me kapitalin dhe rrezikun				
Gropp dhe Heider	2010	327 banka të listuara amerikane dhe 15 europiane 1991-2004	Ndikimi i kërkesave për kapital në përcaktimin e raporteve të kapitalit	Raporti i levës sipas kontabilitetit dhe sipas tregut	Risku i aktiveve = devijimi standard i përvitshëm ndaj çmimit ditor të aksioneve * (vlera e tregut e kapitalit/vlerën e tregut të bankës)		
Athanasoglou	2011	155 banka nga vendet e Europës Lindore dhe Jugore 2001-2009	Ekzaminimi i marrëdhënies ndërmjet kapitalit dhe rrezikut për këto banka	GMM, 3 SLS	Kapitali/aktivet totale Raporti i rregullimit të kapitalit	NPL/Hua totale bruto	0 dhe + për B; + për A; + për U
Camara dhe të tjerë	2013	1451 banka europiane 1992-2006	Ndikimi që ndryshimi i kapitalit në sjelljen ndaj rrezikut	GMM, 2SLS	Kapitali total/Aktive totale	RWA/Aktive totale; NPL/huatë neto	0 dhe + për B; - për U
Berger dhe Bouëman	2013	57,243 banka të vogla; 1,946 të mesme; 1,400 të mëdha në SHBA	Ndikimi i kapitalit ndaj performancës para dhe gjatë një krize	Logit survival; OLS	Kapitali i vet/ aktive totale bruto; Kapitali i Nivelit I; Kapitali totale rregullator	Rreziku i kredisë i llogaritur si: aktive të ponderuara me rrezik sipas Bazel I ndaj totalit të aktiveve bruto	
Marrëdhënia rrezik kapital eficiencë							
Ding dhe të tjerë	2018	Bankat Çikago 2001-2016	Investigon marrëdhënien ndërmjet strukturës së kapitalit, nivelit të rrezikut të portofolit dhe performancës	SFA për eficiencën; 3SLS	Kapitali i Nivelit I /RWA; Kapitali rregullator/RWA: Kapitali i Nivelit I / TA	NPL/TA RWA/TA	+ NPL & Kapital - RWA & kapital + Eficienca &NPL + Eficienca & kapitali - Eficienca &RWA
+: në mënyrë të konsiderueshme pozitive; -: në mënyrë të konsiderueshme negative; B: Bankat; A: të mirëkapitalizuara; U: të nënkapitalizuara; 2SLS: Metoda e katrorëve më të vegjël me 2 shkallë; 3SLS Metoda e katrorëve më të vegjël me 3 shkallë; FGLS metoda e përgjithshme e katrorëve më të vegjël; GMM: metoda e përgjithshme e momenteve; OLS: metoda e thjeshtë e katrorëve më të vegjël; SUR: regresion në dukje i palidhur; RWA: aktive të ponderuara me rrezik; TA: aktive totale; NPLR: kredi me probleme neto; TL: totali i huave; NPL: kredi me probleme							

3.6 Hipotezat kryesore të marrëdhënies ndërmjet rrezikut, kapitalit dhe eficiencës

Mbështetur tek hipotezat që dalin nga literatura teorike dhe empirike në këtë studim do të analizohet sesi ndikohet marrëdhënia e rrezikut dhe kapitalit nga rreziku moral (moral

hazard) për shkak të egzistencës së rrjetës së sigurisë financiare, problemeve të agjencisë si edhe nga efektet rregullatore.

Hipotezat e ngritura në këtë studim janë hipoteza të cilat lidhen me përcaktimin e marrëdhënies së ndërsjelltë ndërmjet rrezikut, kapitalit dhe efikasitetit të paraqitura nga Berger dhe De Young (1997) dhe Kwan dhe Eisenbeis (1997) të cilat janë gjithashtu pjesë e studime empirike të mëparshme për banka të vendeve të ndryshme si trajtuar në rishikimi i literaturës teorike dhe empirike.

Hipoteza e parë që mund të ngrihet është **hipoteza e rregullatorit** e cila bazohet tek studime të cilat përcaktojnë një marrëdhënie pozitive midis kapitalit dhe rrezikut për shkak të mbikqyrjes dhe masave rregulluese (Shrives and Dahl, 1992; Jacques and Nigro, 1997; Aggarwal and Jacques, 1998; Editz et al., 1998). Sipas kësaj hipoteze organet rregullatore dhe mbikqyrja inkurajojnë bankat që të rrisin kapitalin e tyre në raport të drejtë me rrezikun që ato ndërmarrin. Në kuadër të Basel III kërkesat për kapital janë edhe më shtrënguese. Një marrëdhënie e tillë ndërmjet kapitalit dhe rrezikut (ritje e kapitalit kur rritet rreziku) mund të jetë pjesërisht për shkak të monitorimit efektiv që i bëhet tregut kur pozicionet e kapitalit nuk janë të përshtatshme. *Sipas kësaj hipoteze RRITJA E RREZIKUT i paraprin RRITJES TË KAPITALI, lidhje pozitive rrezik-kapital.*

"Hipoteza e rrezikut moral" është një tjetër hipotezë e ngritur për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet kapitalit dhe rrezikut. Sipas saj ndryshimet në kapital do të paraprijnë ndryshime në kah të kundërt të rreziqeve. Kjo marrëdhënie negative midis kapitalit dhe rrezikut mbështetet në argumentin se bankat mundohen të përfitojnë nga skemat e sigurimit të depozitave. Kjo hipotezë është më e përshtatshme për banka të

cilat kanë nivel të lartë të levës dhe të rrezikut. *Sipas kësaj hipoteze ULJA E KAPITALIT i paraprin RRITJS TË RREZIKUT, lidhje negative kapital rrezik.*

Lidhja shkak pasojë që shpjegon këtë hipotezë mund ta këtë drejtimin të kundërt, pra nga kapitali tek rreziku. Nga ana e tyre, ndryshimet e kapitali mund të jenë pasoja (të padëshirueshme) të veprimeve rregullatore. Mbështetur tek Kahane (1977), Koehn dhe Santomero (1980), Kim dhe Santomero (1988), nëse bankat janë të shtrënguara nga veprimet rregullatore për të rritur kapitalin ato mund ta kryejnë këtë duke rritur aktivet me rrezik. *Mbështetur në këtë argumentim RRITJA E KAPITALIT i paraprin RRITJES TË RREZIKUT, lidhje pozitive kapital-rrezik.*

Ekzistenca e **problemmit të agjencisë** ndërmjet pronarëve dhe manaxherëve mund të ngrejë një hipotezë tjetër e cila është në vijim të hipotezës së rrezikut moral. Bazuar tek Gorton dhe Rosen (1995), në një industri bankare e cila sidomos në kuadër të rrezikut moral është e dobët, menaxherët do të synojnë të ndërmarrin më tepër rrezik. Në kushtet e rritjes së konkurrencës, manaxherët të cilët kanë përparësi informacioni në lidhje me cilësinë e portofolit mund të drejtojnë aksionerët drejt një strategjie zgjerimi e cila mund të jetë me tepër rrezik. Manaxherët duke punuar në emër të aksionerëve janë të prirur të përfshihen në huadhënie me rrezik të lartë dhe për mbartur rrezikun tek kreditorët. Nga dhënia e huave me cilësi të dobët dhe rrjedhimisht me rrezik më të lartë, pritet të kenë një kthim më i lartë sepse kthimet e pritshme lidhen me nivelin e rrezikut. Nga ana tjetër, një nivel i ulët kapitali do të thotë se në rast falimentimi banka rrezikon të humbë më pak dhe kjo nxit menaxhimin të marrë më tepër rrezik. *Sipas hipotezës së "rrezikut moral", kur niveli i kapitalizimit të bankës ulet rreziku do të rritet (ULJA E KAPITALIT i paraprin RRITJES TË RREZIKUT, lidhje negative kapital-rrezik).*

Në vijim të hipotezave që mund të ngrihen nga këndvështrimi i **rrezikut moral**, për të fituar nga skemat e sigurimit të depozitave një firmë jo shumë efiçente do të tentojë të ndërmarrë më tepër rrezik për të kompensuar rrënien e kthimeve. Mbështetur në këtë arsyetim mund të parashikohet një lidhje pozitive (negative) e inefiçencës (efiçencës) dhe rrezikut (Këan dhe Eisenbeis, 1996). Pra, *ULJA E EFICENCËS do të shoqërohet me RRITJE RREZIK, lidhje negative efiçencë-rrezik*

Në kuadër të këtyre dy hipotezave, Hughes dhe Moon (1995) dhe Hughes dhe Mester (1998) përfshijnë efiçencën në vlerësimin e kapitalit dhe rrezikut. Në kushte kur gjithë të tjerat janë konstante, nisur nga perspektiva e rregullatorit, ky i fundi mund të lejojë më tepër hapësirë për përdorimin e levës ndaj një firme efiçente dhe me një menaxhim të mirë.

Nga ana tjetër, efiçenca mund të ndikohet nga niveli i rrezikut bankar. Mbështetur në atë që Berger dhe De Young, (1997) dhe Williams (2004) e quajnë si hipoteza e "**menaxhimit të keq**", bankat të cilat veprojnë në nivele të ulta të efiçencës shoqërohen në aktivitetin e tyre nga kosto të larta për shkak të një monitorimi jo të përshtatshëm të kreditimit dhe efiçencë të ulët të kostos si pasojë e një kontrolli jo efiçent të shpenzimeve operative. Manaxherë, të cilët nuk janë të aftë për të bërë një vlerësimin të saktë të kredive do të miratojnë në një sasi të madhe kredi të cilat kanë një vlerë aktuale neto negative. Por jo vetëm kaq, ata nuk janë kompetentë për kryer vlerësimin e kolateralit dhe së fundmi nuk mund të kryejnë një monitorim e duhur të huamarrësve. Në këtë rast rënia e efiçencës së kostos vjen si rezultat i një performance të dobët të menaxherëve dhe kjo sjell rritje në huatë me probleme, në rrezik (Podpiera dhe Éeill, 2007). Pra, *ULJA E EFICENCËS do të shoqërohet me RRITJE RREZIK, lidhje negative efiçencë-rrezik*.

Së fundi, një bankë mund të zgjedhë si mënyrë për të arritur maksimizimin e fitimit afatshkurtër uljen e fondeve për shpërndarjen dhe monitormin e huave. Në kushte të tilla, kur gjithë treguesit e tjerë mbahen konstantë, do të kemi një rritje si të efijencës edhe të rrezikut, pra (në afat të shkurtër) një marrëdhënie pozitive rrezik dhe efijencë. Kjo quhet hipoteza "cost skimping" ose "kufizimi i kostove" në bazë të së cilës një rritje e efijencës në periudhë afat shkurtër për shkak të rrezikut moral sjell rritje të rrezikut në të ardhmen (në periudhë afatmesme). Për shkak të rrezikut moral, mund të ndodhë që banka të operojë me kosto të ulët, me efijencë në kosto, për shkak të shpërndarjes më të ulët të fondeve për analizën dhe monitorimin e kredive. Në periudhë afatmesme këto banka do të kenë një nivel të lartë rreziku sepse do të rriten kostot e administrimit të rrezikut të lartë. Pra, për shkak të uljes së kostove në periudhë afatshkurtër efijenca rritet por cilësia e portofolit ulet gjë që do të thotë se rreziku do të rritet. Pra, edhe në këtë rast *lidhja e efijencës me rrezikun është negative, ULJA E EFICENCËS do të shoqërohet me RRITJE RREZIK*

Hipoteza e "fatit të keq" parashikon një marrëdhënie negative ndërmjet rrezikut dhe efijencës për shkak të faktorë makroekonomië që influencojnë rrezikun (Rossi et al., 2005). Në rast të një rënie ekonomike, rritjes së papunësisë dhe rënies së normave të interesit niveli i huave me probleme do të rritet dhe krahas kësaj edhe kostot për menaxhimin e tyre. Në këto kosto përfshihen kontrolli dhe vlerësimi i huamarrësve, vlerësimi i kolateralit dhe në rast dështimi marrja, ruajtja dhe shitja e kolateralit si edhe ruajtja e cilësisë për huatë afatshkurta. *Nën këtë hipotezë rezulton që lidhja e rrezikut me efijencën të jetë negative (RRITJA E RREZIKUT i paraprin ULJES SË EFICENCES).*

Fillimisht në literaturën teorike, analiza e përcaktuesve të rrezikut kryhen duke u bazuar në faktin që kapitali dhe rreziku përcaktohen njëkohësisht⁴⁰. Më pas, studime të tjera⁴¹, tregojnë se përveç kësaj rreziku dhe kapitali njëkohësisht, mund të përcaktohen të lidhur me nivelin e efijencës bankare.

Meqënëse rreziku, kapitali dhe efijenca janë të lidhura ndërmjet tyre është e nevojshme që modelet empirike të ngritura për studimin e lidhjes ndërmjet rrezikut dhe kapitalit të përfshijnë gjithashtu edhe efijencën bankare.

Ky studim mbështetet në supozimin se vendimmarrja është një proces që ndikohet njëkohësisht nga shumë faktorë. Konkretisht, mbështetur tek ky supozim, vendimet në lidhje me kapitalin dhe rrezikun janë të ndikuara nga niveli i efijencës bankare. Ky studim mbështetet në studimet e mëparshme të Shrives and Dahl (1992) dhe Altunbas et al. (2007) për të studiuar marrëdhënien ndërmjet efijencës së kostos, kapitalit dhe marrjes së rrezikut në sistemin bankar.

3.6.1 Hipotezat e punimit

Në lidhje me marrëdhënien e efijencës së kostos dhe rrezikut, Berger dhe DeYong (1997) kanë paraqitur hipotezat e "fatit të keq", "menaxhimit të keq" dhe "kufizimit" duke përdorur teste të rastësisë së Greinxherit.

Nga sa parashtuar, roli i menaxhimit është shumë i rëndësishëm në vendimmarrje në lidhje me rrezikun dhe struktrën e kapitalit. Mbështetur në teorinë moderne të bankës, manaxherët ndërmjet dy presioneve. Nga njëra anë janë aksionerët të cilët këkojnë përmbushjen e objektivit të tyre për maksimizimin e vlerës kapitalit të tyre dhe nga ana tjetër nuk mund të ndërmarrin shumë rrezik sepse janë të kufizuar nga kërkesat e

⁴⁰ Shrives dhe Dahl, 1992; Jacque dhe Nigro, 1997; Rime, 2001a).

⁴¹ Këan and Eisenbeis, 1997; Hughes and Moon, 1995; Hughes and Mester, 1998

organeve rregullatore. Vendorsja e kërkesave për minimumin e kapitalit rregullator është kryer bazuar tek supozimi se bankat janë të prirura të preken nga rrezikut moral.

Në kuadër të këtij rreziku, për shkak të asimetrisë së informacionit dhe normave të sigurimit të depozitave, sipas teorisë së rrezikut moral, bankat që kanë nivel të ulët të kapitalit kanë premisa për të marrë më tepër rrezik për të shfrytëzuar përfitimet nga sigurimi i depozitave të tyre.

Prandaj,

Hipoteza e rrezikut moral: Ulja e kapitalit paraprin rritje të rrezikut;

H1: Lidhja e kapitalit me rrezikun negative

Sipas hipotezës së "fatit të keq" ngjarje të jashtme çojnë drejt rritjes së huave me probleme për bankat. Rritja e rrezikut shoqërohet me kosto shtesë dhe përpjekje shtesë të menaxherëve. Në këtë mënyrë efienca e koston do të ulët për shkak të rritjes së problemeve me huatë.

Për këtë arsye,

Hipoteza e "fatit të keq": Rritja e rrezikut i paraprin uljes së efijencës së koston

Në rastin e hipotezës së "menaxhimit të keq", dështimi i menaxherëve në kontrollin e kostove sjell rënie të efijencës. Ata, gjithashtu, nuk arrijnë të menaxhojnë mirë sigurimin dhe monitorimin e huave. Pikërisht janë këto probleme me sigurimin dhe monitorimin e huave të cilat çojnë në rritjen e numrit të huave me probleme, rritjen e huamarrësve të cilët nuk arrijnë të paguajnë këstet e huasë.

Si rrjedhim,

Hipoteza e "menaxhimit të keq": ulja e efijencës çon në rritjen e problemeve me huatë, rritjen e rrezikut

Hipoteza e "kufizimit" paraqet një marrëdhënie pozitive të ndërmjet efijencës dhe rrezikut në periudhë afatshkurtër. Kufizimi i i fondeve për sigurimin dhe monitorimin e kredive, ul kostot operative duke sjellë në këtë mënyrë rritjen e efijencës në periudhë afatshkurtër (ulen kostot (inputet), rritet kredidhënia (outputet). Por, pavarësisht nga kjo marrëdhënie pozitive ndërmjet efijencës dhe rrezikut në afat të shkurtër, në afat të gjatë, montorimi i keq i huamarrësve do të sjellë rritjen e kredive me probleme.

Në këto kushte,

Hipoteza e "kufizimit të kostove": ulja e efijencës çon në uljen e huave me probleme në periudhë afatshkurtër. Por, pavarësisht nga kjo, në periudhë afat gjatë **ulja e efijencës çon në rritjen e problemeve me huatë, rritjen e rrezikut. Ndryshimet në efijencë sjellin ndryshime në të njejtin kah për kapitalin dhe rrezikun.**

Hipoteza e rregullatorit

Secila nga këto hipoteza do të kërkojë zbatimin e rregullave të ndryshme. Nëse vërtetohet hipoteza e "fatit të keq" del në pah nevoja e ndërhyrjes së institucioneve rregullatore për të ndikuar në izolimin e sektorit bankar ndaj goditjeve të jashtme; hipoteza e "menaxhimit të keq" si edhe ajo e "kufizimit" duhet të tërheqë vëmendjen ndaj sistemeve të brendëshme të menaxhimit të rrezikut që përdoret nga bankat. Hipoteza e "rrezikut moral" kërkon që të tregohet.

KAPITULLI 4: KAPITULLI IV METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT

4.1 Metoda e kufirit stohastik (SFA, Stochastic Frontier Approach)

Diskutimet në lidhje me eficientën bazohen më së shumti në metodat parametrike, në metodologjinë e kufirit stohastik prodhimit i cili është zhvilluar nga Aigner et al (1997). Eficienta e kostos mund të përkufizohet si një tregues për të vlerësuar nëse kostot e bankës vijnë nga praktikatat më të mira që lidhen me kostot, kombinimi më i mirë i tyre i zgjedhur në tërësinë e kombinimeve për të njëjtin prodhim në të njëjtat kushte. Për llogaritjen e inefficiencës përdorim konceptin e eficientës X . Inefficiencat X janë kombinimi i inefficiencës teknike dhe asaj alokative (Leibenstein, 1996). Eficienta teknike përfaqëson mundësinë që ka firma për të prodhuar nivelin maksimal të prodhimit për një grup të caktuar të hyrjesh në prodhim. Ndërsa, eficienta alokative përfaqëson mundësinë e një firme për të përdorur inputet në nivelin optimal sipas një niveli të dhënë të çmimeve dhe teknologjisë. Kombinimi i të dy këtyre llojeve të eficientës bën të mundur llogaritjen e eficientës së kostos në rastin kur studiojmë koston dhe jo prodhimin. Ineffienta e bankave përfaqëson largësinë ndërmjet kostove me të cilat operon banka dhe minimumit ose siç quhet "praktikës më të mirë" të kufirit të kostos efiente.

Për të bërë një vlerësim të performancës së bankës ose sa efiente është në aktivitetin e saj ka disa modele të cilat ndahen në jo-strukture dhe atyre struktureore. Sipas *modeleve jo-strukture* matja e eficientës kryhet duke përdorur raporte të thjeshta financiare nga pasqyrat financiare. Nga analiza e raporteve financiare mund të merret informacion për të ardhurat e realizuara por përqendrimi në analiza e bazuar vetëm tek pasqyra e performancës nuk është e mjaftueshme për të vlerësuar eficientën e saj. Rritja

e të ardhurave nuk është gjithmonë një tregues i rritjes së efikasitetit gjë që do të thotë se rritja e treguesve të rentabilitetit mund të ndodhë edhe kur një njësi ekonomike është ende duke kryer aktivitetin në joefikasitet. Disa nga raportet financiare që përdoren për vlerësimin e efikasitetit janë: kthimi nga aktivet (ROA); kthimi nga kapitali (ROE) ose raporti i të ardhurave dhe kostos dhe janë raporte të cilat mund të përdoren në çdo industri. Në sektorin bankar, për këtë qëllim, përdoren disa raporte të tjera, specifike, siç janë: raporti i të ardhurave jointerese me të ardhura nga interesi; shpenzime jointerese ndaj totalit të të ardhurave operative; norma e rritjes së depozitave; marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto (Hays et al., 2009) kthimi nga kapitali, raporti i kostove operationale mbi aktivet totale ose.

Modelet strukturore (modelet e kufirit) mbështeten në modelet teorike të prodhimit të cilat kanë në bazë konceptin e optimizimit dhe përcaktimin e kufirit të efikasitetit. Sipas këtyre modeleve, të gjithë faktorët e inputeve dhe outputeve përmbledhen në një matës të vetëm të efikasitetit. Ky matës, ose tregues, ka vlera ndërmjet 0 dhe 1. Modelet strukturore ndahen në parametrike dhe joparametrike. Ky studim është bazuar në teknikat parametrike sipas të cilave efikasiteti i kostos rrjedh nga një funksion i kostos ku kostot variabël varen nga çmimet e inputeve, sasia e variablave të prodhimit, gabimi i rastësishëm dhe mungesa e efikasitetit.

Bazuar në teorinë e dualitetit, në kushte të caktuara (p.sh. çmimet ekzogjene dhe sjellja optimale e prodhuesit), karakteristikat e funksionit të prodhimit (ekonomitë e shkallës ose ekonomitë e shtrirjes) mund të dalin indirekt nga përdorimi i funksionit të kostos ose fitimit. Bazuar në Aigner, Lovel dhe Schmit (1997) dhe Meeusen dhe Broeck (1977) funksioni i kostos është:

$$TC^b = C(p^i, q, \varepsilon^b), \quad b = 1, \dots, n \quad 1$$

Ku C_b është kostoja totale operative e bankës, y_i përfaqëson vektorin e sasisë së variablave të prodhimit bankar, p_k është vektor i çmimeve të variablave të inputeve bankare, ε_b përfaqëson gabimin e rastësishëm të përbërë, nëpërmjet të cilit funksioni i koston ndryshon në mënyrë të rastësishme.

Termi i përbërë i gabimit të rastësishëm përbëhet nga dy pjesë si më poshtë:

$$\varepsilon^b = u^b + e^b \quad 2$$

Ku u_b referohet faktorëve endogjen ndërsa e_b i referohet faktorëve ekzogjenë që ndikojnë në koston e prodhimit bankar. Në këtë mënyrë, termi u_b tregon një rritje në koston e prodhimit bankar për shkak të faktorit të joefiçencës që mund të rezultojë nga një gabim në menaxhim. Si e tillë mund të përmendim përdorimin joracional të sasisë së inputeve për çmimet e dhëna. Nga ana tjetër, përbërësi i dytë i termit të përbërë të gabimit, e_b , përfaqëson një rritje ose ulje në kostot e bankës si rezultat i faktorëve të rastësishëm që rrjedhin nga gabimet në të dhënat, në matjen e faktorëve të papritur ose të pakontrolluar. Si e tillë mund të përmendim kohën, greva, luftëra dhe faktorë të tjerë që nuk ndikohen nga ndryshimet në metodat e menaxhimit.

Për ta bërë të lehtë matjen, u_b dhe e_b supozohet të jenë të ndashëm nga pjesa tjetër e funksionit të koston dhe të dy anët e ekuacionit (1) mund të kenë një formë logaritmike:

$$\ln TC^b = f(p^i, q^j) + \ln u^b + \ln e^b \quad 3$$

Ku f , paraqet formën e funksionit të koston dhe $e_b = \ln u_b + \ln e_b$ paraqet përbërësit e termit të gabimit. Pjesa e fundit e ekuacionit është ajo që bën dallimin në mes të teknikave parametrike dhe joparametrike të efikasitetit për mënyrën se si e veçojnë

termin e gabimit. Teknika jo parametrike bazohet në supozimin se nuk ka koeficient gabimi dhe në këtë mënyrë çdo devijim nga mënyra më e mirë e kombinimit të inputeve për të prodhuar në mënyrë eficiente i ngarkohet joefiçencës. Ndërkohë, teknikat parametrike bazohen në supozimin se joefiçenca ka një shpërndarje josimetrik që në shumicën e rasteve është gjysmë normale, ndërsa gabimet e rastit kanë një shpërndarje simetrike, në shumicën e rasteve standarde normale.

Së pari duhet të përcaktojnë funksionin e marrëdhënies ndërmjet prodhimit të bankës dhe kostove që lidhen me këtë prodhim në mënyrë që të vlerësojmë inefiçencën, u_b dhe gabimin e rastësishëm e_b . Për të vlerësuar funksionin translogaritmik të kostos bankën e konsiderojmë si një njësi me shumë produkte dhe shumë inpute.

4.2 Teknika e shkakësisë së Greinxherit

Teknika e shkakësisë së Greinxherit mund të përkufizohet si një teknikë e tillë ku variabli i pavarur x është shkak për variablin e varur y nëse parashikimi për y mund të kryhet më mirë nëse përfshihet x (Huril dhe Venet, 2003). Kjo teknikë e propozuar nga Greinxher ka për qëllim të gjejë nëse ndryshimi i një variabli është shkak i ndryshimit që ka pësuar variabli tjetër (Granger, 1969). Nëse variabli x është shkak Greinxheri për variablin e varur y , në ekuacionin e variablit të pavarur, koeficientët duhet të jenë të rëndësishëm. Ka tre lloj lidhje shkakësore. *Së pari*, në rastin kur shkakësia është vetëm në një drejtim dhe jo anasjelltas rastësia është e njëanëshme. *Së dyti*, Në rastin kur shkakësia qëndron në të dy drejtimet thuhet se kemi një shkakësi të dy anëshme dhe në rastin kur asnjëri nga variablat, as x dhe as y , nuk janë të rëndësishëm si variabla të pavarur nuk ka shkakësi të Greinxherit (Brooks, 2011). Edhe pse teknikat e shkakësisë së Greinxherit kanë një numër kufizimesh, ato janë përdorur gjerësisht në literaturën ekonomike për të analizuar marrëdhëniet e ndërsjellta. Nëpërmjet kësaj teknike mund të

testohet konsistenca në lidhje me një hipotezë të ngritur por nuk mund të jepen prova të shkakut ekonomik. Kjo teknikë mund të tregojë nëse ka korelacion ndërmjet vlerës aktuale të të variablit të varur dhe vlerës së shkuar të variablit të pavarur. (Berger dhe De Young, 1997; Brooks, 2011).

Parimi themelor i kësaj teknike është zbatuar për studime në fushën bankare nga Berger dhe De Young: lagjet e variablit të pavarur janë shkaktarë Greinxher të variablit të varur (Rossi et al, 2005). Nëpërmjet përdorimit të kësaj teknike nuk testohet vetëm lidhja shkakësore e Greinxherit e variablit të varur me ata të pavarur po mund të testohen edhe lagjet e vlerave të vetë variablit të pavarur. Këto teste mund të kryhen në të dy drejtimet për çdo variabël. Në këtë mënyrë, në rastin e sistemeve të ekuacioneve sipas teknikës së shkakësisë së Greinxherit, çdo variabël mund të jetë i varur në një ekuacion por i pavarur në ekuacionet e tjera dhe të gjithë ekuacionet kanë të njëjtët variabla të varur. Ajo çfarë ka interes në këtë vlerësim janë vlerat e kaluara të variablave të pavarura dhe jo vlerat aktuale. Gjithashtu, ajo që vlen të vlerësohet më tepër dhe që ka rëndësi primare është shuma e koeficientëve jo koeficientët e veçantë. Marrëdhënia e variablave të përcaktuar në sistemin e ekuacioneve varet nga rëndësia dhe shenja e koeficientëve.

4.3 Të dhënat dhe analiza përshkruese e variablave

Në këtë studim përfshihen të dhëna të bankave të nivelit të dytë që kanë vepruar në Shqipëri gjatë periudhës 2014-2018. Numri total i tyre për periudhën 2014-2017 është 16 si paraqitur në Tabela 4.3-1 Lista e bankave të nivelit të dytë të përfshira në studim. Në vitin 2015, Banka Creditagricole blihet nga Banka Amerikane e Inestimeve. Në vitin 2018 kemi kemi largimin e dy bankave: Banka Vento e cila përthithet nga Intesa San Paolo dhe Banka Kombëtare Greke e cila blihet nga Banka Amerikane e Investimeve.

Të dhënat e nevojshme për këtë studim janë marë nga bankat e nivelit të dytë raportojnë sipas sistemit raportues të unifikuar (SRU) si edhe përdorin Formularët e Mbikqyrjes së konsoliduar.

Tabela 4.3-1 Lista e bankave të nivelit të dytë të përfshira në studim

1	BR	BANKA RAIFFEISEN
2	BBSH	BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË
3	BV	BANKA VENETO
4	BKT	BANKA KOMBËTARE TREGTARE
5	BT	BANKA TIRANA
6	BNT	BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE
7	ISBA	BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA
8	BPC	BANKA PROCREDIT
9	BCA '14/ BAI ('15-'18)	BANKA CREDIT AGRICOLE '14 / BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE ('15-'18)
10	BKG	BANKA NBG ALBANIA
11	BA	BANKA ALPHA ALBANIA
12	BPI	BANKA E PARE E INVESTIMEVE ALBANIA
13	BKSH	BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË
14	BC	BANKA CREDINS
15	BSG	BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA
16	BU	BANKA UNION

4.3.1 Kredia, cilësia e protofolit të kredive dhe rreziku i kredisë

i. Kredia

Në fund të vitit 2018, teprica e kredisë ishte 581 miliardë lekë, duke qenë 1.6 miliardë lekë ose 0.3% më e ulët sesa ajo e regjistruar në fund të gjashtëmujorit të parë dhe rreth 20 miliardë lekë ose 3.4% më pak se një vit më parë (Tabela 4.3-2). Kjo ecuri e tepricës së kredisë është rezultat i nivelit të lartë të shlyerjeve si edhe fshirjes nga bilancet e bankave të një totali prej 5 miliard kredi të humbura. Në mungesë të kësaj fshirje, teprica e kredisë do të shënonte një rritje prej 0.5%. Rënia prej 1.4% e kredive për bizneset, ka ndikimin kryesor në rënien në total të tepricës së kredisë për vitin 2018.

Përsa i përket strukturës së kredisë për bizneset në dy vitet e fundit vihet re një tkurrje në portofolin e kredisë për kapital qarkullues duke u reflektuar në një rënie të peshës së kësaj kredie nga 18% në fund të vitit 2016 në 14% në fund të vitit 2018. Kredia për

blerje pajisjesh zë rreth 1/3 e portofolit të kredisë për bizneset, pesha e kredisë për blerje pasurish të paluajtshme në tepricën e kredisë së bizneseve është rreth 25%.

Në lidhje me kredinë për individë vihet re një rritje e cila është rezultat i rritjes me 1.7% i kredisë për individët rezidentë, kredi e cila zë 93% të kredisë për individët. Për këtë kategori të individëve, rritje të shpejtë ka shënuar kredia për pasuritë e paluajtshme dhe kredia për kosum.

Tabela 4.3-2 Të dhëna mbi kategoritë kryesore të kredisë

	Treguesi dhe njësia	Vlera (mld lekë)	Pesha ndaj totalit të kredisë (%)			Ndryshimi (%)	
	Periodha	12/2018	12/2017	06/2018	12/2018	Vjetor	6-mujor
Sipas monedhës	Kredi në lekë	255	44	44	44	-2,5	0,6
	Kredi në valutë	326	56	56	56	-4	-1
Sipas subjektit	Sektori publik	28	6	5	5	-26	1,3
	Biznese	368	64	64	63	-4,4	-1,4
	Individë	185	30	31	32	3,8	1,8
Sipas afatit	Afatshkurtër	166	31	29	29	-11	-3,1
	Afatmesme	111	18	18	19	1	3,6
	Afatgjatë	304	51	52	52	-0,3	0
	Teprica e kredisë	581	100	100	100	-3,4	-0,3

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë

Kredia sipas afatit të maturimit, krahasuar me vitin 2017, (Tabela 4.3-2), ka shënuar rënie për kredinë afatshkurtër (e ndikuar nga rënia në kredinë për kapital qarkullues dhe overdraft për bizneset). Kredia afatmesme ka treguar rritje ndërsa ajo afatgjatë nuk ka ndryshim.

Në mungesë të mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut dhe të fshirjeve të kredive gjatë vitit, teprica totale e kredisë në terma vjetorë do të ishte rritur me 1.8%, kundrejt tkurrjes së raportuar prej 3.4%. Norma mesatare e ponderuar e kredive të reja, në dhjetor 2018, shënoi vlerën 5.7%.

ii. Cilësia e Portofolit të Kredive

Në portofolin e kredive cilësore, evidentohet rritje e kredive të klasifikuara “standard” me 1.66 pikë përqindje, dhe rënie e peshës së kredive të klasifikuara “në ndjekje” me 4.16 pikë përqindje. Ndërkohë, në portofolin e kredive me probleme, evidentohet ulje e klasave “nënstandard” dhe “të humbura”, me përkatësisht 0.07 p.p dhe 2.38 p.p. Ndërsa klasa e kredive të klasifikuara “të dyshimta” evidentohet në rritje me 0.31 p.p.

Tabela 4.3-3 Peshë e tepricës së kredisë sipas klasave (në %)

Klasifikimi i kredisë	2017				2018			
	TI	TII	III	TIV	TI	TII	III	TIV
Standard	77.6	74.3	77.0	78.1	72.7	74.2	77.9	79.7
Në ndjekje	5.0	10.2	8.2	8.7	9.0	7.8	4.8	4.5
Nënstandard	4.6	4.0	3.4	3.3	3.6	3.7	3.5	3.2
Të dyshimta	2.3	2.2	2.5	2.2	2.6	3.0	3.3	2.6
Të humbura	10.6	9.3	8.8	7.7	7.2	6.6	6.1	5.3

Burimi: Banka e Shqipërisë


iii. Rreziku i kredisë

Kredia me probleme. Gjatë vitit 2018, siç shihet edhe nga Figura 3, vijoi rënia e kredive me probleme e cila vjen për shkak të shlyerjes së tyre, fshirjes së kredive të humbura dhe ristrukturimeve. Ulja e kredive me probleme ka ndikuar në uljen edhe me të shpejtë se to të rezervave për rrezikun e kredisë. Përsa i përket mbulimit me kapital të kredive me probleme neto, vlerësohet një përmirësim i këtij treguesi. Gjithashtu nivele të larta ka mbulimi me kolateral i tyre. Nga viti 2012, vit në të cilin shënohet niveli më i lartë i raportit të kredive me probleme neto ndaj kapitalit rregullator, 55.62% , ka vijuar një përmirësim i këtij treguesi duke arritur në fund të vitit 2018 në nivelin 15.51% (shih Tabela 1.1-5).

Vlen të përmendet se si pasojë e uljes së stokut të kredive me probleme me 17%, duke arritur në dhjetor të vitit 2018 në nivelin 11.08% (gjysma e krahasuar me fundin e vitit

2014, niveli i të cilave ishte 22.80% kredive me probleme). Këtë vit teprica e kredive me probleme ka arritur nivelin më të ulët nga viti 2010 (vit në të cilin ky tregues ishte në nivelin 13.96%).

Figura 3 Treguesit e cilësisë së aktiveve



Treguesi i kredive me probleme neto ndaj kapitalit rregullator ka rënë me 7,85 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Ky është një tregues i rritjes së aftësisë së sektorit bankar për të mbuluar, humbjet e mundshme nga përkeqësimi i kredisë, me kapital (referuar Figura 3 Treguesit e cilësisë së aktiveve). Përmirësimi i këtij treguesi vjen si pasojë e rënies më të madhe të kredive me probleme në raport me kapitalin rregullator. E rëndësishme, përsa i përket kredive me probleme, është ruajtja e këtij ritmi rënie të tyre sidomos për bankat që e kanë nivelin e tyre më të lartë sesa mesatarja e sektorit bankar. Aftësia paguese e huamarrësve është ndikuar pozitivisht nga normat e ulëta të interesit si edhe nga mbiçmimi i kursit të këmbimit.

Gjatë dy viteve të fundit, kalimet e kredive nga klasa "Standarde" tek ato "Me probleme" kanë qenë të qëndrueshme. Në lidhje me këtë, nga ana e bankave duhet të kushtohet kujdes për kategoritë që lëvizin nga "standarde" në atë "me probleme". Ato

gjithashtu duhet të qëndrojnë të kujdesshme në procesin e kredidhënies dhe atë të monitorimit të saj.

Mbulimi me kapital i kredive me probleme neto ka shënuar rritje. Rënia e nivelit të kredive me probleme neto ndikoi në përmirësimi e raportit të tyre me kapitalin rregullator. Ky raport ra në nivelin 15.51% nga 15.72% në vitin paraardhës dhe nga 55.62% në vitin 2012 (shih Tabela 1.1-5). Mbulimi me kolateral i kredisë mbetet i larë duke ndikuar në zbutjen e rrezikut të kredisë. Raporti i mbulimit me kolateral i kredive për vitin 2018 shënoi nivelin 78,2%.

4.3.2 Ecuria e depozitave

Niveli i depozitave të sektorit bankar në fund të vitit 2018 arriti në 1,180 miliard lekë duke shënuar një rritje vjetore prej 1.2%. Kontributin kryesor e kanë dhënë depozita pa afat. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat e biznesit. Depozitat në valutë përbëjnë 53% të totalit të tyre. Sipas sektorëve, depozitat e individëve zënë një vend të rëndësishëm në totalin e depozitave sipas subjektit, 83%.

Tabela 4.3-4 Ecuria e depozitave sipas monedhës, subjektit dhe produktit

	Treguesi dhe njësia	Vlera (mld lekë)	Struktura (% ndaj totalit)	Kontributi në normën e rritjes (p.p.)		Ndryshimi (%)	
	Periudha	12/2018	12/2018	Vjetor	6-mujor	Vjetor	6-mujor
Sipas monedhës	Depozita në Lek	553	47	0.4	0.8	0.8	1.7
	Depozita në valutë	627	53	0.9	2.2	1.7	4.2
Sipas subjektit	Sektori publik	27	2	0.0	0.0	-0.7	-0.7
	Biznese	176	15	0.7	0.7	4.6	4.8
	Individë	977	83	0.6	2.3	0.7	2.8
Sipas produktit	Llogari rrjedhëse	397	34	1.2	1.6	3.5	5.0
	Depozita pa afat	124		1.5	1.2	16.5	12.9
	Depozita me afat	643	54	-1.1	0.2	-1.9	0.4
	Stoku i depozitave	1,180	100	1.2	3.0	1.2	3.0


Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë

Ecuria e depozitave për periudhën 2010-2018 ka qënë në rritje.

Depozitat e klientëve mbeten burimi kryesor i financimit për sistemin bankar shqiptar, me një peshë prej 81.23% (80.40% në dhjetor 2017) të totalit të pasivit⁴². Në dhjetor 2018, vlera totale e depozitave të sistemit arrin në 1.180 miliardë lekë, (referuar Tabela 4.3-4), me një rritje vjetore prej 1.25%, krahasuar me një vit më parë. Pesha e monedhës vendase në totalin e depozitave ka rënë lehtësisht në 46.87%, nga 47.08% në dhjetor 2017. Struktura e maturitetit është zhvendosur në drejtim të afateve më të shkurtra, sepse është rritur pesha e llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat, ndërkohë që depozitat me afat janë tkurrur relativisht, nën ndikimin e uljes së vazhdueshme të normave të interesit të tregut.

Raporti kredi/depozita, në dhjetor 2018, paraqitet në nivelin 49.2% (dhjetor 2017: 51.55%) dhe reflekton një strukturë të aktiv-pasiveve që krijon lehtësi në administrimin e likuiditetit, si dhe stimuj potencialë në kredidhënie. Gjatë vitit 2018, treguesi është reduktuar lehtësisht, për shkak të ritmeve të ndryshme të ecurisë së portofolit të kredisë dhe totalit të depozitave (ku portofoli i kredisë ka njohur rënie, ndërkohë që depozitat kanë njohur rritje). Ky raport ka evidentuar gjithnjë vlera më të larta në valutë megjithë rënien e treguesit gjatë vitit 2018 (nga 51.92% në 57.6%), nën ndikimin e të njëjtëve faktorë të përmendur për treguesin në total.

Figura 4 Kredi ndaj depozitave



⁴² Banka e Shqipërisë, Rapoti vjetor i Mbikqyrjes 2018

Gjatë vitit 2018 veprimtaria e sektorit bankar është karakterizuar nga rënie e depozitave me afat dhe rritje e mëtejshme e depozitave në valutë. Kjo tregon praninë e gjerë të valutës në ekonomi e cila nga njëra anë përball me sfida efektivitetin e politikave ekonomike e financiare dhe nga ana tjetër vendos nën presion stabilitetin financiar dhe transmetimin e politikës monetare. Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave në vitin 2017 firmosën një Memorandum Mirëkuptimi për Deeurozimin e Ekonomisë.

Deeuroizimi: Në vitin 2011, Banka e Shqipërisë, sinjalizoi bankat që të favorizonin përdorimin e monedhës vendase në ekonomi dhe në sistemin bankar shqiptar kundrejt përdorimit të monedhës së huaj (banka hoqi remunerimin e rezervës së detyruar në valutë, për të nxitur bankat tregtare të ulin kostot e mbledhjes së fondeve). Në atë periudhë, kredia për ekonominë në valutë përbënte 65% të totalit, ndërsa pesha e depozitave ishte 48.3%.

Në fund të 2017-s, pesha e kredisë në monedhë të huaj zbriti në 50.4%, pra gati me 15 pikë përqindjeje. Por kjo nuk ka ndodhur me depozitat në valutë, të cilat janë rritur me 25% në pesë vitet e fundit, të cilat në fund të vitit 2017 përbënin 53% të totalit. Në këtë vit, Banka e Shqipërisë përveç dy masave të reja që synojnë rritjen e kostove për aktivet në euro, ka parashikuar një fushatë sensibilizuese ndaj grupeve të interesit për t'i orientuar ato drejt rritjes së përdorimit të lekut.

Masa e parë merr në konsideratë ndryshimin e normës së rezervës së detyrueshme. Më konkretisht u përcaktua rritja e normës së rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë në nivelin 12.5% nga 10% që ishte para këtij vendimi. Gjithashtu u ulën detyrimet për mbajtjen e rezervës së detyrueshme në lekë në nivelin 7.5% nga 10% që ishte. Për bankat, ku detyrimet në valutë zënë më shumë se 50% të detyrimeve totale, norma e rezervës së detyrueshme në valutë rritet në 20%.

Masa e dytë rrit kërkesën minimale rregullative për vlerën e aktiveve likuide në valutë. Më konkretisht, për aktivet likuide në valutë do të kërkohej që të jenë jo më pak se 20% e detyrimeve afatshkurtra në valutë (ishte 15%), ndërsa për aktivet likuide në lekë, niveli i raportit do të ruhet në 15%.

Masa e tretë lidhet me rritjen e ndërgjegjësimit të huamarrësve për rreziqet që shoqërojnë huamarrjen në valutë. Më konkretisht, bankave do t'iu kërkohej që: t'i propozojnë huamarrësit një kredi alternativë në lekë; ta pajisin atë me një shembull konkret se si ndryshon kësti i kredisë në rastin e nënçmimit të lekut (me vlera të përcaktuara); të ofrojnë opsionin për përdorimin e mekanizmave që zbusin rrezikun e kursit të këmbimit për kredimarrësin, në rastin kur plotësohen kushtet për të cilat kanë rënë dakord banka dhe huamarrësi.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, me një material kërkimor posaçërisht për euroizimin në Shqipëri, vlerësoi se euro zë 35% të transaksioneve cash, teksa bankat kanë më shumë se 50% të aktiveve në valuta dhe asnjëra prej tyre nuk e kanë analizën e kostove. FMN ka gjetur se ekonomia shqiptare e përdor euron 10% më shumë se niveli optimal.

Ndaj, është e nevojshme që në zbatim të Memorandumit Ndërinstitucional për Fuqizimin e Përdorimit të Monedhës Vendase në ekonomi dhe në sistemin financiar, autoritetet përkatëse (nëse shihet e nevojshme në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë) të kërkojnë nga agjentët realë të ekonomisë ndërmarrjen e veprimeve konkrete në drejtim të uljes së përdorimit të valutave.


4.3.3 Rreziku i likuiditetit

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar vlerësohet në nivele të kënaqshme dhe është përmirësuar gjatë periudhës. Treguesit e likuiditetit në lekë dhe valutë mbeten mbi nivelet minimale rregullative. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues të

sektorit bankar vijojnë të jenë depozitat. Të dhënat tregojnë se niveli i tyre është dy herë më i lartë se ai i kredive të sektorit bankar. Në fund të vitit 2018, raporti “hua/depozita” shënoi 49.2%.

Rreziku i likuiditetit edhe për vitin 2018 është në nivele të ulta. Treguesit e likuiditetit, në mënyrë të vazhdueshme, paraqiten ndjeshëm mbi normat e parashikuara në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë. Treguesi i këtij rreziku, si llogaritur nga raportet e aktiveve likuide, (në lekë dhe valutë), ndaj detyrimeve afatshkurtra, është mbi nivelet minimale që kërkohen nga kuadri rregullator (15% për aktive likuide në lek dhe 20% për ato në valutë). Ky tregues nga niveli 30.62% në vitin 2010 ka arritur në dhjetor të vitit 2018 46.2%⁴³, me një rritje prej 5.42 pikë përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Figura 5 Treguesit me bazë aktivet (në %)



Zmadhimi ka ndodhur kryesisht si pasojë e rritjes të aktiveve likuide me 13.87%. Rritja kryesore e aktiveve likuide i atribuohet kryesisht investimeve në “Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse me bankat dhe institucionet e tjera financiare.

Burimi kryesor i financimit të veprimtarisë së bankave mbeten depozitat, që zënë gati 81% të detyrimeve dhe që mbulojnë me mbi dy herë vëllimin e kredive të sektorit.


⁴³ Niveli minimal i lejuar i këtij treguesi në lekë sipas kërkesave rregullative është 15%, ndërsa i atij në valutë është 20%.

4.3.4 Rreziqet e tregut

Rreziqet e tregut ndaj të cilave është i ekspozuar sektori bankar, edhe pse në rënie gjatë vitit 2018, mbeten të rëndësishme⁴⁴.

Ekspozimet ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të kursit të këmbimit, nuk treguan ndryshime të rëndësishme gjatë periudhës dhe gjatë vitit të fundit. Portofoli i kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit shënoi 24% të totalit të tepricës së kredisë, dhe bizneset vijnë të mbajnë rreth 2/3 e tepricës së kësaj kredie. Lëvizjet e normës së interesit ndikojnë në ekspozimin e sektorit bankar ndaj këtyre luhatjeve. Sipas Bankës së Shqipërisë, të dhënat tregojnë në kushtet kur raporti i pozicioneve të hapura neto në bilanc midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit (në valutë të huaj) me kapitalin rregullator të sektorit është i kufizuar, ndikimi i drejtpërdrejtë i luhatjeve të normave të interesit është i moderuar. Ndërsa ndikimi i tërthortë i rrezikut të normës së interesit mbetet i rëndësishëm.

Figura 6 Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit



Nivelet e pozicionit të hapur neto në valutë tregojnë për një ekspozim të kufizuar ndaj ndikimit të drejtpërdrejtë në bilanc të luhatjeve të kursit të këmbimit, pavarësisht rritjes

⁴⁴ DEKLARATË E BANKËS SË SHQIPËRISË Deklarata e Stabilitetit Financiar për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2018

së lehtë të regjistruar gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit. Si treguesi i agreguar për të gjitha bankat, ashtu edhe treguesi për grupet e bankave sipas madhësisë, ka vlera shumë më të ulëta në krahasim me kufirin e sipërm prej 30% të kapitalit rregullator të përcaktuar nga rregullorja përkatëse.

4.3.5 Rezistenca e sektorit bankar

Për të vlerësuar rezistencën e sektorit bankar analizohen treguesit e performancës financiare dhe të kapitalizimit të veprimtarisë, si edhe kryhen ushtrimet e provës së rezistencës që vlerësojnë reagimin e treguesve të kapitalizimit dhe të likuiditetit të sektorit bankar ndaj skenarëve të supozuar.

4.3.5.1 Rezultati financiar

Sektori bankar e mbylli vitin 2018 me një rezultat financiar pozitiv prej rreth 18.4 miliardë lekësh. Ky rezultat ishte 3.7 miliardë lekë më i ulët se një vit më parë, por më i lartë se rezultati financiar i regjistruar gjatë viteve të tjera të dekadës së fundit. Ndikimin kryesor në zvogëlimin e rezultatit financiar, në krahasim me vitin 2017, e ka dhënë rritja e humbjeve nga instrumentet financiare dhe rritja e shpenzimeve për provigjione. Rezultati financiar i sektorit, për periudhën, ishte në nivele të mira.

Përgjatë vitit 2018, ndikimin më të madh në rezultatin financiar e ka dhënë tremujori i parë, dytë, me një rezultat financiar neto prej rreth 6.08 miliardë lekësh, duke u ulur për tremujorët në vijim. Rënia e të ardhurave neto nga interesat dhe rritja e shpenzimeve për provigjione kanë bërë që fitimi i vitit 2018 të jetë më i ulët se ai i vitit paraardhës.

Figura 7 Kthimi nga aktivet (ROA)






Figure 8 Kthimi nga kapitali (ROE)



Rënia në rezultatin financiar është reflektuar në rënie të lehtë të treguesve mesatarë të përfitueshmërisë së sektorit bankar, ku kthimi nga aktivet (RoA) dhe kthimi nga kapitali (RoE) ranë përkatësisht në 1.3% dhe 13%, nga 1.5% dhe 15.7% një vit më parë (shih Tabela 1.1-5; Figura 7; Figure 8).

Figure 9 Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve



Treguesi i efikasitetit të sistemit, në fund të vitit 2018, është rritur me 1.9 pikë përqindje në krahasim me vitin paraardhës, në kushtet kur të ardhurat operationale janë ulur me 0.69 miliardë lekë ose 1.3%, ndërsa shpenzimet operationale janë rritur me 0.66 miliardë lekë ose 2.2%⁴⁵.

Treguesit	Dhjetor 2018	Dhjetor 2017	Dhjetor 2016	Qershor 2016
Shpenzime operationale (1)	30,188.7	29,530.7	29,143.1	13,944.7
E ardhura operationale (2)	53,490.6	54,185.5	57,799.8	28,098.5
Efikasitetit (1) / (2)	56.44%	54.5%	50%	50%

Burimi: Banka e Shqipërisë

⁴⁵ Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor i Mbikqyrjes 2018

4.3.5.2 Mjaftueshmëria e kapitalit

Kapitali aksioner

Niveli i kapitalit aksioner në dhjetor 2018 (Tabela 4.3-5) është në nivelin 147.45 miliardë lekësh, me një rritje vjetore prej 0.5 miliardë lekësh (ose 0.3%). Kjo rritje është më ulët krahasuar me rritjen gjatë vitit 2017 (10.47 miliardë lekësh ose 7.67%).

Tabela 4.3-5 Treguesit e kapitalit aksioner, dhjetor 2018

Treguesit	Dhjetor 2018		Dhjetor 2017	
	Në mln.	Në %	Në mln.	Në %
Kapitali aksioner	147,453.5	100.0	146,507.5	100.0
Kapitali i paguar	110,251.8	74.8	128,713.8	87.9
Primet e aksioneve	6,440.5	4.4	6,479.8	4.4
Rezervat	18,220.7	12.4	12,924.6	8.8
Diferencë rivlerësimi	(6,994.0)	(4.7)	(2,255.5)	(1.5)
Fitim/humbje e pashpërndarë	1,143.5	0.8	(20,983.6)	(14.3)
Fitim/humbje e periudhës	18,391.0	12.5	21,628.4	14.8

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kapitali rregullator⁴⁶

Kapitali rregullator i sistemit bankar evidentohet në nivelin 142.72 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2017, kapitali rregullator shfaq një rënie prej 0.42 miliardë lekësh (0.3%).

Kapitali bazë i sistemit bankar përbën komponentin kryesor të kapitalit rregullator të sistemit, me një peshë prej rreth 93.16%, në rritje me 2.09 pikë përqindje krahasuar me vitin 2017. Kjo tregon se kapitali rregullator është cilësisht i qëndrueshëm.

Kapitali shtesë i sistemit në fund të vitit 2018, i cili përbëhet kryesisht nga borxhi i varur, është në nivelin 9,76 miliardë lekë. Ky nivel është më i ulët krahasuar me 12.78 miliardë lekëve që ishte në fund të vitit 2017.


Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

⁴⁶ Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor i Mbikqyrjes 2018

Në fund të periudhës, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar shënoi nivelin 18.2%, duke qenë 1.2 pikë përqindje më i lartë se niveli i fundit të vitit 2017 dhe dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar për këtë tregues prej 12%. Përmirësimi në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit është diktuar kryesisht nga rënia e vlerës së aktiveve të ponderuara me rrezik. Kjo rënie ka ardhur nga faktorë të njehershëm që lidhen me ndryshime në kuadrin rregullativ.

Referuar Tabela 1.1-5 Treguesit kryesorë të shëndetit financiar të sektorit bankar, në lidhje me treguesit me bazë kapitalin ndërtohet grafikët si në Figura 10 Treguesit me bazë kapitalin, për peshën e kapitalit rregullator dhe kapitalit të nivelit të parë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik si dhe kapitalit aksioner ndaj totalit të aktiveve.

Figura 10 Treguesit me bazë kapitalin




Gjatë viteve të fundit procesi i ristrukturimit të bankave në vend, po shoqërohet me rritjen e kontrollit të bankave nga kapitali vendas. Kjo është një dukuri e cila ka ndodhur edhe në vende të tjera të rajonit. Në Figura 11, paraqitet struktura e kapitalit të sistemit bankar sipas vendit të origjinës. Tek "Tabela 5.2-1 Aksionerët dhe pesha specifike e secilës bankë në sistemin bankar, dhjetor 2018", jepet informacion në lidhje me aksionerët e bankave, pjesëmarrjen e tyre në kapital, pronësinë, vendin e origjinës dhe peshën specifike që zë secila bankë në sistemin bankar.

Tabela 4.3-6 Struktura e kapitalit aksioner sipas origjinës

VENDI	Turk	Austriak	Italian	Shqiptar	Grek	Francez	Gjerman	Të tjera BE	Të tjera jo BE
Struktura e kapitalit sipas origjinës 2017	26.09%	18.14%	14.73%	14.62%	14.27%	5.73%	2.60%	2.26%	
Struktura e kapitalit sipas origjinës 2018	28.03%	18.80%	16.55%	13.31%	11.04%	5.86%	3.31%	1.80%	2.31%
Ndryshimi 2018 krahasuar me 2017	1.94%	0.66%	1.82%	-1.31%	-3.23%	0.13%	0.71%	-0.46%	2.31%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Figura 11 Struktura e kapitalit në sistemin bankar sipas origjinës



Burimi: Te dhënat nga Tabela 4.3-6

Krahas konsolidimit të veprimtarisë bankare, mbështetur në përvojën e deritanishme, ky zhvillim pritet të kontribuojë në një rol më aktiv të sektorit bankar drejt ndërmjetësimit financiar. Paralelisht, Banka e Shqipërisë në kuadër të aktivitetit të saj mbikëqyrës, do të vazhdojë të punojë për të siguruar standardeve sa më të mira të qeverisjes dhe të administrimit të rrezikut nga ana e sektorit bankar.

4.3.6 Rreziqet për stabilitetin financiar

Me rëndësi për stabilitetin financiar është vlerësimi i rreziqeve sistematike. Për këtë qëllim kryhet analiza e treguesve që lidhen me materializimin dhe akumulimin e rrezikut sistematik. Po ashtu, analizohet ecuria e treguesve që lidhen me nivein e stresit në sistemin financiar si edhe perceptimi lidhur me ekspozimin që ka ndaj rrezikut sistematik veprimtaria bankare.

Për vitin 2018, harta e stabilitetit financiar, e cila synon të ofrojë një qasje të konsoliduar të vlerësimit për këto rreziqe, indeksat e materializimit dhe të akumulimit të rrezikut sistematik dhe indeksi i stresit financiar, përgjithësisht tregojnë rreziqe të kontrolluara për stabilitetin financiar. Kontribut pozitiv në këtë drejtim kanë dhënë treguesit që lidhen me zhvillimet në sektorin real të ekonomisë dhe në sektorin bankar, ndërsa treguesit e rreziqeve që lidhen me mjedisin e huaj ekonomik shfaqin një rritje të lehtë. Përgjigjet e bankave në vrojtimin përkatës tregojnë se ato nuk patën ndryshime të rëndësishme në perceptimin e tërësisë së rreziqeve sistematike gjatë periudhës, por vërehet se ato perceptojnë nivel më të lartë rreziku të lidhur me situatën politike. Kjo përgjigje e bankave ishte e pritshme në vijim të ashpërsimit të klimës politike në vend në fund të periudhës. Ajo gjithashtu evidenton rëndësinë e përmirësimit të kësaj klime për mbështetjen më të mirë të zhvillimeve ekonomike dhe financiare, si edhe kontrollin e rreziqeve të veprimtarisë bankare.

4.3.7 Politika makroprudenciale


Gjatë periudhës, u punua për finalizimin e treguesve të rinj që sinjalizojnë zhvillimet e rreziqeve sistematike, në elementet ciklike dhe strukturore të tij. Lista e treguesve përfshin edhe ato të përcaktimit të ciklit financiar dhe të bankave me rëndësi sistematike, të cilët më pas do të shërbejnë për të sinjalizuar mundësinë e zbatimit të instrumenteve të caktuara makroprudenciale.

Më tej, në kuadër të masave të marra për fuqizimin e përdorimit të lekut në veprimtarinë bankare që hynë në fuqi të plota gjatë periudhës (në korrik 2018), Banka e Shqipërisë ka identifikuar dhe monitoron disa tregues për të vlerësuar efektin e këtyre masave dhe nevojën për rishikimin/pasurimin e tyre. Bazuar në ecurinë e këtyre treguesve gjatë gjashtëmujorit të dytë 2018, vërehet se lëvizjet në shumicën e tyre janë të vogla dhe, në

tërësi, vlerat e treguesve mbeten të shmangura ndjeshëm nga vlerat mesatare të treguesve për vende me ekonomi të ngjashme si Shqipëria. Në këto kushte, është e parakohshme dhënia e një vlerësimi për ndikimin e këtyre masave dhe nevojitet monitorimi i vazhdueshëm i treguesve përkatës.

Në këtë seksion bëhet një analizë përshkruese e variablave të përdorur duke ju referuara grafikëve të ndërtuar për këto variabla sipas bankave dhe njëkohësisht edhe për gjithë sektorin bankar për periudhën 5-vjeçare të marë në studim 2014-2018.


Figura 12 Aktivitet sipas bankave 2014-2018 (në milion lekë)



Përsa i përket vlerës së aktiveve sipas bankave të veçanta të sektorit bankar, Banka Kombëtare Tregëtare, Banka Raiffeisen, Intesa San Paolo dhe Banka Credins janë ato që kanë peshën me të madhe të aktiveve në sektorin bankar. Në përgjithësi duket se të gjitha bankat në përgjithësi (pavarësisht nga madhësia e tyre) kanë një tregues në rritje


të aktiveve të tyre. Banka Raiffaisen, aktivet e së cilës pas vitit 2016 shënojnë rënie, po ashtu edhe Banka Tregëtare dhe ajo Procredit.

Figura 13 Totali i aktiveve sektori bankar 2014-2018



Në total niveli i aktiveve të sektorit bankar ka shënuar rritje deri në vitin 2017. Në vitin 2018 ka një rrënie të tyre.


Figura 14 Kosto totale e aktivitetit të bankave 2014-2018



Përsa i përket koston totale të aktivitetit të bankave, kosto në të cilën përfshihen kosto personeli, kosto operacionale, shpenzime për interesat duket se ky tregues është më i lartë për bankat që si përmendur më lart mbajnë peshën më të madhe të aktiveve të sektorit bankar. Nëse shohim lëvizjen e këtij treguesi për banka të veçanta, ka ndër to që


kanë shënuar rritje të këtyre kostove në vite por kjo është në sinkron (referuar Figura 12) me rritjen e aktivitetit të këtyre bankave. Bankat që kanë tregues rritje të aktiveve të tyre kanë edhe tregues rritje të kostove totale.

Figura 15 Kosto totale e sektorit bankar 2014-2018




Në rang sektori bankar ky tregues, kosto totale, në vitin 2018 tregon rënie krahasuar me vitin 2014 dhe njëkohësisht rritje krahasuar me vitin 2016. Bankat tregohen më të kujdesshme në menaxhimin e kostove të operacioneve dhe në përgjithësi të kostove të aktivitetit të tyre.

Figure 16 Çmimi i fondeve sipas bankave 2014-2018




Referuar modelit të llogaritjes së efikasitetit, çmimi i fondeve përcaktohet si raport i interesave pasive me pasivet që shkaktajnë shpenzime. Ky është një tregues përgjithësisht në rënie (Figure 16) sipas bankave të veçanta por edhe për gjithë sektorin bankar (Figure 17)

Figure 17 Çmimi i fondeve të sektorit bankar 2014-2018



Në lidhje me shpenzimeve të personelit niveli i tyre sipas bankave, harmonizohet me madhësinë e tyre. Tendenca në kohë e rritjes ose rënies të tyre është dukshëm e lidhur me rritjen/rënien e nivelit të aktiveve të bankave të veçanta (Figura 12).

Figura 18 Shpenzime personeli sipas bankave 2014-2018



Nëse bëjmë një analizë në kohë të ecurisë së shpenzimeve të personelit, grafiku i kësaj ecurie lidhet me grafikun e lëvizjes së aktiveve totale të sektorit bankar (Figura 13).

Nëse shohim ecurinë në total të shpenzimeve të personelit, paraqitja grafike e saj është me të njejtën lëvizje si edhe lëvizja e aktiveve (referuar Figura 12)

Figure 19 Ecuria e totalit të shpenzimeve për personelin 2014-2018






Figure 20 Çmimi i punës sipas bankave 2014-2018




Një nga treguesit e përdorur për të vlerësuar efikasitetin e kostos së bankave është çmimi i punës i cili është llogaritur si raport i shpenzimeve për personelin me aktivet totale (në mungesë të të dhënave për numrin e punonjësve). Ky raport është më i ulët për bankat që kanë nivel më të lartë të aktiveve të tyre gjë e cila tregon se niveli i optimizimit të shpenzimeve për këto banka është më i lartë.

Figure 21 Treguesi i çmimit të punës për sektorin bankar në vite




Nëse i referohemi Figure 21 Treguesi i çmimit të punës për sektorin bankar në vite, vihet re një tendencë rënie nga viti 2014-2016 dhe më pas fillon rritja e këtyre shpenzimeve. Meqënëse ky raport lidhet me aktivet totale, rënia e tyre ndikon në rritjen e çmimit të punës të llogaritur në këtë mënyrë në këtë studim.

Figure 22 Çmimi i kapitali sipas bankave 2014-2018



Çmimi i kapitalit për bankat me nivel të lartë të aktiveve duket që është më i qëndrueshëm në vite. Bie në sy nivei i lartë i çmimit të kapitalit për Bankën Veneto, në vitin 2017, vitin e fundit të aktivitetit të saj para se të përthithej nga Intesa Sanpaolo në Romë, si edhe Banka Alpha gjatë periudhës 2014-2016. Në vitet në vijim 2017-2018, niveli i çmimit të kapitalit bie ndjeshëm krahasuar me 2014.


Figure 23 Çmimi i kapitalit 2014-2018



Nëse shohim ecurinë e këtij treguesi në nivelin e gjithë sektorit bankar për periudhën 2014-2018 ky tregues tregon përmirësim. Pas rritjes nga viti 2014 deri 2016, vitet në vijim tregojnë rënie të tij.


Nëse shohim lëvizjen e këtij treguesi për banka të veçanta, vihet re se jo të gjitha bankat kanë këtë lëvizje të nivelit të kredidhënies si vihet re në grafikun e lëvizjes totale të tyre (Figure 25 Kredia mesatare për sistemin bankar 2014-2018).

Figure 24 Kredia mesatare sipas bankave 2014-2018



Banka Raiffaisen, për periudhën në studim, ka rënie të nivelit të kreditimit, Banka Kombëtare Tregëtare ka rritje deri në vitin 2017 e pasuar më rënie në 2018 por gjithsesi më lart sesa viti 2016; Banka Intesa Sanpaolo, për periudhën e mare në studim, në vitin 2014, ka pasur nivelin më të lartë të kredidhënies më pas për periudhën 2016-2018 ka një relativisht qendrueshmëri në këtë nivel; Banka Alpha, gjithashtu ka një nivel të qendrueshmë të aktivitetit të saj kreditues; Banka Credins ka ndjeshëm rritje në këtë tregues për vitin 2018 krahasuar me vitin 2014. Ritmet e rritjes janë më të larta për periudhën 2014-2017. Të njejtën tendencë pozitive kanë shfaqur Banka Societe General dhe Banka Union e para me ritme me të larta rritje.

Figure 25 Kredia mesatare për sistemin bankar 2014-2018




Nëse i referohemi aktivitetit kreditues në nivel sektori bankar ai tregon rritje nga viti 2014 në vitin 2015, një ndryshim të lehtë ulje ngritje për periudhën 2015-2017 dhe për vitin 2018 kemi rënie të nivelit të kredidhënies nga ana e sektorit bankar (referuar Figure 25 Kredia mesatare për sistemin bankar 2014-2018).

Aktivet e tjera që sjellin të ardhura sipas bankave janë më të larta për Bankën Raiffaisen, Bankën Kombëtare Tregëtare, Bankën Intesa SanPaolo. Përsa i përket tendecës në ecurinë e këtyre aktiveve Banka Raiffaisen krahas rënies së aktivitetit kredidhënës ka rënie edhe në nivelin e aktiveve të tjera që sigurojnë të ardhura (e lidhur edhe me rënie në total të aktiveve të kësaj banke për vitin 2018).


Banka Kombëtare tregëtare, ka një tregues në rritje të aktivitetit kredidhënës (Figure 24 Kredia mesatare sipas bankave 2014-2018) si edhe të aktiveve të tjera që sjellin të ardhura (Figure 26).

Figure 26 Aktive të tjera që sjellin të ardhura sipas bankave



Për Bankën Intesa Sanpaolo ky tregues ka një lëvizje paksa të ndryshëm me atë të aktivitetit kredidhënës. Kjo e fundit ka shënuar rënie nga viti 2014 dhe duket pak a shumë e qëndrueshme për peirudhën 2015-2018. Aktivitetet e tjera që sigurojnë të ardhura kanë shënuar rritje në 2018 në krahasim me 2014 por rënie me vitin 2016.

Figure 27 Aktive të tjera që sjellin fitim (sektori bankar 2014-2018)



4.3.8 Përshkrimi i variablave dhe ekuacioneve që do të përdoren në studim

4.3.8.1 Modeli i vlerësimit të efikasitetit

Variablat e përdorur si outpute dhe çmimet e inputeve në modelin e vlerësimit të efikasitetit si dhe përkufizimet e tyre paraqiten si më poshtë.

- i. **Kosto totale** është totali i kostove operacionale të bankës duke përjashtuar kostot jo operacionale
 - ii. Si **outpute** konsiderohen *huatë* dhe të tjerë *aktive* të cilat *sjellin fitim*
- Inputet**
- iii. Çmimi i *interesit* si totali i shpenzimeve të interesit në raport me totalin e depozitave
 - iv. Çmimi i *punës* si totali i shpenzimeve të personelit në raport me aktivet totale
 - v. Çmimi i *aktiveve të qëndrueshme*, në një formë të thjeshtuar, është raporti i shpenzime të tjera operacionale me aktivet e qëndrueshme

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në Tabela 4.3-7 Përkufizimi i variablave, simbolet dhe përshkrimi i variablave që do të përdoren.

Tabela 4.3-7 Përkufizimi i variablave

Variabli	Simboli	Emërtimi	Përshkrimi
Variabli endogjen			
Shpenzime	TC	Kosto totale	Kosto totale përfshin të gjitha shpenzimet operative që lidhen me personelin, interesat, kapitalin fizik dhe të tjera (Shpenzime interesi dhe Shpenzime jo-interesi)
Variabli ekzogjen			
Çmimet e inputeve			
	p ₁	Çmimi i fondeve	i Shpenzime interesi ndaj shumës së pasiveve që shkaktojnë shpenzime
Çmimet	p ₂	Çmimi i punës	Shpenzime të personelit ndaj aktiveve totale ⁴⁷
	p ₃	Çmimi	i Shpenzime të tjera operacionale ndaj

⁴⁷ Llogaritja e çmimit të punës si raport i shpenzimeve të personelit ndaj aktiveve totale për shkak të mungesës së të dhënave për numrin e punonjësve.

		kapitalit fizik	totalit të aktiveve të qëndrueshme
Sasitë e outputeve			
	q ₁	Hua totale	Shuma e huave
Outputet	q ₂	Fond të tjera	Shuma e aktiveve të tjera të cilat sjellin fitim

4.3.8.2 Modeli i vlerësimit të marrëdhënies rrezik, kapital dhe efikasitet

Për të vlerësuar njëkohshmërinë ndërmjet efikasitetit të kostos, kapitalit dhe marrjes së rrezikut, do të përdoret një sistem ekuacionesh dhe vlerësimi do të kryhet duke përdorur modelin me tre shkallë të katrorëve më të vegjël).

Qëllimi i këtij punimi është vlerësimin e sjelljen manaxheriale në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri. Kjo do të arrihet duke analizuar rezultatet e modeli të ndërtuar për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet rrezikut, kapitalit dhe efikasitetit.

Tabela 4.3-8 Sistemi i ekuacioneve të modelit

$$Rrez_{ij} = f(Cap_{ij}, Eff_{ij}, X_{ij})$$

$$Cap_{ij} = f(Rrez_{ij}, Eff_{ij}, X_{ij})$$

$$Eff_{ij} = f(Cap_{ij}, Rrez_{ij}, X_{ij})$$

4

ku X përfaqëson tregues të tjerë specifikë të bankës si edhe tregues makroekonomikë që lidhen me rrezikun, kapitalin dhe efikasitetin.

4.3.8.3 Treguesit për kapitalin dhe rrezikun

Në përputhje me kërkesat për kapital sipas Basel I, II dhe III, raportet e kapitalit llogariten në tre mënyra: kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit ndaj totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve të ponderuara me

rrezik dhe kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve.⁴⁸ Në këtë studim do të përdoret raporti kapitali rregullator i nivelit të parë ndaj totalit të aktiveve, **ETA**, tregues i kapitalizimit. Ky raport tregon fuqinë financiare të bankës për të përballuar humbjet që vijnë nga një portofol i huave.

Në lidhje me matjen e rrezikut, nga literatura vijnë alternativa të shumta. Ndër to më të përdorshme janë raporti i aktiveve të ponderuara me rrezik (aktive të ponderuara me rrezik/totali i aktiveve) dhe ai i totalit të huave me probleme ndaj totalit të huave. Raporti i aktiveve të ponderuara me rrezik është një raport që ndërtohet në përputhje me masat rregulluese të rrezikut të portofolit dhe është përdorur në shumë studime. Sa më i lartë të jetë ky raport aq më i lartë është rreziku i aktiveve. Meqënëse ndaj këtij treguesi ka rezerva për shkak të mundësisë së manipulimit të tij përdoret raporti i huave me probleme si një tregues plotësues i raportit të aktiveve të ponderuara me rrezik. Në këtë studim, si variabël i rrezikut do të përdoret raporti hua me probleme ndaj totalit të huave (**NPL**) si një tregues i cilësisë së aktiveve.

Një raport i lartë i huave me probleme tregon se më herët (ex-ante) bankat kanë marrë hua me rrezik të lartë dhe kjo do të sjellë në të ardhmen (ex-post) një raport më të lartë të huave të këqija. Por, duhet cilësuar se përdorimi i treguesve të rrezikut të përcaktuar nga raportet financiare si tregues të së kaluarës, ka kufizime të ndryshme.

Efienca e kostos (**EFF**) është vlerësuar nga modeli i kufirit stohastik.

4.3.8.4 Tregues të tjerë

Një strukturë e mirë kapitali nënkupton një kombinim të mirë të borxhit, aksioneve të preferuar dhe aksioneve të zakonshme për të arritur maksimizimin e vlerës së tregut me minimizimin e kostos së kapitalit.

⁴⁸ Banka e Shqipërisë, Rregullore për kapitalin rregullator të bankës

Struktura optimale e kapitalit vlerësohet duke gjetur një kombimimin të borxhit dhe të kapitalit që minimizon koston mesatare të ponderuar të kapitalit ($\ddot{E}ACC$) duke maksimizuar vlerën e saj të tregut. Duke analizuar këtë raport mund të thuhet se duke ulur koston e kapitalit, do të rritet vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme të firmës, të skontuara nga $\ddot{E}ACC$. Mbështetur tek kjo mund të thuhet se qëllimi kryesor i menaxhimerëve të bankave duhet të jetë gjetja e strukturës optimale të kapitalit që do të rezultojë në $\ddot{E}ACC$ më të ulët dhe vlerën maksimale të aksioneve. Struktura e kapitalit varet nga disa variabla të bankës ose siç mund të quhen tregues mikroekonomikë. Raporti i provigjioneve për kreditë e humbura me aktivet (**LLP**) përdoret si një tregues i cilësisë së aktiveve. Nëse ky raport është i lartë tregon se në ardhmen do të ketë probleme me portofolin dhe kjo do të rezultojë në një kërkesë për më tepër kapital.

Raporti i huave totale ndaj totali të aktiveve (**LTA**) përdoret si tregues i rrezikut dhe është i përfshirë në të tre ekuacionet për të kontrolluar faktorët e rrezikut. Kombinime të caktuara portofoli kanë më tepër kredi me probleme të cilat sjellin më tepër kosto dhe probleme për ndjekjen e tyre në rast se banka ka një pasqyrë pozicioni financiar intensive në hua. Në kushte të tilla banka ndodhet para presionit për të ulur kostot, pra, për të rritur eficientë. ndodhen para vështirësive.

Raporti i huave ndaj depozitave (**LTD**) përdoret si tregues për të vlerësuar likuiditetin e bankës. Nëse ky raport është i lartë banka mund të ndodhet në një situatë jo të mirë likuiditeti për të mbuluar kërkesa të paparashikuara për fonde. Në të kundërt, një raport i ulët i huave ndaj depozitave tregon se banka ka tregues të ulët të rentabilitetit.

Madhësia (**SIZE**) është një nga faktorët që ndikojnë në përcaktimin e strukturës së kapitalit, në eficientë dhe niveli i rrezikut të portofolit. Sa më i madh totali i aktiveve aq

më të mëdha mundsitë për investime dhe më e lehtë hyrja në tregjet e kapitalit. Për këtë arsye bankat e mëdha kanë raporte të ulëta të kapitalit (Aggarwal dhe Jacques, 2001). Në studim përdoret logaritmi i totalit të aktiveve si tregues i madhësisë.

Rentabiliteti është një tregues i cili ndikon pozitivisht kapitalin bankar nëse banka konsideron rritjen e kapitalit duke përdorur fitimin e pashpërndarë. Si tregues të rentabiliteti përdoren kthimi nga aktivet (ROA) dhe kthimi nga kapitali (ROE).

ROA është një raport i rëndësishëm i efikasitetit dhe performancës operacionale të bankave, duke marrë parasysh kthimet e gjeneruara nga mjetet e financuara nga banka.

ROE është një raport i rëndësishëm i efikasitetit dhe performancës operacionale të bankave, duke marrë parasysh kthimet e gjeneruara nga përdorimi i kapitalit. Ai jep informacion në lidhje me qendryshmërinë e kapitalit. Një raport i lartë ROE vjen si rezultat i rritjes së rentabilitetit/uljes së kapitalizimit dhe e kundërta, një ulje e tij vjen si rezultat i uljes së rentabilitetit/ritjes së kapitalizimit. Për këtë interpretimi i tij kryhet bashkë me interpretimin e kapitalit të mjaftueshmërisë.

Goditjet makroekonomike, siç janë për shembull periudhat e recesionit, mund të ndikojnë raportet e kapitalit dhe portofolin e bankave. Si tregues për të përcaktuar se çfarë efekti kanë faktorët makroekonomikë, goditjet makroekonomike, në kapitali, efikasiteti dhe rreziku gjatë periudhës së marrë në studim, do të përdoret treguesi i rritjes ekonomike (EGR).

Mbështetur në diskutimet më sipër, në Tabela 4.3-9 kryhet një përshkrim i variablave që do përdoren (të varur dhe të pavarur).

Tabela 4.3-9 Përshkrimi i variablave që do të përdoren

<i>Simboli</i>	<i>Pershkrimi i variablit të pavarur</i>	<i>Qëllimi i përdorimit</i>
Kapitali		
1	ETA Raporti i kapitalit ndaj aktiveve Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	Tregues i kapitalizimit. Shërben si mbrojtje kundër mosfunksionimit të aseteve. Ky raport mat masën e mbrojtjes që i jepet bankës nga kapitali që kanë investuar në të. Sa më e lartë kjo shifër aq më shumë mbrojtje ka.
Rreziku		
2	NPL NPL/TL	Tregues i cilësisë së aktiveve, menaxhimit të huave si edhe i rrezikut të kredisë.
Efiçenca		
3	EFF Llogaritet nga modeli stohastik	
Variabla specifike		
4	LLP LLP/TA Provigjione për kreditë e humbura/Aktive totale	Tregues për cilësinë e aktiveve
5	LDR Raporti i huasë ndaj depozitave	Për të vlerësuar likuiditetin si edhe rrezikun e kredisë për një bankë. Një vlerë e lartë tregon një burim potencial të paqëndrueshmërisë dhe paaftësisë paguese
6	SIZE Logaritmi i aseteve totale	Tregues që ndikon tek kap. eff. & niveli i rrezikut të portofolit
7	ROA Kthimi mbi aktivet	Tregues i rentabilitetit
8	ROE Kthimi mbi kapitalin	Tregues i rentabilitetit dhe cilësisë së menaxhimit
9	ID Të ardhura jo nga interesi ndaj të ardhurave bruto	Tregues i nivelit të diversifikimit; lidhet + me madhësinë
10	LATA Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	Tregues për vlerësimin e rrezikut të likuiditetit
Tregues makroekonomikë		
11	EGR Tregues i rritjes ekonomike	Efkti që kanë faktorët makroekonomikë

Mbështetur në diskutimet më sipër ekuacioni 4 mund të shkruhet:

Tabela 4.3-10 Ekuacionet e modelit empirik

Variabli i varur	Modeli	Nr.	Hipoteza
------------------	--------	-----	----------

Rreziku (NPL)	$NPL = \alpha^0 + \alpha^1 E^* + \alpha^2 TA + \alpha^3 EFF + \alpha^4 LI_F + \alpha^5 Ln_{TA} + \alpha^6 SIZE + \alpha^7 ROA + \alpha^8 ROE + \alpha^9 FIXTAS + \alpha^{10} ID + \alpha^{11} EGR$	5	Menaxhim i keq Kufizimit Rreziku moral
Efiçenca (EFF)	$EFF = \alpha^0 + \alpha^1 E^* + \alpha^2 NPL + \alpha^3 LI_P + \alpha^4 LDR + \alpha^5 Ln_{TA} + \alpha^6 SIZE + \alpha^7 ROA + \alpha^8 ROE + \alpha^9 FIXTAS + \alpha^{10} ID + \alpha^{11} EGR$	6	Fati i keq
Kapitali (ETA)	$ETA = \alpha^0 + \alpha^1 E^* + \alpha^2 NPL + \alpha^3 LI_P + \alpha^4 LDR + \alpha^5 Ln_{TA} + \alpha^6 SIZE + \alpha^7 ROA + \alpha^8 ROE + \alpha^9 FIXTAS + \alpha^{10} ID + \alpha^{11} EGR$	7	Rregullatorit

Ekuacioni (6) teston hipotezën e "manaxhimit të keq" sipas së cilës lidhja ndërmjet huave me probleme dhe efiçencës është negative. Meqënëse sipas kësaj hipoteze nivele të ulëta të efiçencës janë një tregues i një performace të ulët manaxheriale e cila ndikon në një vlerësim dhe monitorim të dobët të kredive dhe rrjedhimisht kjo do të sjellë rritje të kredive me probleme. Menaxherët, në një rast të tillë, mund të mos arrijnë të kontrollojnë kostot operative, gjë që sjell rënie në efiçencë. Ata, nuk janë efiçentë në ndjekjen e kredive cilësore⁴⁹ (standarde + në ndjekje) ose në aplikimin e praktikave të monitorimit; nuk bëjnë vlerësimin e duhur për rregjistrin e kredive dhe për kolateralin, zgjedhin një nivel të lartë të kredive të cilat kanë një vlerë aktuale negative ose të ulët. Në këtë mënyrë, edhe pse rritja e dhënies së kredive mund të rezultojnë në periudhë të shkurtër me një rritje në efiçencë, mos zbatimi i plotë dhe korrekt i praktikave të dhënies dhe monitorimit të kredive i paraprin rritje së nivelit të kredive me probleme (kredi nënstandarde + kredi të dyshimta + kredi të humbura).

⁴⁹ Vendim nr. 52, datë 14. 07. 2004 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për të miratuar rregulloren "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË" Klasifikimi i kredive Neni 4

Një marrëdhënie pozitive ndërmjet këtyre dy variablave shpjegohet nga hipoteza e "kufizimit" të kostove. Sipas kësaj hipoteze manaxherët bëjnë një kompromis ndërmjet shpenzimeve operationale në afatshkurtër dhe huave me probleme në afat të gjatë dhe ulin shpenzimet për analizën edhe monitorimin e kredive që disbursohen. Një veprim i tillë ndikon njëkohësisht në cilësinë e kredive dhe efikasitetin e kostos. Një sjellje e tillë kufizuese në periudhë afatshkurtër krijon idenë e gabuar se bankat janë efikente, sepse e njëjta sasi produkti po sigurohet me çmim më të ulët ndërkohë që në afat të gjatë niveli i huave me probleme do rriten.

Ekuacioni (6) përdoret gjithashtu për të testuar hipotezën e "rrezikut moral" sipas të cilit parashikohet një lidhje negative ndërmjet huave me probleme dhe kapitalit.

Ekuacioni (7) përdoret për të testuar hipotezën e "fatit të keq". Kjo hipotezë parashikon një marrëdhënie negative ndërmjet efikasitetit të kostos dhe huave me probleme. Sipas kësaj hipoteze ngjarje të jashtme, ekzogjene, si është përkrahja e rritjes ekonomike, ndikon në rritjen e huave me probleme. Kalimi i një huaje në ndjekje kërkon nga menaxhimi përpjekje dhe kosto shtesë e cila nga kënvështimi i efikasitetit të kostos do të thotë rënie e saj. Në këto kosto përfshihen kontrolli dhe vlerësimi i huamarrësve, vlerësimi i kolateralit dhe në rast dështimi marrja, ruajtja dhe shitja e kolateralit, përdorimi i fondeve shtesë të cilat lidhen me bisedime për mundësinë e shlyerjes së huasë, përpjekje për të treguar situatën si të sigurt dhe të shëndetshme për mbikqyrësit dhe tregun, përpjekje për të patur një cilësi të lartë në huatë aktuale, ruajtja e cilësisë për huatë afatshkurta etj. Të gjitha këto shpenzime shtesë do të vijnë për shkak të rritjes së nivelit të huave me probleme. Pra, rritja e kredive me probleme shkakton uljen e efikasitetit të kostos.

Ekuacioni (8), sipas studimeve dhe artikujve të tjerë, nuk përdoret për të testuar ndonjë nga hipotezat e lart përmendura por në këtë studim ai përdoret për të testuar hipotezën e "rregullatorit". Sipas kësaj hipoteze organet rregullatore dhe mbikqyrja inkurajojnë bankat që të rrisin kapitalin e tyre në raport të drejtë me rrezikun që ato ndërmarrin. Një marrëdhënie pozitive ndërmjet kapitalit dhe rrezikut (rritje e kapitalit kur rritet rreziku) mund të jetë pjesërisht për shkak të monitorimit efektiv që i bëhet tregut kur pozicionet e kapitalit nuk janë të përshtatshme. Pra sipas kësaj hipoteze rritja e rrezikut i paraprin kërkesës për rritje të kapitalit.

4.4 Analiza e rezultateve

4.4.1 Vlerësimi i efikasitetit me anë të modelit të kufirit stokastik

Për vlerësimin e efikasitetit teknike të kostos është përdorur funksioni translog i kostos bazuar në artikullin e Molyneux, Altunbas & Gardener (1996). Meqë databaza jonë përmban të dhëna panel, gabimi i funksionit translog është i përbërë nga dy komponentë të cilët përfaqësojnë gabimin dhe efikasitetin. Vlerësimi është bërë në programin kompjuterik STATA dhe metoda e përdorur për vlerësim është ajo e përgjasisë maksimale. Në formë ekuacioni modeli shkruhet si më poshtë:

$$\ln(TC) = \alpha_0 + \sum_{i=1}^2 \alpha_i \ln Q_i + \sum_{i=1}^3 \beta_i \ln P_i + \frac{1}{2} \left[\sum_{i=1}^2 \sum_{j=1}^2 \delta_{ij} \ln Q_i \ln Q_j + \sum_{i=1}^3 \sum_{j=1}^3 \lambda_{ij} \ln P_i \ln P_j \right] + \frac{1}{2} \left[\sum_{i=1}^2 \sum_{j=1}^2 \delta_{ij} \ln Q_i \ln Q_j + \sum_{i=1}^3 \sum_{j=1}^3 \lambda_{ij} \ln P_i \ln P_j \right] + \sum_{i=1}^3 \sum_{j=1}^2 \rho_{ij} \ln P_i \ln Q_j + \varepsilon$$

ku variabli i varur është kosto totale – TC – në logaritëm natyror, Q_1 është totali i kredive, Q_2 është totali i aktiveve të tjera që sjellin fitim, P_1 është çmimi i fondeve, P_2 është çmimi i punës, P_3 është çmimi i kapitalit, ε është termi i gabimit stokastik dhe $\alpha, \beta, \delta, \lambda, \rho$ janë koeficientët që do të vlerësohen.

Vlerësimi i SFA mund të kryhet për të nxjerrë vlerësues të termit të gabimit, të cilat më pas konvertohen në vlerësues të ineffiçencës dhe të efiçencës. SFA jep mundësinë e vlerësimit të efiçencës sipas bankave duke konsideruar se efiçenca e secilës bankë nuk ndryshon në kohë, vlerësues të cilët mund të përdoren për një renditje të bankave. Por duke qënë se ky është një supozim mjaft i fortë, modeli u vlerësua nën supozimin se bankat mund të kenë efiçencë të ndryshme në vite të ndryshme, supozim i cili është më pranë realitetit. Në mënyrë që vlerat e efiçencës së vlerësuar të mund të bëhen të kuptueshme nga ana sasiore, dhe të vlefshme për qëllime krahasimi ato janë konvertuar duke konsideruar efiçencën e plotë (teorikisht) me 1. Konvertimi është kryer duke pjesëtuar 1 me vlerësimin e efiçencës të marrë nga SFA. Tabela 4.4-1 Tregues të efiçencës, paraqet statistikën përshkuese të rezultatit të efiçencës sipas SFA.

Tabela 4.4-1 Tregues të efiçencës

Variabli	N	Mesatarja	Devijimi standard	Minimumi	Maksimumi
Efiçenca e vlerësuar	78	9.44	17.699	1.147	124.355
Efiçenca e vlerësuar e konvertuar	78	.338	.250	.008	.872

Siç vihet re nga Tabela e mësipërme, bazuar në inputet dhe outputet e përfshira në mënyrë eksplicite në model, efiçenca mesatare e bankave është 33.8 përqind, pra mund të thuhet se ka vend për mjaft përmirësim. Devijimi standart i këtij vlerësimi është 25 përqind, pra ka mjaft variacion në efiçencën bankare. Efiçenca minimale është rreth 1 përqind dhe efiçenca maksimale është 87.2 përqind. Brenda bankave vlerësimet e efiçencës në

vite ndryshojnë mesatarisht me rreth 5.3 përqind, një vlerë kjo e vogël që do të thotë se ka qëndrueshmëri në efikasitetin bankar. Efikasiteti e vlerësuar është përdorur në nënseksionet e mëposhtme për të testuar hipotezat e shtruar në këtë punim për lidhjen mes saj dhe variablave të tjerë, si riskmarrja, kapitalit, asetëve totale, normës së dështimit të kredisë, si dhe rritjes ekonomike të vendit.

4.4.2 Vlerësimi i modelit 3SLS

Ky seksion prezanton rezultatet e analizës empirike të punimit. Së pari, prezantohen rezultatet e modelit 3SLS, i cili vlerëson një sistem me ekuacionet e mëposhtme:

$$\begin{cases} \mathbb{E}[E_{it}|K_{it}, R_{it}, \mathbf{X}_{it}] = \alpha_0 + \alpha_1 K_{it} + \alpha_2 R_{it} + \mathbf{X}_{it}'\boldsymbol{\beta} \\ \mathbb{E}[K_{it}|E_{it}, R_{it}, \mathbf{Z}_{it}] = \beta_0 + \beta_1 E_{it} + \beta_2 R_{it} + \mathbf{Z}_{it}'\boldsymbol{\delta} \\ \mathbb{E}[R_{it}|E_{it}, K_{it}, \mathbf{Y}_{it}] = \gamma_0 + \gamma_1 E_{it} + \gamma_2 K_{it} + \mathbf{Y}_{it}'\boldsymbol{\theta} \end{cases}$$

Ku E është efikasiteti teknik, K është kapitali bankar dhe R është ndërmarrja e rrezikut bankar. Vektorët $\mathbf{X}, \mathbf{Z}, \mathbf{Y}$ përfaqësojnë faktorë të tjerë shpjegues të efikasitetit, kapitalit dhe riskmarrjes, respektivisht. Bazuar në Tahir dhe Mognid (2013), Tabela e mëposhtme (Tabela 4.4-2) paraqet faktorët shpjegues në secilin ekuacion:

Tabela 4.4-2 Faktorët shpjegues në sistemin e ekuacioneve të modelit

$\mathbf{X}$	$\mathbf{Z}$	$\mathbf{Y}$
Ln(Aseteve Totale)	Ln(Aseteve Totale)	Ln(Aseteve Totale)
Raporti hua depozita (LDR)	Rritja e PBB	Rritja e PBB
Rritja e PBB	ROE	ROA
-	-	Risku (<i>ex-post</i>)

Duke marrë në konsideratë që të dhënat janë panel, sugjerohet që të kontrollohet për heterogjenitetin e pavëzhgueshëm ndër vite si dhe midis subjekteve bankare. Në terma teknikë, termat e gabimit të secilit ekuacion formohen nga efektete fiksuar kohore, efektete fiksuar individuale dhe një shok idiosinkratik, që shënohen përkatësisht me $\lambda_t, \mu_i, \epsilon_{it}$. Efektete fiksuar kohore përfshijnë faktorë të pavëzhgueshëm të cilët ndryshojnë ndër vite por janë të njëjtë për çdo subjekt. Ngjashmërisht, efektet e fiksuar individuale përfshijnë faktorë specifikë të subjekteve të cilët nuk ndryshojnë ndër vite. Tabela (i.3) paraqet ekuacionin e vlerësuar të efijencës teknike (të konvertuar, $E \in (0,1)$). Vihet re se efektet e fiksuar kohore nuk janë statistikisht të rëndësishme, pra modeli nuk vuan nga heterogjeniteti i pavëzhguar kohor. Kjo mund t'i atribuohet faktit që të gjithë variablat shpjegues variojnë ndër vite. Për më tepër, rritja ekonomike rezulton variabël i parëndësishëm. Nga ana tjetër, testi për efektet e fiksuar individuale (sipas bankave) sugjeron që ekziston heterogjeniteti i pavëzhgueshëm midis bankave në zgjedhje. Teknikisht, ky rezultat tregon se variacioni në efijencën teknike shpjegohet nga faktorët individualë të bankave të cilët nuk ndryshojnë në kohë. Për shembull, faktorët që nuk ndryshojnë ndër vite, por variojnë midis subjekteve bankare janë politikat individuale bankare, të cilat nuk janë pjesë e zgjedhjes së këtij studimi. Instrumentat e përdorur për të vlerësuar ekuacionin e efijencës janë kapitali dhe riskmarrja bankare. Për qëllimin e këtij studimi, përshkrimi i rezultateve i referohet kolonës (1). Vihet re se kapitali është një faktor i rëndësishëm përcaktues i efijencës teknike në nivelin 1 përqind. Megjithatë, efekti është negativ, sa më pak të kapitalizuara të jenë bankat e nivelit të dytë, aq më e lartë është efijenca teknike.

Tabela 4.4-3 Ekuacioni i vlerësuar i efijencës

Faktorët	(1) EFF	(2) EFF	(3) EFF
⁵⁰ Kapitali	-0.014*** (0.002)	-0.001 (0.001)	-0.014*** (0.002)
Riskmarrja	0.028*** (0.009)	0.003** (0.001)	0.028*** (0.009)
LDR	-0.000 (0.001)	-0.000 (0.000)	-0.000 (0.001)
⁵¹ Ln(Asete)	-0.147*** (0.019)	-0.107*** (0.022)	-0.150*** (0.018)
Rritja e GDP	-0.013 (0.026)	-0.042*** (0.003)	-0.020 (0.031)
Constant	1.993*** (0.222)	1,782.122*** (668.923)	2.029 (0.216)
Efek. Fix	-	-	-
$\frac{EFF_i}{\bar{EFF}}$	-	12482.61	1.19
$\frac{EFF_i}{\bar{EFF}} > \frac{EFF_j}{\bar{EFF}}$	-	0.000	0.999
N	78	78	78

Gabimet standarde në kllapa; *** p<0.01, ** p<0.05, * p<0.1

Burimi: Përlllogaritje të autorit

Ky rezultat bie në kundërshtim me literaturën pasi bankat e mire-kapitalizuara priren të jenë më efijente. Riskmarrja është gjithashtu njëfaktor statistikisht i rëndësishëm i efijencës bankare. Koefijenti i vlerësuar tregon se bankat që luajnë rolin e ndërmjetësuesit financiar janë më efijente. Norma e dështimit të kredisë nuk ka efekt mbi efijencën pasi ky faktor rezulton statistikisht i parëndësishëm. Asetet totale kanë ndikim negativ në efijencën bankare, pra një rritje në asetet totale redukton efijencën teknike të subjekteve bankare.

Tabela 4.4-4 paraqet ekuacionin e vlerësuar të ndërmarrjes së rrezikut. Variablat instrumentalë në këtë ekuacion janë efijenca bankare dhe kapitali bankar.

⁵⁰ Corr(E, K)=-0.235

⁵¹ Corr(E, ln(Asete))=-0.248

Ngjashmërisht me ekuacionin e efikasitetit, efektet e fiksuara kohore rezultojnë statistikisht të parëndësishme, krahasuar me efektet e fiksuara individuale të cilat sugjerojnë heterogjenitet të pavëzhgueshëm ndërmjet subjekteve bankare.

Tabela 4.4-4 Ekuacioni i vlerësuar i marrjes së rrezikut

Faktorët	(1) LTA	(2) LTA	(3) LTA
Kapitali	0.216*** (0.058)	0.137 (0.091)	0.235*** (0.062)
Efiçenca	24.017*** (4.752)	(69.215) 0.018	24.517*** (5.097)
Risku	-0.128 (0.215)	(0.079) (0.000)	-0.138 (0.241)
Ln(Asete)	3.546*** (0.577)	24.229*** (7.022)	3.653*** (0.617)
Rritja e GDP	-0.084 (0.513)	8.411** (3.341)	0.089 (0.645)
ROA	-0.514* (0.275)	-0.245 (0.175)	-0.500* (0.285)
Constant	-42.863*** (8.734)	-349.040*** (105.196)	-44.536*** (9.559)
Efek. Fix	-	0.18 (0.000)	0.59 (0.000)
$\frac{R^2}{R^2_{\text{efek. fix}}}$	-	12482.61	1.19
$\frac{R^2}{R^2_{\text{efek. fix}}} > \frac{R^2_{\text{efek. fix}}}{R^2}$	-	0.000	0.999
N	78	78	78

Gabimet standarde në klapa; *** p<0.01, ** p<0.05, * p<0.1

Burimi: Përlllogaritje të autorit

Referuar kolonës (1), kapitali ka efekt statistikisht të rëndësishëm në ndërmarrjen e rrezikut. Bankat më të kapitalizuara kanë rrezikmarrje më të lartë.

Efiçenca teknike është gjithashtu një faktor statistikisht i rëndësishëm përcaktues i rrezikmarrjes bankare. Rezultatet tregojnë gjithashtu se bankat më efiçente priren të kenë rrezikmarrje më të lartë. Efekti i riskut (ex-post) është zero. Vihet re se bankat e mëdha kanë risk-marrje më të lartë, dhe një rezultat i tillë është intuitiv. ROA është

gjithashtu një faktor i rëndësishëm përcaktues i riskmarrjes në nivelin 10 përqind. Bankat që kanë fitim të ulët kanë riskmarrje më të lartë, pasi riskmarrje më e lartë tregon shanse më të larta fitimprurjeje. Rritja ekonomike rezulton faktor i parëndësishëm në model, pra rritja ekonomike nuk ndikon në nivelin e riskmarrjes.

Tabela 4.4-5, paraqet ekuacionin e vlerësuar të kapitalit. Instrumentat e përdorur janë riskmarrja dhe efienca bankare. Referuar kolonës së parë, bankat më riskmarrëse kanë nivel më të lartë kapitali bankar, kjo tregon se në terma ekonomikë risku është i kushtueshëm. Nga ana tjetër, një risk më i lartë, mund të sjellë një fitim më të lartë. Ashtu si edhe u vu re më sipër, efienca dhe kapitali janë negativisht të korreluara, bankat më e efiente kanë kapital më të ulët. Një rezultat i tillë mund të jetë kontekstual, pasi në vende të ndryshme lidhja efienca-kapital është pozitive, ose bankat mund të arrijnë efienca pa sakrifikuar nivele të larta të kapitalit bankar, për shembull investimi në kapitalin human apo politika të tjera specifike për çdo bankë. Efekti i aseteve në kapital është negativ dhe statistikisht i rëndësishëm në nivelin 1 përqind. Tahir dhe Mognid (2013) argumentojnë se një lidhje negative midis kapitalit dhe aseteve është racionale. Bankat e mëdha priren të kenë pozitive më të lartë në treg, incentivë që iu jep avantazhin e rrezikmarrjes më të lartë pa ofruar kapital të lartë. Rritja ekonomike është faktor i parëndësishëm, ashtu si edhe në 2 ekuacionet e mësipërme. Kjo mungesë e rëndësisë statistikore mund të shpjegohet nga niveli i ulët i zhvillimit të vetë sistemit. Në këtë kontekst, është e mundshme që rritja ekonomike dhe kapitali bankar të jenë pak të korreluar (0.01 në kampionin e analizuar). Së fundmi, efekti i ROE është gjithashtu statistikisht i parëndësishëm.

Tabela 4.4-5 Ekuacioni i vlerësuar i kapitalit

Faktorët	(1) ETA	(2) ETA	(3) ETA
Riskmarrja	3.192*** (0.751)	5.455*** (1.965)	2.810*** (0.724)
Efiçenca	-83.342*** (9.439)	-1,022.727** (416.195)	-77.992*** (8.391)
Ln(Asete)	-12.682*** (1.614)	-125.655*** (46.359)	-11.949*** (1.498)
Rritja e GDP	-0.006 (1.790)	-39.986** (18.036)	-0.690 (2.061)
ROE	0.104 (0.073)	0.189 (0.150)	0.075 (0.061)
Constant	158.775*** (16.717)	1,782.122*** (668.923)	152.168*** (15.645)
Efek. Fix	-	12482.61	1.19
$\frac{F_{\text{efek}}}{F_{\text{fix}}} > \frac{F_{\text{fix}}}{F_{\text{fix}}}$	-	0.000	0.999
N	78	78	78

Gabimet standarde në klapa; *** p<0.01, ** p<0.05, * p<0.1

Burimi: Përlllogaritje të autorit

Rezultatet e mësipërme ka gjasa të ndryshojnë nëse shtrirja kohore e kampionit zgjerohet, ose nëse variabla të tjera, specifike për secilën bankë në zgjedhje do të përfshiheshin në model. Për më tepër, rezultatet mund të jenë të ndjeshme ndaj vlerësuesit të ekuacioneve. Për këtë, është e nevojshme që të verifikohet qëndrueshmëria e rezultateve me metoda të tjera. Për këtë, është vendosur që të përdoret vlerësimi i një modeli autoregresiv me të dhënat panel që kemi në dispozicion. Megjithatë, duhet patur parasysh se vlerësues të ndryshëm bazohen në supozime të ndryshme. Në seksionin e mëposhtëm, paraqiten rezultatet e modelit VAR në panel. Me anë të këtij modeli, është gjithashtu e mundur të kryhen inferenca shkakësie, si shkakësia sipas Granger apo funksionet impuls-reaguese, gjë që nuk është e mundur në vlerësimet e modeleve me tre hapa.

4.4.3 Vlerësimi i modelit VAR

Bazuar në Hansen (2019), modeli VAR për të dhënat panel mund të shprehet si vijim.

Le të jetë $\mathbf{Y}_{it} = (E_{it}, K_{it}, R_{it})'$ vektori i variablave kryesore në analizë. Modelet VAR specifikojnë se mesatarja e kushtëzuar e vektorit $\mathbf{Y}_{it}$, është një funksion i një numri të fundëm vonesash kohore:

$$\mathbb{E}(\mathbf{Y}_{it} | \mathbf{Y}_{it-1}, \dots, \mathbf{Y}_{it-p}) = \boldsymbol{\alpha}_0 + \mathbf{A}_1 \mathbf{Y}_{it-1} + \mathbf{A}_2 \mathbf{Y}_{it-2} + \dots + \mathbf{A}_p \mathbf{Y}_{it-p} \quad (\text{i.1})$$

Williams (2013) sugjeron se modeli VAR i efikasitetit, kapitalit dhe riskmarrjes ka rend kohor 3. Megjithatë, duke patur parasysh se kampioni i këtij studimi është me përmasë të limituar, rendi kohor i përdorur është 1. Modeli bazik i vektorit autoregresiv të rendit të parë, VAR(1), mund të shprehet si më poshtë:

$$\mathbf{Y}_{it} = \boldsymbol{\alpha}_0 + \mathbf{A}_1 \mathbf{Y}_{it-1} + \boldsymbol{\epsilon}_{it} \quad (\text{i.2})$$

ku $\mathbf{A}_i$ janë matricat e koeficientëve të modelit me përmasa (3×3) , $\boldsymbol{\epsilon}_{it}$ është termi idiosinkratik i gabimit dhe $\boldsymbol{\alpha}_0$ është vektori i parametrave konstantë me përmasa (3×1) . Ekuacioni (i.2) mund të shprehet si më poshtë, dhe vlerësimi i tij bëhet nëpërmjet OLS apo GMM.

$$\begin{pmatrix} E_{it} \\ R_{it} \\ K_{it} \end{pmatrix} = \begin{pmatrix} \alpha_{01} \\ \alpha_{02} \\ \alpha_{03} \end{pmatrix} + \begin{pmatrix} \alpha_{11}^1 & \alpha_{12}^1 & \alpha_{13}^1 \\ \alpha_{21}^1 & \alpha_{22}^1 & \alpha_{23}^1 \\ \alpha_{31}^1 & \alpha_{32}^1 & \alpha_{33}^1 \end{pmatrix} \begin{pmatrix} E_{it-1} \\ R_{it-1} \\ K_{it-1} \end{pmatrix} + \begin{pmatrix} \epsilon_{Eit} \\ \epsilon_{Rit} \\ \epsilon_{Kit} \end{pmatrix} \quad (\text{i.3})$$

Referuar analizës së shkakaësisë sipas Granger, le të konsiderojmë modelin e mësipërm.

Teknikisht, R_{it} nuk e shkakton E_{it} sipas Granger nëse matrica e koeficientëve $\mathbf{A}_1$ është trekëndore nga poshtë, pra nëse modeli VAR(1) ka formën:

$$\begin{pmatrix} E_{it} \\ R_{it} \\ K_{it} \end{pmatrix} = \begin{pmatrix} \alpha_{01} \\ \alpha_{02} \\ \alpha_{03} \end{pmatrix} + \begin{pmatrix} \alpha_{11}^1 & \mathbf{0} & \alpha_{13}^1 \\ \alpha_{21}^1 & \alpha_{22}^1 & \alpha_{23}^1 \\ \alpha_{31}^1 & \alpha_{32}^1 & \alpha_{33}^1 \end{pmatrix} \begin{pmatrix} E_{it-1} \\ R_{it-1} \\ K_{it-1} \end{pmatrix} + \begin{pmatrix} \epsilon_{Eit} \\ \epsilon_{Rit} \\ \epsilon_{Kit} \end{pmatrix} \quad (\text{i.4})$$

Në mënyrë të ngjashme, mund të përcaktohet shkakësia për variablat e tjerë në model. Testi i shkakësisë sipas Granger teston nëse në ekuacionin e efijencës, parametri $\alpha_{12}^1 = 0$. Aq kohë sa në literaturë nuk ka kufizime strukturore për modelin e efijencës, kapitalit dhe riskmarrjes, VAR i përdorur në këtë analizë është i formës së reduktuar. Kujtojmë se modelet strukturore, pra modelet që imponojnë kufizime në parametrat e vlerësueshëm janë shpeshherë më pak efijentë. Tabela 4.4-6 prezanton modelin e vlerësuar VAR(1).

Tabela 4.4-6 Modeli i vlerësuar VAR (1)

Variablat	(1) EFF	(2) LTA	(3) ETA
L.EFF	1.026*** (0.019)	8.250 (16.325)	3.283 (11.145)
L.LTA	-0.001*** (0.000)	0.446 (0.285)	-0.181 (0.161)
L.ETA	-0.001*** (0.000)	-0.083 (0.099)	-0.283 (0.555)
<i>N</i>	45	45	45

Gabimet standarde në klapa; *** $p < 0.01$, ** $p < 0.05$, * $p < 0.1$

Burimi: Përlllogaritje të autorit

Interpretimi i koeficientëve është si në OLS (rezultatet me vlerësuesin GMM janë identike). Në ekuacionin e efijencës, vihet re se persistenca në efijencë është faktor i rëndësishëm në parashikimin e efijencës. Si vonesa në kapital, ashtu edhe në riskmarrje kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm dhe negativ në efijencën bankare. Testi i shkakësisë sipas Granger (Tabela i.7) tregon se riskmarrja dhe kapitali shkaktojnë efijencën bankare individualisht dhe bashkarisht në nivelin 1 përqind. Në kontrast me këtë përfundim, nuk ka efekte shkakësie sipas Granger në ekuacionet e kapitalit dhe

riskmarrjes. Pra, kapitali dhe efienca nuk e shkaktojnë riskmarrjen sipas Granger. Në mënyrë të ngjashme, efienca dhe riskmarrja nuk paraqesin efekte shkakësore në ekuacionin e kapitalit. Vlen të theksohet, se modeli VAR(1) plotëson kushtin e stabilitetit, që do të thotë se vlerat e veta të matricës (vlerat eigen) shoqëruese bien në intervalin unitar. Williams (2004) sugjeron se efektet e fiksuara kohore duhen përfshirë në model. Për shkak të kolinearititetit perfekt, disa nga variablat kohorë dummy janë përjashtuar nga modeli.

Tabela 4.4-7 Testi i shkakësisë sipas Granger

Ekuacioni (i)	Kufizimi	χ^2	df	p-value
Ekuacioni (EFF)	LTA	11.125	1	0.001
	ETA	10.708	1	0.001
	ALL	16.536	2	0.000
Ekuacioni (LTA)	EFF	0.255	1	0.613
	ETA	0.702	1	0.402
	ALL	0.862	2	0.650
Ekuacioni (ETA)	LTA	0.087	1	0.768
	EFF	1.266	1	0.261
	ALL	2.335	2	0.311

Testi GC-Granger Causality; p-value: Hipoteza zero refuzohet nëse p-value është më e ulët se 1, 5 apo 10 %.

Burimi: Përllogaritje të autorit

Për më tepër, përfshirja e efekteve të fiksuara kohore ndikon kushtin e stabilitetit. Në aplikime empirike, kushti i stabilitetit është i ndjeshëm ndaj rendit të vonesave kohore të modelit. Njëkëtë aplikim specifik, rendi i modelit është 1 për shkak të numrit të ulët të vëzhgimeve. Tabela 4.4-8 paraqet modelin VAR me efekte të fiksuara kohore. Kontrolli

për heterogjenitet kohor ka ndikim në parametrat e vlerësuar. Së pari, persistenca në efikasitet, kapital dhe riskmarrje ka efekt statistikisht të rëndësishëm në efikasitet, kapital dhe riskmarrje, respektivisht.

Tabela 4.4-8 Modeli i vlerësuar VAR (1) me efekte të fiksuara kohore

VARIABLES	(1) LTA	(2) ETA	(3) EFF
L.LTA	0.473*** (0.040)	-0.036 (0.040)	0.758*** (0.040)
L.ETA	-0.088*** (0.020)	-0.144*** (0.020)	0.464*** (0.020)
L.EFF	0.021*** (0.007)	0.088*** (0.007)	1.780*** (0.007)
N	45	45	45

Gabimet standarde në kllapa; *** $p < 0.01$, ** $p < 0.05$, * $p < 0.1$


Burimi: Përlllogaritje të autorit

Në ekuacionin e riskmarrjes, vihet re se efekti i kapitalit është negativ ndërsa efekti i efikasitetit është pozitiv. Referuar ekuacionit të kapitalit, efekti i riskmarrjes bankare rezulton statistikisht i parëndësishëm. Përkundrazi, efikasiteti ndikon pozitivisht kapitalin bankar. Kontrolli për heterogjenitet të pavëzhgueshëm ndërkohor ndikon gjithashtu në koeficientët në ekuacionin e efikasitetit, që do të thotë se efekti i kapitalit dhe riskmarrjes ndërron shenjë. Pavarësisht se roli i faktorëve të pavëzhgueshëm që ndryshojnë në kohë është i rëndësishëm pasi redukton heterogjenitetin e pavëzhguar, modeli pa efektet e fiksuara është më i besueshëm, pasi plotëson kushtin e stabilitetit. Një nga avantazhet e plotësimit të kushtit të stabilitetit është vlerësimi i funksioneve impuls-reagim (Figure 28 Funksionet impuls - reagim). Në parim, funksionet impuls-reagim tregojnë trajektoren e reagimit të një variabli si pasojë e një shoku të papritur në variablin tjetër.

Në parim, persistenca e shokut duhet të neutralizohet, edhe pse në aplikimet empirike kjo ndodh rrallë. Për këtë analizë janë përdorur të dhënat e simuluar sipas metodës së

Monte-Calo. Gabimet standarde dhe intervalet e besimit janë prodhuar sipas së njëjtës metodë. Numri i simulimeve është 500.

Figure 28 Funkzionet impuls - reagim



Burimi: Përlllogaritje të autorit

Kolona e parë tregon reagimin e kapitalit si pasojë e një shoku në kapital, riskmarrje dhe efizienzë. Trajektorja e reagimit është në konsistencë të plotë me testin e shkakësisë sipas Granger pasi kapitali nuk reagon ndaj asnjë impulsi.

Referuar kolonës së dytë, riskmarrja reagon pak ndaj një shoku në kapital, specifiku, pëson ulje në periudhën e parë të shokut, dhe më pas efekti neutralizohet. Efekti i një shoku në efizienzë është i kundërt me efektin e shokut në kapital: riskmarrja rritet në 2 vitet e para, dhe më pas efekti neutralizohet.

Së fundmi, kolona e tretë prezanton reagimin e efijencës ndaj një shoku të papritur në kapital dhe riskmarrje. Në konsistencë me modelin e vlerësuar VAR (1) në Tabelën i.6, efekti i shokut të kapitalit është negativ, pra efijenca bankare pëson rënie në periudhën e parë të shokut, dhe më pas efekti tenton të neutralizohet, edhe pse nuk shuhet plotësisht. Ngjashmërisht, impulsi ndaj shokut të riskmarrjes është negativ në periudhën e parë të shokut, dhe në kontrast me shokun e kapitalit, efijenca dështon të stabilizohet pasi trajektorja e impulsit ka limit nën vlerën zero (edhe pse shumë pranë zeros).

KAPITULLI 5: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për këtë periudhë në Shqipëri, madje deri në vitin 2014, cilësia e kredisë ishte në nivelin e saj më të ulët. Stoku i kredive me probleme arriti nivelin më të lartë në vitin 2014 dhe nga ai vit deri në fund të vitit 2018 ka pësuar rënie. Në fund të vitit 2013, raporti i kredive me probleme për sektorin bankar ishte në nivelin 23.5%, duke shënuar një rritje vjetore më e ulëta që prej vitit 2007. Në dhjetor 2014, teprica e huave me probleme ra në 22.8%⁵². Në këtë rënie në nivelit të kredive me probleme kanë ndikuar edhe ndryshimet rregullative që nxisnin ristrukturimin e hershëm të kredisë. Cilësia e kredisë është përmirësuar ndjeshëm në vitin 2018 (11.1%) duke shënuar nivelin më të ulët të tepricës së kredive me probleme nga viti 2010 (në këtë vit ky tregues ka qenë 14% kundrejt 10.5% në fund të vitit 2009).

Në kushte të tilla pritet që bankat të përpiqen të ulin ekspozimin e tyre ndaj aktiveve me rrezik të lartë ose të rrisin kapitalin e tyre për të arritur përmbushjen e kërkesave rregullatore.

5.1 KONKLUZIONE

Bazuar në rezultatet e studimit dhe analizën e tyre del në pah rëndësia që ka për bankat së pari kujdesi në lidhje me efijencën e kostos e cila në rastin e sektorit bankar në Shqipëri për periudhën 5 vjeçare, 2014-2018, është në nivele që ka vend për përmirësim. Kjo vjen edhe për shkak të variacionit ndërmjet bankave përse i përket efijencës bankare. Qëndrueshmëria e këtij treguesi për bankat specifike do të thotë që ndryshimi duhet të meret në konsideratë për specifikat e bankave të veçanta dhe politikat e menaxhimit që ato aplikojnë.

⁵² Banka e Shqipërisë, Raporti i stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013; Banka e Shqipërisë, Raporti i stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014; Banka e Shqipërisë, Raporti i stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2018; Banka e Shqipërisë, Raporti i stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010

Gjatë periudhës së marë në analizë (por në ngjashmëri edhe me zhvillimet pas krizës globale financiare 2008 në përgjithësi në Europë)⁵³ marzhi fitimit ka qenë në ngritje dhe rënie të vazhdueshme me një tendencë në rënie. Kjo lidhet me rritjen më të shpejtë të kostove krahasuar me të ardhurat (referuar Figure 6-6 të Aneksit). Raporti i kthimit nga kapitali për sektorin bankar në periudhën e marrë në studim, gjithashtu tregon se pas një kulmimi të tij në mars 2015, moment pavarësisht ngritjeve dhe rënieve ai është në nivele më të ulta se mars 2014 (referuar Figure 6-1 të Aneksit).

Bankat janë fokusuar tek dixhitalizimi i proceseve, produkteve dhe shërbimeve të tyre duke synuar uljen e kostove operative. Niveli i ulët e menaxhimit të kostove mund të lidhet me tre faktorë. *Së pari*, mund të konsiderohet ndikimi që ka kuadri rregullator i vendosur pas krizës globale. Mbështetur tek marrëveshjet e Bazelit, kërkesat rregullatore janë rritur duke ndikuar jo vetëm në rritjen e kërkesave për kapitalin rregullator por edhe mbajtjen e burimeve të tjera në përgjigje të kërkesave rregullatore. Digjitalizimi ndikon në kosto më të ulta të pagesave për personelin në nivel dege apo edhe zyre qendrore, nga ana tjetër kërkon rregullimi bankar kërkon pagesa të larta për punonjës që konsiderohen se janë me rrezik të lartë (përsa i përket mundësisë së tyre për tu larguar), legalë dhe në pajtueshmëri me punën (pjesë e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore). *Së dyti*, nevoja për të qenë një njësi e dixhitalizuar dhe njëkohësisht në përputhje me kërkesat rregullatore, bankat kanë kryer përmirësime dhe investime të rëndësishme në teknologji informacioni. *Së treti*, niveli i lartë i kredive me probleme, të cilat kërkojnë një rritje të shpenzimeve për analizën, ndjekjen dhe trajtimin e tyre.

⁵³ Alf dhe tw tjerw, qershor 2018

Rënia e vazhdueshme e normave të interesit (norma bazë e interesit ka lëvizur nga 2.75% në vitin 2014 në 1% në vitin 2019) në ndikuar në luhatshmërinë e të ardhurave neto. Nga njëra janë normat e ulta të interesit kanë ndikuar në rënien e marzhit të depozitave dhe nga ana tjetër konkurenca ndikon në kufizimin e shfytëzimit të mundësisë për kompensim nëpërmjet rritjes së pagesave për shërbimet e ofruara. Këta faktorë, të kombinuar edhe me kërkesat për kapital ndikojnë në ecurinë në kohë të kthimit nga kapitali.

Tendenca për rritjen e kostove dhe rritjen e kufizuar të të ardhurave duket se do të vijojë, mbështetur kjo në parashikimet e treguesve makroekonomikë për periudhën 2019-2021. Norma e rritjes së PBB pritet të ulet nga 0.6% në fillim të vitit 2019 në 0.4% në vitin 2020, norma vjetore e rritjes do të jetë nga 3.1 në 3.7%, norma e inflacionit nga 1.5 në 2.5%. Kërkesat rregullatore pritet të rriten dhe kjo ndikon në rritjen e kostove për përmbushjen e tyre dhe ndryshime të mëtejshme në teknologji.

Nga ana tjetër pritet që në afatmesëm normat e interesit të mos kenë një rritje të ndjeshme. Duke marrë në konsideratë konkurrencën ndërmjet bankave dhe rregullat për mbrojtjen e konsumatorit mendohet që të ardhurat e komisioneve bankare të mbeten të kufizuara në mundësinë e tyre për rritje. Në këtë kuadër duket që përmirësimi i efikasitetit është vërtet një sfidë për bankat.

Ndaj tyre sygjerohet që të lehtësojnë proceset, produktet dhe shërbimet që ofrojnë. Aktualisht bankat ofrojnë produktet dhe shërbimet ekzistuese krahas atyre të reja duke paraqitur kështu një portofol të madh para klientëve të tyre të arritur nëpërmjet ofertash të ngjashme të cilat ofrohen nëpërmjet një shumëllojshmërie, nga njëra anë, por që kërkojnë ndjekjen e procedura specifike për realizimin e tyre. Kjo është një situatë e cila

duhet të merret në konsideratë për tu ndryshuar në kuadër të përmirësimit të efikasitetit të kostos. Ndjekja e politikave dhe procedurave të tilla nga ana e tyre sjell probleme në lidhje me dixhitalizimin. Sygjerohet që bankat krahas dixhitalizimit të riformatojnë llojshmërinë e shërbimeve dhe produkteve të ofruara. Ato duhet të përfshijnë shërbimet që do të eliminojnë në ofertat që do të mbeten të vlefshme. Rritja e efikasitetit në shërbimet dhe produktet e ofruar lidhet me personalizimin e përvijës së klientëve, i cili ka të bëjë me mënyrën sesi sigurohen produktet bankare. Nëpërmjet tij, klientët marrin shërbimin në kohën dhe kanalin e duhur. Krahas me rishikimin e shërbimeve dhe produkteve të tyre për klientët, bankat, në kuadër të përmirësimit të efikasitetit të kostos, duhet të përmirësojnë proceset e sigurimit të tyre. Kjo e fundit ndikon në uljen e kostove por edhe në përmirësimin e efikasitetit të programeve teknologjike financiare që janë duke u aplikuar.

Mbështetur në rezultatet e studimit, tregohet se variacioni në efikasitetin teknik shpjegohet nga faktorët individualë të bankave të cilët nuk ndryshojnë në kohë. Për shembull, faktorët që nuk ndryshojnë ndër vite, por variojnë midis subjekteve bankare janë politikat individuale bankare, të cilat nuk janë pjesë e zgjedhjes së këtij studimi. Përsa i përket ndërvartësisë së efikasitetit nga kapitali dhe ndërmarrja e rrezikut, vihet re se kapitali është një faktor i rëndësishëm përcaktues i efikasitetit teknik. Megjithatë, efekti është negativ, sa më pak të kapitalizuarat të jenë bankat e nivelit të dytë, aq më e lartë është efikasiteti teknik kjo do të thotë se ato tregohen të kujdesshme në menaxhimin e kostove. Për bankat me nivel të lartë të kapitalit duket mbështetur hipoteza e rrezikut moral. Kjo marrëdhënie është e ndërsjelltë dhe qendron negative, pra efikasiteti ndikon me shenjë të kundërt tek kapitali po ashtu edhe kapitali ndikon negativisht tek efikasiteti duke treguar se "rreziku moral" është prezent në sektorin

bankar. Kjo tregon se bankat e mirëkapitalizuara kanë kosto më të lartë sesa kostot e bankave me nivel kapitali më të ulët . Marrëdhënia kapital-efiçencë në kuptimin e shkaksisë mund të konsiderohet si një marrëdhënie ndërsjelltë, që mund të interpretohet në dy drejtime. Efiçenca e koston është po negativisht shkaktare për kapitalin. Në mënyrë të përmbledhur, kjo marrëdhënie e ndërsjelltë mund të interpretohet: një bankë që ka një nivel të lartë efiçence ka nivel më të ulët kapitalizimi dhe në drejtimin tjetër rritja e kapitalit të bankës ndikon negativisht në rritjen e efiçencës duke reflektuar kujdes nga bankat me nivel më të ulët kapitali dhe prezenë të "rrezikut moral" nga ana e bankave të mirëkapitalizuara.

Riskmarrja është gjithashtu njëfaktor statistikisht i rëndësishëm i efiçencës bankare. Koeficienti i vlerësuar tregon se bankat që luajnë rolin më të rëndësishëm në ndërmjetësuesit financiar janë më efiçente. Lidhja pozitive ndërmjet ndërmarrjes së rrezikut dhe efiçencës tregon se bankat duhet të tregohen më të kujdesshme kur ndërmarrin rrezik më të lartë. Rezultatet e këtij studimi konfirmojnë se efiçenca është shkaktare për rrezikun, dhe lidhja pozitive, në të dy kahet mbështet hipotezën e "menaxhimit të keq" dhe variantin e efiçencës për hipotezën e "rrezikut moral". Normalisht, ndërmarrja e veprimeve me rrezik më të lartë kërkon më tepër kosto për identifikim dhe analizë të çdo rasti, rrjedhimisht rritje të kostove, ulje të efiçencës.

Norma e dështimit të kredisë nuk ka efekt mbi efiçencën pasi ky faktor rezulton statistikisht i parëndësishëm. Asetet totale kanë ndikim negativ në efiçencën bankare, pra një rritje në asetet totale redukton efiçencën teknike të subjekteve bankare duke shfaqur edhe në këtë rast konfirmim të hipotezës së "menaxhimit të keq"

Kapitali ka efekt statistikisht të rëndësishëm në riskmarrje dhe lidhja e tyre është pozitive. Kjo do të thotë se rritja e kapitali dhe masat shtrenguese rregullatore të cilat kërkojnë rritjen e tij ndikojnë në nxitjen e drejuesve për të ndërmarrë me tepër rrezik për të mbuluar kostot që shkakton mbajtja e kapitalit. Bankat më të kapitalizuara kanë ndërmarrje më të lartë rreziku. Një lidhje e tillë pozitive reflekton preferencat që kanë organet rregullatore për të kontrolluar rrezikun nëpërmjet rritjes së kërkesës për kapital duke ndikuar në kufizimin e aktiviteteve që synojnë ndërmarrjen e niveleve të larta të rrezikut.

Efiçenca teknike është gjithashtu një faktor statistikisht i rëndësishëm përcaktues i riskmarrjes bankare. Rezultatet tregojnë gjithashtu se bankat më efiçente priren të kenë riskmarrje më të lartë. Efekti i riskut (ex-post) është zero. Vihet re se bankat e mëdha kanë risk-marrje më të lartë, dhe një rezultat i tillë është intuitiv. ROA është gjithashtu një faktor i rëndësishëm përcaktues i riskmarrjes. Bankat që kanë fitim të ulët kanë riskmarrje më të lartë, pasi riskmarrje më e lartë tregon shanse më të larta fitimprurjeje. Rritja ekonomike rezulton faktor i parëndësishëm në model, pra rritja ekonomike nuk ndikon në nivelin e riskmarrjes.

Bankat më riskmarrëse kanë nivel më të lartë kapitali bankar, kjo tregon se në terma ekonomike risku është i kushtueshëm. Nga ana tjetër, një risk më i lartë, mund të sjellë një fitim më të lartë. Ashtu si edhe u vu re më sipër, efiçenca dhe kapitali janë negativisht të korreluara, bankat më efiçente kanë kapital më të ulët. Një rezultat i tillë mund të jetë kontekstual, pasi në vende të ndryshme lidhja efiçencë-kapital është pozitive, ose bankat mund të arrijnë efiçencë pa sakrifikuar nivele të larta të kapitalit bankar, për shembull investimi në kapitalin human apo politika të tjera specifike për çdo

bankë. Efekti i aseteve në kapital është negativ dhe statistikisht i rëndësishëm. Tahir dhe Mognid (2013) argumentojnë se një lidhje negative midis kapitalit dhe aseteve është racionale. Bankat e mëdha priren të kenë pozitë më të lartë në treg, incentivë që iu jep avantazhin e riskmarrjes më të lartë pa ofruar kapital të lartë. Në këtë mënyrë vërtetohet për bankat në Shqipëri hipoteza e kufizimit "skimping" e cila konstaton një lidhje pozitive ndërmjet rrezikut dhe efikasitetit nga bankat e mëdha. Kjo tregon se në periudhë afatshkurtër këto banka kanë tendencë të ndërmarrin më tepër rrezik duke mos u treguar të kujdesshme ndaj mënyrës se sa dhe si ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme për analizën paraprake, monitorimin dhe vlerësimin në vazhdimësi të aktivitetit kreditues. Procedurë që në periudhë afatgjatë do të ndikojnë në rënien e cilësisë së aktiveve dhe rrjedhimisht rënien e efikasitetit për shkak të kostove shtesë që sjell kjo rënie dhe monitorimi në vazhdim i saj. Rritja ekonomike është faktor i parëndësishëm, ashtu si edhe në efikasitet dhe kapitali. Kjo tregon se nuk mund të vërtetojmë hipotezën e "fatit të keq" që presupozon rritje të rrezikut që hasin bankat në rast. Kjo mungesë e rëndësisë statistikore mund të shpjegohet nga niveli i ulët i zhvillimit të vetë sistemit. Në këtë kontekst, është e mundur që rritja ekonomike dhe kapitali bankar të jenë pak të korreluar. Së fundmi, efekti i ROE është gjithashtu statistikisht i parëndësishëm.

Rezultatet e mësipërme ka gjasa të ndryshojnë nëse shtrirja kohore e kampionit zgjerohet, ose nëse variabla të tjera, specifike për secilën bankë në zgjedhje do të përfshiheshin në model. Për më tepër, rezultatet mund të jenë të ndjeshme ndaj vlerësuesit të ekuacioneve.

5.2 Kufizimet dhe studime në të ardhmen

Studimi i marrëdhënies ndërmjet ndërmarrjes së rrezikut, kapitalit dhe efijencës janë kryer për një periudhë kohore 5 vjeçare, 2014-2018. Mbshtetur në studime empirike në lidhje me këtë çështje, për bankat në Amerikë, Europë dhe vende të tjera të Azisë paneli i të dhënave është më i gjërë në kohë. Një shtrirje e tillë, për periudhën kur filloi derisa arriti kulmin përkeqësimi i cilësisë së aktiveve të bankave aktive në Shqipëri, jep mundësinë e një analize më të mirë të kësaj marrëdhënie dhe të efekteve ekonomike të tyre. Në këtë mënyrë sigurohet informacion mbështetës jo vetëm për politikën individuale, të bankave të veçanta, por edhe për autoritetet mbikqyrëse dhe rregullatore për sektorin bankar në Shqipëri.

Një pjesë e mirë e studimeve në këtë drejtim përfshijnë me tepër se sektorin bankar të një vend. Mendohet që në të ardhmen ky studim të përfshijë vendet e Rajonit me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e gjetjeve me ato të vendeve të tjera të Europës Lindore.

Në studimi i marrëdhënies ndërmjet ndërmarrjes së rrezikut, kapitalit dhe efijencës përfshihen si tregues të cilësisë së aktiveve huatë me probleme dhe aktivet e ponderuara me rrezik duke plotësuar dhe paraqitur më të plotë historikun huamarrës të bankave. Treguesi i huave me probleme përdoret për të vlerësuar qëndrimin që kanë mbajtur bankat ex-ante për të arritur në treguesin es-post dhe për të plotësuar informacionin që nuk është siguruar nga treguesi i aktiveve të peshara me rrezik. Kjo është një analizë që i mungon këtij studimi por që mund të kryhet në studime të ardhshme.

KAPITULLI 6: ANEKS

a. Tabela e aksionerëve dhe peshës specifike të bankave në sektorin bankar, dhjetor 2018

Tabela 5.2-1 Aksionerët dhe peshë specifike e secilës bankë në sistemin bankar, dhjetor 2018

Nr	Banka	Aksionerët	Pjesëma- rrja në kapitali (në %)	Pronësia	Origjina e kapitalit	Vendin i origjinës	Pesha specifike në sistemi bankar (në %)
1.	BANKA RAIFFEISEN SH.A.	15.5 Raiffeisen SEE Region Holding GmbH	100.00	Private	E huaj	Austri	15.5
2.	BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.	Çalik Finansal Hizmetler A.S.	100.00	Private	E huaj	Turqi	29.4
3	BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE SH.A.	Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)	86.7	Private	E huaj	Arabi Saudite	0.6
		Ithmaar Bank BS	4.63	Private	E huaj	Mbretëri e Bahreinit	
		Dallah Albaraka Holding	2.32	Private	E huaj	Arabi Saudite	
		Business Fokus SDN BHD	1.47	Private	E huaj	Malajzi	
		15 individë	4.3	Private	E huaj	Arabi Saudite	
		Saudi Brothers Commerce Co.	0.58	Private	E huaj	Arabi Saudite	
4	BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A	Intesa San Paolo S.p.A	100	Private	E huaj	Itali	11.8
5	BANKA E TIRANËS SH.A	Piraeus Bank SA	98.83	Private	E huaj	Greqi	4.9
		1 individ	1.17	Private	E huaj	Greqi	
6	BANKA ALPHA ALBANIA SH.A	Alpha Bank	100	Private	E huaj	Greqi	5.4
7	BANKA PROCREDIT SH.A	ProCredit Holding AG & CO, KgaA	100	Private	E huaj	Gjermani	2.3
8	BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A.	Financial Group ICB Holding	100	Private	E huaj	Zvicër	0.7
9	BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SH.A	TRANZIT sh.p.k	100	Private	Vendase	Shqipëri	5.2
10	BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.	Fauzi Al-Karafi	28.28	Private	E huaj	Kuvajt	0.1
		Loay J. M. A. Al. Kharafi	18.97	Private	E huaj	Kuvajt	
		Marzouq N.M.A. Al. Kharafi	6.2	Private	E huaj	Kuvajt	
		Bader N.M.A Al. Kharafi	6.2	Private	E huaj	Kuvajt	
		Faisal N.M.A Al. Kharafi	6.2	Private	E huaj	Kuvajt	
		11 individë	34.15	Private	E huaj	Kuvajt	

11	BANKA CREDINS SH.A.	B.F.S.E. Holding B.V.	16.49	Private	E huaj	Holandë	13.5
		Amryta Capital LLP	2.51	Private	E huaj	Britani e Madhe	
		Unioni Shqiptar Kursim Kredi	2.74	Private	Vendase	Shqipëri	
		EDRO sh.p.k	0.95	Private	Vendase	Shqipëri	
		A.F.C.	2.18	Private	Vendase	Shqipëri	
		AK - INVEST	0.95	Private	Vendase	Shqipëri	
		Prima sh.p.k	3.18	Private	Vendase	Shqipëri	
		Renis Tërshana	12.18	Private	Vendase	Shqipëri	
		Aleksandër Pilo	15.30	Private	Vendase	Shqipëri	
		39 individë	32.54	Private	Vendase	Shqipëri	
12	BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A	SOCIETE GENERALE	88.89	Private	E huaj	Francë	5.8
		7 individë	11.11	Private	Vendase	Shqipëri	
13	BANKA UNION SH.A	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)	10.12	Private	E huaj	Angli	3.5
		Unioni Financiar i Tiranës	86.37	Private	Vendase	Shqipëri	
		2 individë	3.54	Private	Vendase	Shqipëri	
14	BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A	First Investment Bank	100	Private	E huaj	Bullgari	1.7
	TOTALI	---	---	---	---	---	100

Burimi : Banka e Shqipërisë

b. Forma e sigurimit të depozitave që aplikohet në vende të ndryshme të botës

Sistemet e sigurimit të depozitave në botë

Në tabelën më poshtë, jepen informacione të mare nga të dhënat e Unionit Ndërkombëtar të Sigurimit të Depozitave: viti kur ka filluar aplikimi i skemës së depozitave për çdo vend; sistemi që aplikohet për këtë qëllim; nëse institucioni i autorizuar për këtë qëllim është i pavarur apo publik; numri i institucioneve të përfshira në skemën e sigurimit; shuma e siguruar e depozitave. Mbështetur tek të dhënat e Tabela

5.2-2, sistemi i sigurimit të depozitave ka filluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1933 dhe ka vijuar të shtrihet në shumë vende të tjera gjatë viteve '90. Në shumicën e vendeve, sigurimi i depozitave kryhet me ndërmjetësimin e një autoriteti të pavarur ose nga Bankat qendrore. Ndryshimi në limit e shumës së siguruar të depozitave sipas shteteve të ndryshme varet nga politikat e qeverive përkatëse si edhe nga fuqia ekonomike dhe investuese e tyre.

Tabela 5.2-2 Analizë strukturore e vendeve që aplikojnë sigurimin e depozitave

Vendi	Viti I prezantimit të skemës së sigurimit të depozitave	Tipi I Agjencive të Sigurimit të Depozitave (ASD)	Numri i institucioneve marrëse depozitash të siguruar nga ASD	Limiti I mbulimit në USD
Afghanistan	2009	Banka Qendrore	14	1,436
Albania	2002	E pavarur	22 ⁵⁴	22,502
Algeria	2003	E krijuar nga Shoqata e Bankave	27	17,181
Argentina	1995	E pavarur	73	24,260
Armenia	2005	E pavarur	17	20,657
Australia	2008	Mbikqyrja Bankare	104	195,000
Azerbaijan	2007	E pavarur	30	17,647
Bahamas	1999	E pavarur	11	50,000
Bahrain	2011	E pavarur	29	53,022
Bangladesh	1984	Banka Qendrore	57	1,210
Barbados	2007	E pavarur	12	12,500
Belarus	2008	E pavarur	24	
Belgium	1974	Ministria e Financave		120,482
Bermuda	2011	E pavarur	4	25,000
Bosnia and Herzegovina	2002	E pavarur	23	30,660
Brazil	1995	E krijuar nga Shoqata e Bankave	187	75,588
Brazil	2014	Banka Qendrore	779 ⁵⁵	75,577
British Virgin Islands	TBC	E pavarur	6	100,000
Brunei	2011	E pavarur	11	37,383
Bulgaria	1999	E pavarur	23	120,186
Canada	1967	E pavarur	82	79,713
Canada (Québec)	1967	Mbikqyrja Bankare	286	79,713
Canada (British Columbia)	1968	E pavarur	42	
Canada (Alberta)	1974	Mbikqyrja Bankare	21	Mbulim i plotë (garanci e depozitave dhe interesave 100%)
Canada (Manitoba)	1965	Mbikqyrja Bankare	29	
Canada (Neë Brunswick)	1994	E pavarur	10	199,283
Canada (Neëfoundland and Labrador)	1981	E pavarur	9	199,283
Canada (Nova Scotia)	1995	E pavarur	25	199,283

⁵⁴ 16 Commercial Banks and 6 Savings and Credit Associations

⁵⁵ 77 unione krediti; 2 kooperativa bankare

Scotia)				
Canada (Ontario)	1977	E pavarur	93	199,283
Canada (Prince Edëard Island)	1992	E pavarur	7	99,641
Canada (Saskatcheëan)	1953	E pavarur	44	
Afrika Qendrore	2011	Mbikqyrja Bankare	63 ⁵⁶	9,158
Chile	1986	Ministria e Financave	21	4,738
Chinese Taipei	1985	E pavarur	401	100,509
Colombia	1985	E pavarur	49	16,756
Colombia	1998	Ministria e Financave	185	6,702
Croatia	1995	E pavarur	30	119,623
Czech Republic	1994	E pavarur	32	120,020
Denmark	1987	Të tjera	145	120,019
Ecuador	2009	E pavarur	661	32,000
El Salvador	1999	E pavarur	23	10,227
Estonia	1998	E pavarur	9	120,019
Finland	1970	Të tjera	9	119,930
France	1980/1999	E pavarur	362	119,048
Georgia	2017	E pavarur	15	1,928
Germany	1976	E krijuar nga Shoqata e Bankave	154	20% e kapitalit të çdo banke-
Ghana	2016	E pavarur	587	1,389
Gibraltar	1998	E pavarur	11	120,000
Greece	1995	E pavarur	21	119,933
Guatemala	2002	Banka Qëndrore	17	2,723
Guernsey	2008	E pavarur	24	674,582
Honduras	2001	E pavarur	25	9,633
Hong Kong SAR	2004	E pavarur	151	63,988
Hungary	1993	E pavarur	45	119,828
Iceland	1999	E pavarur	8	
India	1962	E pavarur	2109	1,564
Indonesia	2004	E pavarur	1898	149,740
Iran	2013	E pavarur	38	27,721
Ireland	1995	Banka Qëndrore	297	119,048
Isle of Man	1991	Ministria e Financave	12	67,568
Italy	1987	E krijuar nga Shoqata e Bankave	173	119,990
Italy	1996	E krijuar nga Shoqata e Bankave	293	120,019
Jamaica	1998	E pavarur	11	4,800
Japan	1971	E pavarur	565	94,127
Japan	1973	E pavarur	787	94,127
Jersey	2009	E pavarur	19	
Jordan	2000	E pavarur	21	70,522
Kazakhstan	1999	E pavarur	30	30,091
Kenya	1985	E pavarur	13	969
Korea	1996	E pavarur	294	46,816
Korea	2004	E pavarur	898	46,816
Kosovo	2011	E pavarur	9	6,001
Kyrgyz Republic	2008	E pavarur	25	2,905
Lao PDR	1999	E pavarur	40	5,634
Lebanon	1967	E pavarur	69	3,500
Libya	2010	E pavarur	18	8,378
Liechtenstein	2001	E krijuar nga Shoqata e Bankave	14	100,000
Lithuania	1997	E pavarur	75	119,933
Luxembourg	1989/2015	E pavarur	108	116,158
Macao SAR	2012	E pavarur	27	62,098
Macedonia	1997	E pavarur	16	35,979
Malaysia	2005	E pavarur	43	61,782
Malta	2003	E pavarur	22	120,062
Mexico	1999	E pavarur	48	120,254
Mexico	2009	E pavarur	157	7,499
Mexico	2009	E pavarur	36	7,518
Moldova	2004	E pavarur	11	356
Mongolia	2013	E pavarur	14	8,240
Montenegro	2004	E pavarur	15	58,248
Morocco	1996/2015	E pavarur	16	8,000

⁵⁶ 52 banka and 11 institucione mikrofinanciare

Nepal	2010	E pavarur	89	2,727
Netherlands	1978/2015	Banka Qëndrore	36	120,019
Nicaragua	2001	E pavarur	7	10,000
Nigeria	1989	E pavarur	1072	1,637
NoRWAY	1961/2004	E krijuar nga Shoqata e Bankave	131	243,754
Oman	1995	Banka Qëndrore	17	52,016
Palestine	2013	E pavarur	15	20,000
Paraguay	2003	Banka Qëndrore	25	27,383
Peru	1991	E pavarur	43	30,092
Philippines	1963	E pavarur	587	10,014
Poland	1995	E pavarur	621	119,809
Portugal	1992	E pavarur	42	119,933
Portugal	1987	E pavarur	81	120,192
Romania	1996	E pavarur	28	119,740
Russian Federation	2004	E pavarur	781	24,306
RWAnda	2016	Banka Qëndrore	482	598
San Marino	2011	Banka Qëndrore	6	120,019
Serbia	1989	E pavarur	29	59,765
Singapore	2006	E pavarur	36	37,408
Slovenia	2001	Banka Qëndrore	14	120,482
South Africa	TBC			
Sri Lanka	2010	Banka Qëndrore	76	1,963
Sudan	1996	E pavarur	37	
Sëeden	1996	E pavarur	132	115,401
Sëitserland	2005	E pavarur	298	100,000
Tajikistan	2004	E pavarur	44	1,984
Tanzania	1991	Banka Qëndrore	59	669
Thailand	2008	E pavarur	35	456,660
Trinidad and Tobago	1986	E pavarur	24	55,444
Turkey	1983	E pavarur	39	26,512
Uganda	1994	E pavarur	33	822
Ukraine	1998	E pavarur	83	7,126
United Kingdom	2000	E pavarur	764	114,865
United States	1933	E pavarur	5679	250,000
United States	1970	E pavarur	5573	250,000
United States (Massachusetts)	1961	E pavarur	83	
Uruguay	2005	E pavarur	12	42,397
Uzbekistan	2002	E pavarur	26	
Vietnam	1999	E pavarur	1275	3,309
ëest African Monetary Union	2014	E pavarur	201	2,557
Yemen	2008	E pavarur	17	7,984
Zimbabëe	2003	E pavarur	25	1,000

Source: International Association of Deposit Insurers Official Ëeb Site, <https://ëëë.iadi.org/en/about-iadi/iadi-members-and-participants/hoë-to-join-iadi/> (15.06.2019); 2018 Annual Survey (as of year-end 2017)

c. Profili i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave⁵⁷

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (“Agjencia” ose “ASD”) është një institucion i pavarur i themeluar në vitin 2002. Ajo e ka nisur veprimtarinë e saj më 12 tetor 2002. Projektligji “Për sigurimin e depozitave” ka për qëllim kryesor të rregullojë sigurimin dhe kompensimin e depozitave duke mbrojtur interesat e depozituesve, si dhe për të

⁵⁷ ASD, Këshilli Drejtues: VENDIM Nr. 14, datë 31.05.2018 Mbi miratimin e Planit Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2018-2020

kontribuar në stabilitetin e sistemit bankar dhe financiar. Kuadri ligjor mbi bazën e të cilit ushtron aktivitetin e saj dhe ndryshimet e tij në kohë si në tablën më poshtë.

Tabela 5.2-3 Kronologjia e kuadrit ligjor të ASD

ligji nr. 8873	29 mars 2002	“Për sigurimin e depozitave”
ligji nr. 10106	30 mars 2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”
ligji nr.78/2012	26 korrik 2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar
ligji nr. 53/2014	22 maj 2014	"Për sigurimin e depozitave" (nga muaji korrik i vitit 2014)
ligji nr. 39/2016	03 maj 2016	“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.53/2014 “Për sigurimin e depozitave””.
ligji nr. 132/2016	03.05.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar

Agjencia i raporton Bankës së Shqipërisë (“Autoriteti Mbikëqyrës”), Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. ASD-ja është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave dhe e Forumit European të Siguruesve të Depozitave. Agjencia është themeluar me qëllim sigurimin dhe kompensimin e depozitave në bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit (“SHKK -të”) që operojnë në Shqipëri. Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave është i detyrueshëm për të gjitha institucionet e licencuar nga Banka e Shqipërisë që mbledhin depozita. Bazuar në ligjin për sigurimin e depozitave, ligji nr. 132/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar agjencia siguron dhe kompenson deri në 2,500,000 Lek depozituesit në çdo bankë anëtare të skemës së sigurimit. Njëkohësisht, Agjencia siguron dhe kompenson deri në 2,000,000 Lek depozituesit anëtarë në çdo shoqëri kursim-krediti anëtare e skemës së

sigurimit. Agjencia ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të ligji për sigurimin e depozitave. Në veçanti, por jo vetëm, Agjencia anëtarëson dhe përjashton subjektet në skemë; verifikon të dhënat e raportuara periodikisht nga subjektet anëtare; kryen verifikimetë plota dhe të pjesshme në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave në subjektet anëtare; zhvillon veprimtari për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për skemën e sigurimit të depozitave; kompenson depozitat, sipas dispozitave të këtij ligji; arkëton kontributet fillestare, primet e sigurimit, dhe kontributet e jashtëzakonshme; dhe investon mjetet financiare, sipas dispozitave të këtij ligji. Me ligjin nr.133/2016 datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar në kuadër të paketës ligjore të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Shqipëri, me autoritet përgjegjës Bankën e Shqipërisë në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Agjencisë i janë ngarkuar edhe detyra të tjera shtesë. Në këtë ligj, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave i janë caktuar kompetenca për administrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, fond i cili përbëhet nga kontributet e bankave dhe përdoret sipas dispozitave ligjore në rastet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Figure 6-1




Figure 6-2 Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto




Figure 6-3 ROE




Figure 6-4 Marzhi i interesit neto




Figure 6-5 Të ardhura neto nga interesi





Figure 6-6 Krahاسimi i ecurisё sё shpenzimeve dhe tё ardhurave



LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

1. Aggarwal, R. and K. Jacques (1998): A simultaneous equation estimation of the impact of prompt corrective action on bank capital and risk. Paper presented at the Conference on the Future of Capital in New York, February 1998.
2. Aggarwal, R., K.T. Jacques (1998), Assessing the impact of prompt corrective action on bank capital and risk, *Federal Reserve bank of New York Policy Review*, October, 23-31.
3. Albertazzi, U., Marchetti, D.J. (2010). Credit Supply, Flight to Quality and Evergreening: An Analysis of Bank-Firm Relationships after Lehman Bank of Italy, *Working Paper* No. 756
4. Altunbas, Y., Carbo, S., Gardener, E.P.M & Molineux, P. (2007). Examining the relationship between capita, risk and efficiency in European banking. *European Financial Management*, 13(1), 49-70.
5. Altunbas, Yener , Lynne Evans and Phil Molyneux (2001), Ownership and Efficiency in Banking, *Journal of Money, Credit and Banking* , 33, 4, November, 926-954
6. Anderson, R.C., Fraser, D.R. (2000). Corporate control, bank risk-taking, and the health of the banking industry. *Journal of Banking and Finance* 24, 1383–1398.
7. Avery, R. B., A. B. Berger (1991): Risk-based capital and deposit insurance reform. *Journal of Banking and Finance* 15 (1991) 847-874.
8. Baltensperger, E. and H. Milde (1987): *Theorie des Bankverhaltens*. Springer-Verlag, Berlin, Heidelberg 1987.
9. Bank of Albania, 2006-2015. Supervision Annual reports 2005-2014 [Online] Available:
http://www.bankofalbania.org/web/supervision_report_new_2614_2.php
10. Bank of Albania, 2006-2015. Supervision Annual reports 2005-2014 [Online] Available:
http://www.bankofalbania.org/web/supervision_report_new_2614_2.php

11. Bank of Albania, 2013. Regulation “On Capital Adequacy Ratio”. [Online]
Available:
http://www.bankofalbania.org/web/rules_and_regulations_2799_2.php
12. Bank of Albania, 2013. Regulation “On Capital Adequacy Ratio”. [Online]
Available:
http://www.bankofalbania.org/web/rules_and_regulations_2799_2.php
13. Bank of Albania, 2013-2014. Annual Reports [Online] Available:
http://www.bankofalbania.org/web/Annual_Report_new_2611_2.php
14. Bank of Albania, 2013-2014. Annual Reports [Online] Available:
http://www.bankofalbania.org/web/Annual_Report_new_2611_2.php
15. Bank of Albania, 2015. Regulation “On the Bank’s Regulatory Capital” [Online]
Available:
http://www.bankofalbania.org/web/rules_and_regulations_2799_2.php
16. Bank of Albania, 2015. Regulation “On the Bank’s Regulatory Capital” [Online]
Available:
http://www.bankofalbania.org/web/rules_and_regulations_2799_2.php
17. Banka e Shqipërisë, 2018 raporti vjetor i mbikqyrjes raporti i stabilitetit 6M2 2018
18. BANKA E SHQIPËRISË, Deklarata e Stabilitetit Financiar për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2018
19. Basel Committee on Banking Supervision (1999): Capital requirements and bank behaviour: The impact of the Basel Accord. Basel Committee on Banking Supervision working paper no.1, April 1999.
20. Beaver, W., C. Eger, S. Ryan, and M. Wolfson (1989): Financial reporting, supplemental disclosures, and bank share prices. *Journal of Accounting Research* 27 (1989) 157-178.
21. Bennink, H. A. and G. J. Benston, (2000), The future of banking regulation in developed countries: lessons from and for Europe, *mimeo*.
22. Benston, G., Eisenbeis, R., Horvitz, P., Kane, E., & Kaufman G. (1986). *Perspectives on safe and sound banking: Past, Present, and future*. MIT Press, Cambridge 1986.

23. Berger, A. N. (1995), The relationship between capital and earnings in banking, *Journal of Money, Credit, and Banking*, 27, 432-456.
24. Berger, A. N., Herring, R.J. and G.P. Szego (1995), The role of capital in financial institutions, *Journal of Banking and Finance*, 19, 393-430.
25. Berger, A.N. and R. De Young (1997), Problem loans and cost efficiency in commercial banking, *Journal of Banking and Finance*, 21, 849-870.
26. Bernake, B.S., & Lown, C.S., (1991). The credit crunch. *Brookings Papers on Economic Activity* 2, 205-247.
27. Besanko, D. and G. Kanatas (1996): The regulation of bank capital: Do capital standards promote bank safety? *Journal of Financial Intermediation* 5 (1996) 160-183.
28. Bhattacharya, S., A. W. A. Boot, and A. V. Thakor (1998): The economics of bank regulation. *Journal of Money, Credit, and Banking* 30 (1998) 745-770.
29. Black, F., M. H. Miller, and R. A. Posner (1978): An approach to the regulation of bank holding companies. *Journal of Finance* 51 (1978) 379-412.
30. Board of Governors of the Federal Reserve System (1999): Using subordinated debt as an instrument of market discipline. Report of a study group on subordinated notes and debentures. Staff Study no. 172, December.
31. Boot, A. and S. I. Greenbaum (1993): Bank regulation, reputation, and rents: Theory and policy implications. In *Capital Markets and Financial Intermediation*, edited by C. Mayer and X. Vives. Cambridge University Press, 1993.
32. Boot, A. W. A., Dezelan, S. and Milbourn, T. T., 'Regulatory distortions in a competitive financial services industry', *Journal of Financial Services Research*, Vol. 16 (2 and 3), 1999, pp. 249-59.
33. Buser, S., A. Chen, and E. Kane (1981): Federal deposit insurance, regulatory policy, and optimal bank capital. *Journal of Finance* 36 (1981) 51-60.
34. Calem, P. S. and R. Rob (1996): The impact of capital-based regulation on bank risk-taking: A dynamic model. Board of Governors of the Federal Reserve System, Finance and Economics Discussion Series 96, no. 12, 36

35. Calomiris, C.W. and C.M. Kahn (1991), The role of demandable debt in structuring
36. Cebenoyan, A.Sinan, Elizabeth S. Cooperman, Charles A. Register and Sylvia Hudgkins (1993). The relative efficiency of stock versus mutual S & Ls: A stochastic frontier approach. *Journal of Financial Services Research* 7, 151-170
37. Chessen, J. (1987): Capital comes to the fore. Issues in Bank Regulation, Spring 1987.
38. Cornett, M. M. and H. Tehranian (1994): An examination of voluntary versus involuntary security issuances by commercial banks. *Journal of Financial Economics* 35 (1994) 99-122
39. DeAngelo, H. and R. W. Masulis (1980): Optimal capital structure under corporate and personal taxation. *Journal of Financial Economics* 8 (1980) 3-29.
40. Demirgüç-Kunt, A. and E. Detragiache (2000): Does deposit insurance increase banking system stability? An empirical investigation. IMF working paper WP/00/03.
41. Dewatripont, M. and J. Tirole (1994): The prudential regulation of banks. MIT Press, Cambridge.
42. Diamond, D. W. and P. H. Dybvig (1986): Banking theory, deposit insurance, and bank capital regulation. *Journal of Business* 59 (1986) 55-67.
43. Diamond, D. W. and R. Rajan (2000): A theory of bank capital. *Journal of Finance* 6 (2000) 2431-2465.
44. Dothan, U. and J. Williams (1980): Banks, bankruptcy and public regulation. *Journal of Banking and Finance* 4 (1980) 65-88.
45. Duran, M.A. and Lozano-Vivas, A. (2015), *Moral Hazard and the Financial Structure of Banks*, *Journal of International Financial Markets, Institutions and Money*, Vol. 34, pp. 28–40, available at: www.sciencedirect.com/science/article/pii/S1042443114001231 (17.05. 2016).
46. Editz, T., I. & Perraudin, W., (1998). The impact of capital requirements on U.K bank behaviour'. *Reserve bank of New York Policy Review*, vol.4 (3) 1998 pp15-22

47. Ediz, T., I. Michael, and W. Perraudin (1998): Bank capital dynamics and regulatory policy. Paper presented at the Conference on the Future of Capital in New York, February 1998.
48. Evanoff, D. D. and L. D. Wall (2000): Subordinated debt and bank capital reform. Federal Reserve Banks of Atlanta Working Paper 2000-24, November.
49. Fama, Eugene and Michael C. Jensen (1983), Separations of ownership and control,
50. Fama, Eugene. (1980), Agency problems and the theory of the firm. *Journal of Political Economy*, 28 , 288-307.
51. Fiordelisi, F. & Marquez-Ibanez, D. and Molyneux, P. (2011). Efficiency and risk in European banking. *Journal of Banking and Finance*, Elsevier, vol. 35(5): 1315-1326
52. Flannery, M. J. (1991): Pricing deposit insurance when the insurer measures bank risk with an error. *Journal of Banking and Finance* 15 (1991) 975-998.
53. Freixas, X. and Gabillon, E., ‘Optimal regulation of a fully insured deposit banking system’, *Journal of Regulatory Economics*, Vol. 16 (2), 1999, pp. 111–34.
54. Freixas, X. and J. Rochet (1997), *Microeconomics of Banking*, MIT press, Cambridge.
55. Freixas, X. and J.-C. Rochet (1997): *Microeconomics of banking*. MIT Press, Cambridge, Mass.
56. Furfine, C. (2000): Evidence on the response of US banks to changes in capital requirements. BIS working paper no. 88, June 2000.
57. Furlong, F. T. and M. C. Keeley (1989): Capital regulation and bank risk-taking: A note. *Journal of Banking and Finance* 13 (1989) 883-891.
58. Furlong, R. (1988): Changes in bank risk-taking. *Federal Reserve Bank of San Francisco Economic Review*. Spring 45-56.
59. Galai, D. and R. Masulis (1976): The option pricing model and the risk factor of stock. *Journal of Financial Economics* 3 (1976) 53-81.

60. Gambacorta, L., & Mistrulli, P.E. (2004). Does bank capital affect lending behavior? *Journal of Financial Intermediation* 13, 436-457.
61. Gennotte, G. and D. Pyle (1991): Capital controls and bank risk. *Journal of Banking and Finance* 15 (1991) 805-824.
62. Giammarino, R., T. Lewis and D. Sappington (1993): An incentive approach to banking regulation. *Journal of Finance* 48 (1993) 1523-1542.
63. Goddard, J., Molyneux, P. And Wilson, J., (2001). *European Banking – Efficiency, Technology and Growth*. London Wiley, 2001
64. Goddard, John, Philip Molyneux and John Wilson (2001), *European Banking - Efficiency*,
65. Gorton, G, & Rosen, R., (1995). Corporate control, portfolio choice and the decline of banking. *Journal of Finance*. Vol. 50 (5), 1995, pp.1377-1420.
66. Gorton, G. and R. Rosen (1995), Corporate control, portfolio choice and the decline of banking, *Journal of Finance*, 50, 1377-1420.
67. Green, R. C. (1984): Investment incentives, debt, and warrants. *Journal of Financial Economics* 12 (1984) 115-136
68. Gropp, R. and J. Vesala (2001): Deposit insurance and moral hazard: Does the counterfactual matter? ECB working paper no.47, March 2001.
69. Hughes J.P. and L. Mester (1997), Bank Capitalization and Cost: Evidence of Scale Economies in Risk management and Signalling, *Review of Economics and Statistics*, 314-325.
70. Hughes, J. P. and Mester, L., ‘Bank capitalization and cost: evidence of scale economies in risk management and signalling, *Review of Economics and Statistics*, Vol. 80 (2), 1998,
71. Hughes, J.P, C. Moon (1995), Measuring bank efficiency when managers trade return for reduced risk, *Department of Economics Rutgers University, Working Paper*.
72. Jensen M.C., & Meckling, W.H., (1976). Theory of the firm: Managerial behavior, agency costs and ownership structure. *Journal of Financial Economics* 3 (1976), 305-360 *Journal of Law and Economics*, 26, 301-326.

73. Kane, E., (1989). The S&L insurance crisis: How did it happen? Washington, DC: Urban Institute Press
74. Keeley, M.C. (1990). Deposit insurance, risk, and market power in banking. *American Economic Review* 80 (1990) 1183-1200
75. Kishan, R., & Opiela, T., (2000). Bank size, bank capital, and bank lending channel. *Journal of Money, credit and banking* 32(1), 129-141
76. Koehn, M., & Santomero A.M., (1980). Regulation of bank capital and portfolio risk. *Journal of finance* 35 (1980), 1235-1244.
77. Kwan, S. And Eisenbeir, R., (1997) Bank risk, capitalization and operating efficiency. *Journal of Banking and Finance*, Vol.12 (2 and 3), 1997, pp.117-31
78. Matten, C. (1996). Managing Bank Capital: capital allocation and performance measurement. (2nd ed.) Chichester: Wiley
79. Mayne, L. S., (1972). Supervisory influence on bank capital. *Journal of Finance*, Vol.27 (3), 1972, pp 637-51
80. Merton, R.C., (1977). An analytic derivation of the cost of deposit insurance loan guarantees. *Journal of Banking and Finance* 1 (1977), 3-11.
81. Miles, D., Yang, J., & Marcheggiano, G. (2012). Optimal bank capital. *The Economic Journal* 123, 1-37.
82. Modigliani, F., & Merton H.M., (1958). The cost of capital, corporation finance and the theory of investment. *The American Economic Review*, 261-297.
83. optimal banking arrangements, *American Economic Review* 81, 497-513.
84. Peltzman, S., (1970) : Capital investment in commercial banking and its relationship to portfolio regulation. *Journal of Political Economy*, Vol.78 (1), 1970, pp1-26.
85. Ross, S.A. (1977): The determination of financial structure: The incentive-signaling approach. *Bell Journal of Economics* 8 (1977) 23-40.
86. Santos, J. A.C., (1999). Bank capital and equity investment regulations. *Journal of Banking and Finance* 23, 1095-1120.
87. Saunders, A., Strock, E., & Travlos, N.G. (1990). Ownership structure, deregulation, and bank risk taking. *Journal of Finance* 45 (1990), 643-654.

88. Shrives, R.E., & Dahl, D., (1995). The relationship between risk and capital in commercial banks. *Journal of Banking and Finance*, Vol. 16 (2), 1992, pp.439-57.
89. *Technology and Growth*, Wiley: London
90. Woo, D., (2003). In search of “capital crunch”: Supply factors behind the credit slow down in Japan. *Journal of Money, Credit and Banking* 35(6), 1019-1038.